

**MJEKIMI I CIRROZAVE HEPATIKE ME KORTIKOSTEROIDE TE KOMBINUAR OSE
JO ME SPIROLAKTON DHE DIURETIKE TIAZINKE.**

DOCENT JOSIF E. ADHAMU

(Katedra e Terapisë së Fakultetit-Shef i katedrës J. E. Adhami)

Me gjithë përparrimet e dukeshme që janë bërë gjatë këtyre viteve të fundit, cirroza hepatike vazhdon të mbetet sëmundje me prognozë shumë të rëndë, e cila shpejt a vonë shpët drejt zhvillimit të ascitit dhe edemave, drejt çfaqjes së insuficencës së rëndë të këtij organi, hemorragjive di-gjestive ose komës hepatike vdekjeprurëse.

Të nisur nga të dhënat e literaturës dhe të bazuar mbi faktin se cirroza përsaqëson një fazë të avancuar të proceseve inflamatorë ose distrofike kronike, të cilat shpët drejt sklerozës së organit, ne ndodhemi përparrë një situate të tilë ku jo vetëm ndalimi ose ngadalësimi i evolucionit të procesit cirrotik, por edhe përmirësimi ose stabilizimi klinik, përbëjnë një sukses në mjekimin e kësaj sëmundjeje.

Për këtë qëllim një rol të rëndësishëm lozin preparatë kortikosteroide, përdorimi i të cive filloj që atëherë kur Cattan R. dhe Vesin P., të bazuar mbi rezultatet që patën nga kozponzioni Zoekler S.J. dhe Hegstrom G.J. (1953), treguan veprimin e delta kortizonit në metabolizmin e ujit dhe të natriumit. Ky veprim, simbas Cachin M. e b.p., u konfirmua nga një seri autorësh të tjera si Bickel, Bariety dhe b. p., Vachon dhe Lambert, Linquette etj.

Sot është e njojur se nën veprimin e kortizonikëve favorizohet proteinogeneza, vecantërisht shtohen albuminat e heparit e të plazmës dhe si rrjetim i ritet presioni onkotik, gjë që pengon çfaqjen e ascitit dhe edemave. Veç kësaj delta-kortizonikët pakësojnë permeabilitetin kapilar, rititet diurezën hidrike dhe natriurinë, duke shtuar filtrimin glomerular dhe duke inhibuar reabsorbimin tubular të ujit e të natriumit me anën e një veprimi direkt mbi sistemin enzimatik tubular. Si pasojë ulet presioni hidrostistik, rititet volumi i plazmës qarkullonjëse dhe ndofta për këtë arësy, inhibohet sekretimi i aldosteronit. Kortizonikët kanë një veprim antifibroblastik, antiinflamator, stimulojnë proceset e glukoneogjenezës, favorizojnë glikogjenopeksinë hepatike, marrin pjesë në metabolismin e celulës hepatike dhe zgjedhjanë stazën biliare intrahepatike, duke vepruar mbi procesin inflamator që blokon kanalin e Herring gjatë dajes nga lobuli.


Nga të dhënat e para të literaturës mbi mjekimin e cirrozave me kortikosteroide, vlefja e përmënden punimet e vitit 1957 të Cattan R. dhe Vesin P., Boulet P. dhe b.p., Cachin M. dhe b. p., De Gennes L. dhe b. p., Lamache A. dhe b. p., etj.

Që atëherë kortizonikët filluan të përdoren më gjërësisht në mjekimin e cirrozave.

Në një punim të vitit 1959, ne kemi vënë në dukje rezultatet e para të mjekimit me delta-korteni në 8 cirrotikë të dekompensuar të mjekuar në klinikën tonë gjatë viteve 1958 dhe pjesërisht 1959. Sot do të përpinqemi të jepim një pasqyrë të shkurtër mbi mjekimin e 109 rasteve me forma të ndryshme cirrozash hepatike.

Ky material i përket periodës 1958., deri në tetor 1964. Të ndarë sipas vitit të shtrimit në klinikë, kemi:

| Viti | 1958 | 1959 | 1960 | 1961 | 1962 | 1963 | 1964 | Shuma |
|---------------|------|------|------|------|------|------|------|-------|
| Nr. i rasteve | 2 | 8 | 12 | 15 | 14 | 29 | 29 | 109 |



Përsa i përket sekshit, 60 ishin meskuj dhe 49 femra.

Lidhur me moshën e të sëmurëve tanë, mund të themi se ekziston një shpërndarje shumë a pak uniforme që nga 21 deri në 70 vjeç, me një ulje të rasteve në dy ekstremit, d.m.th. 20 vjeç e poshtë dhe mbi 70 vjeç.

Kjo gjë duket qartë në pasqyrën e mëposhtëm:

CIRROTIKET E MOJEKUAR ME
KORTIKOSTEROON SIPAS VITIT
TE SHTREMIT

| Moshë | 20 e poshtë | 21-30 | 31-40 | 41-50 | 51-60 | 61-70 | Mbi 70 | Shuma |
|---------------|-------------|-------|-------|-------|-------|-------|--------|-------|
| Nr. i rasteve | 5 | 24 | 21 | 18 | 21 | 17 | 3 | 109 |


Nga 109 rastet, 30 i përkisnin cirrozes atrofike të tipit Laennec të dekompenuar, 18 ishin cirroza splenomegalike, 22 i cilit gjatë evolucionit të tyre në mënyrë sekondare kishin shpërë në atrofi të heparit dhe në dekompensim, duke marrë pamjen e formës Laennec. 41 qenë sindrome hepatobiliale, prej të cilëve 22 të kompenuar, kurse 19 të dekompenuar, me ascites, por megjithatë hepari ishte akomë i rritur d.m.th. qenë cirroza hepatosplenomegalike. 15 të sëmurë të tjerë vuanin nga Morbus Banti, prej të cilëve 1 në stadi i parë, 2 në të dytin, 9 qenë të dekompenuar dhe i përkisnin stadi të tretë, kurse 3 të fundit qenë dekompenuar mbas splenektomisë.

Dy paciente paraqitin një cirrozë hepatomegalike. Njëri prej tyre burri 56 vjeç nga Fieri, rezultonte se në anamnezë kishte kaluar malarje. Kur u shtrua në klinikë ishte në gjendje të rëndë me ascites, edeme dhe hidrotoraks bilateral. Ekzaminimi i likuidit ascitit tregonte se densiteti ishte 1011, gjë që fliste në favor të transudatit, por mbjellja në teren Löwenstein dhe Šula për B.K. ishte pozitive. Versamenti pleural e kishte peshën specifike 1015, ndërsa mbjellja për B.K. që negative. Natyrishët që para një rasti të tillë nuk mund të mohohet roli i infeksionit tuberkular mbi heparin, por nga ana tjetër duhet përmendur se ka dhe raste kur asciti i cirrotikëve të infektohen në mënyrë sekondare nga turbekulozi, për shkak të rezistencës së ulët që paraqitin këta pacientë.

Rasti i dyti që një grua 51 vjeç, e cila kishte kaluar malarjen dbe para 2 vjeç *morbus Botkin*.

Në dy të sëmurë të tjerë që fjala për cirrozë biliare sekondare të çsaqur mbas kohës së komisë. Vien të përmëndet njëri prej tyre Jonuz R. vjeç 28, të cilin gjatë ndëshkimit gjikale iu konstatua cirroza biliare, por menjëherë mbas saj ra në gjendje të lëkuar dhe iu çfaq asciti; në gjendje të dekompenuar u transferua nga kirurgjia në klinikën tonë në tetor 1962. Prej këtë del qartë roli që lot narkoza dhe vetë ndëshyrja kirurgjikale në dekompensimin e cirrozave të stabilizuara ose latente. Rasti i fundit i përket sindromit Cruveilhier Baumgarten me splenomegalji deri afér umbilikosit, kurso hepari kishte filluar të atrofizohet dhe nuk prekej lobi i djathtë, ndërsa i majti 3-4 cm, nën *processus xiphoides*. Në regjionin epigastrik dukej një garkullim venoz shumë i theksuar që ngjitej deri mbi sternum; sipër tij ndëgjoi një zhurmë venoze e vazhdështme dbe prakej një *thrill*.

Duke analizuar të dhënat anamnesticë të pacientëve tanë, konstatuan se 48 veta ose 44% të rasteve kishin kaluar malarien, 24 veta ose 22% *Morbus Botkin*, një prej këtyre të fundit të rasteve kishin kaluar më shumë se 10 vjet. Duke analizuar të dhënat anamnesticë të pacientëve tanë, konstatuan se 48 veta ose 44% të rasteve kishin kaluar më shumë se 10 vjet. Duke analizuar të dhënat anamnesticë të pacientëve tanë, konstatuan se 48 veta ose 44% të rasteve kishin kaluar më shumë se 10 vjet.



CIRROTIKET E MOJEKUAR ME KORTIKOSEROIDE NDARE SIMBAS GRUP MO/HAVE

të sëmurrë ose 19,26% të rasteve përdorin alkoolin, 8 veta ose afro 7,34% kishin antecedente tuberkulare, 3 kishin bëri splenektomi, 2 kolecistekomi, 1 kishte kaluar brucelozë, një ndodhjej nën mjekimin e dispanjerisë dermatoveneriane për lues. Një i sëmurrë tjetër, nuk kishte të dhëna klinike ose anamnestike për lues, megjithatë reaksionet serologjike i dëlin pozitive. Por siç dihet, ka raste kur në cirotikët këto reaksione mund të janë pozitive, pa qënë i sëmuri fuetik.

Në disa nga këta të sëmurrë janë gjetur dy ose më shumë faktorë etiologjikë të kombinuar prandaj është vështirë tia atribuohet shkakëtimin e cirrozes vetëm njërit prej tyre. Këshlu 7 veta kishin kaluar malarije dhe Botkin, 6 malarie, Botkin dhe përdorin alkool. Duke qenë se malarien e kanë kaluar disa vjet më parë, të krijohet përshtypja sikur cirroza splenomegalike është zhvilluar që në atë kohë, kurse çfaqja e hepatitit viral ka dhëna goditjen e fundit dhe e ka transformuar këtë chroze latente në të dekompenzuar.

Fshëri e vërtotë se në disa raste mund të mos ketë qëndrueshme përmes fjalës *marbus Botkii*, por për ikterin e alarmit të cirrozes, i cili gabimisht është interpretuar si hepatit infektiv. Por nga ana tjetër nuk mund të mos heshet që fakti, që një pjesë e këtyre hepatiteve zhvillohen pa ikte. Sidoqoftë duke analizuar materialin tonë, ne na krijohet përshtypja sikur roli i malariës në etiologjinë e cirrozeve, megjithëse akoma shumë i lartë, ka tendencë për tu ulur, ndërsa ai i hepatitit viralus ndodhet në ngritje e sipër, kështu që brenda një kohe relativisht të shkurtër, ne do të ndodhemi para një fakti kur kurbat e këtyre dy sëmundjeve do të kryqëzoohen njëra me tjeterin.

Këtë pikpamje ne e çfaqim mbasi kemi bërë një krahasin midis materialit të sotshëm dhe një punimi tjetër të bërë në klinikën tonë në vitin 1958, ku nga 198 cirrotilë të shtruar në Spitalin Nr. 1 gjatë pesëvjeçarit 1950-1954, konsistuan se nga 89 raste që kishin të dhëna etiologjike në anamnezë, 50 ose 56,2% të rasteve kishin kaluar malarien, kurse vetëm 8 ose 9% e tyre kishin të dhëna anamnestike për hepatit infektiv.

Edhe në vëndet e tjera, vitet e fundit vihet re një ngritje e rasteve me M. Botkin në anamnezë.

Për këtë rajafton të kujtojmë se në regjionin e Puglia-s në Itali që është i afërt me vëndin tonë, Albano O. dhe b.p. (1963) nga 103 cirrotikë që kanë studuar, kanë gjetur një mbizotërim të hepatitit infektiv në anamnezë; këshlu 44 pacientë kishin kaluar këtë sëmundje, kurse 26 malarijen.

Sidoqoftë, pesha specifike e malariës vezhdon të jetë e lartë edhe në disa zona ku valët e hepatitit infektiv janë çfaqur shumë vjet më parë se sa në vëndin tonë. Këshlu Muskin A.S. dhe Poliak E. I. (1959), nga 70 raste cirrozash të shtruar në spitalet e Tashkentit, 25 kishin kaluar malarijen, kurse 20 *marbus Botkii*.

Nga të sëmurrë e tjera të kontigjentit tonë, 6 kishin kaluar malarie dhe përdorin alkool, 2 Botkin dhe pinin alkool, 1 malarie dhe kolecistekomi, 1 malarie dhe lues dhe i fundit malarije tuberkulos dhe brucelozë.

48 veta ose 44% e rasteve, paraqitnin ascit në anamnezë, kurse gjatë shtrimit asciti u konstatua në 82 vjet 75,2%.

Në 45 të sëmurrë qarkullimi kolateral ishte i dukeshëm mirë, kurse në 7 raste sasia e likuidit ascitit ishte aq e theksuar sa shkaktonte hernie umbilikale. 33 pacientë ose 30,27% kishin edeme të anësive të poshtme, prej të cilëve një kishte *anasarca*, kurse tjetri edeme të regjionit lumbo-sakral.

29 të sëmurrë ose 26,6% të rastevë kishin hidrotoraks uni ose bilateral.

Për hidrotorask flasin ëdhe Poinsu R. dhe Chanas P. (1958).


Nga 29 rastet tonë, 9 ose 31% e kishin likuidin në të djathtë, 6 ose 20,7% në të majtë, kurse 14 ose afro 48,3% bilateral. Vlen të shënohet se shpesh herë hidrotoraksi nuk vitet në dukje as gjatë ekzaminimit radiologjik. Këshlu në 4 nga pacientëtanë skopia e toraksit ishte negative, kurse në autopsi u gjend hidrotoraks bilateral.

30 nga të sëmurrë tanë paragjinën subikter gjatë shtrimit, kurse 9 ikter, ndërsa një tjetri ikteri ju çfaq gjatë mjejkimit.

Dieta që kemi përdorur në të sëmurrëtanë, ka qënë shumë a pak e ckuilivuar duke përmbyllur proteinëna shatazore në formë gjizë të freskët, misli të zjarrë dhe e dekloruar.

Nga preparatet kortikosteroide kemi përdorur delta kortenin *per os* në 103 të sëmurrë, duke e filuar mazatarisht me 40 ose 30 mg/ditën, e duke e ulor gradualisht. Në raste të rralla e kemi zvërvendosur me ultra kortenol intramuscular ose intravenos. Dozat totale të delta kortenit kanë qënë: ndër 500 mg, 44 veta, 501-1000 mg, 38 raste, 1001-1500 mg, 17 të tjerë, 1501-2000 mg, 8 të sëmurrë dhe mbi 2000 mg, vetëm një person.

Një pacient është mjekuar vetëm me ACTH, kurse në 40 të tjerë delta korteni është kombinuar



DOZAT TOTALE TE DELTA KORTENT
NE 103 CIRROTIKE

me këtë preparat. Nga këta 37 të sëmurrë kanë marrë ndërën 250 U ACTH, gjë që tregon se në shumicën dërmnjëse të rasteve, ky preparat është përdorur me doza të vogla vetëm për të stimuluar suprarenalen, sidomos gjalë uljes së fundit të dozave të delta kortenit. Në 2 të sëmurrë sasia e ACTH ka qënë midis 251-500 U, kurse në dy të fundit midis 501 dhe 750 U.

Gjatë përdorimit të preparateve kortikosteroidë, jemi kufizuar në dhënien e dozave të vogla në 9 veta, të cilat kanë patur hemoragji digestive në anamnezën e tyre. Nga këta 3 *hematemesis*, 5 *melena* dhe 1 të kombinuar: *hematemesis* dhe *melena*.

Në 43 të sëmurrë osë 39,45% të rasteve, kortikoferapinë e kemi shoqëruar me transfuzionë plazme. Këshiu 16 veta kanë marrë më pak se 600 cc, 14 të sëmurrë midis 601-1200 cc, kurse 13 më tepër se 1200 cc.

Përdorimi i plazmës lufton hipovolemisë që paraqitën këta të sëmurrë, veçanërisht në ato formë të dekompenzuara ku koeficienti albumina-globulina është ulja shumë. Veprimi i plazmës është i dysfishtë, qoftë direkt duke shuar masën qarkullonjëse, qoftë indirekt sepse me shthinjin e albuminave të gjakut, rritet presioni onkotik dhe likuidet kalojnë nga indet në qarkullin.

Vçë kësaj luftimi i hipovolemisë pakësion prodhimin e aidosferonit.

Në 12 pacientë, veçanërisht në raste komplikacionesh hemoragjike, kemi bërë transfusion gjakut.

Është mirë që në burra, veçanërisht kur kortizonikët përdoren për kohë të gjatë, kohë mbas kohës përvëç ACTH-it të bëhet testosteron. Jo vetëm kajë, por disa autorë sikurse Girolani M. (1956) rekomandojnë përdorimin e dozave të mëdha të propionatit të testosteronit me 100 mg. ditën. Doza të tilla kemi përdorur ëdhe në në 13 të sëmurrë të këtij kontigjentit me rezultate të kënaqëshme.

Në 20 të sëmurrë preparatet hormonale janë kombinuar me kloriazid 1,5 gr. ditën duke e shoqëruar me *kalii chlorat* 3 gr. ditën, mbasi ky preparat mund të gjotë nga hipokalemia e thijeshë deri në komën e elektroliktikë. Në 23 raste kloriazidi është zëvendësuar me hidrokloriazid 150 mg/ ditën. Ky ka vetinë që eliminon më pak kalumin nga organizmi. Të dy këta preparate janë dhënë me ndërpërje 3 ditë po, 4-5 pushim.

Gjatë përdorimit të preparateve tiazinikë duhet kujdes i veçantë, mbasi mund të ngjasin turbullime të amoniogjenezës dhe urogjenezës, të cilat shpilen në hiperamoniemi, encefalopati portokavë dhe komë hepatike.

Kombinimi i kortikosteroidave me diuretikë tiazinikë, bëa që të rritet diureza akoma më tepër dhe faverizon tharjen e shpejtë të versamenti evë në kavitetet serozë.

Që në vitin 1963, delta kortenin e kemi shoqëruar me spirolakton «SC 9429» i njohur ne enrin aldakton, në 26 të sëmurrë të këtij kontigjentit. Dozat ditore kanë qënë mezzatarisht 400-600 mg, pastaj i kemi ulur gradualisht deri në 100 mg. Dozat totale të këtij preparati kanë qënë ndërën 2 gr. në 3 raste, 2,1 deri 5 gr. në 14 raste, 5, 1-10 gr. në 5 të sëmurrë dhe mbi 10 gr. në 4 të tjerë. Kuptohet vetiu se këta të fundit janë përdorur gjatë 2 ose më shumë cikleve të përsëritura.

Nën veprimin e tij diureza e pacientëve rritet shumë, ndonjëherë nga 400-500 cc. që ata eliminonitë para mjekimit, arrin në 3-4 litra dhe më shumë, aqë sa detyrohemë ti ulin shumë shpejt dozat e preparatit për të evituar një dezidratim të madh të pacientit, tromboza venoze ose fenomene hiponatriemie. Diureza rritet veçanërisht shumë kur spirolaktoni shoqërohet me diuretikë tiazinikë, mbasi veprimi i tij ushqrohet mbi tubulat renale distale dhe vetëm pjesërisht në ato proksimale, ndërsa preparatet tiazinike veprinun kryesor e kanë mbi tubulat proksimale, kurse sekondaria në distale.

Shoqërimi i tiazinikëve me spirolakton ka dhe avantazhin se ndërsa të parit çojnë në hipokalemë dhe rezik për komë elektroliktikë, spirolaktoni krahas diurezës hidrike e natriureti, pakësion eliminimin e K në urinë, prandaj kalemia normalizohet ose ka tendencë që të rritet.

Ndryshime të tilla kanë konstatuar shumë autorë: Vachon A. e b.p. (1961), Lockwood C.H. (1961), Albeaux-Fernet M. dhe Romani J.D. (1962), De Martinis C. e b.p. (1962), Ghiringhelli L. dhe Comoli G. (1962), Runcan V. dhe b.p. (1962), Kukes V. G. (1963), Panaiteşcul Gh. (1963) etj. si dhe punimet e klinikës tonë gjatë këtyre dy vjetëve të fundit.

Krahas terapisë hormonale dhe diuretike, të sëmurrëve tanë u janë bërë vitamina C, B1, PP dñs sidomos doza të mëdha të vitaminës Bi2 500-1000 gamma ditën, metioninë ctj.

Preparatet hormonale i keni bërë nën mbrojtje e antibiotikëve: penicilinë ose streptomisinë simbas nevojës dhe veçanërisht grupi i tetraciklinave që eliminohen me anën e rrugëve ibiliare. Indikacioni më të madh këto të fundit e gjejnë në gjendjet prekomatoze, encefalopati të portokavës oss më komat hepatike, sepsë atëherë duhet të shkatërrohen flora proteobakterike e intestinit, e cila merr pjesë në procesin e amoniogjenezës.

Nën veprimin e terapisë së kombinuar, asciti u resorbuat në 46 nga 82 rastet, d.m.th. në afro 56,1%, kurse nuk u resorbuat në 36 osë 43,9%, por ëdhe nga këta të fundit në 7 mbeti minimal. Në 2 raste likuidi resorbohet brenda disa ditësh kur përvëç delta kortenit e kloritës sëndit i shfohej spirolakton, por mbas ndërpërjes së tij reformohet; kjo gjë u përsërit katër herë për sejçilin. Në njërin prej tyre gjatë kohës që merrte spirolakton dho kloriazid pa delta-korten, u çfaq një ikter, i cili është vështirë të thuhet në se i detyrohej vetë evolucionit të sëmurrës, apo toksicitetit të këtyre preparateve.

Tek një i sëmurë i tretë likuidi u çduk dy herë dhe i rishilloi mbas ndërprerjes së spirofaktorisë. Edhe në raste të tjera ne kemi qëndrë të detyruar të perdonim më tepër se një cikël spirofaktori.

Përsë i përkert kohës së resorbinimit të likuidit ascitic, nga 45 rastet, në 17 u çduk në më pak se 15 ditë, në 12 të sëmurë midis 16 dhe 30 ditë, në 8 midis 31 dhe 60 ditë, në 4 midis 61 dhe 90, në 2 pacientë mbë 90 ditë, kurse në 3 nuk që përcaktuar me saktësi koha e resorbitit.

Në një numrin rastesh, nën veprimin e terapisë hormonale, krahas përmirësimit të gjendjes së përgjithëshme, konstatohen edhe ndryshime përsa i përkert dimensioneve të heparit e të lienit. Këto duken më qartë në format anascitike, kryesisht sindromet hepatobiliale, mbasi në format ascitike dimensionet e vërteta të këtyre organeve mështohen nga likuidi dhe meteorizmi. Megjithatë në do të jepim një pasqyrrë krahasojse të dimensioneve para dhe mbas mjekimit.

Nr. i cm. që hepari e kalon harkun brinjor para dhe mbas mjekimit.

| Hepari në cm. | Nuk preket | Deri 2 | 2,5-5 | 5,5-10 | Mbi 10 | Nuk përcakohet nga asciti |
|------------------------------|------------|--------|-------|--------|--------|---------------------------|
| Gjatë shtrimit Nr. i rasteve | 28 | 9 | 24 | 9 | 1 | 38 |
| Në Dalje Nr. i rasteve | 42 | 20 | 35 | 4 | ... | 8 |

Midis këtyre vlen të përmendet rasti i pacientes Kasiani Zh. vjet 38, e cila paraqiste një citrozë hepatosplenomegalike të kompensuar me heparin deri në *fossa ilica dextra* dhe lëasin në *fossa ilica sinistra*. Mbas mjekimit më delta korten hepari u zgjodhia deri në 3 cm., kurse splina deri në 4 cm. Disa muaj më vonë pacientja u shtrua prapë me heparin deri në *umbilicus* e lienin në nivelin e *crista ilica sin.* Nën veprimin e terapisë hormonale të dy organet u zgjedhuan brenda 2 muajsh.

Numri i cm. që lieni e kalon harkun brinjor para dhe mbas mjekimit.

| Lieni në cm. | Nuk preket | Deri 2 | 2,5-5 | 5,5-10 | Mbi 10 | Nuk preket nga asciti | Mbas splenektomisë |
|------------------------------|------------|--------|-------|--------|--------|-----------------------|--------------------|
| Gjatë shtrimit Nr. i rasteve | 2 | 8 | 26 | 22 | 7 | 41 | 3 |
| Në dalje Nr. i rasteve | 7 | 18 | 32 | 33 | 8 | 8 | 3 |

Nga 109 të sëmurët e mjekuar prej nesh, gjatë qëndrimit në klinikë vdiqën 12 veta ose 11% e rasteve. Prej këtyre 6 ishin cirroza atrofike të tipit Laennec, 5 cirroza splenomegalike të dekompenzuar që merrnin karakter të ngjashëm me ato të tipit Laennec dhe një ishte *morbus Banti, status post splenectomy* i dekompenzuar.

Nga këta 6 veta vdiqën nga koma hepatike: një u shtrua me bronkopneumoni bilaterale ra në komë e nuk doli dot, i dyti mbas një paracenteze evakuatore të nesërmen e kishte ndërgjegjjen të erësuar dhe ditën e III-të ra në komë; i treti 12 ditë mbas ndërprerjes së delta kortenit pati shënjat e encefalopatisë porto-kavë dhe të nesërmen ra në komë. Nga kjo gjendje mundëmëtua nxjerim, por pastaj u çfaqën shënjat të një insuficience hepatike të rendë me ikter, epistaksis diateza hemorragjike, iu përsëritën shënjat e encefalopatisë portale dhe vdiq nga koma duke bërë dhe një hematemëzë të vogël terminale, por gjatë kësaj kohë nuk merrte delta korten. Rasti i katërt paraqiste encefalopati porto-kavë, ra disa herë dha doli nga gjendja prekomatoze deri sa vdiq, më tepër nga insuficience kardiopulmonare që e shqëronte. Në dy të tjerët koma u zhvillua pa ndonjë veçori dhe nuk vlefë të vihet në dukje.

Gjashtë të sëmurë të tjerë patën hemorragji digestive: hematemëzë ose melenë, në të gjithë delta kortenit u ndërpër mejnjehën. Në tre prej tyre mbas hemorragjisë u çfaq koma: tek i pari që të nesërmen, tek i dyti 9 ditë mbas ndërprerjes së delta kortenit, kurse tek i treti mbas 2 javësh. Këto janë *komai post-hemorragjike* të përshkruara nga Cachera, të cilat dha ne i kemi hasur shpesh herë në klinikën tonë. Ky është shkaku që mbas hemorragjive të cirrotikëve, krahas luftës kuadër hemorragjisë, ne kërkojmë të marrin masa për të prevnuar hipertensionin.

ramoniemiqen dhe pasojen e saj komen hepatike. Per kote qellim ndalojmë proteinat, përdorim ambranicinë per te Iftuar florën intestinale proteolike dhe acidin glutaminik ose kripërati e tij per te neutralizuar superprodhimun e amoniakut.

Tre te sëmurët e fundit vdiqen nga hemorrhagja: njërit iu përsërit ajo 40 ditë pas ndërpërjes së delta kortenit, dy te tjerët vdiqen nga hemorrhagja gjatë kohës që merrnin respektivisht 20 dhe 15 mg. delta korten, por në autopsi u gjend tek njëri trombozë e vena lienalis, kurse tek tjetri trombozë e venave: *porta, linea lis* dhe *mesenterica*.

Përveç këtyre 12 rasteve, në klinikën tonë vdiq dhe një pacient tjetër me *morbus Banti*, i cili dy herë u përmirësua nën veprimin e terapisë hormonale, por kur u shtrua për herë të tretë pati *hematemesis e melena*. Mbasi ndërpërjes së delta kortenit ju çfaqën shënjat e encefalopatisë porto-kavë dhe vdiq nga koma hepatike.

Nga të sëmurët e tjerë dy patën hemorrhagji digestive që u ndaluau mbas ndërpërjes së delta kortenit.

8 veta duallën në gjendje të rëndë me insistimin e tyre ose të familiarëve. Prej këtyre dy genë në gjendje prekomatoze. 2 te tjerë muarrëm vesh se vdiqen në shtëpinë e tyre; njëri nga këta gjatë qëndrimit në klivikën tonë kishte shënjat e encefalopatisë porto-kavë.

Një i sëmurë tjetër me encefalopati porto-kavë ishte shtruar në repartin e psihiatrisë, por nën veprimin e terapisë u përmirësua dhe vazhdon të jetë në gjendje të mirë.

Dy te tjerë, megjithëse u përmirësuan, lëkuri nuk u resorbua plotësisht, por me kërkesën e tyre u nxorrën nga klinika për të vazhdur mjekimin në spitalin e qytetit ku ata banonin.

Nga manifestimet anësore të këritzonikëve, duhet përmëndur se 6 veta patën djerë të shumta, 2 *facies lunata*; tek një u çfaqën palpitacione, tek një djegie epigastrale dhe dhëmbje që u pasuan nga një hematomezë me rreth 100 cc.

Nga të gjitha këto që thamë, del se nga 109 rastet e mjekuar me kortikosteroide, në 10 ose 9,17% të rasteve u çfaqën hemorrhagi digestive. Por me përfjashtim të rastit të fundit, në 9 të tjerët eshtë vështirë të thuhet se sa duhet tia atribuojmë delta kortenit dhe sa vetë sëmundjes, mbasi hemorrhagjitet janë një komplikacion që konstatoheshin édhe para erës së preparave hormonale.

Lidhur me këtë mjafton të përmendim se Popper H. dhe Schaffner F. duke folur për shkaket e vdekjes së cirrotikëve kanë grumbulluar nga autorët të ndryshim 535 raste vdekjeje; në 229 prej tyre shkaku i vdekjes që koma hepatike, kurse në 163 hematomeza, megjithëse të dhënat janë marrë nga viti 1936 në 1955, d.m.th. para përdorimit të kortikosteroideve në cirrozat.

Sidoqoftë, pikëpamjet e sotëshme janë se me përdorimin e preparave hormonale éshtë pakësuar përqindja e vdekjeve nga koma hepatike dhe éshtë shtruar ajo nga hemorrhagjitet e traktit digestiv.

Përveç rasteve të sipërpërmendura, tek një paciente u detyruam ta ndërpresim delta kortenit mbas disa ditësh, mbasi u çfaq një glikozuri dhe hiperglicemi. Ma sa duket delta kortenit vuri në dukje një diabet latent. Duke qënë se pacientja tonë kishte një ngjyrë pak të errët të lëkurës, dyshuar se mos kishim të bënë me një hemokromatozë, por ekzaminimet e ndryshime, duke përshtirë dhe biopsinë e lëkurës, flisin kundra saj.

Edhe Zhrebcoi L. A. (1963), gjatë mjekimit të 64 cirrotikëve me këritzonikë, konstatoi 3 raste diabeti steroid.

Nga manifestimet anësore të spirolaktonit, përveç disa rasteve që mbas çkarkesës së madhe të likuive dhe NaCl, paraqitjnë lodhje, këputje, *vertigo*, të cilat tek një paciente qenë aqë të theksuara sa u detyruam ti japid djetë me kripë, vlen të përmëndet rasti i të sëmurës Bike K. vjeç 36 që iu çfaq një pilozitet i theksuar në ftyrë simbas tipit maskulin. Kishte kaluar Botkin para 8 vjetësh, kurse 3 vjet më vonë iu çfaqën dhëmbët në hipokondrin e dajtë, për të cilat ishte shtruar disa herë në spitalin e Librazhudit. Në janar 1964 u operua për një ekinokok gjigani të mëqësish. Gjatë ndërryjes kirurgjikale u konstatua se hepari ishte atrofizuar, kishte rabetur vetëm një lamë e hellë, kurse kaviteti peritoneal porsa evakuohet mbushej brenda pak ditësh me një likuid që i përgjiste birës së zezë.

Në një gjendje të tillë u transferua në klinikën tonë në mars të 1964. Përveç mjekimit me delta korten, plazmë, diuretikë tiazinkë ju bënë dhe tre cikle të gjatë me spirolakton. Gjatë ciklit të parë iu çfaq piloziteti i ftyrës, i cili vazhdoi të shtohet édhe disa ditë mbas ndërpërjes së spirolaktonit, pastaj u ndalua. 17 ditë më vonë, spirolaktoni u rifillua me doza më të vogla se më parë 300 mg/ditë, qimet e mjekrës dhe mustaqeve filluan t'i rriten përsëri, megjithëse pacienta pjesërisht i kishte hequr. Përveç këtyre, ditën e VIII-të të ndërpërjes së spirolaktonit në ciklin e parë si dhe gjatë ciklit të tretë, iu çfaqën turbullime psihiqe: qante, bërtiste, thoshte se do çaje barkun me gërrshërë ose thikë, deshë të ikë nga spitali etj. Ndërsa këto turbullimet e fundit éshtë vështirë të themi në se duhen lidhur me spirolaktonin apo janë manifestë të encefalopatisë portokavale, pilozitetin është i kemi attribuar këtij preparati që bën pjesë në hormonet androgjene, kështu formula e tij éshtë: 3-(3-oxo, 7 acetylthio-17-hydroxy-4-androstene-17- α -yi) propionic acid - γ - lactone.

Përsa u përket rezultateve të largëta, të sëmurët tanë u observuan nga disa muaj deri 6 vjetë. 20 veta u shtruan përsëri në klinikën tonë; prej këtyre 16 për herë të dytë, kurse 4 për herë të tretë. Një pjesë e këtyre qenë nga ata që likuidi nuk u ishte resorbuar plotësisht; kurse

pjesa tjetër pësoi një recidivë të ascitit. Nga këta një me *morbus Banti* (*status postsplenectomy*), siç e kemi përmëndur më lart, vdiq nga hemorragjia dhe koma hepatike. Tre doftër nga klinika në gjendje të rëndë, prej të cilëve 2 vdiqën në shtëpi. Tre të tjerët dolën me likuid, një prej të cilëve me minimal, kurse i dyti gjatë qëndrimit në klinikë paraqiti shënjat e encefalopatisë, por pastaj u qetësua. 13 të tjerët dolën në gjendje të mirë, pa likuid ascitit.

Megjithë rezultatet e arritura në mjekimin e cirrozave të hepatitit, ne nuk kemi mjetë përti ti shënuar këto definitivish, prandaj del e qartë rëndësia e madhe që ka profilaksia e kësaj sëmundjeje.

Profilaksia e cirrozave, përvëç luftës kundër faktorëve etiologjikë, konsiston në mjekimin sa më të plotë të hepatiteve kronike. Porsa të vihet diagoza e një hepatiti të tillë, pavarësisht nga etiologjia dhe stadi evolutiv në të cilin gjendet, një nga masat më kryesore të mjekimit patogenetik e përbën pushimi i të sëmurëve. Simbas të dhënavë të Buligescu L. dhe b.p. (1964), disa autorë rekomandojnë pushim të ndërprerë me shtrirë në spital 1 muaj çdo 3-4 muaj deri sa të shërohet, kurse të tjerë qelësi absolute i-2 vjet. Scholm I. (1962), ka arritur të shërojë hepatitet kronic hidropigjene vetëm me anën e qetësise absolute, duke i mbajtur të sëmuët në kondita sanatoriale 16-18 muaj dhe pa arije medikament. Për mjekim sanatorial të gjatë shëtit dhe Lupu N. Gh. (1962) eji.

Prej këtej kuptohet përgjegjësia e madhe që mbajnë mjekët kuronjës, dhe komisionet e ekspertizës mediko-puntore ose mediko-ushtarake në përcaktimin e aftësisë të këtyre pacientëve.

Të bazuari mbi të gjitha sa thamë, mund të arrijmë në këto konkluzione paraprake.

1) Në anamnezën e të sëmurëve të mjekuar prej nesh me preparate hormonale, vëndin e parë e ze malaria, pastaj vjen hepatiti infeksios. Por duke i krahasuar të dhënat e vitit 1950-1954 me ato të sotëshme, villet re një ulje e rasteve malarike nga 56,2% një 44% dhe në ngritje e atyre me *morbus Botkin* në anamnezë nga 9% një 22%.

2) Nën veprimin e terapije hormonale të thjeshtë ose të kombinuar me diuretikë tiazinikë ose spirolakton, asciti resorbohet plotësisht në një pjesë të madhe të cirrozave të dekompensuara (simbas të dhënavë tona në 56,1% të rasteve), kurse në të tjerët nuk jep efekt ose rezultatet janë të paqëndruëshme.

3) Kombinimi i preparateve hormonale me diuretikë tiazinikë ose spirolakton bën që diureza dhe natriureza të rriten shumë, kështu edhem, hidrotoraksi dhe asciti resorbohen brenda një kohe më të shkurtër.

4) Gjatë përdorimit të preparateve kortizonikë villet re prirja për tu shtruar numuri i hemorragjive digestive dhe për tu pakësuar aj i komave hepatike.

5) Ndërsa nga preparatet hormonale, përvëç resorbin të versamenteve, mund të presim dhe një përmirësim të gjithanëshëm të cirrozës, diuretikët kanë vetëm një veprim simptomatik.

6) Midis manifestimeve anësore të spirolaktonit që përshtohen në literaturën e konsultuar prej nesh, vlen të shihet edhe një manifestim tjeter: hirsutizmi.

(Paraqitur në redaksi më 25-XI-64).

BIBLIOGRAFIA

- 1) *Adhami J. E.* Mjekimi i sotshëm i cirrozave hepatike. Dhëne për botim Shëndetësisë Popullore.
- 2) *Adhami J. E., Kostagi M.* — Mjekimi me delta korteni i cirrozave hepatike të dekompensuara. Shëndetësija Popullore 1959, 6, 6-16
- 3) *Adhami J. E., Kostagi M., Audoni K., Bulki Dh.* — Cirrozat hepatike në Shqipëri simbas materjalit të spitalit Civil të Tiranës gjatë vjetëve 1950-1954. Shëndetësija Popullore 1958, 3,44-49.
- 4) *Albano O., Losurdo S., Francavilla A.* — La cirrosi epatica in Puglia Min. Med. 1963, 54, 32, 1142-1147.
- 5) *Albeaux-Fernet M., Romani J. D.* Les œdèmes. Hormonothérapie, antagonistes de l'aldostérone et salidiurétiques. Paris 1962.
- 6) *Bariéty M., Gajdos A., Coury C., Korccevic M.* — Action comparée de la métacortandarine sur la diurèse et le métabolisme du sodium et du potassium chez le sujet normal et au cours de la cirrhose hépatique. Presse méd., 1956, 64, 1699.
- 7) *Boulet P., Miroze J., Barjon P.* Etude physiologique et indications de la delta cortisone dans le traitement des cirrhoses. Revue internationale d'hépatologie. Paris 1957, 7, 3, 273-287.
- 8) *Buligescu L., Moldovan T., Marinescu N., Jonită C.* Stadiul actual al tratamentului hepatitelor cronice. Medicina internă 1964,XVI, 9,1025-1037.

- 9) *Cachera R.* Le coma hépatique, sa physiologie, son traitement par l'acide glutamique.
La sem. des Hop. 1955, 31, 1542-1552.
- 10) *Cachin M., Pergola F., Potet F., Levillain R., Leluc R.* Delta cortisone et cirrhoses ascitiques. Etude biologique et histologique. Incidents therapeutiques.
La sem. des Hop. 1957, 33, 54, 3168-3174.
- 11) *Cachin M., Pergola F., Slama P., Potet F., Levillain R.* — Le traitement des cirrhoses alcooliques par la delta cortisone.
Archives des maladies de l'appareil digestif et des maladies de la nutrition. 1957, 46, 513-535.
- 12) *Cachin M., Pergola F., Slama P., Potet F.* — Le traitement des cirrhoses alcoolique par la métacortandracine.
La sem. des Hop. 1957, 33, 14, 928.
- 13) *Cattan R., Vesin P.* Etat actual du traitement des cirrhoses ascitiques par la delta -cortisone. La Sem. des Hop 1957, 2, 76-79.
- 14) *Cattan R.* — La corticothérapie dans le traitement des cirrhoses alcooliques du foie.
Academie Nationale de Medicine. Paris. Seance du 3 juin 1958.
- 15) *De Gennes L., Mathieu de Fosé R., Moreau L., Bricaire H., Tourneur R., Janson.* La dextrocortisol dans le traitement des cirrhoses ascitiques.
La Presse Med. 1957, 65, 31, 709-712.
- 16) *De Martinis C.* — Un nuovo inibitore della sintesi degli ormoni corticosurrenali: il 2-metil -1, 2-bis (3-piridil)-1-propanone (S. U. 4885-Metopiron). Minerva Med. 1962, 53, 36, 1367.
- 17) *Girolami M.* Le traitement de la cirrhose hépatique par de très hautes doses de propionate de testostérone.
Medicine et hygiene. Geneve 1957, 15, 373, 422.
- 18) *Ghiringhelli L., Cornoli G.* — Osservazioni sull'impiego di un antialdosteronico (aldactone) nella terapia della ritenzione idrica.
Minerva Med. 1962, 53, 45, 1760.
- 19) *Kukes V. G.* — O primenjenju blokatora aldosterona.
Kliničeskaja med. 1963, 6, 65.
- 20) *Lamache A., Bourel M., Chevrel M., Cormier M., Richier J., Dauleux L., Lenoir P., P., Frangeul R.* La corticothérapie surrenale au cours des cirrhoses du foie chez les alcooliques. La sem. des Hop. 1957, 33, 27, 1716-1730.
- 21) *Lockwood C. H.* Lo spirolatone nel trattamento delle asciti da cirrosi epatica. Canad. M.A.J. 1961, 11, 631. (Marré nga Miniera Medica 1962, 45, 53, 1768).
- 22) *Mnushkin A. S., Poliak E. I.* Nekotorie osobennosti ctiologii i kliniki cirozov pečenji.
Kliničeskaja med. 1959, 10, 84.
- 23) *Panaiteescu Gh.* Indicații și limite ale tratamentului cu diuretice nemercuriale. Viața medicală 1963, X, II, 721-728.
- 24) *Poinso R., Chanas P.* Les manifestations pleurales des cirrhotiques. La presse Médicale 1958, 66, 49, 1106-1108.
- 25) *Popper H., Schaffner F.* Liver: Structure and function.
Botim italian, Roma 1960.
- 26) *Runcu V., Racoveanu C., Geib R., Popescu T.* Tratamentul cu spiroloctona în ascitele persistente ale ciroticilor. Medicina internă 1962, XIV, 9, 1123-1129.
- 27) *Vachon A., Basset C., Arcadio F., Joud R.* Les spirolactones dans le traitement des cirrhoses ascitiques (26 observations). Lyon med. 1961, 19, 1029-1043.
- 28) *Vesin P.* Les œdèmes. Nouvelles études biologiques, cliniques et therapeutiques.
La sem. des Hop. 1958, 34, 32-33, 1948-1949.
- 29) *Zoeckler S. J., Hegstrom G.J.* Cortisone in decompensated portal cirrhosis. Gastroenterology 1953, 24, 30.
- 30) *Zherebcov Li. A.* Primjenjenije prednizolona pri hroničeskih hepatitah i cirrozaх pečenji.
Kliničeskaja medicina 1962, 11, 98.



TREATMENT OF CIRRHOSIS HEPATICA WITH CORTICOSTEROID DRUGS.

(Summary)

A survey is made of 109 cases of liver cirrhosis treated with corticosteroid preparations during the years 1958-1964.

30 of the patients had atrophic decompensated cirrhosis of the Laennec type, 18 — spleno-megalic cirrhosis, which during its evolution had caused the atrophy and decompensation of the liver and had become similar to the Laennec form; 19 had decompensated hepatosplenomegalic cirrhosis, 15 were diagnosed as morbus Banti, 2 had hepatomegalic cirrhosis and 1 was a syndrome of Cruveilhier-Baumgarten, 2 had secondary biliary cirrhosis. Analysing the case histories of these patients, it can be seen that 43 (44%) had had malaria in their anamnesis, 24(22%) had suffered from viral hepatitis, 21(19.26%) had been addicted to alcohol, 8(7.34%) had different tubercular processes.

It is pointed out that the part of malaria, although still important, has a marked tendency to diminish, whereas the part viral hepatitis plays in this process is increasing, so much so that within a short time it shall replace that of malaria. The author comes to this conclusion by comparing the present situation with that of the period 1950-1954, when 56.2% of the cirrhosis hepatitis cases could be attributed to malaria and only 9% had a history of viral hepatitis.

44% of the cases had ascitis in their history and 75.2% had ascitis at the time of hospitalisation; 39.27% had oedema, 26.6% hydrothorax on one or both sides.

In 108 cases the hormonal treatment was applied with deltacortene 30-40mg daily; one patient was treated with ACTH only. In 40 cases deltacortene was combined with ACTH, but in most cases ACTH was used only for the stimulation of the suprarenal secretion.

In 43 cases plasma transfusion was used.

In 13 cases the treatment with corticosteroids was combined with testosterone, in 20 with chlorthia 4-1.5 g daily, in 23 with hydrochlorthiazid 150mg daily with periodic pauses; in 26 patients — with spiro lacton. Together with the hormonal and diuretic therapy were used vitamins C, B, PP, but mostly B₁₂ 500-1000 gamma daily, some hypotropic substances, as well as antibiotics.

As a consequence of this treatment ascitis disappeared in 56.1% of the cases. During treatment in the clinique died 12 patients; 6 in hepatic coma, 6 from internal haemorrhages. In 3 of these last cases coma hepatica came after the haemorrhages.

One patient with morbus Banti had two remissions, but after the second he fell into coma and died from porto-caval encephalopathy. 8 were released from hospital in a grave state.

Of 109 patients treated with corticosteroids 10(9.17%) had digestive haemorrhages. In one case the treatment was interrupted, since it was discovered that he had latent diabetes. A woman, 36 years old, showed signs of hirsutism after treatment with spiro lacton (3 sicles).

DISA TË DHËNA KLINIKO-STATISTIKORE MBI DISKOPATITË E NJEKUARA NË SPITALIN E P. USHTARAK

KOL. DOC. HIQMET DIBRA
(Spitali P. Ushtarak — Shef. KOL. S. IMAMI)

Dhimbjet e «mesit» ose të belit apo dhimbjet lombosakrale, që cilësohen me epitetet të ndryshme mjekësore si lombago, lombalgi, lombo-iskialgi, radikulite lombo-sakrale, rakiqë e me rale diskopati ose *discitis* etj. zënë një vënd me rëndësi në mjekësinë ushtarake.

Simbas të dhënavë statistikore të Spitalet Përgjithshëm Ushtarak për periudhën 10 vjeçare 1954-1963, numri i ushtarakeve me lezione të sistemit nervor periferik arrin në 31,1% kundrejt numrit të përgjithshëm 100% të pacientëve të shtruar dhe mjekuar për dëmtimë organike të ndryshme të sistemit nervor në përgjithësi. Nga të dhënat e Klinikës së Neurologjisë të Fakultetit Mjekësor, del se sëmundjet e sistemit nervor (S.N.) periferik përbëjnë 18-20% të të gjithë morbozitetit. Një përqindje të tillë 18-20% kanë konstatuar edhe P.M. Saradzhishvili, D.S. Guber-Gric, S.M. Petjelin, D. A. Shamburov, kurse dëmtimet e sistemit nervor periferik nga të dhënat e Spit. P. Ushtarak arrin në 31,1%. Është përtu theksuar se autorët e përmendur kanë konstatuar se, 70% të dëmtimeve të sistemit nervor periferik (S.N.P.) e përbëjnë radikulitet lombo-sakrale.

Nga analiza e bërë historisë së sëmundjeve të 260 pacientëve ushtarake të shtruar në repartin e neurologjisë të Spit. P. Ushtarak gjatë periudhës 1954-1963 për dhimbje lombo-sakrale (radikulitis lombo-sakrale, lombago, lombalgi, lombo-iskialgi ischias etj.), del se 58% të pacienteve të këtij grupi duhet të konsiderohen «diskopatira», mbasi të dhënat anamnestike dhe klinike flasin për një diagnoze të tillë. Diagnosa e diskopative, siç rekomandon V.V. Staravoit duhet mbeshtetur në tablone klinike, ndërsa metodat plotues të kërkimit luajnë vetëm një ro! ndihmës.

B.A. Dubnov tregon se ne analizën e 334 rasteve të shtruar për radikulit lombo-sakral 76% paraqesin shenja klinike të qarta të një diskote. Ndërsa autore të tjerë (A.K. Stienk, M.I. Kagan, L.S. Kadin, Z.L. Lurie, Mikser, dhe Barr) tregonin se nga ekzaminimi i pacienteve të dërguar e shtruar për *ischias* del se një pjesë e tyre kanë deformime të ndryshme të vertebrave e sidomos të disqeve intervertebrale në formë diskote, ostokoudroze, protruzioni diskal, hernie, të cilat duhet të konsiderohen si «diskopatira».

Simbas të dhënavë të L. Ectors, de Seze, Forestier, Sicard, etj. nga 77 gjë 93% të rasteve me *ischias* kanë lindur si pasojë e një diskopatie.

Shumë autorë të sotshëm (O. Scaglietti, D.S. Guber Gric, de Seze, T. Alajouanine si dhe neurokirurgët Forestier, J. Guillaume, R. Desporges, S. Gotteron, S.H.Jurmand, M. Maitre etj.) janë të mendimit se do të ishte me sakte që 70-80% të dhimbjeve akute të menjëherëshme lombosakrale që lidhin në përgjithësi me një traume ose sforcim të kolonës vertebrale, të cilësohen si diskopati osc diskote, mbasi këta kemi të bëjmë me një patologji të diskut *invertebral*. Ndërsa De Seze, J. Guillaume, R. Desporges Gotteron S. H. Jurmand dhe M. Maitre në një botim të tyre propozojnë termin «sciaticque paralysante» (nga këta 100 raste u operuan 38 dhe në 32 prej tyre u konstatua një hernie diskale).

* * *

Ashtu siç rekomandojnë autorët Sicard, Lievre, Levi-Lebar, Ectors, Guber-Gric, etj. për të arritur në diagnozën e diskopatisë, jemi mbeshtetur në të dhënat klinike e paraklinike që vijojnë:

Faktori traume ose sforcimi fizik i kolonës vertebrale është gjetur në shumicën e rasteve. Nga anamneza rezultoi se 15% e pacienteve kishin patur një traume; 65% ankonin një sforcim fizik (marrje keq e kryqeve, hap i gabuar, duke ngritur një peshë të rëndë, lëvizje e papritur rrëshqitje etj.) 12% ankonin të ftohit dhe lodiqjen fizike; 8% e pacienteve dhimbjet e tyre të menjëherëshme nuk i lidhin me asnjë.

Dhimbja lombo-sakrale është shkaku që i ka detyruar pacientet të shتروhen në spital. Ajo është në përgjithësi 92% e menjëherëshme dhe e vazhdueshme me rrezatim në njëren nga anësitë

e poshtëma gjatë nervit ischiadigus në 11% të rasteve dhimbja është rezatuar në të dyja anësitë në 7% dhimbjet kalonin nga njëra këmbë tek tjetra ndërsa në 5% të rasteve dhimbjet mbeten të lokalizuara në «mes» pa asnjë rezatim, duke dhënë përshtypjen e një Lombango.

Në 40% të rasteve çregullimet e sensibilitetit dualësh në pah në formë parestezish të lehta (impje të gjunjve, këmbëve). Në diskopatitë, hipostenzitë tipit radikular janë simptoma më rëndësi dhe në i kemi hasur në 85% të rasteve, ndërsa Garçar-Gric po këto simptoma i ka gjetur në 80% të rasteve. Anestezinë në faqen e jashtme të kërcirët dhe të këmbës e kemi takuar në 15% të rasteve.

Cregullimi të sensibilitetit të thellë dhe termik janë takuar në 4% të rasteve sidomos në disa forma të rëndë diskopatit. Ne mendojmë se këtu kemi të bëjmë më tepër me çregullimë sensibiliteti të natyrës histerike, që çafqet si një mbishtresë funksionale, mbasi një simptomë të tillë nuk e kanë observuar autorë të tjerë dhe nuk ka se si të spiegohet nga ana klinike.

Në 95% të rasteve në perkusion është provokuar dhimbje duke shtypur pikat vertebrale në nivelin e L₄-L₅-S₁, ndërsa 70% të tyre ankonin dhimbje të gjithë kolonës lombo-sakrale. Në 75% të rasteve pikat e Walekxit ishin të dhimbëshme, kurse në 23% kemi konstatuar dhimbje në shtypjen të nervit femoral. Simptomët e Lassegue e kemi gjetur në 85% të rasteve ndërsa, atë të Bonnet në 42%.

Modifikimi i reflekseve, sidomos ai i akilian, është një nga shenjat objektive me të rëndësi-sime. Në 38% të rasteve refleksi akilian ka qenë i dobët, në 15% nuk provokohej fare dhe në 4% i gjallë.

Në diskopatitë rëndësi të madhe ka vënia në dukje e simptomave reflektore-tonike, si tendosja e muskujve ekstensorë të shpinës, sidomos gjatë lëvizjeve aktive e pasive. Të tillë simptoma janë hasur në 85% të rasteve, kurse autorë të tjerë po këto simptoma i kanë takuar në 100% të pacienteve (Scaglitti, Dubnov, Guber-Gric etj). Simbas këtyre autorëve pikërisht në këto simptoma duhet të mbështetemi për të vënë diagnozën e diskopatisë.

Tendosja e muskujve ekstensorë të shpinës në 20% të rasteve ka shkaktuar një skoliozë të lejtë, ndërsa lordoza është takuar vetëm në 4% të pacienteve. Kjo tendosje e muskujve ekstensorë të shpinës bën kontrast me atoninë muskulare të muskujve *glutei*, sidomos të anës më të prekur, që në i kemi gjetur shumë të dukëshme në 42% të rasteve.

Karakteristike për diskopatitë është ecja e të sémurit. Pacientet ecin si të ugrirë, marrin poza antalgjike, duke u përpjekur ta mbajnë kolonën vertebrale të palëvëzëshme ose tui shinanë lëvizjeve që shtojnë dhimbjen. 95% e pacienteve tanë merrin poza antalgjike, sidomos kur uleshin sapo shtriheshin në shtrat, etj. Këtu vlen të theksohet se gadi 80% e pacienteve, kur i vinit të ecnin në majë të gishtrinjve, e ndjeuin veshen më të lirshëm, sikur u pakësoseshin dhimbjet. Këtij simtomë i kemi kushtuar një vëmëndje të veçantë dhe bile të sémurët ishin porositor të ecnin në majë të gishtrinjve, duke i konsideruar këto ushtrime si një metodë kurimi.

Hipotonia muskulare e kofshës në anën e dhimbëshme është hasur në 15% të rasteve, kurse Guber-Grici në 33% të pacienteve dhe Dubnov në 40% të rasteve.

Në diskopatitë me dekurs kronik dhe recidivues takohen atrofi muskulare. Në 15% të rasteve psh. në kemi hasur atrofi të muskujve *glutei* në 23% atrofi të muskujve *cruris* dhe 7% atrofi të të gjithë artit.

Më 7.8% të rasteve u gjetën simptoma neurologjike bilaterale por me të theksuar e të dukëshme në anën ku dhimbjet ishin me të forta. Ndërsa V.V. Staravoit simptomat neurologjike bilaterale i ka hasur në 19.6% të pacienteve me hernie diskale mediane në segmentin lombor.

Këto janë simptomat që vërehen në përgjithësi në diskopatite, por ato nuk çafqen gjithmonë në mënyrë të dukëshme e të qartë prandaj del nevoja e kryerjes se ekzaminimeve plotësuese.

Si ekzaminime plotësuese janë përdorur kryesisht ekzaminimet radiologjike, ekzaminimi i likuorit cerebro-spinal, elektro-diagnostiku dhe mielografija. 82% e pacienteve me diskopatitë i janë shtruar ekzaminimit radiologjik dhe tek 60% të tyre nuk është konstatuar ndonjë gjë me rëndësi; tek 16% spondiloze, 10% spondilo-artrit ose lombartrit, 3% spina bifida, 7% sakralizim dhe 4% lombalizim. Puntura lombare i është bërë vetëm 60% të pacienteve. Nga këta vetëm 3.9% kishin një disostacion proteino-citologjik të theksuar; mbi 1 gr. 0/00 proteinë me 2-7 celula për mm³, tek 30% të pacienteve proteinë arriinte nga 40-60%, kurse tek të tjerë likuori cerebro-spinal paragjitej normal në çdo pikëpamje. Prova Stookey — dhe Quickeinsleit rezultoi negative në të gjitha rastet.

Elektrodiagnostiku është përdorur këto pesë vjetët e fundit por jo në mënyrë sistematike për këtë arsye nuk mund të jepim ndonjë të dhënë statistikore të vlefshme.

Përsa i përket mielografise, duke përdorur si mjet kontrasti lipiodolin, është zbatuar vetëm në raste të rralla (3.9% të diskopatitë); aty ku kemi pasur shënjë të kjarta për hernie diskale. Vlesa të thiksohet se edhe pas ristabilizimit të gjendjes, këtyre pacienteve u mbeti një dhimbje në «bisht» dhe kjo me siguri si pasojë e një epiduritë të shkaktuar nga lipiodoli.

Sikundër u theksua edhe me lart, vetëm 3.9% të pacienteve me diskopati kanë paraqitur simptoma të dukëshme të një hernie diskale kirurgjikale. Hernia diskale në dy raste është çafqar mbas një traume (dy ushqare u traumatizuan në shpinë nga shembja e dheut); në katër raste mbas një sforsimi të kolonës vertebrale (që të katër oficere, dhe që kanë qëna-

mjekuar edhe më parë për lombago ose *ischias*). Dhimbja mbas sforcimit është qfaqur menjëherë dhe i ka blokuar pacientët në vënd. Nga të dhënët e V.A.Dubnov rezulton se në 334 raste të shtruar për radikulit lombo-sakral 76% paraqesin shënjë të qarta të një diskoco; nga këta 94.2% dualën të shëruar ose të përmirësuar, ndërsa nga 5.8% që dolën pa përmirësim vetëm 3.3% u diagnostikuat për hernie diskale dhe iu nënshtruan operacionit.

Të gjithë pacientët me hernie diskale merrin pozicion të detyruar e paraqesin një skolioze të kolonës vertebrale. Në 2 raste pacientët rrinin të «ngjitet si qiri», dhimbjet në fillim lokalizoheshin në pjesën lombare si në lombago, më vonë ato u rrezatuat në formë lombo-krurale ose lombo-iskialgje bilaterale.

Qfaqen e hernisë diskale e kemi gjetur të lidhur me traumën ose sforcimin fizik, ndërsa Schmorle, Forestier, Thurel, Giroire, De Seze, Scaglietti e lidhin gjithmonë vetëm me sforcimin fizik. Guber-Grie, Dubnov, Osnë fillimin e hernisë diskale e lidhin në radhë të parë me traumën pastaj me sforcimin fizik më rrallë me infeksione skute ose pa shkak.

Hernite diskale që kemi hasur karakterizohen me një dekaks pak a shumë të zgjatur. Me kalimin e kohës dhimbjet shpërndohen nga regjioni lombo-sakral në trajektori e nervit ischiadicus mbas një periudhe që të jetë verejtur riakutizimi si pasojë traumash të vogla, sforcimsh fizike ose të stohurit. Simptomi i Lassegue e Bonnet ka genë gjithmonë i pranishëm. Pacientët ankonin dhimbje me të mëdha kur shtriheshin përbysë dhe e ndjenja veten të lehësuar kur viniq jastegjë nën kokë. Në shurat atyre ju pëlgjente të rrinin me gjunjët e mbledhur në bark mbasi ky pozicion i qëtësonte. Likuori cerebro-spinal ka rezultuar gjithmonë me disociacion proteino-citologjik të theksuar (mbi 1 gr. 0/00 proteinë me 2-3 celula për mm³). Reflekset akiliani të ruajtura, bës të gjata. Kemi konstatuar një hipotonji muskulare të theksuar të muskujve *glutei* dhe 2 raste me afrofi muskulare në të dy arret, por më e theksuar në njëren anë.

Në diskopative, 50% të rasteve, kemi konstatuar një dobësi të dukeshme të muskulit eksensor të gishtit të machës të këmbës dhe të muskulit *tibialis anterior*. Ky simptom është gjetur gjithmonë në hernitë diskale. Edhe neurokirurgu Samotokin i klinikës neurokurgjikale te akademisë mjekore të Leningradit i këp një rëndësi të madhe këtij simptomit, të cilin e quan «shënja e gishtit të machës këmbës».

Çregullimet e sensibilitetit kanë qënë kurdeherë të pranishme, por me të dukshme në fazën e jashtme të këmbës e të kërcirit.

Hernite diskale duhet të diferencohen nga grupi i diskopative mbasi po ti hedhim një sy letërsisë mjekësore të ditëve tonë, shohim se ndëryhyjet kirurgjikale janë bërë rregull për «radikulit dinlegjen».

Disa autorë francezë (Alajouanine, Thurel, Giroire Forestier megjithëse 80% të *ischias* i konsiderojnë si pasojë e hernisë diskale, ndëryhyjen kirurgjikale e rezervojnë vetëm në 8-10% të rasteve.

Dubnov dallon dy forma diskozash, hernite dhe protruzionet e disqeve, dhe se vetëm për hernite duhet të ndëryhet kirurgjikalisht.

Vlen të bëhet diagnoza diferencale e dhimbjeve të regionit lombo-sakral, që nga ankesat e të sëmuarëve dhe nga simptomat përgjatin diskopative.

Ndër të shtruarit për dhimbje lombo-sakrale «të padurueshme që u qfaqen menjëherë pas një traume (shembje tuneli, aksident automobilë), kemi verejtur 4.2% lombalgira «histericë». Këto raste nuk mund të konsiderohen si simulim, mbasi u shëruan me një psikoterapi të thjeshtë. Edhe P. Lance ka konstatuar se 5-6% të dhimbjeve lombosakrale, me shenja subjektive të një diskopatie, ishin të natyrës funksionare si pasojë e një sinistroze histerike.

Spondiliti specifik ose morbus Pott i regionit lombar mund të simuloje fare mirë një diskopati, sidomos kur dhimbjet dhe rigjiditeti qfaqen menjëherë mbas një sforcimi fizik apo traume. Ky gabim diagnostik theksohet edhe më tepsë kur reperti radiologjik rezulton normal ose flet për një spondilo-artrit banal ose ngushtim të hapësirave intervertebrale. 4.2% të rasteve me lombago ose *ischias* që në fillim paraqesnin shenjat e një diskopatie, me vonë na rezultuan me spondiliti specifik *insipiens*. Një konstatim të tillë ka bërë edhe M. Gaucher në 4% të rasteve të shtruar për *ischias* «diskogjen».

Një vënd me rëndësi ze diagnoza diferencale diskopative me të ashtuquajturin «reumatizëm vertebral», që shkakton dhimbje të forta në pjesën lombo-sakrale të kolonës vertebrale. Është fakt se çdo algi vertebral që nuk sqarohet menjëherë, ciliçohet si reumatizëm i kolonës vertebrale. Spondilo-artroza reumatizmale është e shpeshtë, më rrallë takohet spondilo-artiti ankirozant, por këto dy forma të reumatizmit inflamator vertebral përbëjnë një terren të përshtatshëm për diskopati, kur mbi të vepron fakturi traumatik. 24% e rasteve me dhimbje lombo-sakrale kanë qënë të natyrës reumatizmale.

Një vënd të posaçëm meritor diagnoza diferencale me dhimbjet që shkaktojnë malformacionet e kolonës vertebrale, si *spina bifida occulta* (3%), sakralizimi (7%), lombalizimi (4%) është karakteristike se dhimbjet e «mesit» të shkaktuara nga malformacionet nuk pushojnë gjatë natës, por përkundrazi shtohen. Shumica e këtij grupi (70%) kanë evokuar traumën si shkaktar të dhimbjeve. Trauma, siç thotë M. Gaucher, mund të luajë një rol të rëndësishëm në shkaktimin e krizave të para të dhi mbëshme.

Dhimbjet lombo-sakrale, megjithëse janë studjuar qysmë prej vjetesh, mekanizmi dhe etiopatogjeneza e tyre u sqarua vetëm aty nga viti 1930.

Punimet e Schmorle, M. N. Shapiro, M. N. Kagan, Forestier, De Seze nga viti 1930-1940 i kushtuan një rëndësi të veçantë diskut intervertebrai në lindjen dhe zhvillimin e dhimbjeve lombo-sakrale.

Ndërsa autorë të tjerë (Sicard, Liervre, Levi-Lebar) i kushtojnë një rëndësi të madhe traumes në lindjen e diskopative dhe e konsiderojnë atë si vendimtarë në hernite diskale. Autorë të tjerë (Falkoner, Mac George, Begg, Schenk, Kagan) dhe që përbëjnë shumicën, nuk e mohojnë rolin e traumes, por e konsiderojnë të tepruar.

Ajo që ka më tepër rëndësi soli është spiegimi që i japin disa autorë (J.A./Lurie, J. Kolman, E.V. Schmid, Scaglietti, Guérer-Gric) etiopatogjenezës të dhimbjeve lombo-sakrale, të cilat në të kaluarën nuk spiegoreshin, Problemi u sqarua në sajë të individualizimit anatomik dhe radiologjik dhe ndërrhyrjeve neuro-kirurgjikale në kolonën vertebrale.

Shumica e autorëve konsiderojnë sot si faktor etiologjikë të diskopative proceset degenerative të indeve të diskut intervertebrai degenerativ ky që vjen si pasojë e traumes. Simbas Scagliettit diskopatite degenerative duhet të konsiderohen si proces artrozik, që prek individet në moshën 30-50 vjeçare. Desporges Gotteron thotë se qysmë nga moshë 30-50 vjeç shtohen proceset artrozike, të favorizuara nga një diskopati e vjetër e shkaktuar nga një sforcim i kolonës vertebrale.

Me këtë faktor artrozik mund të spiegojmë shumicën e diskopative tona tek ushtarët që kishin kaluar moshën 30 vjeç (82% ishin oficerë mbi 30 vjeç dhe 18% ushtarë).

* * *

Përdorimi i termit «diskopati» apo «diskoze» është relativisht i afërt ne mjekësi dhe soi shërben për të cilësuar me të shumtë e dhimbjeve lombo-sakrale, që çfagen pas një sforcim apo traume të kolonës vertebrale.

Mendojmë se ky term shënon një hap përpëra si nga ana e etiopatologjisë, ashtu dhe nga ajo e masave mjekonjëse.

Megjithëse dhimbjet lombo-sakrale nga paraqitja duken të thjeshta; po të shikohen në mënyrë të gjithanëshme atëherë del në shesh se problemi është më si komplikuar i përsa i përkert mijekimit ashtu dhe për masat mediko-legale.

Nga grupi i diskopative duhet të dallohen mirë rastet me herni diskale që kanë nevojë, për ndërrhyrje kirurgjikale, ndërsa pjesa dërmuese e diskopative duhet të mjekohet në mënyrë konservative (regjim shtrati absolut, terheqje, fiskulture speciale, fizioterapi etj.)

(*Paraqitun në Redaksi më 18.3.1965*)

BIBLIOGRAFIA

1. *Alajouanine Th. et Petrit-Dutastallis.* Le nodule fibro-cartilagineux de la face postérieure des disques intervertébraux. Presse Médicale 1930,98.
2. *Barr I. S.* Intervertebral disk lesions as cause of sciatica. Brit. Med. Jour. 1938, X.
3. *Casteigne P.* Bilan étiologique de l'examen d'un malade atteint de lombalgie et sciatique. Rev. du praticien, 1955, I, 6.
4. *Campbel A.M.G. Thilifis D.G.* Cervical disk lesions with neurological disorder. Differential diagnosis, treatment und prognosis. British Medical Journal 1960-5197
481-485
5. *De Sèze et Guillaume I.* Physiopathologie de la sciatique disco-radiculaire commune. Presse Médicale, 1949,25.
6. *De Sèze S. et Merle P.* L'âge de la sciatique. La Sem. des Hôpitaux de Paris 1949,25.
7. *Desporges-Gotteron R.* Etat actuel du traitement des lombalgies. La Clinique 1963, 580, 97-101.
8. *De Zeeze, Guillaume J.* Sciatique paralysante.
9. *Desporges-Gotteron, R.* Jurmand S.H. et Maitre M. La Semaine des Hôpitaux 1957, 45, 1773-1796.
10. *Dubnov B.L.* K klinike i diferencilnoj diagnostike pojasičnih diskozov. Zhurnall nevropatologii i psihiatrii im. Korsakova 1963 5, f. 37-42.

11. Elisejev V.A.
Popova M.N.
Rodinova E.P.
12. Ectors L.
13. Falconer A. Mc. George M. Observations on the cause and mechanism of symptom production in sciatic and lowback pain. J. Neurol. et Psychiatr. 1948, II, I.
14. Forestier J.
15. Forestier J. et Arlet I.
16. Gaucher M.
17. Gaucher M.
18. Giroire H.
19. Guber-Gric D. S.
20. Kadin L. S.
21. Lance P.
22. Lance P.
23. Lièvre I. A.
24. Lurje Z. L.
25. Mixter W.
26. Osna A. I.
27. Saradzhishvili P..
28. Scalietti. O.
29. Starovoit V.V;
30. Schmorl G.
31. Sicard A. Lièvre I. Quelques aspects nouveaux du diagnostique et du traitement de la sciatique
Ledoux L.
- Shamburov D.A.
32. Shamburov D.A.
33. Shenk A.K.
34. i Kagan M.N.
- Thurel R.
- 35.
- Pojasnicno-krestcovie radikuliti, nevriti nevralgii,
Opit sovjetskoy medicini v Velikoj Otjecevenoj
Vojne 1941-1945 g.g. 1949,26.
- Radiculite du S2 et hernie discale. Acta Neur. et Psych. Belgica, 1950,
52,9.
- Les spondilites
La revue du medecin praticien 1961,XI,3537-3541
- Les douleurs rachidiennes du rhumatisme
La revue du medecin praticien 1961,XI,3585-3589;.
- Nevralgias sciatiques diorigine discale.
Concours medical, 1957,32
- Zabolevanija pojasnichno-krestcovovo otdella nervnoj sistemi f. f.
44-64, 125-134 Medgiz 1961.
- Diagnostika i lečenje grizh mepovonočnovo diska Voprosi Neurohirurgi, 1952, I
- Algic rachidienne et medecine psychosomatique
La Revue du praticien, 1961, XI, №. special, 3496-3535.
- Douleurs et malformatins du rachis Ibidem 3609-3617
- Le traitement de la sciatique
La semaine des hopitoax des hôpitaux de Paris, 1955, 58
- Sporne voprosi kliniki i patogeneza pojasnichokrescovovo radikulita.
Voprosi nejrohirurgii, 1957,4
- Rupturē of lumbar intervertebral disk. Ann. Surg. 1934,4.
- Pojasnichaja diskalgija – Zhurnall Nevrollogii i Psihiat. im. Korsakova, 1963, 63, I, 31-36.
- M. nijkotorie spornie voprosi patogeneza t.n. radukulitov. Izdatelstvo Akademii Nauk Gruzinskoy SSR Tbilisi 1960
- Stato attuale delle discopatie.
Progresso Medico 1963, 19, 261
- Dvuhstoronjaja nevrollogičeskaja simtomatika pri patologiji pajasnich diskozov
Zhurnall nevropatologii i psihitrii korsakova 1767-1774
- Bearbeitet von Jungans H. Die gesunde und kranke Wirbelsäule im Röntgenbild und Klinik. 1951.
- Quelques aspects nouveaux du diagnostique et du traitement de la sciatique
Concours Medical, 1956, II.
- Ishias, 1954, Medgiz.
- Spinomozgovaje zhiktost
Medgiz, 1954.
- Lomboiskiljiga i jejo ortopedičeskaja osnova v svete sovremenih danih. V. sb. Ljumboiskialgii. Biomedgiz. M. L. 1937.
- Sciatique tronculaire et sciatique radiculaire.
Rev. Neur. 1949, 71, 10.

SOME CLINICO-STATISTICAL DATA ON CASES OF DISKOPATHY IN THE MILITARY HOSPITAL OF TIRANA (1954-1963)

(Summary)

The author analyses for a period of ten years (1954-1963) the cases of pain in the lumbosacral region, among which an import anplace take the afflictions of the vertebral diskax, From 260 case histories (with radiculitis lumbosacralis, lumbago lumbos-ischialgia, ischias etc.), 153 (58 percent) should be considered as diskopathy. Only in 15 percent of themthe anamnesis contains a traumatic factor; 65 percent had severe pressure on the backbone, 12 percent had cold or fatigue, 8 percent had no apparent cause.

In all the diskopathic cases the pains began suddenly and were continuous, with irradiations along the ischiadic nerve; in 11 percent of the cases the irradiation of the pain was in both legs; in 7 percent the pain passed from one leg to the other; in 5 percent the pain remained localized in the lumbosacral region without any irradiation.

Sensory troubles in the form of light paraesthesia were noted in 40 percent of the cases, hyperesthesia of the radicular type in 85 percent. In 95 percent of the cases the pain could be provoked by percussion of the vertebrae L4, L5 and S1.

The author noted alterations of the achilean reflex in 58 percent of the cases. Tonic reflexory symptoms with tension of the extensor muscles of the back were registered in 85 percent of the cases; 20 percent had light scoliosis; 95 percent walked in an antalgic posture; 80 percent relieved their pain by walking on tip-toe, eliminating at the same time the need of the antalgic posture. For this reason the author considers the tip-toe walk as a diagnostic test and as a means of treatment.

In 7.8 percent of the cases the neurologic phenomena were bilateral.

The complementary examinations gave the following results:

a) X-ray examination in 82 percent of the cases; 60 percent had no appreciable changes; 16 percent had spondylosis, 10 percent spondyloarthritis, 3 percent spina bifida, 7 percent sacrolysis, 4 percent lumbolysis.


b) Lumbar puncture in 60 percent of the cases: 3.3 percent had proteinocytopathic dissociation with proteins over 0.1 percent and cells 2-7 per mm³; in 30 percent of the cases the proteins attained 46 percent, whereas in the rest the liquor was normal.

c) Myelography was done in 3.4 percent of the cases which had apparent signs of diskal hernia.

Of the patients that had insupportable pains in the sacro-lumbar region 4.2 percent had hysterical lumbargia, 4.2 percent a beginning of tubercular spondylitis and 24 percent - vertebral rheumatism.

In the author's opinion the term diskopathy or diskostis is of much help from the etiological, diagnostic and medico-legal viewpoint.

From the group of diskopathy should be distinguished the diskal hernia, which should be subject to neurosurgical intervention; according to the anatomo-pathological data they form 3.9 percent of all the cases of diskopathy.



MBI TERAPINË NË MJEKIMIN E SKIZOFRENISE

PROF. XHAVIT GJATA

(Klinika e psikjatrije — shfisi i klinikës Xh. Gjata)

Si shumë probleme të tjera të mjekekisë edhe mjeekimi i skizofrenisë ka bërë evolucionin e vet. Terapia e vërtetë e kësaj sëmundjeje që bëri revolucion në gjithë kompleksin e saj është terapija aktive e cila ka rreth tri dekada jetë. Edhe ne, që në vitin 1939, kemi fillojë të aplikojnë metodën aktive të mjeekimit të skizofrenisë, që në atë kohë kemi përdorur pireto-terapinë me esencë terebentine, etj. sulfozinën, molarotropinën, kardiazolterapinë. Më vonë sidomos nga viti 1948, fillojë aplikimin e insulinoterapiesë somnoterapisë dhe të elektroshokut. Gjashtë vjetët e fundit vumë në jetë edhe metodat e njëjtimit me anën e psikoleptikëve. Gjatë viteve 1939 deri në 1948 mjeekimi është bërë me metoda të ndara. Me krijimin e repartit të psikiatrije në Spitalin e Tiranës në 1948 dhe vëçancën me krijimin e klinikës së fakultetit, fillojë të bëjnë një mjeekim kompleks të të sëmurëve me skizofreni duke kombinuar njëra mbas tjetrës insulinoshokun, somnoterapinë, dhe elektroshokun. Kemi bërë në të njëjtën kohë insulinoterapinë me elektroshokun, osc kombinim të këtyre metodave me preparatet e rauvollë serpentina dhe psikoleptikët.

Nga 370 rastet tonë, 310 janë mjeekuar me elektroshok, 218 me insulinë, 108 me rausedil dhe serpazil dhe 172 me neureleptikë si klorpromazinë, largaktil, torazinë, kompasinë, stelazinë. Insulinoterapia është përdorur nga ne në këtë mënyrë: Kura fillohet dy ditët e para me nga dhjetë unitete insulinë në ditë, pastaj bëhen vetëm pesë unitete qëdo ditë gjer sa bis në komë. Të sëmurët ndahen në dy grupe: një pjesë e tyre janë mjeekuar me gjendje komatoze të lehta, kurse shumica e pacientëve është lënë në komë të thikë që ka zgjatur nga gjysëm ore gjer dy orë maksimum. Numri i gjendjeve komatoze për një kurë 45 gjer në 60, dhe më rrallë gjer në 70 seanca. Kemi vënë re se kur kemi përdorur metodën e komave të thella zakonisht kemi patur remisione dhe përmirësimë më të theksuarë. Në të sëmurët që kanë paracitit gjatë terapisë kontraksione muskulare, insulinën e kemi kombinuar me barbiturate, një natë përparrë kemi ikuanduar 6 ose 10 centigram luminal, në rastet më të rënda kemi injektuar gr. 0,20 luminal intramuskular. Në shumë raste për qetësinë e këtyre kontraksioneve kemi injektuar edhe adrenalinë ose gjer në 5 ampule vitamina B₁ nga 50 miligram. Përdaljen e pacientëve nga gjendja komatoze në kemi përdorur rrugëna nazale, duke hedhur me sondë zakonisht shiroq 200 gr. (sheqer 6 pjesë dhe ujë 4 pjesë); kur pacienti nuk ngrihet kemi bërë 30 cc glukoza 40% intravenc. Kur është vonuar zgjimi janë injektuar gjer 300 cc, glukoza 40%. Gjatë kurës me insulinë është patur parasysh parimi që për çdo unitet insulinë nevojiten 2 ose 3 gr. sheqer dhe kur sasija e insulinitës i kalon të 60 unitet, atëherë jepet 1 gr. sheqer për unitet insulinë. Gjatë mjeekimit me insulinë përmirësimi i sëmundjes ka ardhur në mënyrë graduale, dhe në mbarim të kurës pacientët kanë qenë shpesh herë në remision të plotë. Si komplikacione më të shpeshta nga insulinoterapija ne kemi patur pneumonija nga aspiracioni i pështymës ose i shiropit. Nga njëherë kur i sëmuri nuk e ka ngrënë plotësisht ushqimin ose kur e ka vjellë, ka ndodhur që të bjerë përsëri në komë mbas 2 gjer më 10 orësh. Mjeekimi edhe në këtë rast bëhet me glukoza intrav. më 40%. Si gjatë eksperiencës sonë ashtu edhe në literaturë janë vërejura raste vdekjesha nga komë insulinike. Dista aerore provojojnë se për çdo 500 të mjeekuar ngjet 1 vdekje. Ende mbanet problematike vdekja nga insulinina, shkaku është toksiciteti i preparatit, një e forcave mbrojtëse të organizmit, cëdema akute e pa pritur e trurit apo mikrohemoragjji. Në gjendjet komatoze insulinike të thella që kanë zgjatur mbi 24 orë, janë aplikuar glukoza 40%, kardiostenikët, antibikët magnesium sulfurici 25%, solucion skopolaminë 1%, klorpromazina me injekcion, luminali sub-kutan, vitamimat pp, B₁, B₁₂, noradrenalinë dhe lobelins. Kolatë e fundit një sukses të madhi na ka dhënë në kohën e zgjatur hidrokortizoni intravenoz deri 100 miligram në ditë.

Një vënd të posaçëm në mjeekimin e skizofrenisë ka zënë edhe terapia me elektroshok. Në përgjithësi është fillojë me 60 volt, dhe rrallë herë është arritur në 120 volt. Të sëmurëve

o kemi bërë gjithësej 12 gjer në 25 seancë. Zakonisht kemi aplikuar më qdo dy ditë një seancë elektroshoku. Gjatë këtij mjekimi kemi takuar shumë rrallë këto komplikacione: Disa pacientë kanë patur luksacione të mandibulës, të cilat janë reponuar me një herë; shumë të rralla kanë qënë luksacionet e kökës së humerusit një rast ka qënë me frakturë të baçinjës, një me frakturë të coli femoris dhe një me frakturë të kolonës vertebralë. Në një pacient mbas një seancë elektroshoku u çlaq hëmiparçza tranzitore për disa orë e shoqëruar me afazë.

Rezultatet e elektroshokut kanë qënë të mira, në mënyrë të veçantë në format katatonike dhe haluzinatore paranoidë. Ky mjekim brënda scancave të para jep përfundimë të mira me remision të plotë por myftë herë ky remision është tranzitor; pas disa javëve rifillojë përsëri fenomenet psikotikë. Kurse me insulinoterapinë remisionet janë shumë të gjata; një gjë të tillë e kemi konstatuar sidomos atëherë kur ne kombinojmë elektroshokun (12 seanca) dhe pasaj aplikojmë insulinën, ose kur vepërjojmë duke përdorur dy herë në javë sismoterapinë gjatë kurës së insulinoterapisë.

Këtu nuk po përmendin mjekimet me kardiozolterapinë dhe somnoterapi për arsyet se në kohën e sotme pothuaj se janë lënë si të pa vlefshëm.

Një vënd të rëndësishëm në injektimin e skizofrenisë gjatë gjashtë vjetëve të fundit në klinikën tonë ka patur edhe terapija me preparatet e reuvolfia serpetina sic është rezerpina si edhe me derivatet e fenotiazinës së janë klorpromazina, komazina, stelazina. Serpazili ose rezerpina janë përdorur duke filluar me 1/4 mgr. dho doza është rritur gjer në 6 mgr. në ditë, doza mesatare ka qënë katër cse pesë miligram pro ditë, dhe kura është vazhduar rreth 100 ditë. Nga një herë gjatë përdorimit të këtyre preparateve kemi parë ulje të tensionit arterial dhe sindromin parkinsonik, këto simtome shduken me ndalimin e medikamentit. Në këtë rast si mjekim: përdorim vitaminat B₁, B₆, B₁₂, PP, C, kafezinë, strikininë, solucion gluukozi 40% dhe dezoksiko-kortikosteron acetat me anë të injekzionesh. Disa autorë kanë dhënë gjer 15 mg. rezerpinë në ditë. Pasi imbaron kura themelore në spital, i sëmurë ka vazhduar mjekimin në shtëpinë e tij me dy cse tre mgr. në ditë, kjo qubel kurë mbajtëse (mantehimenti) e cila vazhdon gjashtë muaj gjer në dy vjetë. Disa autorë e gjenin të nevojëshme që këto preparate të kombinohen me sasira të vogla hipnotikësh. Gjatë mjekimit me derivatet e rauvolfia serpetina nuk këshillohet në as një mënyrë mjekimi me elektroshok. Nga observacionet tona rezulton se këto preparatë veprojnë në mënyrë pozitive si në format akute ashtu edhe në ato kronike të skizofrenisë. Këto medikamentë kanë toksicitet të vogël dhe jashtë rezultate të mira sidomos kur përdoren dozat mbajtëse për një kohë të gjatë. Po ashtu përdoren me sukses gjatë remisjoneve për të parandaluar racidavit.

Prej vitit 1958 në mënyrë sistematike kemi filluar të mjekojmë të sëmurët skizofrenë me forma akute dhe kronike me klorpromazinë dhe derivate të tjera të fenotiazinës. Skeinë që përdorim në klinikë është si vijon: e fillojmë me 25 mgr. me injekcion intrantuskular për një javë kur arritet në 300 mgr. ose 400 mgr. medikamentet jepet nga goja.

Zakonisht klorpromazina jepet në 3 doza në ditë. Kura vazhdou rreth 100 ditë, dhe pas-taj vazhdon për 6 gjer 24 muaj kura e mbajtjes me 75 mgr. gjer 200 mgr. në ditë. Ka autorë që arrinjë edhe 800 mgr. e nuk të përpjek klorpromazinë në 24 orë. Kështu p.sh. Koldman thotë se rezultate më të mira ka arritur me dozë maksimale ditore 800 mgr. largakti të vazhduar për 4 gjer 6 muaj. Autorë të tjera kurën e mbajtjës e vazhdojnë 900 ditë.

Gjatë mjekimit me neuroleptikë ne kemi parë edhe fenomene anësore, në shumicën dërmuese të pacientëve vërehet një eritemë e lekuret në vënder që i prek dielli, në dy raste kemi patur hepatite toksike me ikter. Kur pacientët nuk kanë qëndruar shtrirë dhe sidomos në filim të mjekimit kanë çlaqur gjëndje klopateide, hipotonitë të presionit arterial, adinimë të rrallë, është vënë re vomitus dhe diare. Simptomimë tipik në rastin e dozave të mëdha është sindromi parkinsonik, i cili është një konstatim po thujë në të gjithë rastet. Sindromin tipik të Delay nuk e kemi konstatuar, ky sindrom konsiston në filim me palëvizmëri, pastaj me sindromin hipertonikët në qafë, gojë, me vonë qëqet sindromin hipertonik t'i plotë i ngjashëm me parkinsonizmin por këtu pacienti ka nevojë të lëvizë si një automat. Këtyre sindromave u ngjitet sindromi depresiv si edhe ai neurovegjetativ me pështymë të shumtë, djersë, bradikardi, hipotension. Edhe përsa i përkert numurit të saktë të këtyre fenomeneneve kollaterale do të përshtkuhet në një studim tjetër të mëvonshëm. Vitet e fundit kemi preferuar kombinimin e psikoletikëve, duke përfshirë grupin e fenotiazinës dhe të rauvolfia serpetina, me insulinën. Sipas herë kemi shtuar edhe elektroshokun. Kur është imbaruar një kurë është vazhduar tjetra.

Shumë autorë, sot janë të mendimit se klorpromazina është në gjendje t'i spostojë kurët me insulinoshok etj. në mjekimin e skizofrenisë. Kështu p. sh. Cade & Herich shkruajnë se injekimi me klorpromazinë i skizofrenisë është aq efikas sa që nuk ka më nevojë për të përdorur ractodat e tjera. Phili përkundrazi mendon se insulinoterapia dhe elektroshoku mbeten si kurat më të mira. Tarasov Ju. K. mendon se si insulinë edhe klorpromazina jashtë efekte të nejshëm rreth 50% remisione të thella dhe përmirësimë. Po kështu Serajski U. Ja. dhe Galenka V. E. kanë patur përmirësimë të theksuara nga aminezina, Zhislin S.G., Ra-skin I.G., Tarasov Ju.K. vënë në dukje se mjekimi me aminezinë, jep rezultate të favorëshme në të sëmurët me një dekurs të gjatë dhe të vazhdë është skizofrenë. Ashtu si kanë shkruar autorët e ndryshëm edhe ne dalim me të njejtit konklikacione se forma katatonike e skizofrenisë ka prognozën më të mirë që forma simpleks është ajo që ka prognozën më të keqe.

Nga 370 të sëmürët tregë 94 janë me remision, 59 me remision sociale, 90 me përmirësim, 115 të pa shëruar dhe 12 vdiqën. Nga numri i përgjithshëm i të sëmürëve 103 kanë patur nga një recidivë, 43 me dy recidiva, 23 me tre recidiva dhe 26 mbi katër recidiva. 151 pacientë janë në gjendje terminale (gjendje pa lëkundje të theksuar, që ka marë stabilitet). Shuma më e madhe e të sëmürëve tonë përbëhet nga forma katatonike me 148 pacientë dhe nga forma halucinatore paranoide me 102 pacientë. Shifrën më të madhe të remisioneve dhe të rëmisioneve sociale e përbëjnë të sëmürët me katatonë, 85 veta në 148, ndërsa forma simpleks e skizofrenisë ka numrin më të lartë, 42 të pa shëruar në 50 pacientë.

a) Simbas eksperiencës sonë rezulton se kombinimi i insulinës me klorpromazinë të aplikuar njëra mbas mbartimit të tjetrës është mjaft e efektishme me qenë se njëra metodë potentializon veprimin e metodës tjeter.

b) Po të krahasohej të ndara këto 2 metoda mund të themi se janë efikase në të njëjtën mënyrë.

c) Simbas eksperiencës sonë insulinoterapia jep remisione të plota dhe të gjata më të mira format ekipozitivë me dekurs të zgjatur dhe në format kronike.

ç) Nga njëherë kombinimi i insulinës, psikoletikëve dhe elektroshokut na ka dhënë rezultate edhe më të mira në rastet persistente, kur metoda e veçuara kanë qenë të pa fuqishme.

đ) Në format halucinatore paranoide, hebephrenike dhe katatonike insulinë e kombinuar me neuroleptikët ose edhe me elektroshok na ka dhënë remisione totale dhe sociale mjaft të rëndomtë.

dh) Efikaciteti i terapisë varet nga zbatimi i përpikët i dozave të përshtatësimeve p.sh. 300 gjer 400 mg derivate të fenotiazinës dhe 4 gjer 6 mg reserpine të vazhduarë gjer në 100 ditë, dhe pastaj me terapi mbajtëse për 6 gjer 24 muaj, si edhe me 45 gjer 60 scanca gjëndjeje të thellë komatoze lidhur me insulinoterapinë.

(Paragjitur në Redaksi më 5.X.1964)

BIBLIOGRAFIA

- 1) *J. Delay, P. Deniker etj.* La presse medical Janar 1959 Nr. 4, Nr. 6 faqe 123-126, faqe 201-203
- 2) *J. Laboucaire, O. Lacassin, P. Barres.* Annales medico-psychologiques. Janar 1960 faqe 21-46
- 3) *J. Piette.* Annales medico-psychologiques Maj 1960. faqe 1003.
- 4) *J. Piette, A. de Schaeppiwer.* Annales medico-psychologiques Frur 1961 faqe 380-381.
- 5) *E. Evrard.* Annales medico-psychologiques Prill 1961 faqe 793-794.
- 6) *Follin, Chanoit Pilon, Huchon.* Annales medico-psychologiques Maj 1961 faqe 967-983.
- 7) *J. Trillot, J. Noyer* — Dhjetor 1961 faqe 990 Annales medico-psychologiques.
- 8) *R. Chevallier.* Annales Medico-psychologiques. Dhjetor 1961. faqe 1006.

THE TREATMENT OF SCHIZOPHRENIA

(SUMMARY)

This article analyses 370 cases of schizophrenia treated by different methods:

310 — with electroshock

218 — with insulin shock

108 — with rauseudyl and serbasiil

172 — with neuroleptics (chlorpromazine, thorasin, compasin, stellosin,).

The conclusions of the author on the results of the treatment are the following:

a) The combination of chlorpromazine and insulin, given alternatively the one after finishing the other, has been satisfactory, since the one drug potentiates the other.

b) The two methods compared separately have approximately the same effect.

c) We have the impression that the treatment with insulin gives more complete and long remissions, especially in chronic and more protracted cases.

d) Sometimes the combination of insulin with psychotropics and electroshock has given better results in persistent cases, when isolated methods have had no effect.

e) In the paranoid forms with hallucinations, hebephrenia and catathexy insulin combined with neuroleptics and electroshock has given total remissions.

f) The effect of the treatment depends upon the accuracy of the doses that should be combined, for example 300-400 mg phenothiazin derivates and 4-6 mg reserpine to be continued for 100 days, and after that to follow with a maintenance therapy of 6-24 months with 45-60 sessions of comatous state caused by treatment with insulin

FLORA MYCETARE E TRIHOMYKOZAVE NË QYTETIN DHE RETHIN E TIRANËS

MIHAL CARIDHA

(Katedra e Dermato - venerologjisë — Shef Prof. K. Kerçiku)

Studimi i myknavës në përgjithësi, kohët e fundit, shumë autorë i kanë dhanë randësia madhe, me qenë se asht vje re pëchqapja e tyne, sidomos e epidermositivë dhe kandidomykozave të lëkurës dhe viscrale nga përdorimi i gjanë i antibiotikeve.

Një konditë e randsësishme për lëshimin e trihomoykozave (trihofiti, mikrospori dhe favus), është studimi i florës mycetare. Me anë të studimit, zbulohen iset dhe speciet e ndryshme të këpurdhavje parazitarë, që shkaktojnë këto sëmundje. Asht e ditum, se sëmundjet parazitare të lëkurës shkaktohen nga shumë lloj myknash patogjene. Kuadri klinik që shkaktojnë këta parazitë, është shpesh i njëjtë për speciet e ndryshme. Nga ana tjetër edhe me anë të ekzaminimit mikroskopik nëk mund të bahet diferençimi i tyne. Kjo gjë mbrijhet duke bërë analizat bakteriologjike. Diagnosa kulturale (etiologjike) e trihomoykozave caktion qartë edhe erigjinën humane apo zoofile të tyne, gjë që të orienton shpejt për burinim e infeksionit si dhe për masat antipepidemike që duhen marrë.

Studimi shkencor i florës mycetare, ka fillue nga fundi i shekullit të kaluem, themeluesi i të cilit është R. Sabouraud (1864-1938). Të gjitha vendet e Evropës, ndërmjet tyre dhe ato të Ballka it, njëjtin tashmë mërishtetet e speciet e parazitëve që shkaktojnë trihomoykozat në vendet e tyne. Njofitimet e para mbi florën mycetare në vendin tonë, janë dhanë në studimin «Dermatomykozet në Shqipni», në vitin 1955 nga prof. K. Kerçiku dhe Doc. Z. Kakariqi, që asht pasues nga dy artikujt tonë. Mendojmë se, edhe për vendin tonë, ka ardhë koha që të bahet një studim shkencor i florës mycetare. Studimi i florës mycetare të trihomoykozave në qytetin dhe rrëthin e Tiranës, bashkë me depistimin dhe mjekimin e të sëmundnëve, ka fillue në vitin 1960 dhe ka vazhduar deri në qershor të vitit 1964.

Grumbullimi i materialave patologjike, mbjellja e tij, si dhe diagnostikimi i kolonive janë ba nga ne, në laboratorin mykotik pranë Spitalit Klinik Nr. 2.

Për kultivimin e kolonive të parazitëve, kemi mbjellë flokë të sëmundjeve, skuama dhe thonj, por ma rrallë pës nga elementet profunde të trihofitës. Materjalin patologjik, para se mo e mbjellë e kemi coptue në copa sa ma të vogla, tue vendos 2-3 pjesë në një epruve të, në distancë 2 cm. larg nga njana tjetra. Mbjelljet i kemi ba në terrenin ushqyes agar glukoze Saburo. Që të mos zhvillohen dhe koloni të bakterieve të ndryshme, simbas përpunimit të Popov I. S. dhe Mishchenko L. I, këtij terreni i keni shtruc dñe levomycetine 0,1% si dhe Vitamin B₁ tue logarit 1 mil për liter. Për zivillimin e kolonive, në kohë vere, epruvatet i kemi lari në temperaturë të dhomës, kurse në dimër i kemi vendosë pjesërisht në termostat dhe një pjesë tjetër në ambient të ngrohtë. Kohët e fundit të gjithë materialin e kemi vendosun në termostat.

Gjatë periudhës në studim, nga të sëmundët e konstatuam në qytetin e Tiranës, mbjellen e materialit patologjik e kemi marrë prej 338 veta. Prej këtyre, kanë mbimë 211 herë, baras me 62,3%, fise dhe specie të ndryshme të dermatofiteve. Prej 74 mbjelljeve të tjera, ose 21,8% janë zhvilluar koloni të tjera, kurse 53 herë, baras me 15,16%, nuk ashië rrit asnjë lloj kolonijo.

Nga 211 epruveve në të cilat janë zhvillue dermatofitet, 116 herë ose 54,9%, ata kanë qenë të pastërtë, kurse 95 herë ose 45% është me ta janë rrit dhe koloni të hueja. Prej 13 të sëmundnëve janë zhvillue taga 2 specie të ndryshme dermatofitesh, dhe prej 198 të tjerëve, kanë mbimë nga një specie. Zhvillimi i kolonive të dermatofiteve asht ba simbas përshtkrit që e janë shumë autorë (Bruchus dhe Alexander, Pinetti etj.).

Specien ma tē shpeshtë që kemi diferençue, ka qenë *Tr. violaceum*. Ajo ka fillue me mbimë zakonisht mbas 5-7 ditëve si asht mbjellë dhe nga fundi i javës së trete, kolonia e saj asht zhvillore komplet. Ma vonë ose kanë qëndrues për njifarëkohë (veth dy jave), pa u ndryshme ose shpejt kanë pësue ndryshime polimorfike dhe pleomorfike, tue u mbulue me push të gjatë, të hollë dhe të dendur. Në epruvatat që janë mbi një ambient të ngrohtë, por jo konstant, kemi konstatuar fillimin e mbirjes mbas 10-15 ditë ose ma vonë, mbi janë mbjellë. Shpesht kolonitë fillostanë kanë pas ngjyrë si të verdhë me një duancë roz dhe ma vonë asht zhvilluo pigmenti i tyne karakteristik, që ka ngjyrë violet, prej ku kolonia ka marrë edhe emrin. Intensiteti i ngjyrës së pigmentit, ka ndryshue shumë, tue fillue nga ngjyra violet e zdehië deri në violet intensive. Shpesht kolonitë që në fillim të mbirjes kanë pas ngjyrë violet të theksuarë, e cilë ka ardhë gradualishë tue u ba ma intensive dhe kanë marrë nuancë të errët. Kemi vërejtë dite koloni që, në qendër kishin ngjyrë violet, kurse periferia e tyre kishin ngjyrë të verdhë si dylli. Veçori të tjera të kolonive tonë, sikurse kë vërejtë dho Pinerit, kanë qenë mbulimi i tyne me një velo të hollë prej pluhuni të bardhë, koloni të vogla apo gjigande etj. Kolonitë kanë qenë gjithmonë të ngritura mbi nivelin e terrenit, me kulli të qarri dhe po degëzimë në thellisë të terrenit. Forma e kolonive ka qenë ovalë ose e stërgjatun, po shpesht në anjet kanë pasë thellime të shumta dhe t'ima, që i pëpërt kolonive parjen e llojeve të brengut të dotit. Sipërfaqja e kolonive ka qenë e lëmuar apo me brazde të rralla, por shpesht kemi vërejtë edhe shumë rudha t'ima, të çregjulta dhei zik-zake. Nga ekzaminimi mikroskopik i kolonive të *Tr. violaceum*, konstatuam shumë micela të gershetueme në formë lizhoshë, të cilat kishin pësue ndryshimet përkatëse, simbas vjetërisht së kolonive. Mikrokondide apo aleuri vumë re rallë. Varianti decalvans i kësaj specie, si nga ana makro dhe mikroskopike, ka pas karakteristikat e *tr. violaceum*. Të njëjtat veçori kan pas dhe kolonitë *tr. gibarum*, vetëm se në to nuk asht zhvillue pigmenti ngjyrë violet.

Kolonitë e *tr. ochraceum*, që Bodin (cit. Brubus, Aleksandër e ka qujt dho *tr. verrucosum*), kanë fillue me mbimë mbas 7-9 ditëve dhe janë zhvillue komplet mbas 2-3 javësh. Në fillim kolonitë kanë qenë të sheshta, të thata, ngjyrë të bardhë — gri dhe me pak brazda jo të thella. Ma vonë, ato janë zmadhuc, kanë marrë formë gëjsëm sfere, me sipërfaqe të ashpër, të thate dhei me brazda të thella që të ipso përshtypjen e një verruce vulgare. Mikroskopikisht konstatuem micela të trasha, të segmentueme si dhei me pak klamidospor.

Në materialin tonë, kulturat e *tr. gypsum*, kanë fillue me mbimë mbas 3-4 ditëve dhe komplet janë zhvillue nga dita e tetë deri dyshëm. Kolonitë kanë qenë në formë dhe madhësi të ndryshme, të përbame nga një pluhun i bardhë, i imët, i ngashëm me pluhunin e gipsit. Kemi diferençue tipin asteroid dhe të granuluem. Kuadri mikroskopik i tyre, paraqitet me micela të degëzue, dhei me shumë aleuri. Në majën e micelave vumë re disa fije të përdredhura në formë spirale. Konstatuam edhe makrokondide, që nga forma e tyre, kanë marrë emrin masure (verejena rusisht, Spindel-gjermaoisht). Maja e tyre ishte lehtësishë e mprehte dhe përmbyajshin 2-3 celula të gjana.

Kolonitë e *tr. sulfureum*, kanë fillue shpejt me mbimë dhe brenda dy javëve kanë pushtue gjithë terrenin, tue dalë edhe jashtë tij. Ato përbaheshin nga një push i hollë, i gjatë, ngjyrë të verdhë si të sqafurit. Mikroskopikisht u vumë re fije të holla micelare me fryrje anësore dhe terminale, si dhei masure dhe klamidospor terminal. Gjatë fijeve micelare, kishite dhei konidie të stërgjatuna apo cilindrike.

Tr. Schönlini ka fillue me mbimë mbas 6-8 ditëve. Kolonitë e tij kanë tendencë me u rrit ngadalë dhei mos u bantë të mëdha. Kur ishin sa një kokë gruni, kishin ngjyrë të verdhë si të dylli. Ma vonë ato bafen të thata, me brazhda, prandaj duken si të rudozuma. Kulturat e vjetra shpesht janë mbuluem me pluhun të bardhë. Nga ekzaminimi mikroskopik konstatuem micela të septueme, me mikronidie të rralla dhei me degëzimë në majën në formë «të brinjëve të drejtë të veriu».

Kolonia e mikrosp. Audouinii ka fillue me mbimë mbas 5-7 ditëve dhe shpejt asht rritë Kolonia e zhvillueme kishte këtë paraqitje: i gjithë terreni asht i mbuluem me një shtresë të bardhë prej pushi mjast të imët, me një brazhdë së gjati dhei me pak së gjani. Ekzaminimi mikroskopik të kësaj kolonie nuk ja kemi ba, me qenë se asht dërgue jashtë shtetit për verifikim.

Kolonitë e micr. *gypsum* kanë fillue me mbimë shpejt dhei për një kohë të shkurtën (10-12 ditë), kanë pushtue gjithë terrenin. Ata kishin ngjyrë roze të hapërt — krem dhei me pak brazda në qendër. Mikroskopikisht kishin shumë fije micelare të gjana, të pasuna me konidie laterale, formë ovale si dhei masure të gjana, të shkurtëna me 6-8 celula në brendësi.

Në pasqyrën Nr. 1 po paraqesim fiset dhei speciet e këpurdhave parazitare, që kemi diagnostikue në qytetin e Tiranës.


Pasqyra N. I

Fiora e dermatofiteve të qytetit të Tiranës, mesata dhë seksi i të seminave


| Flora e dermatofitave të qytetit të Tiranës, moshat dhe sekti i tij shtesë | Kolonite mikste | | | | | | | | | | Për qin. | | |
|--|-----------------|---|-----|----|-------|----|-------|---|-------|---|-------------|-----|----------|
| | 0-4 | | 5-9 | | 10-14 | | 15-19 | | 20-24 | | Shuma | tot | |
| | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | |
| Tr. violaceum | 6 | 3 | 54 | 51 | 13 | 12 | 2 | 2 | — | — | 75 | 68 | 143 67.7 |
| Tr. viol. decaly. | — | — | 3 | — | 1 | 1 | — | — | — | — | 4 | 1 | 5 2.3 |
| Tr. crateriforme | — | — | 4 | — | — | 2 | — | — | 3 | — | 7 | 2 | 9 4.2 |
| Tr. cerebriforme | — | 1 | 1 | 1 | 1 | — | — | — | — | — | 2 | 2 | 4 1.8 |
| Tr. scuminatum | — | — | — | 1 | — | — | — | — | — | — | — | 1 | 1 0.4 |
| Tr. gypseum | 1 | 1 | 3 | 2 | 2 | 1 | — | — | — | — | 6 | 4 | 10 4.7 |
| Tr. verucosum | — | — | — | — | — | 1 | — | 1 | — | 1 | — | 3 | 3 1.4 |
| Tr. favif. album | — | 1 | — | — | 1 | — | — | — | — | — | — | 1 | 1 0.9 |
| Tr. sulfureum | — | — | 2 | 2 | 1 | — | — | — | — | — | 3 | 2 | 5 2.3 |
| Tr. Schonleini | 3 | 2 | 2 | 2 | 1 | 2 | — | 1 | — | — | 6 | 7 | 13 6.1 |
| Tr. quinceanum | — | — | — | — | — | 1 | — | — | — | — | — | 1 | 1 0.4 |
| Micr. Audouini | — | — | — | 1 | — | — | — | — | — | — | — | — | 1 0.4 |
| Micr. gypseum | — | — | 1 | — | — | — | — | — | — | — | 1 | — | 1 0.4 |
| Shuma | 10 | 8 | 70 | 60 | 20 | 20 | 2 | 4 | 3 | 1 | 105 | 93 | 198 |
| | | | | | | | | | | | 5 | 8 | 13 6.1 |
| | | | | | | | | | | | 110 | 101 | 211 99. |

Sikurse shifet nga pasqyra, përqindja ma e madhe e specieve që kanë shkaktue trihomykozat në qytet, asht ajo e tr. *violaceum* me 67.7%. Po të shtojmë dhe përqindjen (2.3%) të variantonit decalvans, të cilin Brushe dhe Aleksander, Pinetti, e konsiderojnë si tr. *violaceum*, atëherë kjo specie përbën 70% të të gjithë specieve.

Në studimin e tyre Prof. K. Kërciqi dhe Doc. Z. Kakariqi, këtë specie e kanë kultivuar 90%, nga të sëmuani e caktuave dhe rretheve të ndryshëm, që janë shtrues në patull. Në punën tonë të maparëshme e kemi diferençue 68,2% dhe 84,2% (Caridha 3,4). Autorët jug 8 % e Grin E. I. dhe Ozegoviç L. në Serbi dhe Herzegovinë, tr. *violaceum* e kanë konstatuar 66,63%. Kurse në Maqedoni 48,3%. T. Filkov dhe P. Bocov ne rrethin e Blagojogradskit e kanë diferençue 92%.



Ndër speciet e randësishme asht edhe tr. Schönlein, të cilin ne e kemi diagnostikuar në këtë punë 6.1%, kurse ma parë 5.26% dhe 3% (Cardia 3.4%). Në krahasim me rrëthin e Tiranës, në qytet këtë specie e kemi diferençue ma shpesht, sepse gjatë depistimit disa të sëmënë kanë ardhë nga rrëthi dhe janë vendosë në qytet. Në republikat e përmendurë të Jugosllavisë, autorët e sipërshtenë e kanë diferençuem këtë specie respektivisht 30.65% dhe 11.2%. Autorët bulgarë në rrëthin e Kollarovgradskit thonë se favusi përban 50% të rasteve me trihomykoza, kurse në Turqi asht konstatuar 39%. Në përgjindje shumë të ulët kemi diferençue dermatofitit e fosit mikrosporor (0.9%), që tregon se mikrosporia asht shumë pak e përfshapun në qytetin e Tiranës. Interesant asht fakti se ky infeksion ka ardhë tu u shtue kohët e fundit në disa vende si p.sh. në Jugosllavi, B.R.S.S. (Moskë) etj. Nga 27% që ishte në fëmijët e shkollave të distrikut të Beogradit mbas luftës së parë, ka arrit në 93% mbas luftës së II-të (Grin, Ozegoviç). Në Maqedoni këta autorë tr. (micr.) ferrugineum e kanë konstatuar 48.3%, kurse micr. Audouini 1%. Ziseman V. E. në Bashkimin Sovjetik (Moskë) ka vërejtë shimin e të sëmënëve me mikrospori që në vitin 1960 ata përbajshin 73% të të gjithë të sëmënëve me mikroza të kokës. Micr. *gypseum* ne e kemi diferençue vetëm një herë (0.4%) kurse Alteras I. dhe Avram A. në qarkun e Bukureshtit 27%.



Simbas klasifikimit klinik trihomikoza në qytetin e Tiranës, paraqiten në këto raporte: Trihofilija 92,6%, favusi 6,9%, mikrosporia 2,4%.


Prej të sëmënëve të zbuluar në rrëthin e Tiranës, mbjelljen e materjalit patologjik e kemi aplikuar nga 364 veta, prej të cilëve 234 herë, osc 64,2% kanë mbimë koloni të dermatofiteve. Prej 65 të sëmënëve, baras me 17,5% janë zhvilluar mykna të husj, kurse prej 65 të tjerëve, nuk asht zhvilluar asnjë lloji kolonie. Nga 234 kultivime të dermatofiteve, 164 herë ata kanë qenë të pastërtë dhe 70 herë të kombinuar me koloni të myknave të huej. Në pasqyrën Nr. 2 po paraqesim fiset dhe speciet e diagnostikuarët në rrëthi e Tiranës.

Pasqyra Nr. 2 dhe diagrama Nr. 3

Flora e dermatofiteve të rrëthit të Tiranës, mosha dhe seksi i të sëmënëve

| | 0-4 | | 5-9 | | 10-14 | | 15-19 | | 25-29 | | 30-34 | | mbi 35 | Shuma | Tot. | % | |
|--------------------|-----|----|-----|----|-------|----|-------|----|-------|----|-------|----|--------|-------|------|-----|----------|
| | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | | | | | |
| Tr. violaceum | 3 | 3 | 47 | 55 | 43 | 26 | 2 | 3 | -- | 1 | -- | 2 | — | 4 | 95 | 94 | 189 80.7 |
| Tr. vio. var. dec. | -- | -- | 2 | 1 | 11 | 3 | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | 13 | 4 | 17 | 7.2 |
| Tr. crateriforme | 1 | -- | 1 | -- | -- | 1 | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | 2 | 1 | 3 | 1.2 |
| Tr. cerebriforme | -- | -- | -- | 1 | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | 1 | 1 | 1 | 0.4 |
| Tr. acuminatum | -- | -- | -- | -- | 1 | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | 1 | — | 1 | 0.4 |
| Tr. glabrum | -- | -- | -- | -- | 2 | 2 | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | 2 | 2 | 4 | 1.7 |
| Tr. Schönlein | -- | -- | 2 | 4 | 4 | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | 6 | 4 | 10 | 4.2 |
| Tr. gypseum | -- | -- | 2 | 2 | -- | 1 | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | 2 | 3 | 5 | 2.1 |
| Tr. fav. album | -- | -- | 1 | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | 1 | — | 1 | 0.4 |
| Micr. gypseum | -- | -- | -- | -- | 1 | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | 1 | — | 1 | 0.4 |
| Shuma | 4 | 3 | 55 | 63 | 62 | 33 | 2 | 3 | -- | 1 | -- | 2 | — | 4 | 123 | 109 | 232 |
| | | | | | | | | | | | | | | 2 | — | 2 | 0.8 |
| | | | | | | | | | | | | | | 125 | 109 | 234 | 99.5 |

Kolonitë mikstë





Edhe në Rrethin e Tiranës, specia ma e shpeshtë asht trich. violaceum (80.7%), të cilës po ti shtojmë edhe variantin e saj decalvans (7.2%) përmban 87.9%. Variantin decalvans që në rrethin e Tiranës e kemi diferençue ma shpesht, e konsiderojmë si të veçantë nga trich. violaceum, për kuadrin klinik që ai shbaktion. Bashkë me simptomat e tjera të trihotitës së kokës, të sëmuarë nga asht zhvilue ky variant, kishin edhe vatra atrofike pa flokë, që nuk shikohen nga trich. violaceum.

nja trich. violaceum.
Trich. Schönekei, që ne e kemi diagnostikue në rreth 4.2%, mendojmë të klasifikohet në fisin ahorion, me qenë se kuadri klinik që ai shkakton asht shumë i ndryshëm nga ai i specieve të fisit trihofiton. Vëtëm pesë herë kemi diagnostikuar trich. gypseum, që asht barazi me 2.1%, por që në zonat fshtare Chmel dhe Buhvald e kanë konstatuar 61.3% të trihofitit.

Simbas klasifikimt klinik trihomykozat nē mreth paraqiten si vijon: trihositia 95,25% dhe favusi 4,74%.

Prej materialitë mbledhun nga kafshët me trihofitoze në reth, kemi diagostikue vëtëm dy specie zoofile: trich. verrucosum dhe sulfureum. Nga nji viç i kooperativës bujqësore Fush Preze asht zhvillue trich. vireocephalum.



Gjatë periudhës në studim, prej të sëmënëve të konstatuar në qytetin dhe rrëthin e Tiranës mbijelljet i kemi aplikuar në 702 veta. Prej tyre janë zhvilluar 445 koloni të dermatofiteve parazitare, të cilët 430 herë kanë genë të vetme, kurse 15 herë të tjera kanë mbimë nga dy koloni të specieve të ndryshme.

Edhe si qark, specia ma e shpeshtë që asht zhvillue, ka qenë trich. violaceum, e cila përbën 74.60% të të gjithja mbirjeve. Po t'i shtojmë edhe variantin e saj decalvans (4.94%) atëherë kjo specie zen 79.5%. Në vend të dytë vjen trich. Schöneni me 5.16%, pastaj trich. gypseum me 3.37%. Po rjeshtojmë me radhë speciet e tjera dhe përqindjet e tyne:

Trich. crateriforme 2.09%, Verrucosum 0.67%, Trich. faviforme album 0.67%, Trich. acuminatum 0.44%, micr. gypseum 0.44%, trich. Quinckeanum 0.22% dhe micr. Audouini 0.22%.

Prej 430 të sëmënëve nga të cilët asht zhvillue nga një specie, 401 herë, baraz me 93.2%.

Prej 430 të sëmënëve nga të cilët asht zhvillue nga një specie, 401 herë, baraz me 93.2%.

Prej 430 të sëmënëve nga të cilët asht zhvillue nga një specie, 401 herë, baraz me 93.2%.

Në bazë të klasifikimit klinik, që i ndan trihomykozat në tre grupe, në qarkun e Tiranës ato paraqiten si vijon: trihofitja 93.72%, favusi 6.04% dhe mikrosporia 2.22%.

Konkluzione

1. Trich. violaceum asht kultivuar në qytet 67.7%, në rreth 80.7% dhe në qark 74.6%.
2. Dermatositet me origjinë humane i kemi diagnostikuar 93.2%, kurse ato me origjinë zoofile 6.7%. Prej zoofileve vendin e parë e zen trich. gypseum me 3.7%. Nga njii vjet kemi diferençuar një herë trich. violaceum.
3. Kemi zbuluar për herë të parë në vendin tonë këto dermatofite: trich. violaceum var. decalvans, trich. glabrum, crateriforme, cersitiforme, acuminatum, gypseum, verrucosum, faviforme album, sulfureum, Quinckeanum, micr. Audouini dhe gypseum.

(Paraqitur në redaksi më 20/III/65).

BIBLIOGRAFIA

1. Alberis I. Avram A. «Gribkovaja flora Buharestkoj oblasti» Vest. Der. Ven. Nr. 2, 1961
2. Bruchus C. die Alexander A. «Allgemeine Mykologie» — Në Handbuch der Haut u ge- chlesichtskrankheiten von Jadassohn, vol. XI, Berlin 1928.
3. Caridha M. «Eksperiencia e jonë mbi përdorimin e epiliqës në Klinikën e Derma- tologjisë në të sëmënët me trihomykosë» Bul. U. Sh. T. Ser. Shk. Mjekësore Nr. 2 1960.
4. Caridha M. «Rezultatet e mjekimit të trihomykozave me griezofulvin» po atje Nr. 1 1964.
5. Chmell. Buchvald L. «Profesionalnije dermatomikozi v sjellskom hozjastve» Vest. Der. Ven. Nr. 2 1962
6. Filkov T. Bocov P. Zbornik trudova, tom. v. f. 110-119, Sofia 1959.
7. Grin E. I. Otegoviq L. «Problemi attuali delle dermatomycosi in Jugoslavia» Min. Med. Vol. 50 N. 33 Torino 1959.
8. Kerçiku K. Kakariyi Z. «Dermatomikozet në Shqipni», Bul. Shk. Natyrës N. 3 Tirana 1955.
9. Leone R. «Aspetti micologici, clinici et epidemiologici delle micosi cutanee in Piemonte». Min. Dex. vol. 37, N. 2 Torino 1962.
10. Pinetti P. «Trichophyton violaceum» monografi. Cagliari 1962.
11. Popov J. S. Mishchenko L. Y. «V Metodika k razvitiu cisti kultur ot bakterrii». Vest. Der. Ven. N. 10 1962.
12. Ziserman V. E. «Izmenjenija Gribkovoj flori Moskvi za 15 let», Vest Der. Ven. N. 10 1962.

THE MYCETIC FLORA OF DERMATOMYCOSIS IN THE CITY AND DISTRICT OF TIRANA.

(SUMMARY)

This work was done during the mass survey and treatment of dermatomycosis in the period 1960-1964. Material from the lesions was inoculated to the glucose-agar medium of Sabouraud, enriched with levomycin 0.1% and vitamin B₁ 1mg per liter.

From the materials from patients of the city of Tirana were isolated 221 cultures. The most frequent type found was Trichophyton violaceum (67.7%), which together with its variant decalvans (2.3%) reached 70% of the cases.

(1961), takohet me shpeshtë në familje 0-2 vjeç. Me fijim shumë akut, kolle, dispne, cianoze, farngotrakciit gripal; vështirësi në thithje të gjirit. Në autopsi, zona të vogla të kuge të errëta të dendura të alternuara nga zona të paprekura. Histologjikisht në mushkëri: Lezione është intersticioam, parekima e trashur dhe e infiltruar me infiltratë limfocitarë dhe elemente të qelizave të rendit konxunktiv në evolucion, edemë akute interstitiale dhe hiperemi e paktë (doçent Bittu në materialin tonë), ose septjet interalveolare të trashura për së tepërmil, në disa zona me parete infiltruara dendësisht nga element mononuklear; vazat interseptale në disa zona të zgjernara të obushura me eritrocite. Alveolet me dimensione të ndryshme me septe të çarrës. Infiltrate të dendura mononuklearë peribronkiale (Dr. Çesk Rroku në materialin tonë). Në materialin e Bernard Stüriberg histologjikisht ka patur zgjorim edematoz të septeve interalveolare me infiltration mononuklearë dhë edemë peribronkiale, dhe më rrallë, grumbullim i septeve të poli dhe mononuklearëve, alveole të kolabuara osc i lumenit i lumenit alveolar nga likidi i edemës dhe celules eksfoliatore.

Bronkopneumonite: Sidomos në fëmijët e moshës së gjirit me gjithë se përfekt të anti-biotiko-terapise proguza e tyre është më e mirë, prap se prap nuk janë rradhur shumë për arësyte të relit të madh që në çfaqjen e kësaj sëmundjeje luajnë faktoret debilitonjës predispozonjës: ushqimi i pa përshtatshëm, distrofi, iopvaminoze veçanërisht rritjeshë dhe sëmundje të ndryshme, grip e tjera ato të vijave të sipërme respiratore rrufë, faringo-trakeobronkite si dha faktoret bashkëveprues të rastit të ambientit të Jashtëm, stina e dimrit, të stofhit, komplikacion sekondar të cilëve është dhë vetë bronkopneumonia siç dihet botërisht. Edhe bronkopneumonija në fëmijët e kësaj mosha është oligosimptomatike, temperaturë e paktë, dispne, cianoze, kolle, dhe gati gjithmonë vështirësi ose pa qejf në kapjen e gjirit, kuadri anatemopatologjik i këtyre bronkopneumonive bakteriale ruk ka pësuar ndryshime substanciale, vev atyre që i takojnë gradës dhe shtrirjes së procesit në këto raste nga të cilat asnjë ruk i ishte nënshtruar antibiotiko-terapise.

Dy fjalë vëcas, për një sëmundje që vitet e fundit është vëçuar si entitet nosologjik i ri midis pneumopative akute infektive (që ne i kemi konstatuar 9 raste). Këtë entitet autorët francezë Bariethy dhe Choubrac, e quajnë «Bronkopneumopati akute dispneizante» ose «Bronkioliti akut sofokant», dhe që në të kaluarën njihesh si një infeksion kataral ose purulent që shtrihesh deri në bronkiolet, kurse tashti dihet se intereson dhe parekimen polmonare dhe në mënyrë shumë të përhapur, që prek fëmijët e moshës 0 deri 1 vjeç dhe deri 2 vjeç. Me etiologji virusale (virus sincial), bakterikemikotike, parazitare, dhe simbas B.D. Ackerman, në disa raste nga shkaqe alergjike, «Bronkioliti sofokant» çfaqet në këtë fëmijë mbas një stofhje ose mbas një gripi me një kuadër morboz të rëndë që karakterizohet nga dispne me tirazhe, cianoze, dispne të thjeshtë, aritmë respiratore dhe komprometim serioz të gjendjes së përgjithësme, me mortalitet të madh (Bariethy Choubrac).

Në anamnezën e afërtë, shenja predominonjëse në rastet e pëershkruese nga B.D. Ackerman është kolla dhe po kështu në rastet tona (N. 19/64, N. 17/64, N. 21/63; N. 16/63). Temperaturë febrile e lartë (G. Fanconi) ose dhe e paktë (B.D. Ackerman) ose pa shenja klinike të diktuarë siç janë dhe disa nga rastet tona (N. 45/62, Prot. N. 29/64; N. 41/63; N. 66/62).

Reperti stetoakustik simbas këtyre autorëve ekspiratori i zgjatur sibile ekspiratore, ranioli të holë ekspirator (B.D. SD Ackerman). Leukocitet në normë, respiracion superficial, lëvizje të fletëve të hundës, cianoze dhe zbehje (G. Fanconi, G. Fronia).

Në disa nga rastet që pëershkrueamë (45/62, 29/64, 41/63, 2/63) ka patur cianoze dhe konvulsione. Në autopsi: bronket e mëdha të enjtura ose jo, dhe kryesishë atelektazi polmonare dhe pika të verdhë (eksuadat) në shtrypdjë të bronkioeve. Bronkiolet respiratore me enjte të duhkshme të mukozës, me reduktum ose mybillyje të lumenit të tyre me eksudat muko-purulent dhe atelektazi të alveoleve komunikonjës Histologjikisht: «Mukoza e deskuamar, fenomene inflamacioni të tipit proliferativ dhe destruktiv (G. Fanconi si edhe në rastet më Nr. Prot. 19/63 dhe 19/64 të kazuistikës tonë (F. Harito).

Kqyrja rontgenologjike ve në dukje një zmadhim jar (Bariethy dhe Choubrac) me shenim të traumës bronkiale vazale dhe pakesim të tejdukëshmërisë të parenkimes polmonare (G. Frontali).

Konditat anatomiko-funksionale të përmendura të subjektit, mosha e të tjera, kondita debilitonjëse favorizonjëse, si dha ato bashkëvepruese të rastit, janë në bazë të shpeshtësisë akoma të madhe të morbiditetit të vdekjeve të paritura nga bronkpneumonia, për çfaqjen e secilës nuk mjafton vetëm veprimi i agjentit patogeni veprues, por kryesishë konditat e tjera e secilës nuk mjafton vetëm veprimi i agjentit patogeni veprues, por kryesishë konditat e tjera të subjektit. Gjithashtu ndryshimi i fizionormës klinike të tyre në kuptimin që këto zhvillojnë një kuadër oligosimptomatik, ose asymptomatik, dhe në mënyrë të heshtur, ruk jep përshtypjen e një gjendjeje të rëndë dhe të rrezikësme për fëmijën, që në realitet është i tillë, duke fëqur kështu mundësinë e një mjekimi të shpejtë dhe të plotë, dhe duke përfunduar në vdekje në mënyrë të papritur.

Dhe në fakt, në shumicën e rasteve që ne përshkruanjë kështu janë zhvilluar si bronkopneumonite, ashtu dhe bronkiolitet akute sofokante. Një pjesë e mire e këtyre fëmijëve pak kohë para vdekjes ka patur kolle, teshtima dhe mungesë dëshire ose mundësie të kapjes së gjirit, shenja këto që kanë genë shprehje e procesit patologjik në zhvillim, por që nga prindërit,

dhe në disa raste edhe nga mjeku vizitues janë konsideruar të parëndësishme, dhe jo të denja për obseracion më të imtë klinik dhe rontgenologjik që në këto raste do të të ndihmon shumë për një mjekim më të plotë.

MATERIALI YNË Mbë 315 autopsi mjeko-ligjore të bëra nga ne në kufomë të përsoneve të vdekur të të gjithë moshave të të dy gjithave, nga shkaqet të ndryshme, 185, baraz me 58,4% i takojnë atyre nga shkaqet të dhunëshme, ndërsa 130 baraz me 41,6% i takojnë vdekjeve të papritura nga procese patologjike.

Nga 130 raste që i takojnë vdekjeve të papritura të të gjitha moshave, të të dyja gjinive, dhe nga të gjitha shkaqet, 70 baraz me 53,8% i takojnë fëmijëve. Nga të 70 fëmijët e vdekut papritur, 34 baraz me 48,5% janë meshkuj, ndërsa 36 baraz me 51,5% janë femëra. Kjo e dhënë ndryshon nga ato të literaturës mjeko-ligjore të huaj të konsultuar (R. Cilli, 53,3% meshkuj, Weyrich-Thorner 54,9% meshkuj), ku predominojnë meshkujt. Rastet tonë janë të paktë, që të mund të shprehin mendim gjithë edhe në formë hipoteze. Nga të 70 fëmijët e vdekut papritur, që përfshijnë moshat 0-deri i 4 vjeç 53 baraz me 75,7% janë të moshës 0-deri 1 vjeç. Dhe nea këta 41 fëmijë baraz me 77,3% janë të moshës 0-deri 4 muaj, të dhëna këto në pajotën plotësish me ato të literaturës mjeko-ligjore të huaj të përmendor (Richter 84%; Weyrich 75,3%; Pjeczarkowski-Olbrycht 70,2%).

Simbos shkaqet e më e madhe në materialin tonë i takon «Pneumopatite akute infektive» raste 52 baraz me 74,2%, dhe prej këtyre, kryesisht bronkopneumonise me 40 raste baraz me 76,9%. Nga këto 40 raste bronkopneumonisë për të gjitha moshat, 36-90% i takojnë moshës 0-1 vjeç; 3 raste baraz me 7,5%, moshës 2 vjeç dhe një rast baraz me 2,5% moshës 3 vjeç. Bronkoliiteve akute sofokante 9 raste baraz me 17,3% i takojnë moshës 0-deri 1 vjeç të gjitha. Pneumonite intersticiale 2 raste baraz me 3,8% i takojnë moshës 0-1 vjeç dhe në rast trakeobronkit akut baraz me 1,9% i takon moshës 0-1 vjeç. Edhe këto të dhëna në pajtim të plotë në ato të autorëve të huaj të përmendor. Ndërsa në kazuistikën e O. Steinberg dhe C. Raven ka një predomini të «Pneumonive intersticiale». Në kazuistikën e këtyre autorëve nuk figurajnë veçanërisht «Bronkoliite akute sofokante» që në materialin tonë figurajnë me 16,9% niti shumën e përgjithësme të të gjitha pneumopatite akute infektive. Në fëmijët 0-1 vjeç, mosha më e piekur është ato 0-deri 4 muaj me 41 raste baraz me 77,3%. Në fëmijët e moshave 2-14 vjeç, në materialin tonë gjithsej 17 raste baraz me 24,6%.

PESHA SPECIFIKE E VDEKJEVE TË PAPRITURA, ME ATË TË VDEKJEVE NGA TË NJËJTAT SHKAQE DHE NË TË NJUJTIEN MOSHË TË DIAGNOSTIKUARA DHE TË MJEKUARA NË QYTETIN E TIRANËS.

Siq rezulton nga të dhënat demografike dhe nga të dhënat e Drejtorisë të Spitalit Nr. 3 Prof. S. Bekteshi, për të njëjtën periudhë kohë, përqindja e vdekjeve nga të gjitha shkaqet dhe për të gjitha moshat është ulur në mënyrë të ndjeshme në krahasim më vjet e kaluar, po ashtu edhe nga «Pneumopatite akute infektive». Megjithëkëtë përqindja më e madhe e vdekjeve i takon moshës 0-deri 1 vjeç, dhe në këta, asaj 0-deri 4 muaj, dhe shkaku kryesor i këtyre vdekjeve për shumë e dinërit i dedikohet akoma «Pneumopatite akute infektive». Për vitin 1961,80% të fëmijëve të vdekur ishin të moshës 0-deri 1 vjet. (60% të tyre 0—deri 4 muaj) dhe përqindja më e madhe nga bronokpneumonia. Në vitin 1962, përqindja ka qenë 79%, për vitin 1963,71,7%. Dhe në pesëmuajorin e parë të vitit 1964 ka qenë 71,7%.

Gjithashu të dhënat mjeko-ligjore tonat, edhe përsëri i përkert stinës së dimërit, pranverës, në të cilën kasoë ndodhur vdekjet më të shumta nga «Pneumopatite akute infektive» 82,5% pajtohen plotësish me ato të klinikës pediatrisë dhe të autorëve të huaj. Po të marrim parasysh numurin e madh të fëmijëve të mjekuar për këto sëmundje në spital dhe të shëruar, do të dalë akoma më i quartë dëmi i madh i shkaktuar për mungesë aplikimi të mjekimit të duhur që më siguri do të kufizonte për sëtëpërtim këtë dëmi. Për kufizimin dhe estimimin në të ardhmen të këtyre rasteve mendojmë se duhet bërë një koordinimin më i kujdesëshëm i punës për depistimin e herëshëm dhe mjekim racional të këtyre sëmundjeve që zhvillohen me pak shenja klinike dhe në mënyrë të heshtur.

PËRSHKIMI I RASTEVE. Duke qenë natyra dhe qëllimet e këtyj studimi jo vetëm mjeko-ligjor, por edhe mjekonjëse profilaktike, mendoj se përshtkrimi i një numuri të mërtë të këtyre rasteve do të vlefjë për të vënë në dukje edhe konditat e shëndetit të momenteve të fundit të jetës që kanë preceduar vdekjen dhe vetë rrethuan e ndodhënë së sjanë në këta fëmijë. Kjo ndihmon të dalë më e quartë dhe se ku duhet të drejtohet veprimëndja në të ardhmen për depistimin dho mjekimin me kohë të këtyre pneumopatite akute infektive që zvillohen edhe me shenja klinike të paktë, edhe në mënyrë të heshtur, deri në momentin e vdekjes ose deri në disa minutë ose dhjetra minuta para që çdo ndihmë është pa efekt.

Në shenjicët e rasteve që përshtkuajmë, qofshin këto të precedura nga sëmundje të mëparështue të diktuarë në anamnezën e afërme, ose jo, oligosimptomatike, ose asimptomatike, ka patur disa shenja (kolle, leshtima, veshëtësi në kapje të gjithë nga ana e fëmijëve që vjetë), që përdhunojnë vëgë shprehja klinike e procesit morbil i zhvilluar. Mërgimtarët nga ana e përcaktojnë të këqëre fëmijëve kryesisht dhu, ose dhu e rrejtur në disa raste, mik janë

interpretuar drejt si të tilltë, por si shenja të parëndësishme. Kështu që nuk janë preokupuar për ju dhënë ndihmë mjekësore të duhur, dhe si rezultat kanë përfunduar në vdekje të papritur.

Pikërisht në drejtim të interpretimit të drejtë të këtyre shenjave «të parëndësishme» duhet të përcendrohet vëmendja dhe kujdesi i prindërve dhe i mjekut dhe të merren masat mjekonjëse profilaktike në kohën e duhur, për kufizimin në të ardhmen të këtyre vdekjeve.

Për lehtësi paraqitjeje të rasteve, i ndamë në dy grupe: 1) Grupi i rasteve pa sëmundje të mëparëshme dhe pa shenja klinike në anamnezë e tyre të afërt ose të largët, dhe 2) Grup i rasteve me sëmundje të mëparëshme dhe oligosimptomatike.

RASTE PA SËMUNDJE TË MËPARËSHME DHE PA SHENJA KLINIKE TË DIKTUARA NË ANAMNEZËN E AFËRT OSE TË LARGËT TË TYRE.

1) *Lilj. D. 10 muajsh feme*, Nr. i Prot. të autopsisë 57/61: Asnjë sëmundje e mëparëshme në anamnezë, asnjë shenje klinike sëmundjeje në ditët e fundit të jetës së saj. Në orën 3.00 të mëngjesit të datës 21/8/961 prindërit e gjetën të vdekur në krevatin e saj. Në autopsi: Konsistencë e shtuar e mushkërtive, zmadhimi i tyre, zona emfysematore dhe zona të kuqe të errëta, pika hemorrhagjike nënë pleurën vishuale dhe në Tymus. *Histologjikisht* (Dr. Cesk Kroku): «Grupa alveolash të mbushura me likuid koloidal të përzorë me eritrocite dhe me elemente mononuklerare, afër tyre zona me emfizemë të pakëtë. Degenerim alveolar i hepatociteve, sidomos në poriferi.

2) *Aj. E.... 4 muajsh mashkull* Nr. i Prot. të autopsisë 91/63: Pa sëmundje të mëparëshme në anamnezë, pa shenja klinike sëmundjeje ditët e fundit të jetës së tij. Me 16/3/63, rrëth orës 9.45 vdiq pa pritur në gerdin. Në autopsi: Në trake dhe në bronke sasi mukus, në *mushkëri*: zona të kuqe të errëta të fundosura, pika hemorrhagjike nënë pleurën vishuale. *Kayra histopatologjike* (Docent Puhumb Bitri) vuri në dukje: «Mushkëritë: Lezione në intersticium parenkima e trashur dhe e infiltruar me infiltrate limfocitare dhe elementa të celizave të rendit konjunktiv të evolucion. Edem akte intersticiale, ipercitri e moderuar; »*Diagnosi histopatologjike: «Pneumoni intersticiale»*.

3) *Fatime S.... feme*, 3 muajsh, Nr. Prot. të autopsisë 39/62: Pa sëmundje të mëparëshme në anamnezë, pa shenja klinike sëmundjeje në ditët e fundit të jetës së saj. Rrëth orës 4.00 të mëngjesit të datës 28/4/962 disa minuta pasi kish pire gjirin, pati konvulsione dhe brenda pak minutave vdiq. *Autopsia vuri në dukje*: Kufojnë fëmije distrofik». Në trake dhe në bronke sasi mukus, pika hemorrhagjike nënë pleurën vishuale, në mushkëri zona të kuqe të errëta dhe zona gri ndërmjet tyre. *Histopatologji*: (Dr. F. Harito): Bronket me mukus në lumenin e tyre, edem të mukoza, qeliza të deskuamuara. Alveolet me intersticium shumë të ipremuar në hapësirat e tyre, eksudat me shumë elemente qelizore neutrofil dhe shumë eritrocite». *Diagnosi histopatologjike: «Bronkopneumoni e tipit serohemoragjik».*

Të tillë janë edhe rastet e fëmijëve, *Nat. P.* 8 muajsh me Nr. Prot. të autopsisë 45/62 me «Bronkiolitis akuta mbytëse»; *fëmijës pa emër*, 5 ditesh, me Nr. Prot. i autopsisë 29/64, me «Bronkiolitis akuta mbytëse»; *fëmijës Arb. C.* 3 javesh me Nr. Prot. të autopsisë 41/63 me «Bronkiolitis akuta mbysë»; *Shkel. G.*... 26 ditesh me Nr. Prot. të autopsisë 16/64 me «Bronkopneumoni». *Lenon Ster* ... 5 muajsh me Nr. Prot. të autopsisë 66/62 me «Bronkiolitis akuta» e shumë të tjerë.

RASTE ME SËMUNDJE TË MËPARËSHME NË ANAMNEZËN, DHE ME SHENJA KLINIKE TË FAKTA TË SËMUNDJES GJATË DITËVE TË FUNDIT TË JETËS SË TYRE.

1) *Shkelz. C.... 4 muajsh Nr. Prot. autopsisë 88/62: Bistrofik* prej lindjes: gjithëmonë rekonte, qante, grundi shpesh; në mbrëmjen e datës 4/11/62 rrëth orës 23.00 e ema i është gjithë dhe e vuri në gjumë. Rrëth orës 2.00 të mëngjesit të datës 5/2/62 fëmija qante, përpigesh, grindesh; pati konvulsione dhe brenda pak minutave vdiq. *Autopsia vuri në dukje*: Mushkëritë me konstistencë të parenkimes shtuar, ajrosje e pakët, zona të fundosura të errëta; *Histopatologji*: Alveolet pjesërisht të mbushura me masë roze të çelur që përbën sasi të pakët qelizash të mëdha të epitelit alveolar të deskuamuara, konxhestion i septumeve, bronket dhe bronkiotë paraqesin një zmadhim të qelizave të mukoza që vendë vendë, marrin pamje spumoze. Epitel edematoz dho hiperezik përrrëth. Septet e disa alveoleve të ruptuara. *Diagnosi histopatologjike: «Bronkopneumoni»*.

2) *Sulej. Dr.... 8 muajsh, mashkull*, Nr. i Prot. të autopsisë 14/63. Një javë para vdekjes fëmijës ka qenë sëmuar me grip, dbe trakeobronkit akut, u vizitua nga mjeku, ju dihanë barnat e duhura, pati një përmirësim në dukje. Në datën 21/2/63 fëmija u keqësua pa pritmas, temperaturë fabrike e lartë, mjeku i thirrur e gjeti të vdekur. Autopsia vuri në dukje: «Në trake dhe bronke sasi të mjaftueshme mukusi; mushkëritë në konsistencë të shtuar në lobet e poshtës; *Histopatologji*: «Në alveolet e mushkërtive eksudat me karakter të theksuar hemorrhagjik, bronket me epitel edematoz në gjendje ipersekretionë». *Diagnosi histopatologjike: «Bronkopneumoni»*.

3) *Alfred F.... 2 muajsh, meshkull*, Nr. i Prot. i^t autopsisë 4/64 fëmijë distrofik.

Një javë para vdekjes pati reshtimë dbe dñe, mës disa ditëve u përmirësua në dukje.

në datën 10/I/64 treth orës 5.00 të mëngjesit fëmija u keqësua, merrte frymë me zor, i lëvizniu flegrat e hundës, kishte temperaturë febrile.

Prindërit menjëherë e transportuan me makinë në spital, Sa mbrijti në ambulancën e pranimit të spitalit vdiq.

Autopsia vuri në dukje; Muskëritë: me konsistencë të shtuar në lobet e poshtëme, me zona të kuqe të errëta (blu), emfizeme në margo, ajrim i pakët, pika hemoragjike nënë pleurën vishërale.

Kgyrja histopatologjike «Dr. Çesk-Rroku» vuri në dukje: «Septet anteraleveolare të trashura së tepërti në disa zona me parele të infiltruara dendësishë nga elemente mononukleare, vazat interseptale në disa zona të zgjeraura, të mbushura me eritrocite, alveolet me madhësi të ndryshme shumë sëpse të çara, grupe alveoleash atelektaziko, infiltrate të dendura mononukleare, peribronkiale». Diagnosi histopatologjike: «Pneumoni intersticiale».

Si këto që u përshkruan ka që gjajt raste të tjera fëmijësh të vdekur papritur, por që në anamnezën e tyre të afërt ose të largët kanë qenë sëmurë dhe gjëri ditët e fundit të jetës së tyre çfaqen simptoma klinike të sëmundjes të pakta, ose të qarta. Të tillë janë rastet e fëmijëve Min. Kr., Femer 6 muajsh me Nr. Prot. autopsie 11/63 vdekur nga «Bronkioliti akut mbytës»; Ay i Don. Jon., femer, 20 ditësh Nr. Prot. i autopsisë 1/63 vdekur nga «Bronkopneumonia». Ay i Hatixh. K... femer, Nr. Prot. autopsie 46/62; vdekur nga «Bronkopneumoni serohemoragjikë». Sulejman Sp. ... mashkull, 8 muajsh Nr. Prot. autopsie 21/63, vdekur nga «Bronkiolitis akuta serodeskuamative». Shk. Kr...., dy muajsh Nr. Prot. autopsie 31/63 vdekur nga «Bronkopneumonia». Lida. H...., femer, 5 muajsh, Nr. Prot. i autopsisë 16/63 vdekur nga «Pneumoni serohemoragjike». Myrteza L.... mashkull, Nr. Prot. i autopsisë 15/64 vdekur nga «Bronkiolit akut mbytës». Stavri St.... mashkull, 6 muajsh, Nr. i prot. të autopsisë 19/64 vdekur nga «Bronkopneumoni». Shp. Ha.... mashkull, 3 javësh Nr. Prot. i autopsisë 19/64 vdekur nga «Bronkiolitis akut proliferativ deskuamativ». Ilir. K.... mashkull, 2 muajsh, Nr. i prot. autopsisë 31/64 vdekur nga «Bronkopneumonia».

DISKUTIM MJEKO-LIGJOR. Nga përshkrimi i rasteve, shifet se në një përqindje të mirë të tyre (39,1%) fëmijët para vdekjes të ndodhur në mënyrë të papritur, nuk kanë çfaqur shenja klinike sëmundjeje, as edhe sëmundje të ndryshme të njohura me anamnezën e tyre të afërt ose të largët. Kurse 60,9% të rasteve, fëmijët, në ditët e fundit të jetës së tyre kanë çfaqur shenja klinike të pakta sëmundjeje, si edhe sëmundje të njohura me anamnezën e tyre të afërt ose të largët (grip, rrufë, trakeit, bronkiti akut etj.). Në kazuistikën e R. Gilli kjo përqindje është e ndryshme, 50% të rasteve të përshkrura nga ky autor kanë qenë pa shenja klinike. 25% të tyre kanë patur shenja klinike të pakta. 25% të tyre me shenja klinike të qarta. Gjithashtu vijet në dukje, (në materialin tonë) se përqindja me e madhe e bronkopneumonive 69%, janë çfaqur në fëmijë distrofike, fakt ky i njohur mirë nga klinika, si një nga faktorët predispononjës të rëndësishëm për afekionet bronkopneumonike në fëmijë të moshës së gjirit, dhe të moshës pak më të madhe. Edhe në literaturën mjeko-ligjore të huaj ky fakt konfirmohet në 58% të rasteve të bronkopneumonive R. Gilli 17. Prandaj, është e nevojëshme që organet sanitare dhe organizatat e masave të tjerheqin vëmendjen e prindërvë të fëmijëve edhe në këtë drejtim, për uljen e morbitetit dhe mortalitetit nga këto sëmundje. Po ashtu të forcojmë punën në drejtim të depistimit të herëshëm të këtyre rasteve dhe mjejkimit racional të tyre.

KONKLUZIONE TË PËRGJITHËSHME

- Në qytetin e Tiranës përqindja më e madhe e fëmijëve të vdekur papritur i takon moshës 0-1 vjeç 75.7%, dhe ndër këta 77.3% në moshën 0-4 muaj.
- Shkaku kryesor i këtyre vdekjeve janë «Pneumonite akute infektive banale» 74.2%, dhe në këto kryesorit «Bronkopneumonia» 76,9% të rasteve «Bronkioliti akut mbytës» me 17,3% të rasteve dhe «Pneumoni intersticiale» 3,8% të rasteve, trakeobronkiti akut 1,9%.
- Vdekjet më të shumta kanë ndodhur në stinën e dimërit dhe të pranverës 82,5%.
- Pjesa më e madhe e fëmijëve të vdekur papritur nga këto sëmundje kanë qenë distrofike 69%).
- Në përqindjen më të madhe të rasteve (60,9%) kuadri klinik ka qenë oligosimptomatik, dhe me sëmundje të mëparëshme në anamnezën e afërt. Në 39,1% të rasteve kuadri klinik ka qenë asimptomatik dhe pa sëmundje të mëparëshme të diktuar në anamnezën e afërt të fëmijëve të vdekur.

(Paraqitur në redaksi me 2/X/1964)

BIBLIOGRAFI.

- Ackerman B. D. «Bronkiolitet akute». Clinical Pediatrics New-York Vell. I, Nr. 2, 1962 cituar në «Miorra Pediatrica vell, 16 Nr. 5. shkurt, 1964.
- Aydajev M. J. «Mjekësia Ligjore» Botim 1959.
- Bariethy dhe Choubrac «Bronkopneumopatitë akute dispneizante» 1961, cituar në «Polyclinico vell. 70 Nr. 40-44-1963.

- 4) Bour H. «Zhvillimi i ideve dhe faktave mbi Pneumopatië akute, Tentativë përkufizimi dhe klasifikimi »Revue de practicien. Tome XIV Nr. 10 -Prill, 1964.
- 5) Bakllanov e të tjera «Polmonitet Stafilokoksike» Pediatria, Moskë, Nr. 3-1960.
- 6) Coury C. dhe Safar N. «Pneumopatië akute virale dhe bakterike jo tuberkulare »Revue de Practicien Tom XIV. Nr. 10 Prill 1964.
- 7) Cattabeni C. M. «Vdekjet e dyshimta në vitia e parë të jetës »Relacion në Kongresin e VII të Nipologjisë, Romë, Prill 1954.
- 8) Cazzaniga A., Catta-beni C. M. «Mjekësia Ligjore» 1961.
- 9) Costedor A. «Le mort subite» Paris 1935.
- 10) Camps F. Londre «Komunikim shkencor në Mbledhjen e III Ndërkombëtare të Mjekësisë Ligjore — Londrë, Prill 1963.
- 11) Domenicci F. Mjekësia Ligjore përfshi praktik «Botim i dytë, 1961.
- 12) Fanconi G. Mallgrin A. «Traktat Pediatrie » Përkthim italisht, 1960.
- 13) Frontali G. «Manual i Pediatrisë», Botim i dytë. Rishtypur — 1960.
- 14) Formaggio T. «Mjekësia Ligjore» 1961.
- 15) Gervais M. «Vdekjet e papritura në fëmijët e moshës së gjirit» Annales de médecine légale XLIV — 1963.
- 16) Galy P. Roumagoux J. «Sindromet e natyrës gripale pa dyshime bronkopulmonare deri te bronkop. akute jo kondensante sezionale.
- 17) Gilli R. «Vdekjet e pa pritura në fëmijë» Botim Salpictri, 1950
- 18) Maccaggi D. «Mjekësia Ligjore» 1958.
- 19) Minor C. L. Moschalaia E. A. «Polmonitet Stafilokoksike dhe komplikacionet e tyre. Një trajtim kirurgjikal i emergjencës» Clinicals Pediatrics New-York vell. I, 1962, Minerva Pediatrica vol. 16, Nr. 5. 1964.
- 20) Mitjaeva N.A. «Pneumonitë si shkak vdekjeje të pa pritura në të porsalindurit dhe në ato të moshës së gjirit »Sudebno-Medicinska Ekspertiza, Nr. 3-1962.
- 21) Simonin C. «Mjekësia Ligjore dhe Gjyqësore » Botim i 3-të 1955 —Paris.
- 22) Popov M.V. «Mjekësia Ligjore» Përkthim shqip — 1958.
- 23) Steinberg B. «Vdekjet e pa pritura në fëmijë nga pneumonitë intersticiale».
- 24) Komunikim shkencor në Mbledhjen e III-të Ndërkombëtare të Mjekësisë Ligjore — Londrë — prill 1963.
- 24) Raven C. «Pneumonitë akute intersticiale si shkak vdekjeje në fëmijët». Komunikim shkencor në Mbledhjen e III-të ndërkombëtare të Mjekësisë Ligjore. Londrë, 1963.
- 25) Rajski N. I. «Mjekësia Ligjore» përkthim shqip, 1958.
- 26) Vanzetti F. «Anatomia Patologjike» 1944.
- 27) Visko G. Fasceio P. G. «Polmonitet» Policlinico Vell. 70 Nr. 40-44, 1963.
- 28) Herder J. «Vdekjet subite në fëmijët nënë 2 vjeç »Komunikim shkencor në Mbledhjen e III-të Ndërkombëtare të Mjekësisë Ligjore, Londrë, 1963.
- 29) P. Pavli. «Vdekjet e papritura në fëmijë» Leksion në Kursin e I-rë të klasifikimit të Mjekësisë Ligjore të Rrëtheve, Dibjetor, 1963.
- 30) P. Pavli. «Vdekjet e papritura në fëmijë» Leksion në Kursin e V-të Tetor, 1963.
- 31) Brelet. La mort subite chez l'enfant (These du Paris, 1906)
- 32) Nobecourt-Boulanger. Pilet. Kongresi i VI-të i pediatrisë i gjuhës franceze.
- 33) Pechere. «Vdekjet e menjëherëshme në fëmijë» Kongresi i XV-të i mjekësisë ligjore, Paris 1930.

SUDDEN DEATH FROM ACUTE LUNG INFECTIONS IN CHILDREN 0-1 YEARS OLD IN TIRANA.

(Summary)

Some medico-legal observations are presented about the causes of death of all the persons that died in Tirana during the period from Jan. 1 1961 to June 30 1964. From them 41.6% had died suddenly from causes unknown until after autopsy. 53.8% were children; 48.5% male and 1.5% female; 75.7% were under 1 year old, 24.3% from 2 to 14 years. From the children under 1 year old 77.3% were under 4 months; the principal causes of death of these children were acute lung infections (in 74.2%), from which «bronchopneumonia» 76.6%, «suffocating acute bronchiolitis» 17.3%, «interstitial pneumonia» 3.8%, and «acute tracheobronchitis» 1.9%.

Most of these deaths have occurred during the winter and early spring (82.5). From all the children dead from bronchopneumonia 69% were distrophic. In 39.1% there had been no clinical symptoms of the illness, in 60.9% the symptoms had been very slight.

NDRYSHIMET E PROTEINAVE TË SERUMIT TË GJAKUT NË TË SËMURËT ME CIRROZË HEPATIKE

MILTO K. KOSTAQI

(Katedra e Terapisë së Fakultetit — Shef i katedrës Doc. J. Adhami)

Në këtë punim, kemi marrë në studim 62 të sëmure, ku janë bërë 313 ekzaminime proteinave metodën refraktometrike, me qëllim që të shohim ndryshimet që pësojnë proteinat totale, albuminat, globulinat dhe koeficienti albumina/globulina si para ashtu dhe mbas mjekimit.

Si rregull të sëmureve u bëshesh ekzaminimet proteinike në ditët e para të shtrimit ose para mjekimit, një ose disa herë gjatë mjekimit dñe në fund të terapisë osc para daljes nga spitali. Kështu kemi patur mundësi të shikojmë ndryshimin e proteinave totale, fraksioneve proteinike dhe koeficientit albumina/globulina në dinamikë.

Materjali i jonë i ndarë simbas seksit përbëhet nga 48 meshkuj dhe 14 femra, kurse, simbas grup moshave kemi:

Shpërndarja e cirrozave hepatike simbas grup moshave:

| Mosha në vjeç | 20—30 | 31—40 | 41—50 | 51—60 | 61—70 | Mbi 70 | Shuma |
|---------------|-------|-------|-------|-------|-------|--------|-------|
| Nr. rasteve | 14 | 16 | 9 | 10 | 10 | 3 | 62 |

Sikurse shihet numuri më i madh i rasteve i takon moshës 31-40 vjeç me 16 raste ose 25,81% pastaj vjen mosha 20-30 vjeç me 14 raste ose 22,58% dhe pastaj ata të moshës 51-60 vjeç dhe 61-70 vjeç me 10 raste seicili ose 16,13%.

Simbas stadir të kompensimit ose të dekompenimit kemi: 48 raste janë të dekompenzuar dhe 14 të kompensuar.

Nga të 62 të sëmure tanë ekzaminimet proteinike si para dhe mbas mjekimit janë bërë komplekt vetëm nët 32 raste, kurse 30 të tjerëve nuk u janë përcaktuar para daljes nga spitali, por janë bërë ditët e fundit të përdorimit të terapisë.

Si mesatare përcaktimin e proteinemisë, jemi bazuar në shifrat e përcaktuara nga Adhami J. (1963), i cili me të njëjtën metodë, proteinat totale i konsideron me vlefsh kufitare 7,1-8,0 gr%, albuminat 4,51-5,5 gr%, globulinat 2,51-3,50 gr% dhe koeficientin albumina/globulina 1,50-2,49.

Kështu nga të 62 rastet tona 36 veta paraqitnin një hipoproteinemi d.m.th. ndënë 7,1 gr%, 16 veta i kishin proteinat normale d.m.th. midis 7,1-8,0 gr%, 16 veta i kishin proteinat normale d.m.th. midis 7,1-8,0 gr%, kurse 10 të tjerë paraqitnin një hiperproteinemi d.m.th. mbi 8,0 gr%. Prej këtyre të fundit, midis 8,1-8,5 gr% ishin 8 raste, kurse mbi 8,5 gr% 2 të sëmure prej të cilëve njëri 10,30 gr%.

Për hipoproteinemi në të sëmure me cirrozë hepatike flasin shumë autorë. Kështu Gambigliani Zoccoli A., Franzini C. (1952), thonë se raporti i zakonshëm në rastin e cirrozave hepatike është një hipoproteinemi totale, me hipalbuminemi dhe hiperglobulinemi.

Bondar Z.A. (1959), i cili ka patur nën obervacion 110 të sëmure me sëmundje kronike të heparit, thotë se përmbytja e proteinave në këta të sëmure ka tendencë të rritet në 80% të rasteve të tij. Kurse gjatë ascitit dhe edemave masive, proteinat totale nuk kalojnë 4-6 gr%.

Kurse Sarrazin A. (1964), tregon se në fazat e para të cirrozave proteinat totale mund të jetë normale, po ashtu dhe koeficienti albumina/globulina. Kurse në stadin ascitik shihet hipoproteinemi dhe inversion i rapportit albumina/globulina.

Në të sëmurët tanë në 10 raste ne konstatuan një hiperproteinemi. Për një gjë të tillë flasip dhe shumë autorë të tjerë. Kështu Fauvert M.M. dhe Hartmann (1957), kanë vënë re në 209 raste me cirrozë hepatike një hiperproteinemi pamvarësish se cila është etiologjia e tyre. Po ashtu dhe Cachin M., Pergola F., Potet R. dhe bashkëpuntorët (1957), kanë konstatuar një shtim të proteinave totale në 15 raste me cirrozë nga 45 që kishin nën observacion. Tarexhev I.E. (1960) në 40 të sëmurë me cirrozë hepatike ka konstatuar hiperproteinemi në 7 raste. Kurse Szostak W. e bashkëpuntorët (1962), konstatuan hiperproteinemi në 4 nga 28 të sëmurët me cirrozë hepatike dbe thonë se hiperproteinemia në këtë sëmundje nuk është një gjë e rrallë. Në të sëmurët e tjerë proteinat ishin në normë. Simbas Gambighiani Zoccoli A., Franzini C., hiperproteinemia vrehat në 40% të rasteve, kurse nc e konstatuan në 24,2%.

Mbas mjekimit me preparate kortikosteroide të kombinuar ose jo me diuretikë, d.m.th. para se të sëmurrët të dirlin nga klinika, u bënë ekzaminimet refraktometrike të proteinave totale dhe fraksioneve të tyre në 32 të sëmurë.

Gjatë këtyre ekzaminimeve ne konstatuan një pakësim të rasteve me hipoproteinemi dhe rritje të numurit me proteinat totale normale.

Po të krahasojmë rezultatet e ekzaminimeve refraktometrike të proteinave totale, vetëm në këta 32 të sëmurë, ku janë përcaktuar si para dhe mbas mjekimit, do të shohim këto ndryshime të cilat ne i kemi shpërthyer në pasqyrën e më poshtëme:

Shpërndarja e cirrozave hepatike simbas proteinemisë totale para dhe mbas mjekimit.

| Proteinat totale gr% | Ndënë 5,0 | 5,1—6,0 | 6,1—7,0 | 7,1—8,0 | 8,1—9,0 | Mbi 9,0 | Shuma |
|----------------------|-----------|---------|---------|---------|---------|---------|-------|
| Para mjekimit | 1 | 3 | 17 | 8 | 3 | — | 32 |
| Mbas mjekimit | 1 | — | 8 | 17 | 4 | 2 | 32 |

Nga kjo pasqyrë vihat re një pakësim i rasteve me hipoproteinemi nga 21 para mjekimit, në 9 mbas tij dhe një shtim i atyre me proteinat të rritura nga 3 në 6 raste.

Këto ndryshime duken më mirë në një pasqyrë tjetër ku përvëç numurit absolut të rasteve shprehet dhe përqindja e tyre.

Numuri dhe përqindja e cirrozave hepatike simbas përbajtjes së proteinave totale para dhe mbas mjekimit.

| Proteina totale gr% | Të ulura | | Normale | | Të larta | | Shuma |
|---------------------|-------------|------|-------------|------|-------------|------|-------|
| | Nr. absolut | % | Nr. absolut | % | Nr. absolut | % | |
| Para mjekimit | 21 | 65,6 | 8 | 25 | 3 | 9,4 | 32 |
| Mbas mjekimit | 9 | 28,1 | 17 | 53,1 | 6 | 18,8 | 32 |

Rastet me proteinemi normale kanë ndryshuar shumë nga 25% para mjekimit në 53,1% mbas terapisë. Kurse rastet me hipoproteinemi zbritën më shumë se gjysma nga 21 para mjekimit ose 65,6% në 9 mbas tij ose baraz me 28,1%. Ata me hiperproteinemi pësuan një rritje nga 3 raste ose 9,4% para mjekimit, u rritën afersisht në dyfishin d.m.th. në 6 raste ose 18,8% të tyre.

Kjo rritje e rasteve me hiperproteinemi mund të shpjegohet se mbas mjekimit me substancë lipoprotepe, kortikosteroide të kombinuara ose jo me plazmë, ndërpitet deri në një farë shkalle zhvillimi i procesit të sëmundjes, përmirësohen provat e flokulacionit, shthohet oreksi i të sëmurrëve, pakësohen rastet me hipoproteinemi dhe hiperglobulinemi. Këto influencojnë dhe në përmirësimin e treguesave të proteinave totale.

2 — Nga fraksionet proteinike ndryshimin më të madh e pësojnë albuminat, të cilat janë të pakësuara në 90,3%, pastaj vijnë globulinat që janë më të larta se norma në rreth 59,7%.

3 — Koefficienti albumina/globulina u gjend i ulur në shumicën dërmonjëse të rasteve, në 50 të sëmurë (80,6%).

4 — Mbës mjekimit, krashtë përmirësimit të gjendjes të të sëmurit, zhdukjet së edemave dhe ascitit, proteinat totale normalizohen, shtohen rastet me albumina normale, pakësohen globulinat dhe si pasojë e tyre normalizohet koefficienti albumina/globulina.

(Paraqitur në redaksi më 25/XI/64)

BIBLIOGRAFIA

- 1 — *Adhami J.* Ndryshimet e proteinave të seromit të gjakut, para dhe mbas mjekimit me preparate antibakteriale dhe kortikosteroide tek të sëmurët me poliserozite tuberkulare. Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat mjekësore 1963, 1, 3.
- 2 — *Bondar Z.A.* Kliničeskoje značenie izmjenjenij bjelkov krovi pri zaboljevanija pečeni. Sovjetskaja medicina 1959, 4, 79.
- 3 — *Cachin M., Pergola F., Potet R., Levillain et Laluc R.* Delta cortisone et cirrhoses ascitiques. La semaine des hopitaux 1957, 88, 3168.
- 4 — *Darnis F.* Los troubles du metabolisme hydro-electrolitique dans les cirrhoses du foie physiopathologie et traitement. Le revue du praticien 1964, IV, 20, 2583.
- 5 — *Fauvert M.M. et Hartmann.* Les protéines plasmatiques au cours des cirrhoses. La semaine des hopitaux. 1957, 72-73, 2897.
- 6 — *Gambigliani Zoccoli A., Franzini C.* La diagnostica funzionale delle epatopatie. Edizione Minerva Medica 1952.
- 7 — *Gembicki M., Magas S., Szymendere J.* Rendësija e ekzaminimit të kuadrit elektroforetit të proteinave të seromit të gjakut gjatë diagnostikimit të cirrozave të heparit. Pol. Arch. Med. Wewnet 1961, 8, 1049. (Marrë nga Refer. zhur 1962, 3, 42).
- 8 — *Jean-Pierre Etienne.* Les icteres des cirrhoses alcooliques. La revue du praticien 1964, XIV, 20, 2555.
- 9 — *Sarrazin A.* Rappel classique de l'examen clinique et paraclinique d'un cirrhotique evolution generale et éléments du pronostic des cirrhoses. La revue du praticien 1964, XIV, 20, 2 537.
- 10 — *Szostak W., Furman L., Maciejewski E.* Marskose watrby jake przyczyna podwuzsnego egolnego pozioma bialka w surowicy. Pol. arch. Med. Wewnet. 1962, 8, 1037.
- 11 — *Tareev I.E.* Kliničeskoje značenie proteinogrami pri cirrozaх pečeni. Sovjetskaja Medicina 1960, 8, 57.
- 12 — *Varley H.* Praktiki kliniqi biohimia. 1960, 314.
- 13 — *Wewalka F.* Cirrhozat e heparit dhe përmbytja e proteinave në plazmë. Wien z. inn. Medd. 1961, 3, 85.

CHANGES IN THE PROTEIN CONTENTS OF BLOOD SERUM IN PATIENTS WITH CIRRHOSIS HEPATIS

(Summary)

A study of the blood serum proteins in patients with liver cirrhosis was started since 1958, and 1518 protein determinations were done, using for this purpose the AB refractometer and the Zeiss ultrathermostate.

This work surveys only 62 cases with cirrhosis hepatica and points out the changes undergone by the blood serum proteins in toto, in their different fractions and the albumin/globulin coefficient before and after treatment.

As normal are taken the figures of protein contents given by Josif Adhami: total proteins 7.1-8.0g%, albumin 4.5-3.5g%, globulins 2.5-3.5g%, the albumin/protein coefficient - 1.50-2.49.

Hypoproteinaemia was noted in 25% of the cases observed. Another 35% showed slight hypoproteinæmia.

The most important changes concern the proteinic fractions. Albumin was found low in 90.3% of the cases; globulin was higher than normal in 59.7%. Important changes were observed also in the albumin/globulin coefficient, which was low in 59 cases - 80.6%.

DISA TË DHËNA STATISTIKORE MBI UROLITIAZEN NË VENDIN TONË.

Kand. Shk. Mjek. PËRPARIM TEPELENA

(Katedra e Patologjisë së Përgjithshme Shef Doc. P. Bitri)

Studimet klinike dhe eksperimentale të shkullit të fundit kanë treguar se në etiologjinë urolitiazës kanë rëndësi faktorët e ndryshëm me karakter ekzo dhe endogen. Rëndësi të veçantë në etiologjinë e kësaj sëmundje në vende dhe në konditë të caktuara kanë një seri faktorësh ekzogenë që dëmtojnë metabolizmin e kriprave, të proteinave dhe të ujit dhe veprimtarinë ekskretuese dhe sekretuese të reneve.

Simbas të dhënave të A.P. Avicin (1963,1964) A. Butt (1936) I.P. Pogorjellko (1960) A.J. Duhanov (1962) etj., kjo sëmundje takohet më tepër në zona të caktuara gjëografike si në Egjipt, në republikat Sovjetike të Azis së mesme, në Kaukazin Verior, në Brazil, në Siri, në Konë Jugore etj. Simbas këtyre autorëve një shpërndarje e tillë e sëmundjes lejon të mendohet se në etiologjinë e urolitiazës nji rëndësi të veçantë duhet të kenë faktorët biogeofizikë dhe klimaterikë.

Shumë autorë të tjerë si P.O. Elion (1930) A.J. Mirkosimov (1929) Brod (1937) Mates (1953) K.I.Takirov (1960) H. Fletcher (1961), A.J. Pitel (1964) etj. rëndësi të dorës së parë në prejardhjen e urolitiazës i jatin faktorët infektivë, në radhë të parë infeksioneve të rrugëve urinare. Simbas përkrahës të kësaj teorije infeksionet dhe në radhë të parë pielonefrit si sëmundje më e shpeshtë e reneve dëmtojnë funksionimin normal të aparativit urinar, çregulllojnë metabolismin e ujit, të kriprave, proteinave dhe ekilibritin acido bazik të ambientit të mbërëndshëm të organizmit, ulin forcën e solucioneve koloidale mbrojtës, krijojnë kondita të favorëshme për precipitinim e kriprave të urinës të cilat në gjendje normale qëndrojnë në formë solucionesh të tretura. Por sa do i madhi që të jetë roli i faktorëve infektivë në prejardhjen e urolitiazës, formimi i gurëve urinare nuk është i lidhur gjithnjë me infeksionin. Për këtë flet fakti se shpesh gurët urinare kanë karakter aseptik. (G. Hommertsten N. Flotcher) simbas N. Flotcher I. Sufi (1961) urolitiza aseptike takohet në 20-30% të rasteve. Nga ana tjetër ritja e nivelit hygjeaniko-sanitar të vendet e ndryshme të botës nuk i përgjigjet suksesive të arritura në profilaksinë dhe mjekimit e kësaj sëmundje (I.V. Davidovski). Shumë autorë si N.N. Jellasnski (1950) A.I. Pokrovskaja (1957) M.N. Kovalov (1957) N. Saby (1958) etj. rëndësi të dorës së parë në prejardhjen e urolitiazës i jatin shtimit të sasisë së kalçiumit në gjak dhe në urinë në ruge egzogjene..

Por disa autorë të tjerë dha sidomos ata të shkollës Franceze (A.J. Pitel) predikojnë se kalçiumi egzogjen i marë në sasi të mëdha nuk ka rëndësi në prejardhjen e urolitiazës mbassi organizmi konkretisht renet dhe trakti digjesiv kanë aftësi të madhe për eliminimin e kalçiumit të tepërt.

Disa autorë si A.P. Avicin, M.P. Pogojelko etj. rëndësi në prejardhjen e urolitiazës i jatin temperaturës së ambientit rrëthues si faktor që mund të shkaktojë dehidratimin e organizmit, çregullimin e metabolismit të kriprave dhe proteinave A.T. Avicin (1964) shkruan se gjatë luftës së dytë botiore të ushtarakët e ardhir nga vendet e ftohta që vepruan në zonat me temperaturë të lartë të Azis dhe Afrikës ka pasur çfarëje të një urolitizëz të shpeshtë.

K.M. Takirovi Z.I. Ikramov etj. i jatin shumë rëndësi në prejardhjen e urolitiazës stazës urinare të shkakuara nga qëndrimi në pozicion shtrirë e cila ndihmon zhvillimin e proçesave inflamatore dhe infektive.

Por nënkopuhet se influence e faktorëve të ndryshëm etiologjike ekzogenë të urolitiazës dobësojnë aftësitë fiziologjike dhe forcën e solucioneve mbrojtëse të urinës, në radhë të parë mukopolisahariteve. Natyrishët kjo nuk vepron në mënyrë të izoluar dhe të njëanëshme, por në mwartësinë nga gjendja e reaktivitetit të përgjithshëm të organizmit, sistemit nervor dhe endokrin (A. Pitel T. Danovski J.P. Davidovski N. Fletcher dhe R. Chute S.G. Grebeshnikov etj).

Duke patur parasysh se në spitalet tona shتروhen me urolitiazet janë një fenomen i shpeshtë, i vumë si detyrë veçtes të studojmë gjendjen dhe disa nga momentet etiologjike të kësaj sëmundje në vendin tonë si shpeshtësinë e sajë në relacion me sëmundjet e tjera në rrethet e ndryshme të vendit; me moshën seksin dhe profesionin.

Për këtë qëllim përpunuam historitë e sëmundjeve të të sëmurëve me urolitiazet të opervuar nga në stacionin balnear të Gjinës gjatë vjetave (1958-1960) historitë e sëmundjeve të sëmurëve me urolitiazet të mjekuar në spitalin e kirurgjisë të Tiranës 1961-1963, gjithsej 910 raste si dhe kartelat e autopsive të shërbimit anatomopatologjik të spitalit Nr. 1 të Tiranës të vjetëve 1961-1963, gjithsej 2100 kartella.

Rezultatelet e përpunimit të kartellave të të sëmurëve me uroliazen të mjekuar në stacionin balneologjik të Gjinës gjatë viteve 1958-1960 dhe në spitalin kirurgjikal të Tiranës gjatë vjetave 1961-1963 (gjithsej 910 raste) tregojnë se urolitiazet e shpeshtë në vendin tonë. (Për vitet 1961-1963) ajo ze vendin e tretë si për morbozitet ashtu dhe për operabilitet ndërmjet sëmundjeve të tjera. Kjo sëmundje në vendin tonë prek në mënyrë të ndjeshme moshën e re fëminore (3%) e rasteve me urolitiazet janë kuruar në moshën 1 deri 10 vjeç, nga të cilat 22% në moshën 1 deri 5 vjeç dhe 9% në moshën 5 deri 10 vjeç.) Përsa i përkthet se 65% të rasteve kanë genë meshkuj dhe 35% femra, kurse përsa i përkthet profesionit nuk u gjendet asnjë regularitet.

Më rëndësi janë të dhënat që dalin nga përpunimi i historive të sëmundjeve lidhur me frekuencën e urolitiazes në rrethet e ndryshme të vendit tonë. Vihet re një frekuencë e lartë e kësaj sëmundje në disa rrethe të vendit tonë: si në atë të Krujës, Burelit dhe pjesës jugore të bregdetit (Sarandës). Kështu p.sh. po të krahasojmë rrethet e tillë si Kruja, Bureli dhe Peshkopija që kanë të njejtin drejtum sherbimit të kualifikuar (kryesisht Tiranët del se nga rrethi i Krujës ka patur 42 raste, nga rathi i Burelit me afersisht atë popullsi që ka Kruja 31 raste, kurse Peshkopija me popullsi shumë më të madhe vetëm 4 raste. Nga qyteti i Sarandës që ka një popullsi shumë më vogël se rrethi i Peshkopisë dhe të sëmurët përvëç qytetit të Tiranës mund të drejtohen për ndihmë të kualifikuar dhe në qendrat e tjera (Vlorë, Gjinokaster) ka pasur 12 raste urolitiazet. Nga fshati Borsh i Sarandës ka patur 7 raste kurse nga qendra e Ndëroq që ka popullsi më të madhe se Borshi, ka patur vetëm një rast. Nga qendra e Petrelës të rrëthit të Tiranës që ka një popullsi baraz me 2/3 e asaj të Borsh ska patur asnjë rast.

Nga përpunimi kartellave të 2100 e autopsive të shërbimit anatomopatologjik të spitalit Nr. 1 të Tiranës për vjetet (1958-1962) rezulton se ndërmjet të vdekurve nga sëmundje të ndryshme në këtë spital prezenca e gurëve urinar takohet 3.7% të rasteve, 25% e sasisë së këtyre gurëve janë gjetur në moshën 0.1 vjeç, 42% e rasteve në të cilat janë gjetur gurë urine; kanë patur diagnozë klinike patanatonike dizenteri, dispepsi dhe sëmundje të tjera të traktit digestiv, 27% bronchite, bronchopleumoni dhe pleurite, 21% piolonefrite, 10% sëmundje të tjera të ndryshme, 57% e rasteve të autopsive në të cilat janë konstatuar gurë në rrugët urinore kanë genë meshkuj dhe 43 femra.

KONKLUSIONET E MUNDËSHME PARAPRAKE:

1. Urolitaza përbën për vendin tonë një sëmundje të shpeshtë që prek në mënyrë të theksuar moshën fëminore.
2. Shpërndarje e urolitiazës në zonat e ndryshme të vendit tonë kanë një karakter të theksuar disproporcionale.
3. Sëmundjet infektive të traktit digestiv mundë të shikohen si burim i rëndësishëm etiologjik i urolitiazës në vendin tonë.
4. Lidhur me seksin tek ne predominon urolitaza në bura.

(Paraqitur në redaksi më 5/4/65)

LITERATURA:

- A. Vicin A.P. Vjesnik akademii medicinskikh nauk Nr. 12, 1964
A. Vicin A.P. Arkiv patologii Nr. 8, 1964
Brod J. Kroničeski piełonefrit f. 54-74, 1960
Butt A. Etiolog factors in renal lithiasis f. 89-95 1956.
Danovski T. chinkal endocrinology VIII 137-147 1962.
Davidovski I.V. Obshaja patologie čelovjeka f. 167-170 1961.
Dukanov A.J. Urologia djeckovo vozrasta f. 179.-195 1961.
Foljan P.O. Etiologia endemickovë urolitiaz vjesnik kurortol. 2. 930
Fletcher H. Esentjal urologi f. 175-177 1961.
Grebenšnikov G.S. Maçekomenie blezn. Disertacion dikrential 1950.

- Hamuarten A.G.* Asepti urolitiazis. Congressus balnologi internat. 65-70 950
Konovalov M.N. Etiopatogenezz urolitiaza. Disertacion 1957.
Mates J. Mineraini vodu k lecenie urologicheskovo chorobe. Rozhd. Chirurgii 1956 XXXV-1.
Mirkosimova N.A. Materiali k izucheniu moçekamenoi bolezni v Azerbzh. 1928.
Jellanski N.N. Novie puti k etiologii i terapii nefrolitiaza zhurnali urologia Nr. 2 f. 30-35 1937.
Pitel A.J. Osnovi prakticheskoi urologii f. 105-135 1964.
Pitel A.J. Klinicheskaja medicina Nr. 11 1962.
Pogurollko I.P. Kirurgicheskoi vmeshateljstvo pri kamjah poçek i moçetocni kov f. 21-40 1960.
Saly K.H. Calcnkus duseasc in e single kindne uroll. f. 10 1959.
Tahirov K.M. Moçekamenaja bolezn u detei u ezhkistave f. 29-42 1962.
Chute R. Clinical aspekt of hypérparathyroidism weth special referenza to urologi. Jurnal 36, 159-167 1936.

THE DISTRIBUTION OF UROLITHIASIS IN ALBANIA

(S u m m a r y)

The author presents a statistical study of urolithiasis in Albania.

He reviewes 910 cases treated in the Tirana State Hospital during the period 1961-1963, as well as 2100 case histories of all the post mortems done in the hospital during the same period. From this survey it can be concluded that urolithiasis in Albania is frequent, especially among children years old, mostly in certain districts like Kruja, Burel and Saranda.

DISA TË DHËNA MBI NEFRITET AKUTE NË USHTRI

HAJRO SHYTÌ

(Spitali Përgj. Ushtarak — Drejtëor Kolonel S. Imam)

Nephritis acuta (Glomerulonephritis acuta diffusa) është afekcion bilateral i glomeruleve renale që zhvillohet në formë diffuse si pasojë e reaksionit të përgjithshëm të organizmit kashi një infeksioni të caktuar. Proseset inflamatore karakterizohen nga ndryshime morfologjike që cojnë në pengesën e rjedhjes së gjakut në kapilarat glomerulare për shkak të inflamacionit të tyre, edemes dhe proliferimit endotelial të kapilarave glomerulare.

Glomerulonephritis acuta diffusa ka etiologji infekcioze-alergjike. Ay lind në shumicën e rasteve disa dit mbas kalimit të një inflamacioni faringo-tonsilat, katari të rrugëve të sipërme të frysëmarrjes ose të një vatre tjejetë infekciozo-mikrobiiale.

Sëmundja në pikpamje klinike manifestohet me hematuri, albuminuri, edeme, azotemi të shtruar dhe hipertension arterial.

Objekti i studimit përbëhet nga 30 të sëmurë të mjekuar në spitalin tonë me *glomerulonephritis acuta diffusa* gjatë 5 vjetve të fundit.

Të sëmurët kanë ardhur në spital nga reparte të ndryshme të garnizonit të Tiranës dhe garnizoneve të tjera jashtë Tiranës. Midis tyre nuk është gjetur asnjë lidhje epidemiologjike.

Shtrimi i tyre në spitale është bërë në 18 raste javën e parë të sëmundjes, 5 raste javën e dyte dhe në 7 javën e tretë të sëmundjes.

10 raste i takojnë moshës 18-20 vjeç, 15 moshës 21-25 vjeç dhe 5 moshës 31-35 vjeç. Nga ushtarët në vitin e parë të shërbimit ishin 22 veta, në vitin e dyte 3 dhe në vitin e tretë 1.

Sëmundja është çfarë:

në tremujorin e parë 10 raste

në tremujorin e dyte 2 raste

në tremujorin e tretë 1 rast

në tremujorin e katërt 17 raste

Simbas anamnezës 19 të sëmurë 2-3 javë para fillimit të sëmundjes kishin kaluar infeksione faringo-tonsilare dhe katata të rrugëve të sipërme të frysëmarrjes.

Kuadri klinik është karakterizuar nga një fillim i menjëherëshëm i sëmundjes dhe rendim të gjendjes së përgjithshëm shëndetësore e cila i ka detyruar të sëmurët të ndërpresin stërvitjen dhe të kërkojnë ndihmën mjekosore.

Qjetësimet kryesor që kanë akuzuar të sëmurët ditët e shtrimit në spitalë kanë qenë: dispneë në lëvizje të zakonëshme e akuzuar nga 14 të sëmurë. 15 raste me rendim të epigastrium dha në hipocondrin e gjithë 5 prej të cilave kanë patur të vjella dhe një rast me sindrom pseudoadappendikular. 10 raste me dhimbje mesi në formë rendimi, kurse 19 të tjerë dhimbje koke.

Në 16 raste fillimi i sëmundjes është shoqëruar me oliguri, në 4 urina ka patur ngjyrë të kuqe. 22 të sëmurë kanë akuzuar anjje të fytyrës, anësive të poshtme dhe të durave. Në 10 raste fillimi i sëmundjes ka qenë me temperaturë.

2 të sëmurë janë sjellë në spital në gjendje të rëndë komatoze me kriza konvulsive.

Eksaminalimi klinik objektiv i bërë ditet e para të qëndrimit në spital ka vënë në dukje në 28 të sëmurë edeme të madhësive të ndryshme të lokalizuara në fytyrë dhe në pjesët e ndryshme të trupit. Këta të sëmurë kanë paraqitur një pamje pastoze të fytyrës dhe amje të shpresës subcutane të gjithë pjesëve të trupit. Edemet në prekje ishin të buta, të pa dhimbëshme që me ndryshimin e pozicionit të sëmurit ndryshonin lokalizimin e tyre. Lidhur me këtë fakt, të sëmurët zakonisht ne anamnezë kanë treguar se në mëngjes fytyrët e kishin më të enjtor se në mbërmje, ndërsa një pjesë prej tyre kanë treguar se në mbërmje këmbet iu ajeshin ma tepër ndërsa në mëngjes këtë gjë nuk e vini re.

Në 12 raste janë gjetur versamente pleurale tek të cilët Rivalta ka rezultuar negativ. 4 të sëmurë kanë patur anasarca.

Të gjithë të sëmurët kanë patur një pamje të zbetë të fytyrës me gjithë që figura eritrocitare nuk është gjetur e ndryshuar.

Tensioni arterial ishte i ritur (Mx 145-190, Min. 90-110 mm Hg.) në 19 raste. Tensioni minimal ka qenë më i qëndrueshëm dhe në vlefsh më të ritura në raport me presionin sistolik. Në 11 rastet e tjera tensioni arterial është gjetur normal. Paralel me ritjen e tensionit arterial, në 11 rast kufiti e zemrës kanë qenë të zmadhuara kryesisht nga e majta, kurse në 20 raste është konstatuar akcentum i tonit të dytë mbi aortë. Në 14 raste këto fenomene janë shoqëruar me shenja klinike të insuficencës kardiovaskulare.

Në 7 të sëmurë janë konstatuar fenomene staze në bazat pulmonale, ndërsa në 15 raste të tjera Hepari kalonte kufirin e arkut kostar.

Në fillim sasia e urinës për shumicën e rasteve ka qenë më pak se 1/2 litre në 24 orë. Pesa specifike e urinës ka qenë në limite të normës.

Hematuria e konfirmuar mikroskopikisht është gjetur në të gjitha rastet, nga të cilët në 6 eritrocite të rralla për fushë, në 3 raste 10-20 eritrocite për fushë dhe në 21 shumicë eritrocite shpesh për fushë.

Albuminuria ka qenë prezent tek të gjithë të sëmurët. Në 22 raste 0.5-4 gr.% o kurse 8 të tjera gjurmë. Në 13 raste janë vrejtur cilindra hialine dhe granuloze.

Azotemia ka qenë e ritur në 14 raste nga të cilët në 2 0.41-0.50 gr.% o, në 3 0.51-0.60 gr.% o, në 2 0.61-0.70 gr.% o, në 3 0.71-0.80 gr.% o, në 1 raste 0.91-0.95 gr.% o. Azotemia është gjetur e ritur pothuajse në të gjitha rastet me insuficencë kardiovaskulare.

EKG e regjistruar në 5 të sëmurës tregon për të 5 rastet bradikardi sinusale (55-60/min), u në 1 rast iskemi e shtrësës subendokardiale, në 1 rast deformimi i fazës repolarizuese (sheshim deri negativizim i valëve T në lidhje standard dhe lidhjet prckordiale), në 2 raste voltazhi i ulët. Të gjitha këto reperte janë normalizuar mbas përfundimit të mjekimit të sëmurëve.

Në 20 raste eritroscidimentacioni ka qenë i ritur (20-70 mm/orë). Kuadri i gjakut nuk ka paraqitur ndonjë vezori.

Kontrolli tonsilar në 6 raste ka konstatuar *Tonsillitis chronica* me rekondidim për tonsilektomi. Në kontrollin stomatologjik, në 5 raste janë gjetur infeksione dentare.

Ekzaminimi i fundus oculi vetëm në 2 raste me hipertension arterial të theksuar ka shënuar ngushtim të arterieve retinale ndërsa në të gjitha rastet e tjera reperti okulistik ka qenë normal.

Për të illostruar rastet e obervuara po japid një shëmbell të mjekuar në spitalin tonë: I sëmuri Th. M. 32 vjeç, 20 dit mbasi kishte kaluar një inflamacion kataral të sytë, u anjtuq nga fytyra, duart, këmbët dhe pjesët e tjera të trupit. 2 dit më von iu çfaqën dhimbjë në bark të lokalizuara në hypokondriq e djathitë dhe në regionin apendikular të shoqëruara me të vjella. Ditët e fundit qdo mëngjes ishte çuar me palpebra të anjtruta sa memzi i hapeshin siyé. 4-5 ditët e fundit kishte vënë re që sasia e urinës ishte pakësuar. Ishte detyruar të lironë rypin e mezit dhe rypin e orës së dorës. Cizmet nuk e nxinin. Amien e fytyrës e kishin vënë re edhe shokët e tij në report. Për këto shqetësimë më 13/7/63 u shtrua në spital.

Pacienti i ndiente veten të dobët, pa fuqi, akuzonte dhimbje koke, dhimbje barku dhe imbahej fryma.

Në ekzaminimin klinik objektiv i sëmuri paraqiste një pamje pastoze të fytyrës, tegumenitet të zbeta. Edeme në pjesët kurruale të anësive të poshtme dhe në regionin lumbosakral. Pulsit i fortë me frekuencë 60/min. Kufiri i majtë i zemrës kalonte reth 2 cm. vijën medioklavikulare. Toni i dytë mbi aortë i akcentuar. TA 150/100 mm Hg. Në bazin e hemitoraksit të djathitë paraqiste 3 gishta matitet me zhdukje të *fremitus pectoralis* dhe të numurit vezikular. Abdomeni i lirë por i dhimbshëm në prekje të thellë në regionin apendikular. Hepari prekej 2 cm. nënë arkun kostar.

Ekzaminimi paraklinik vuri në dukje këto të dhëna: urina e turbullt, ditët e para me sasi deri 350 cc. në 24 orë me peshë specifikë 1022. Sedimenti në urinë përbante 10-15 eritrocite përfushë, leukocite 4-5 përfushë dhe cilindra hialine dhe granuloze të rralla. Albuminuria 0.76 gr.% o, Azotemia 0.76 gr.% o, Kreatininemia 2.10mg%. Skopia e toraksit vinte në dukje versamenti pleural të djathitë deri në i.c. VI. Panksioni pleural nxori likuor me ngjyrë citrike ku reaksiuni Rivalta rezultoi negativ. Në EKG paraqiste bradikardi sinusale (me frekuencë 56-60/min) dhe voltazhi të ulët. Ekzaminimi otoskopik dhe stomatologjik nuk i konstatuan ndonjë vatrë infekcioze. Në të kaluarën pacienti nuk kishte patur asnjë sëmundje.

Qyshe ditët e shtrimit në spital ju fillua terapia e zakonëshme. Regjim shtrati, 3 ditët e para pa ushqim maudej dieje pa krypë, calcium chlorur, vitamina, penicillin (me qëllim profilaktik).

Brenda 14 ditve të gjitha fenomenet u likuiduan, diureza u rivendos në normë. TA u normalizua, pulsi u bë më i shpejtë (75/min); zemëra mbriti në kufit normalë, versamenti pleural u resorbua. Hepari u zgogëluar në madhësi normale. Azotemia zbriti në 0,37 gr.% o. Deri në këtë kohë në sedimentin e urinës persistonin 10-12 eritrocite përfushë. Mbas 6 javësh edhe reperti në urinë u normalizua dhe i sëmuri doli nga spitali në gjendje të mirë.

Nga formati abortive të nefriteve akute kemi mundur të izolojmë vetëm 2 raste të cilat janë e adhur në grupin e nefriteve të thjeshta të tipit renal me hematuri të theksuar dhe albuminuri të moderuar.

Diagnoza e nefriteve monosimptomatike është e vështirë. Vetëm prezenca e proteinurisë

dhe e hematuris së izoluar pa llogaritur anamnezën dhe simptomat ekstrarenale, nuk jepin bazë për diagnozën e nefritit akut difuz (6). Këto forma abortive të nefriteve pa irritje të TA dhe pa edeme nuk mund të dallohen nga nefritet insulare. Prandaj udhëheqës për këtë duhet të shërbejë eksperiencia sipas të cilës nefritet difuze lindin mbas infekzionit (forma post infekcioze), kurse nefritet insulare gjatë infekzionit (forma intrafekcioze) (4,5).

Në 2 rastet tonë radhitja e tyre në formën hemoragjike të nefriteve akute difuse është mbështetur në këto të dhëna:

Tek të dy rastet sëmundja filloj me dhimbje të leta në regionin lumbar, dobësi të përgjithshme. Njëri prej tyre kishte vënë re që urinën e bënte të kuqe. Ekzaminimi mikroskopik i sedimentit të urinës konstatoi shumicëtë eritrocitesh përfshinë, 4-5 leukocite, cilindra hialine dhe granuloze të rralla dhe gjurma albuminash. Për këto arësyte u shtruan në spital.

Nga anamneza e tyre rezulton se 2-3 javë përparrë të dy të sëmurrët kishin kaluar inflamacion të rrugëve të sipërme të frysëmarrjes përfshinë të cilën ishin mjekuar në kondita stacionare.

Ekzaminimi klinik objektiv nuk vinte në dukje ndonjë ndryshim nga norma, me përvjetorin e shumësimit Pasternackyt që ishte letësishë pozitiv në të dy anët. TA normal. Edemet mungonin. Prova e PSP, Van Slyke, radiografia e aparatit urinar, cystoskopija, urografia descendente nuk vinte në dukje ndonjë ndryshim nga norma. Kontrolli radioskopik i pulmoneve si dhe kontrolli otojatrik e stomatologjik nuk zbuluan ndonjë vatrë infekcioze. Kuadri i gjakut ishte normal tek të dy të sëmurrët. Eritrosedimentacioni i shtuar 15-25 mm/orë. Flotacioni i urinës përfshin B.K. negativ. Urokultura përfshin bakterie negative. Kurba termometrike normale.

Reperti në urinë persistonte i njëjtë me gjurma albuminë dhe shumicëtë eritrocitesh në sediment edhe përfshin javë të tjera.

Në këto rrethana të dy rastet u konsideruan si nefrite akute difuse forma hematurike dhe së tillë u trajtuan deri sa reperti në urinë u normalizua.

Nga komplikacionet e nefriteve akute kemi observuar 2 raste tek të cilët sëmundja është zhvilluar me një dekurs të rendë me çfaqje të eklampsisë si pasojë e fillimit me vonesë të terapisë dhe të regjimit hospitalier.

Karakteristika të përbashkëta përfshinë edhe përfshinë që ishte akute difuse forma hematurike dhe së tillë u trajtuan deri sa reperti në urinë u normalizua. Nga komplikacionet e nefriteve akute kemi observuar 2 raste tek të cilët sëmundja është zhvilluar me një dekurs të rendë me çfaqje të eklampsisë si pasojë e fillimit me vonesë të terapisë dhe të regjimit hospitalier.

Karakteristika të përbashkëta përfshinë që ishte akute difuse forma hematurike dhe së tillë u trajtuan deri sa reperti në urinë u normalizua. Nga komplikacionet e nefriteve akute kemi observuar 2 raste tek të cilët sëmundja është zhvilluar me një dekurs të rendë me çfaqje të eklampsisë si pasojë e fillimit me vonesë të terapisë dhe të regjimit hospitalier.

I sëmuri R.I. 21 vjeç, i cili nuk ka qenë oliguria deri anuria e plotë edeme të fytyrës dhe të anesive. TA i naltë (sistoliku dhe diastoliku), kriza kloniko-tonike të pjesëve të ndryshme të trupit, të vjella, bradikardi, simptome meningeale, rigiditet të qafës shtim simetrik i reflekseve osteotendinoze, klonus, verbim i përkohëshëm, turbullime akustike dhe gjendje deliri, albuminuri 3-4 gr.%. Ponksioni lumbar në të dy të sëmurrët ka nxjerë likuor të kjartë me disociacion albumino-citologjik. Këta dy raste dallonin nga njeri tjetri me faktin se ndërsa njëri që paraqiste edeme të generalizuara me hydrotoraks, azoteminë, e kishte 0.31 gr.%, kurse tjetri me edeme më të moderuara azoteminë e kishte 0.60 gr.%.
I sëmuri R.I. 21 vjeç, i cili nuk ka qenë oliguria deri anuria e plotë edeme të fytyrës dhe të anesive. TA i naltë (sistoliku dhe diastoliku), kriza kloniko-tonike të pjesëve të ndryshme të trupit, të vjella, bradikardi, simptome meningeale, rigiditet të qafës shtim simetrik i reflekseve osteotendinoze, klonus, verbim i përkohëshëm, turbullime akustike dhe gjendje deliri, albuminuri 3-4 gr.%. Ponksioni lumbar në të dy të sëmurrët ka nxjerë likuor të kjartë me disociacion albumino-citologjik. Këta dy raste dallonin nga njeri tjetri me faktin se ndërsa njëri që paraqiste edeme të generalizuara me hydrotoraks, azoteminë, e kishte 0.31 gr.%, kurse tjetri me edeme më të moderuara azoteminë e kishte 0.60 gr.%.
I sëmuri R.I. 21 vjeç, i cili nuk ka qenë oliguria deri anuria e plotë edeme të fytyrës, mësose, parase te anesive që herë pas herë kalonin ne spasma kloniko-tonike, cianoze te buzeve dhe te thonje. Gjuha e anjur e gjakosur. TA 170/100, pulsi bradikardit 60 min. Reflekset osteotendinoze te shtuara. Simptomet meringeale pozitiv, klonus, azotemia 0.60 gr.%. Urina e paket 120 cc e mare me kateter, me pesha specifikë 1024. Albuminuria 3.5 gr.%. Ne sedimentin e urinës eritrocite me shumicë përfshinë, cilindra hialine të rralla. Ponksioni lumbar nxori likuor me ngjyrë të kjartë në të cilën përmbytshin albuminë 0.45 gr.%, Pandy pozitiv i letë, glucosa 0.05 gr.%. Citosia 5 në 1 mm³. Iu nxuar 10 cc likuor CS dhe mbas kësaj i sëmuri u leteset.

Të sëmuri iu aplikuan komprëse të stofta nuk kanë 3% sol. chloralhidrat 50 cc me luminal 0.05. Venepunkcione 400 cc gjak. Lobelin, glucos, calcium, chlorur, penicillin. Mbas kësaj terapije gjendja e të sëmurrët përmirësua dhe mësuesia e sëmurrës së cilës 60 ditëve doli nga spitali i shëruar.

Sic rezulton nga të dihet e më sipërme, forma kryesore e nefriteve akute të mjekuara në spitalin tonë kanë qenë nefritet albuminurike dhe edematoze me hematuri mikroskopike dhe cilindruri, azotemi të letë, hipertension arterial dhe në një përqindje të rasteve me insufisience kardiovaskulare.

Vetëm në dy raste janë ndeshur format fruste hematurike të nefriteve ndërsa në 2 raste të tjera format e komplikuara me eklampsi.

Simptomet kryesore të nefriteve akute nuk kanë qenë të shprehura me të njëjtin intensitet tek të gjithë të sëmurrët tonë. Ato kanë qenë të kombinuara në mënyrë të ndryshme dhe janë çfaqur e zhdukur në fazat e ndryshme të sëmundjes.

Kështu p.sh. në 14 raste kanë predominouar format e nefriteve akute me çfaqje të insufisience kardiovaskulare, që është karakterizuar me dispne, cianoze, rritje të TA, edeme të shumta, në 9 prej të cilave me azotemi të naltë.

Në 5 raste format e nefriteve janë paraqitur me edeme, hipertension arterial, azotemi të rritur; hematuri dhe albuminuri njëri prej të cilëve me eklampsi.

Në 9 raste forma e nefriteve me edeme, hematuri dhe albuminuri, pa rritje të TA dhe pa azotemi të shtuar njëri prej të cilëve me eklampsi.

Në 2 të sëmurrët vetëm me simptome renale pa edeme, pa TA të rritur dhe pa azotemi të shtuar

Ky variabilitet në simptomatologjin klinike të nefriteve akute ndodh përfakt se nefritet nuk zhvillohen si entite te morboze definitive. Ato ndryshojnë nga një moment në tjetrin, pranë daj simptomet e ndryshme në kuadra klinik të nefriteve nuk përfaqësojnë një formë definitive por një moment të caktuar në historin e sëmundjes (2).

Mjekimi i të sëmurëve është filluar me uritë plotë 3 ditët e para. Në format e leta është lejuar 1/2-1 litër leng pemësi në formë komposte për 24 orë. Regjim shëratë për një kohë mësatare prej 1 muaji. 3 javët e para është përdorur calcium chlorur në doza të mëdha për os. Glucos i.v., vitamina. Penicillina është aplikuar në dozën 800.000 un. në 24 orë për një kohë prej 7-10 ditësh parësishet nga aktiviteti i vatrës infekcioze. Në rastë të vëçantë ajo është aplikuar prej një kohe më gjatë. Mbas regjimit të urisë të sëmurët janë furur në dietën pa krypë me një përbajtje të këtillë: proteinë 60.1 gr., yndyrna 47.7 gr., Karbohydrate 395 gr. gjithëseit 2313 kalori. Mbas zhdukjes së edemeve, normalizimit të TA dhe zhdukjes së shenjave të insuficiencës kardiovaskulare, me gjithë prezencën e albuminurisë reziduale dhe hematurisë mikroskopike, të sëmurëve iu është shkuar në dietë 4-5 gr. krypë. Në fund të kurës është bërë mjekimi i fokusave nënë mbrojtjen e penicillines.

Dekursi i sëmundjes në përgjithësi ka patur karakter ciklik në të cilën janë dalluar dy periudha kryesore:

Në periudhën e parë (koha e përfshirë mudis datës së shtrimit në stacionar dhe datës kur i sëmuri është liruar nga edemet, insuficiencia kardiovaskulare dhe normalizimi i azotemisë) diureza është shkuar. Të sëmurët kanë eliminuar sasi të madhe urine (2.5-3.5 lira në 24 orë). Edemet janë zhdukur të së bashku me to është përfunduar resorbimi i versamentit pleural. Ralet statikë në pulmone janë zhdukur. Me zhdukjen e edemeve është normalizuar tensioni arte rial. Në të njëjën kohë janë zhdukur shenjat e insuficiencës kardiovaskulare. Kufit e zemrës janë kthver në normë. Të sëmurët mbas kësaj periudhe e kanë ndier veten mirë pa dispne përturuese.

Niveli i azotemisë ka filluar të zbresë qysh me fillimin e diurezës së madhe dhe normalizimi i saj është përfunduar në kohen e zhdukjes së plotë të edemeve, të normalizimit të TA dhe të zhdukjes së shenjave të insuficiencës kardiovaskulare.

Kjo periudhë në rastet tonë ka zgjatur 7-14 ditë. Mbas përfundimit të kësaj periudhe nuk është vretur asnjë komplikacion lidhur me rritjen e përsëritur të tensionit arterial ose të insuficiencës kardiovaskulare. Recidivat e edemeve me karakter nefrotik nuk janë ndeshar.

Mbas mbërrimit të periudhës së parë ka ndjekur periudha e dyte e dekursit të sëmundjes (koha e përfshirë nga mbërrimi i periudhës së parë deri në zhdukjen e të gjithës simptomeve klinike dhe paraklinike të sëmundjes). Kjo periudhë në pikpamje klinike është karakterizuar me prezencën e proteinurisë, hematurisë mikroskopike dhe cilindrurisë hialine dhe granuloze në sedimentin e urinës. Me zhdukjen e edemeve dhe normalizimin e TA në 1/3 e rasteve është vënë re që hematuria përkohësisht është shkuar, mandje rishtas ka filluar të pakësitet deri sa në fund të mjekimit ka aritur limitet e normës.

Të sëmurët në këtë periudhë e kanë ndier vehten më mirë, dhimbjet e kokës dhe të vezit ja në zhdukur dhe përvëc repertit në urinë të gjitha të dhënat e tjera klinike dhe paraklinike janë qenë normal.

Zgjatja mesatare e qëndrimit në stacionar i të sëmurëve ka qenë 4-6 javë Brenda kësaj kohë janë zhdukur të gjitha simptomet renale dhe ekstrarenale të sëmundjes.

Mbas daljes nga spitali e ushtarakeve të shërbimit të detyruar, gjendja e tyre shëndetësore nuk është ndjekur nga ana e jonë, për shkak të vend banimit të tyre në zona të ndryshme dhe të largëta.

KONKLUZION:

1. *Glomerulonephritis acuta diffusa* përbën një nga format e shpeshta të nefropative në ushtri. Nga kjo sëmundje preken kryesisht ushtarakët e vitit të parë të shërbimit të cilët 2-3 javë para fillimit të saj kalojnë një inflamacioni faringo-tonsilë ose katar të rrugëve të sipërme të frysëmarrjes.

2. Nefrite akute të obseruara në ushtri në pikpamje klinike i takojnë formës së përzier që karakterizohet me simptome renale dhe ekstrarenale, me hematuri, albuminuri, oliguri, edeme, hipertension arterial, azotemi të shkuar dhe simptome të insuficiencës kardiovaskulare.

Vëtëm 6% të rasteve i takojnë nefriteve të tipit të thjeshtë renal me albuminuri dhe hematuri pa simptoma ekstrarenale.

Komplikacionet kryesore të nefriteve akute kanë qenë eklampsia e cila është manifestuar me të gjitha simptomet klinike dhe që me mjekimin racional kanë përfunduar në shërim të plotë.

3. Hospitalizimi i hershëm i të sëmurëve si dhe mjekimi kompleks i tyre ka siguruar në të gjitha reset një dekurs të favorshëm që është shprehur me zhdukjen e simptomeve renale dhe ekstrarenale brenda një kohe mesatare prej 4-6 javësh.

(Paraqitur në redaksi me 20/12/64)

LITERATURA

1. *Campanact D., Migone L., Romeo F.* Malattie dei reni e delle vie urinarie. ne Patologie medica, III. f. 1011-1064
2. *Pasteur Vallery-Radot, Pierre Delafontaine.* Precis des maladies des reins. Paris 1959
3. *Tarjejev E.M.* Nefrite. Moskva 1958
4. *Vancura A.* Choroby ledvin a mocovych cest. Pathologie a Therapie nemoci vnitrich. Pelnar J. Praha 1934
5. *Vancura A.* Morbus Brighti (Nefritidy). Urologie. Klika M. Praha 1950
6. *Vovsi M.S.* Bolezni sistem moceotdelenije. Moskva 1960

SOME OBSERVATIONS ON ACUTE NEPHRITIS IN THE ARMY.

(S u m m a r y)

This work surveys the clinical aspect of 30 cases of acute diffuse glomerulonephritis, observed in the military hospital of Tirana. The patients were all young men, doing their military service, who contracted nephritis after acute attacks of inflammation of the pharynx or tonsils.

From the clinical point of view these cases represent mixed forms of nephritis with renal and extrarenal symptoms: haematuria, albuminuria, oliguria, high blood pressure, oedema, which in 50% of the cases were aggravated by heart insufficiency.

The author describes briefly the treatment, which in all the cases resulted in the rapid recovery of the patients.

STUDIMI DINAMIK I OSHILOGRAFISË NË TË SËMURËT ME ENDARTERITIS OBLITERANS

DOC. FIQIRI BASHA

(Katedra e Anatomihistologjisë — Shef S. Çico)

Mjekimi kirurgjikal dhe konservativ i endarteritit obliterans kërkon një varg analizash dhe ekzaminimesh fizike, sepse, pa këto shpesht herë është vështirë të përcaktohet grada e obturacionit dhe niveli i tij. Të dhëna më të sigura mbi çregullimet funksionale ose morfoloqike jep oshilografia.

Oshilografiya (ose edhe oshilometria) është një metodë ekzaminimi shumë e thjeshtë dhe gjithmonë e mundëshme për tu aplikuar në çdo vënd dhe prandaj vlen të shifrytëzohet më gjérësisht duke filluar që nga ekzaminimet e para ambulatorore (ku diferencohen sëmundjet vaskulare nga sëmundjet e tjera) dhe deri në ekzaminimet e përsëritura klinike me qëllim që të nxirren në dukje ndryshimet dinamike të mundshme në indeksin oshilator. Për këtë arsyet metoda e oshilografisë që përdoret gjérësisht në klinikat kirurgjikale dhe terapeutike, për diagnostimin e sëmundjeve të vazave dhe të zemrës, mori një rëndësi të veçantë edhe në të sëmurët me endarterit.

Për të regjistruar të dhënat oshilografike, ne kemi përdorur oshilografin «scrkin» dhe oshilometrin e tipit «Pachon». Siç dihet oshilograma është amplituda e shkruar që pasqyron madhësinë e valvites pulsive të murit arterial. Këto valë të regjistruara automatisht janë të ndryshme dhe varen nga komprimimi që bën mansheta e oshilografit ose e oshilometrit mbi indet dhe murin arterial. Gjatë ekzaminimit duhen marrë parasysh të gjithë faktorët që influençojnë në indeksin oshilator, sikurse elasticiteti i arteriave, kalibri i vazës, sistemi nervor, zemrë etj.

Për sa i përket elasticitetit të arteriave, ky ulet nga qendra në periferi, ashtu sikurse edhe kapaciteti që mvarët nga kalibri i vazës, dhe vjen duke u zgjegħluar distalisht në mënyrë graduale.

Gjatë ekzaminimit duhet marrë parasysh edhe grada e kontraktilitetit të arterieve, tonus apo spasma etj. Sikurse dihet arteriet e marrin tonusin kryesish nga nervat vazokonstriktore që ngushtojnë me anën e muskulaturës cirkulare të lëmuar lumenin e arteriave (Ll. Fogelson).

Për këtë arsyet metoda e oshilografisë së përsëritur që ne kemi aplikuar para dhe mbas provës funksionale me ngarkesë, nxjerr indekse të ndryshme oshilatore që reflektojnë, tonusin normal, gjendjen spastike ose lezonë të thella morfoloqike.

Ndryshimet e indeksit oshilator dokumentojnë gjithë dinamizmin e procesit obliteronjës dhe tregojnë njëkohësisht edhe shifrat e presionit maksimal, të mesëm dinamik dhe minimal në arteriet e ekzaminuara. Këto të dhëna plotësojnë ekzaminimin e përgjithshëm të aparatit kardiovaskular. Metoda është ekzakte dhe mjaft e ndjeshme.

Në figurën e paraqitur më poshtë vijen re ndryshime të dukeshme në indeksin oshilator ku në regjistrimin e parë amplitudat e vogëla reflektojnë një gjendje spastike të murit arterial, kurse në të dytën indeksit oshilator është pak a shumë normotonik.




Fig. 1

indeksi oshilator nuk është i njellojtë për të dy anësitë, këto ne nuk i kemi marrë parasysh në shumicën e rasteve, ndërsa diferenca e mëdha kanë vërtetuar se janë reflektimi i lezonave të thellia endarterike dhe sëmundjesh të tjera vaskulare.

Në interpretimin e oshilografisë ka rëndësi madhësja e indeksit oshilator. Duke u bazuar në indeksin oshilatorë të njeriut normal që arrin mesatarish rrëth 20 mm. në kërcirin dhe 2-4 mm. në këmbë, atëherë del shumë demonstrative e bindëse edhe oshilograma e rregjistruar në kërcirin e sëmurë nga endarteriti.

Për të vlerësuar më drejtë gjëndjen funksionale ose morfologjike të arterieve të anësise së lezonuar, ne jemi bazuar edhe në mekanizmin e rregjistrimit sepse shpeshi herë oshilograma paraqet në disa të sëmurë vetëm një vijë të drejtë, ndërsa gjendja e përgjithësme e tyre është e mirë dhe ata nuk ndjekjnë ndonjë çrrëgullim të madh. Në këto raste ne nuk kemi menduar gjithmonë se vaza është e obliteruar plotësisht por vetëm në një pjesë, sepse sic e ka treguar më vonë edhe ekzaminimi arteriografik, këtu janë zhvilluar kolateralet, me anën e të cilavet gjaku kalon në segmentin distal.

Për të gjitha rastet duhet marrë parasysh edhe gjëndja e elasticitetit të kapsulës së aparatit; ku disa kapsula jep amplituda më të mëdha, ndërsa disa të tjera jepin valivitje më të vogla. Ne, për këtë qëllim, kemi ekzaminuar sistemun arterial periferik në një praktikisht të shëndo shë dhe këtë indeks që ka qenë në disa aparate më i vogël se 20 mm. në kërci e kemi marrë si hazë për të vlerësuar çrrëgullimet arteriale në të sëmurët.

Ekzaminimet në të sëmurët u kryen në klinikë dhe në një punkt të tipit dispansorial pranë spitalit Nr. 2. Mansheta e oshilografit vendet në segmentet më distale dhe gradualisht kalohe në pjesët më centrale, duke marrë nga një oshilogramë për çdo nivel dhe çdo anësi veçmas të gjatë. Amplitudat normale ose patologjike të judeksevet oshilografike, na jepin edhe të dhëna të vlefshme për të gjykuar mbi gjëndjen funksionale të zemrës, të tensionit arterial dhe të vazave arteriale magistrale.

Gjatë ekzaminimit i sëmuri rrin ndenjur osë i shtrirë në shtrat dhe aparatit vijet në një nivel me shtratin. Konditë e domosdoshme për të marrë oshilograma të mira është pozicioni horizontal që duhet të mbajë anësia dhe evitim i çdo lëvizjeje. Për këtë qëllim të sëmurit i propozohet që ta shtrijë këmbën dhe ta lerë fare të lirë. Kjo arrihet më mirë kur i sëmuri i shtrin të dy këmbët. Të gjithë të sëmurët janë ekzaminuar në kondita të barabarta. Në kemi përdorur si vend matjeje në shumicën e rasteve 1/3 e mesme të kërcirit për të dy anësitë e poshtëmë.

Për të diferençuar spazmën e vazavet nga lezonet morfologjike oshilogramat janë përsëritur mbas pesë minutash, deri sa u arritën të merren indekse oshilatore konstante. Format

Fig. Nr. 1. Dy oshilogrfi të rregjistruara para dhe mbas ngarkesës në 1/3 e mesme të kërcirit të të sëmurit K.P. ku amplitudat në pozën e parë janë të çrrëgulla dhe koincoidojnë me gjendjen spastike të arteries, ndërsa në pozën e dytë paraqiten amplituda të çrrëgulla dhe adekuate me gradën e shtypjes së anësise nga mansheta e oshilografit gjë që korespondon me një indeks normotonik.

Pra duke komprimuar murin arterial me manshëtin e oshilografit rregjistrohet automatisht edhe ndryshimi në shkallën e presionit arterial. Studimi dhe vlerësimi i gradave të këtyre ndryshimeve, lejon që të zbulohen në kohën e duhur çrrëgullimet e tonusit të arterieve periferike si edhe grada e zhvillimit të qarkullimit kolateral kompensator të gjakut. Përveç kësaj ekzaminimi oshilografik në të sëmurët me e ndarterit obliterant përparrë dhe mbas injekimit konservativ dhe kirurgjikal, na dha mundësi që të vlerësojmë më drejtë prognozën e injekimit përkatës.

Për të gjykuar më mirë mbi gjendjen e murit arterial, ne bëmë oshilografinë bilaterale d.m.th kribasimin e oshilogramave të marrë nga arteriet periferike, simetrike në nivele të ndryshme. Normalisht arteriet simetrike kanë kalibr të barabartë dhe rrëgullimet jepin pothuaje oshilograma identike. Kur oshilogramat paraqesin asimetri të vogla d.m.th, kur

indeksi oshilator nuk është i njellojtë për të dy anësitë, këto ne nuk i kemi marrë parasysh në shumicën e rasteve, ndërsa diferenca e mëdha kanë vërtetuar se janë reflektimi i lezonave të thellia endarterike dhe sëmundjesh të tjera vaskulare.

Në interpretimin e oshilografisë ka rëndësi madhësja e indeksit oshilator. Duke u bazuar në indeksin oshilatorë të njeriut normal që arrin mesatarish rrëth 20 mm. në kërcirin dhe 2-4 mm. në këmbë, atëherë del shumë demonstrative e bindëse edhe oshilograma e rregjistruar në kërcirin e sëmurë nga endarteriti.

Për të vlerësuar më drejtë gjëndjen funksionale ose morfologjike të arterieve të anësise së lezonuar, ne jemi bazuar edhe në mekanizmin e rregjistrimit sepse shpeshi herë oshilograma paraqet në disa të sëmurë vetëm një vijë të drejtë, ndërsa gjendja e përgjithësme e tyre është e mirë dhe ata nuk ndjekjnë ndonjë çrrëgullim të madh. Në këto raste ne nuk kemi menduar gjithmonë se vaza është e obliteruar plotësisht por vetëm në një pjesë, sepse sic e ka treguar më vonë edhe ekzaminimi arteriografik, këtu janë zhvilluar kolateralet, me anën e të cilavet gjaku kalon në segmentin distal.

Për të gjitha rastet duhet marrë parasysh edhe gjëndja e elasticitetit të kapsulës së aparatit; ku disa kapsula jep amplituda më të mëdha, ndërsa disa të tjera jepin valivitje më të vogla. Ne, për këtë qëllim, kemi ekzaminuar sistemun arterial periferik në një praktikisht të shëndo shë dhe këtë indeks që ka qenë në disa aparate më i vogël se 20 mm. në kërci e kemi marrë si hazë për të vlerësuar çrrëgullimet arteriale në të sëmurët.

Ekzaminimet në të sëmurët u kryen në klinikë dhe në një punkt të tipit dispansorial pranë spitalit Nr. 2. Mansheta e oshilografit vendet në segmentet më distale dhe gradualisht kalohe në pjesët më centrale, duke marrë nga një oshilogramë për çdo nivel dhe çdo anësi veçmas të gjatë. Amplitudat normale ose patologjike të judeksevet oshilografike, na jepin edhe të dhëna të vlefshme për të gjykuar mbi gjëndjen funksionale të zemrës, të tensionit arterial dhe të vazave arteriale magistrale.

Gjatë ekzaminimit i sëmuri rrin ndenjur osë i shtrirë në shtrat dhe aparatit vijet në një nivel me shtratin. Konditë e domosdoshme për të marrë oshilograma të mira është pozicioni horizontal që duhet të mbajë anësia dhe evitim i çdo lëvizjeje. Për këtë qëllim të sëmurit i propozohet që ta shtrijë këmbën dhe ta lerë fare të lirë. Kjo arrihet më mirë kur i sëmuri i shtrin të dy këmbët. Të gjithë të sëmurët janë ekzaminuar në kondita të barabarta. Në kemi përdorur si vend matjeje në shumicën e rasteve 1/3 e mesme të kërcirit për të dy anësitë e poshtëmë.

Për të diferençuar spazmën e vazavet nga lezonet morfologjike oshilogramat janë përsëritur mbas pesë minutash, deri sa u arritën të merren indekse oshilatore konstante. Format

spastike ose disa momente të caktuara spazme, kanë dhënë indekse oshilatore të ndryshme gjatë tre-katër ekzaminimesh me rradhë.

Autorë të ndryshëm sirkurse Troupjanski M.S., Zbykovskaja L. A. Piloitkin F. M. etj. thonë se oshilografija nuk mund ta diferencojë spazmën nga lezonet e thella organike.

Duke u bazuar në të gjithë kompleksin e shënjave klinike të cilat u plotësuan edhe me të dhënat e ekzaminimit fizik dhe laboratorik, të sëmurët u ndanë në grupe që i përkisnin fazave të ndryshme të zhvillimit të procesit. Ne dalluan tri forma dhe tri faza (simbas klasifikimit të Berjozov-Zajec G.P.) në të cilat u ndanë të sëmurët që ne ekzaminuan, me endarterit obliterant. Në të sëmurët që i përkisnin fazës së parë të zhvillimit të procesit, vihet re dëjetitë e shtuar, stohje e pjesëve distale të gjymtyrëve, lodhi këmbësh gjatë sforsimeve fizike, paresztë, dhimbje periodike gjymtyrësh, calim të herëpas herëshëm (claudicatio intermittens), dobesim pulsi ose mungesë periodike e tij në art. *dorsalis pedis* ose *tibialis posterior*, zgjogrim oshilonesh arteriale d.m.th. një indeks i vogël oshilografik ose oshilometrik dhe një numur i vogël kapilarësh në një mm. linear të observuara me kapilaroskop.

Në fazën e dytë vërvëhet dëjseritë e madhe, stohje e vazduharshme, mungesë pulsi në arterien dorsalis pedis e tibialis posterior, zhdukmen potkuajse fare oshilacionet në pjesët e poshtëme të kërcirrit ose indeksi oshilatorështë i vogël në 1/3 e sipërme të kërcirrit, pakësim i madh i numurit të kapilarëve që janë çdhe të deformuar dhe të zbehtë, ndryshime trofike lokale etj.

Në fazën e tretë përvëc atyre që u përmendën më lart, çfaqen carje dhe ulceracione të lëkurës e cila përgjithësisht cahet kurse në disa vende nekrotizohet duke filluar në llozhën e thonjëve, këmbë filion të edematizohet, kapilarët zhdukmen krejtësisht në pjesët periferike ndërsa amplitudal oshilografike ose oshilometrike paraqesin një vijë të drejtë pa asnjë valvitet.

Që nga fillimi i vitit 1956 dhe deri në tetor të vitit 1964 u ekzaminuan me oshilograf më shumë se 3000 të sëmurë, që paraqisin sëmundje vaskulare sirkurse Morbus Raynaud dhe syndromat e saj, tromboflebitë, varice, syndrome postflebitikë, *acroerythrocyanosis*, syndrom Leriche etj. Nga këta u ekzaminuan edhe 287 të sëmurë me endarterit obliterat që janë mjekuar më parë në klinikë dhe diagnostikuar që në punktin dispanserial. Në mes të tyre kishte edhe 8 gra. Mos është nga 18-60 vj.

Edhe nga studimi i oshilogramave, në shumicën dërmonjëse të rasteve, u gjetën rreaksione të njëjta vaskulare karakteristike për fazat dhe gradat e ndryshme të insuficiencës vaskulare.

Grupi i të sëmurëve me endarterit obliterat që i përket gradës së parë të insuficiencës vaskulare përbëhet prej 108 vetash d.m.th. 37,6%.

Grupi i të sëmurëve që paraqet një insuficiencë të gradës së dytë, përbëhet prej 90 vetash d.m.th. 31,3%.

Grupi i të sëmurëve me insuficiencë të gradës së tretë, përbëhet prej 89 vetash d.m.th. 31,01%.

Sirkurse vihet re edhe në shifrat që u paraqiten më lart, shumica e të sëmurëve (duke përfshirë të dy grupet e fundit sëbashku) paraqiten për ekzaminimin dhe mjekim në fazë të avancuar të pocesisit, atëherë kur është vështirë (është arriven rezultate më të mira terapeutike, mbasi vaskularizimi është i pari jaftueshëm, atëherë kur pengojnë ndryshimet trofike për një mjekim të efektueshëm dhe indeksi oshilatorështë një vijë e drejtë, ose vëtëm një deri dy milimetra).

Pak më shumë se 1/3 e të sëmurëve janë paraqitur pa ndryshime të theksuara trofike, me puls të dobësuar në arteriet magistrale me dhimbje të ndërprrera dhe me indeks oshilator të kënaqëshëm ose mbi 6-8 mm.

Të dhënat oshilografike në të gjitha rastet u janë përgjegjur edhe të dhënave subjektive klinike arteriografike, kapilaroskopike etj.

A.V. Kizeiova shkruan me plot të drejtë që kur ekzaminohet i sëmuri ku supozohet ndonjë sëmundje e aparatit kardiovaskular, dhe veçanërisht me endarterit obliterant, oshilografija sëmundje duhet të jetë e domosdoshme, meqenëse ndryshimet kryesore të amplitudës oshilografike merren pikërisht kur lezonohen arteriat.

Vështirësi paraqet interpretimi i indeksit oshilator kur lezonohen vazat e imta. Kështu L.A. Zbykovskaja shkruan se në këto raste indeksi oshilator zgjelohet në 1/3 e poshtëme distale, ndërsa në 1/3 e sipërme të kërcirrit ky indeks ruhet. Edhe ne kemi pasur raste të këtij lloji dhe shumica janë mjekuar me sukses pa amputacion. Në nuk kemi pasur në përgjithësi raste me indeks oshilator të madh mbi 6 mm., që i përgjigjet pak a shumë insuficiencës së gradës së parë të pajisjes me gjak që të ketë përfunduar në amputacion, por gjithmonë kur iudeksi oshilator ka genë me i vogël se 2 mm. ose një vijë e drejtë, kjo ka treguar me saktisë se procesi shkon drejtë amputacionit, në rast se nuk merren masat e duhura terapeutike. Më në fund, kur indeksi oshilator tregon zero ose një vijë të drejtë dhe klinikisht vihen re kjarritë fenomenet e gangrenës, atëherë këtu masat e mjekimit ndonjë mund ta ulin nivelin e amputacionit ose ta kufizojnë nekrotominë, megjithatë intervenimi për amputacion ose nekrotomi është i pa evituarshëm.

Si ilustrim për këtë që u thanë më lart mund të shërbejnë këto raste të observuar:

I sëmuri S.K. vjeç 47, me profesion punëtor, u shtrua në klinikë me 11/II/1960 me endarterit obliterant, me insuficiencë vaskulare të gradës së dytë, në një fazë akutizimi dhe me çfaqe tromboflebiti migranti. E ka ndjerë vehten të sëmurë para disa vjetësh kur i u çfaqën

dhimbjet në këmbët por në janar të vitit 1959 filloj të ndjëjë dhimbje dhe lochje të mache në këmbën e majt, ndërsa gishti i pestë i saj filloj t'i ulçerohet.

Status praesens: Mbulesat e lëkurës së gishtave të këmbëve kanë ngjyrë cianoïke, kurse lëkura e gishtit të pestë ka ngjyrë të kuqe dhe është ulçeruar. Pulsi rrungjen në arterien *dorsalis pedis* në të dy anët. Tensioni arterial me sfigmomanometër është 120/60, të njëjtë shifra mund të lexohen edhe në oshilogramën. Tensioni i mesëm dinamik është 100 mm të Hg. Mbas mjekimit preqitator konservativ dhe më vonë mbas sympatektomisë, gjendja e të sémurit u përmirësua, gjë që u reflektova edhe në zmadhimin e amplitudës oshilografike.

Fig. Nr. 2. Oshilograma e të sémurit S.K. me endarterit obliterant të formës trombangitike me insuficencë vaskulare të gr. II të fazës trofike. Shifrat tregojnë tensionin arterial në mm. të zhvës. Anash janë paraqitur oshilografitë e të dy këmbëve para operacionit, me indeks të ndryshëm oshilator. Në oshilogramën e mesit indeksi oshilatorë i marrë nga 1/3 e mesme e kërcirat të majtë është diçka më i madh në krahasim me indeksin aty pranë para mijekimit.




Fig. 2

Shëmbulli i sapopërkruar i historisë së sëmundjes, vërteton faktin se këtu kemi të bëjmë me lezione të vazave të imta, mbasi në arteriografi trungjet magistrale ishin të kalueshme plotësisht ndonjëse kishte alteracione trofike në gishtin e këmbës. Këte e vërteton më shumë edhe fakti se amplituda oshilografike u zmadhuva mbas operacionit gjë që nuk ndodh kur lezionohen vazat magistrale, por vetëm kur këto janë në gjendje spastike.

Ne kemi patur 12 raste të këtilla nga 36 të sémurë të këtij grupi të ekzaminuar me oshilograf, të cilët janë mijekuar mo sukses pa amputacion.

Duke ndjekur rezultatet e largëta edhe me metodën e ekzaminimit oshilografik, vihet se të sémurët e grupit të insuficencës vaskulare të gradës së dytë, janë të predispozuar për alteracione më të thella morfollogjike dhe në rrabdë të parë ata të formës trombangitike, në rast se nuk i bëhet mijekimi i duhur periodik dhe ai kirurgjikal të cilin e refuzojnë shpesh herë këta të sémurë.

E tillë është oshilografija e të sémurit I/K., i cili u shtrua me endarterit obliterant, në një fazë akute me edemë dhe skuqje të këmbës. Indeksi oshilator arrin deri në 2 mm. Ekzaminimi arteriografik tregon ndryshime në 1/3 e poshtëme të arteries *tibialis posterior*. Ekzaminimet e përsëritura oshilografike dhanë të njëjtin indeks oshilator. (Fig. nr. 3)

Fig. Nr. 3 Oshilografje e të sëmuarit J.K. me indeks oshilator deri më 2 mm. si përparrë ashtu edhe mbas mjekimit.

Format spastike me insuficacë të gradës së parë që të dytë, paraqesin lëvizje dinamike të theksuarë dho qjo vihet re mirë në oshilogramat që u regjistruan shumë kohë mbas mjekimit.




Fig. 3

EM

Për ilustrim po vëmë në dukje oshilogramën e të sëmurit J.Z. i cili u paraqit për mjekim në një gjëndje të atillë kur indeksi oshilator jepte vetëm oshilacione të vogla deri në dy-tre mm., ndërsa mbas mjekimit është shumë muaj më vonë kur ai u paraqit për kontroll në punktin dispanserial, ekzaminimi oshilografik tregoi një indeks oshilatorë të ngritur deri në 10 mm fig. Nr. 4).




Fig. 4

Fig. Nr. 4. Oshilografija e të sëmürit J.Z. me ndryshime të indeksit oshilator të këmbës së majtë. Në dy rregjistimet e anëshme duken oshilacionet arteriale me amplituda të ndryshme para dhe mbas mjekimit

Disa nga këta të sëmürë të operuar jo vetëm që kanë pasur ndryshime të dukëshme objektive dhe subjektive, por edhe indeksi oshilator ka treguar mbas disa javësh një rritje të amplitudës oshilografiqe. Si shembull mund të vlejë edhe oshilografija e të sëmürit S.J., i cili u shtrua me çfaqje klinike të theksuara dhe me indeks oshilator pothuajse një vijë të drejtë. Mbas mjekimit operativ dhe mbas ekzaminimit oshilografik postoperativ, indeksi oshilator u zmadhua deri në dy mm. zhivë. Fig. Nr. 5.




Fig. 5

Fig. Nr. 5. Oshilograma e pacientit S.J. e formës spastike e gradës së II para dhe mbas simpatektomisë.

Ne kemi observuar 13 të sëmürë të tillë, nga 39 që janë ekzaminuar edhe me oshilograf, të cilët i përkisnin formës spastike të gradës së dytë me përmirësimë të indeksit oshilator veçanërisht në fazat e më vonëshme postoperative.

Duke studjuar oshilogramat e të sëmürëve të formës spastike të endarteritit me insuficiencë të gradës së parë, rezulton se amplituda e marrë para mjekimit është shumë më e vogël se sa ajo që u rregjistrua mbas mjekimit. Reaksiioni ndaj provës fizike është në këta të sëmürë pothuajse gjithmonë normotonik dhe në rastë të rralla indeksi oshilator zbret më tepër se 4 mm. Këto lëkundje tregojnë se këtu nuk janë zhvilluar ende ndryshimet morfologjike.

Për të sëmürët e formës sklerotike është karakteristike edhe ulja e indeksit oshilator deri në 0 mm., nga shifra maksimale që mund të arrijetë deri në 4 mm. dhe në sekundje të tjera 2 mm. ose 1 mm. Kjo në oshilograme regjistrohet me zigzako të vogla respektivisht me shifrën dhe si një vijë e drejtë kur indeksi është 0. Mbas mjekimit të duhur konservativ apo kirurgjikal, indeksi oshilator në këta të sëmürë është ngritur. Ne nuk kemi observuar në këto forma të endarteritit asnjë rast kur indeksi të jetë zmadhuar mbas intervenimit operativ.

Ne kemi pasur 61 të sëmürë të këtij lloji që i përkisnin formës sklerotike, të cilët u ndoqën per një periudhë nga 3-7 vjet për të marrë rrezultatet e largëta, duke i ekzaminuar edhe me anën e oshilografit ku shumica e tyre u mijekuan me sukses, por pa dhënë asnjë zmadhim të indeksit oshilator. Fig. Nr. 6.

Të sëmuret e ekzaminuar me oshilograf me formë dhe grada të ndryshme:

| | Grada I ins. | Gr. II ins. | Gr.III ins. |
|---------------|--------------|-------------|-------------|
| Spastike | 69 | 39 | 29 |
| Trombangitike | 37 | 36 | 16 |
| Sklerotike | 2 | 15 | 44 |

Fig. Nr. 6 Oshilograma e të sëmuret H.M. (i formës sklerotike) bilaterale me indeks të vogël oshilator dho pa ndryshim mbas injekimit.




Fig. 6

Mungesa e ndryshimeve në madhësinë e indeksit oshilator në të sëmuret e formës sklerotike, mbas operacionit, shpjegohet edhe me transformimet e mëdha anatomike që kanë ndodhur në muret e vazave periferike nga proceset obliterative në to. Për këtë dëshmojnë edhe arteriografitë të cilat tregojnë ndërprerje të kalueshmërisë se vazave magistrale si edhe të dhënat mikroskopike që u muarën në anësit e amputuara të disa të sëmureve në fazë të avancuara të sëmundjes.

Këto që u përmendën më lart nabi rezultatet e ekzaminimit oshilografik na lejojnë që të vijmë në këto konkluzione:

1) Rezultatet e ekzaminimit oshilografik në të sëmuret me endarterit tregojnë jo vetëm një indeks oshilator të vogël dhe të ndryshem ndërmjet anësish së majtë dhe të djathtë, por mbas injekimit ai ndryshon në disa të sëmure të formës spastike dhe trombangitike të gradës së parë dhe të dytë.

2) Indeksi oshilator i të sëmureve të formës sklerotike, nuk rrjet nibras injekimit konservativ ose kirurgjikal, por mbetet në shumicën e rasteve konstant, ose bie në pakicën e rasteve në sifra të ulta deri në një vijë të drejtë.

3) Ekzaminimet periodike me oshilograf lejojnë që të gjenden ndryshimet dinamike eventuale, të cilat jo vetëm eë verifikojnë diagnozën, por ndihmojnë në përcaktimin e formës, të gradës së pajisjes me gjak për injekim. Kjo metodë lejon që të vlerësohen drejt edhe rezultatet e largëta të injekimit.

(Paraqitur në redaksi me 7/11/1964)

BIBLIOGRAFIA

1. Babigev S. — Dinamicheskoe izuchenje oscilografii u bolnyih s natrialnym stenozom — Hirurgija 1960 Nr. 9 page 81 Med-giz Moskva.
2. Fogelson M.I. — Sozraji Serde i Sosudov 1951.
3. Porjabin V. — Kompleksnoe lechenie endarterioza i aterosklerozy perifericheskikh sosudov — Hirurgija — 1960, Nr. 9, page 73 Med-giz Moskva.
4. Zaicev G.P. — Endarterioz — Hirurgia Nr. 10, 1950.

DYNAMIC OSCILLOGRAPHIC STUDY OF PATIENTS WITH OBLITERATING ENDARTERITIS.

(Summary)

In this work the author discusses the value of the method of oscillography in the diagnosis of endarteritis obliterans. In the numerous examinations he has made with and without supplementary charge the author has noticed some dynamic changes of the oscillatory index after treatment in the first and second phases of the spastic and thrombangitic forms of the disease. The results of the oscillographic examination showed that in general the oscillatory index is insignificant and ever different in the sick and healthy limbs.

In patients with sclerotic processes the index does not increase after therapeutic or surgical treatment and does not indicate the state of the collateral circulation.

A great importance is attributed to the avue of the oscillaory index, but there are many cases, when the oscillatory movements are considerable and the clinical manifestations show a grave state; these patients have mostly the thrombangitic form of the affection. On the other hand, there are cases when the oscillographic momvenets are insignificant and the clinical state of the limb is good, without any apparent clinical symptoms that could speak in favor of a profound lesion, these patients have generally the sclerotic form of endarteritis. Both the conservative and surgical methods of treatment give no dynamic change of the oscillographic data.

Excluding these cases of the thrombangitio and sclerotic forme, the patients with endarteritis could be divided according to the oscillographic examination in special forms and phases; for example, the patients of the first phase present only slight diminutions of the oscillographic amplitude those of the second phase show pronounced diminutions, while the patients of the third phase present only a straight line.

TË DHËNA MBI KURIMIN E 43 INSUFICIENCAVE KARDIAKE ME DIGITOKSINË,

THOMA MELE

(Spitali i Përgjithshëm Ushtarak, drejtor : Sinan Imam)

Vitet e fundit, në letërsinë mjekësore ndërkombe të janë shumëzuar pikpamjet e reja rreth përdorimit të digitalinës (të njojur qysh nga fundi i shekullit të XVIII-të), nga njëra anë, si mjet kurativ efikas kuadër insuficiencave kardiake — në kundërshtim me mendimin e dikur-sigurt kundër dekompensimeve eventuale të përsëritura [Levine, S.A. (1957), Lang, G.F. (1958), Rothlin, E. dhe Taeschler, M. (1959), Lenci, F. (1959) Pondl F. (1950) Félix, H. dhe Dupré, N. (1962), Chirone, E. (1962) Lerner, I.P. (1962), Slama, R. (1962), Ostapjuk, F.E. (1963) dhe të tjerë].

Sot shprehet bindja se përdorimi i digitalinës në insuficiencat kardiake shënon fillimin e një ere të re në terapinë e kardiopative, erë që mund të krahasohet me atë të insulinës në mjakimin e diabetit dhe me atë të antibiotikëve në luftën kundër sëmundjeve infektive. [Chirone E. (1962)].

Këto njojuri u përpoqmë i zbatojnë gjatë praktikës sonë terapeutike, dhe në këtë punim paraqitet analiza e 41 insuficiencave të trajtuara me digitalinë, kryesisht gjatë vitit 1963.

RASTET:

Të sëmurët karakterizohen, si vijon, nga:

— *të dhënat anamnestike*: a) dëmtimi me lëngata reumatizmale 21 veta, b) me pneumo-kardiosklerozë 14, c) me ves kongenital 2, ç) me etiologji të paqartë 4.

— *shkalla e insuficiencës kardiake*: të gradës së tretë 14 veta, të gradës së dyti 15, të gradës së parë 12; 2 pacientë me ves kongenital manifestonin insuficiencë kardiake vetëm pas lodiheje fizike.

— *mosha*: prej 16-30 vjet 13 veta, prej 30-50 vjet 17, prej 50-70 vjet 5.

— *seksi*: 36 femra dhe 7 meshkuj.

U konstatua se, në vijim të afeksioneve primare, shënjat e para të insuficiencave kardiake janë çfaqur pas një periudhe që zgjat nga 1-18 vjet.

METODA E ZBATUAR DHE REZULTATET:

Të sëmurëve u është caktuar në fillim regjim shtrati me pushim të plotë, dietë me vlerë kalorike të ulët, por që ruan sasinë normale të karbohidrateve.

Në kurimin e pacientëve kemi patur parasysh kurdoherë shkallën e dekompensimit, recidivat, gjendjen e subjektit, mjakimin e mëparshëm, funksionalitetin e organeve, sidomos të mushkërvit, të veshikave dhe të mëloqisë. Çdo të sëmuri i është aplikuar qysh në krye egzaminimi elektrokardiografik me qëllim që, së pari, të njihet situata kuadri klinik dhe, së dyti, të ndiqej zhvillimi dinamik i sëmundjes dhe kontrolli i terapisë.

Të gjithë të sëmurët janë mjakuar me (digitalinë), njërin nga glukosidet e digitalis purpurea. Pavartisht nga lashtësia e përdorimit, digitalina, edhe në ditët tona, mbetet mjeti më i fuqiger më sot në kurimin e insuficiencave kardiake.

^{*)} Digitaline Nativelle.

Kohët e fundit janë bërë hapa të mëdha në prodhimin e digitalinës së kristalizuar, kimi-kisht të pastër, nëpërmjet veçimit kromatografik të glukosideve të ndryshme. Digitalina që kemi përdorur ne është e standardizuar në mënyrë t'aille që dihet me përpikmëri përbajtja në miligramë e glukositit kardioliqik më i përshtatshëm, të përfshirë të solucionit ose të tabletat, të cilat mund të jepen per os apo në rrugë parenterale; gjatë hospitalizimit, të sëmurët janë kuruar, sipas rastit, me rrugën e parë ose të dytën, gjatë një periudhe që ka lëvizur prej 1 gjer në 2 muaj. Kështu bie fjalë tek pacientët me dekompansimë të gradës së tretë, trajtimi është pësurre me dozën 0,2 të miligramit, të shqëruar me solucion 40% glukoze 10 cc. dy herë ditë; kjo ka vazhduar prej 2 gjer më 7 ditë, pas kësaj kohë është kaluar në dhëni per os, e cila ka ndryshuar prej 5-10 pikë, që janë baras me 0,1-0,2 të miligramit. Në rastet e tjera, kur marra është porositur per os, posologjia maksimale pro die nuk e ka kapérxyer 0,5 të miligramit, dhe është pakuar gradualisht gjët në dozën kompenzonjëse — mbajtëse, e cila u është rekondruar të sëmurëve në kushtet jashtë spitalit, si mjet profiliaktik për evitim e ridekompansimeve të mundësimeve.

Dibet se, në krahasin me glukosidet e digitalis lanata, ato të digitalis purpurea kanë një rreze veprimi më të gjatë, më të vazhduarshme dhe, si të tillë, janë pra, më me efekt, veçanërisht në rastet e kurës kompenzonjëse-mbajtëse, se ato të digitalis lanata, të cilat kanë veprim tepër imediat dhe mund të këshillohen — ashtu sikurse kemi vepruar edhe ne ndonjë herë — kryesisht në raste ndihme të shpejtë [Chirone, E. (1962), Félix, H. dhe Dupré, N. (1962) e tjetër].

6 përqind e të sëmurëve kanë pësuar të vjella që mund të interpretohen si shënja intoksiacioni, por kontrolli nuk vërtetoj shënja hiperdigitalizimi në elektrokardiogram, siç janë zgjatja e sistolek elektrike, depresioni i segmentit S-T ose ulja e dhëmbit T. (Fogelson L.I. 1957, Zuckermann R. 1957). Përsa i përket kaliumit, edhe në qoftë se ay del i lartë për mbikoncentracionin normal, kjo nuk do të thotë se metabolismi i tij është regjular në miokard. Dy të sëmurë, pas prerjes së digitalinës, paraqitnë takiaritë, komplikacion fort i rëndë, që kërkon ndërhyrje urgjente. Kjo na dha të kuptojmë se vjellja pat rrjedhur kryesisht nga irritacioni i stomakut për arçesë se digitalina që marrë ne bark të zbrazët. Këtu kemi të bëjmë, pra, më shumë me një fenomen intolerance, i cili s'mund t'i atribuohet ndonjë efekt tokstik të digitalinës. Në rastin konkret duhet pohuar se tek të gjithë pacientë tanë nuk u vu re asnjëherë ndonjë fenomen tokstik i vërtetë, i mirëfilltë. Me qëllim preventimi të ndonjë çafqajeje të tillë anësore ne kemi përdorur sidogofshi solucionin 5% kalium chloratum, 5 herë në ditë nga një lugë gjelle, i cili shërben si antidot kundër hiperdigitalizimit: sipas njofitmeve të letërsisë mjekësore, përfshirë edhe solucionin këshilllohet qyshtë ne krye të mjekimit dhe thuhet se sa më e rëndë të jetë shkalla e dekompansimit aq më i nevojshëm është përdorimi i tij i menjëherëshëm. Të sëmurëve tanë u është dhënë kalium chloratum, me ndërprerje, dhe duke u patur parasysh kurdoherë diureze cu 24 orëve. (Selye, H. (1961), Ostapjuk, F.E. (1963)) Këshilllohet gjithashtu, në ndonjë rast me efekt më të mirë, edhe kaliumi glutaminatum Sikorov H. dhe Cowerilles -I- Në literaturën përkatëse zihen në gojë efekte tokstike, që varen nga illoji i preparatit, nga sensibiliteti individual, nga mbisundimi i ndryshimeve irreversible organike në miokard, nga prishja e balancit të elektroliteve të plazmës së gjakut dhe veçanërisht të ioneve të kaliumit intracelular dhe ekstracelular, por kryesisht, në raste thithjeje dozash të larta glukosidësh digitalike, qoftë edhe për një kohë jo të gjatë.

Për të luftuar edemat janë përdorur preparate diuretike merkuriale ose sulfamidike, sipas indikacionit: chlorthiasidi tri herë në ditë nga 0,5 gr. gjatë 3-4 ditësh osc hydrochlorthiasidi 3 herë në ditë nga 50 miligram, me ndërprerje po aq të gjata, apo metopironi 3 herë në ditë nga 0,5 gr., i përcjellë me 50 miligram chlorthiasidi. Pavarësisht nga përdorimi i tyre, në të gjitha rastet është vënë re fazë refraktare, pas një farë kohe.

Si analiza më orientonjëse kemi zbatuar ato proteinoprecipitonjëset dhe elektrosorezën në letër, të cilat nuk janë specifike, por, të marra në lidhje me dekursin klinik, ndihmojnë më vlerësimin e gjendjes së të sëmurëve dhe në kurimin e tyre të mëtejshëm.

Duke u bazuar në sa u pohua më lart, jemi pësurre me gjendje aktive të infekcionit reumatizmal, që e bën dhe më të veshtrirë mjekimin e kësaj kategorie të sëmurësh. Është konstatuar se ndryshimet e gjakut, të rrjedhura nga infekzioni, normalizohen relativisht brenda një kohe të shkurtër, ndërsa gjenda aktive e infekcionit reumatizmal mund të vazhdojë më muaj. Ky kuadër klinik e ve shpesh mjekun kuronjës në gjumë.

Një pjesën më të madhe, dekompansimet tek subjektit e moshës së re (të cilët në rastin tonë janë 10 veta) shqërohen me gjendje aktive të infekcionit reumatizmal, që e bën dhe më të veshtrirë mjekimin e kësaj kategorie të sëmurësh. Është konstatuar se ndryshimet e gjakut, të rrjedhura nga infekzioni, normalizohen relativisht brenda një kohe të shkurtër, ndërsa gjenda aktive e infekcionit reumatizmal mund të vazhdojë më muaj. Ky kuadër klinik e ve shpesh mjekun kuronjës në gjumë.

Një kujdes i veçantë i duhet kushtuar periudhës kur i sëmuri zë të kalojë nga regjimi i shtratit në regjimin e lirë. Ky interval kohë tek të sëmurët tanë ka zgjatur 20-30 ditë, me përashtim të ndonjë rasti të rrallë, që ka vonuar edhe më shumë. Periudha e regjimit të lirë për pacientin ka një rënësi shumë të madhe, sepse lichtet me stërvitjen graduale të zemrës së cënuar.

Ata tē sémurē që kanë palpitacione dhe marrje tē frymës nē ecje janë akoma tē pakompensuar dhe shpej mund tē dekompensohen pavarësisht nga mjekimi, prandaj pér vlerësimin e kësaj periudhë duhet tē kihet parasysh gjëndja funksionale e organeve dhe, nē radhë tē parë, e veshkave dhe e mëlcisë.

Në një të tretën e numurit të të sëmurrëve është vërejimi diurezë e reduktuar në fillim, dhe, pas 3-4 ditëve të kurës, diureza është rritur, por pesha specifike e urinës ka mbetur gjithmonë e ulët në shifrat 1012-1015. Në qoftë se pesha specifike e urinës nuk arrin masat normale për një kohë të gjatë, progozoa e kompensimit mbetet e dyshimtë: kjo mund të spjegohet jo vetëm nga ndryshimi që kanë pësuar veshkat gjatë dekompensimit, por edhe nga ndonjë faktor tjetër, siç mund të jetë një nefropati e mëparshme (Tarejev E.M., 1958). Në analizat e urinës sasias e albuminës ka lëvizur nga gjurmja gjer në 0,50/00. Sipas autorës të ndryshëm persistencë e proteinurisë, qoftë dhe me doza të vogla, është një shenjë negative për kardiakët. [Majer (1931), cituar nga Çerviakovskij, N.A. (1964)]. Dy të sëmura të kësaj natyre, pasi kanë dalë prej spitalit janë dekompensuar përsëri, pas disa javësh. Ky dekompensim, nga njera anë, mund të shpjegohet prej ndërprerjes së mjekimit profilaktik me digitalinë ose, gjithashtu, nga ndonjë mësimgarkesë tjetër, që mund të ketë rrjedhur nga lodhja fizike, shqetësimi shpirtëror, vajiu-mësimia ose prishja e dictës.

30% e numurit të të sëmurrëve të mjekuar, sidomos ata me stenozë mitrale, kanë paragjitur aritmë, si ekstrasistole, fibrilacion, flutter në formë permanente dhe paroksimale. Gjatë fazës filiestare të kurës me digitalinë, si pasojë e efektit dromotrop negativ të saj, format takistolikë u transformuan në formë bradisistolike. Tek 2 të sëmura efekti bradicardik u çfaq disë ditë pas dhënies së digitalinës, dhe të rrashurat e pulsit zbritnë nën 60 pa deficit periferik, fenomen që na detyroi ta ndërprisim përdorimin e digitalinës. Këto të sëmura, 24 orë pas ndërprerjes së digitalinës, manifestuan takiaritmë në formë paroksimale. Në të dyja rastet u intervenua me lanadzozit c — glukosid të digitalis lacata — (2 cc në 20 cc solucion glukoze 40% endovenoz) duke u përsëritur ndërhyrja në krye të çdo 6 orëve gjersa të sëmurrët e kaluan krisjen. Mjekimi i aritmive në rastet e zakonshme është kryer i kombinuar me digitalinë dhe kinidinë. Skema e terapisë me digitalinë është bërë ashtu si u tha më lart. Kinidina është filluar me posologji të vogla 0,15 pro dosis duke e ritur këtë në ditën e tretë dhe të katërtë gjëri në 10 pluhura të tillë pro die. Më pas, doza pakësohej gradualisht. Është e ditur se sikurse digitalinakacioni na ka detyruar të kufizohemi në dhëniën e kinidinës atyre të sëmurrëve që çfaqinë më të përzitë rrezik për tromboemboli.

E cila qe shtruar me diagnozë kolikë renale më 26/II/1962.

E semura në hyrje ankonte dhëmbje në hipokondriq i dhjeti që dhe në lozhën renale të asaj-ane, kishte të vjella me gjak, temperaturë dhe dhëmbje koke. Nga një egzaminim klinik më i imtë rezultoi se pacientja paraqiste zbehje të fytyrës, lodhje të përgjithshme dhe mbaitje të frysme.

Në perkusion: kufiri i majtë i zemrës paralel me linjën aksilaris anteriore, në auskultacion: zhurmë presistolike në vatrën mitrale, galop protodiastolik dhe takaritmi 140 në minutë me deficit periferik të pulsit gjër më 80 në minutë. Në të dy bazat e mushkërive dégjohët ndonjë ral staze. Hepari dhe leni brënda caqeve të normës; e sëmura nuk kishte edema, kishte një akrocianozë të lehtë. Gjëndra tiroide jo e zmadhuar. Nga anamneza dilitë se pacientja kishte vuajtur prej vijë poliartriti reumatizmal në vitin 1945; 6-7 vjetet e fundit ndjente shqetësimë, si marrje të frysës, sidomos pas sforçosh fizike, gjatë të cilave të sëmurën e mbyste nje kolaj, me gjak.

Përveç kësaj, dhembjet lumbale i kishte prej 7 ditësh. U konkludua se gjendeshin përparrë një vesi mitral të kombinuar, me origjinë reumatizuale, të shoqëruar me taksimitë perpetua.

Të sëmurej i nismë terapinë me digitalinë tri herë nga 5 pika në ditë, papaverinë $0,03 \times 3$; eufilinë $0,2 \times 3$. Pas tri ditësh pacientja zuri të ndjente përmirësim, frekuencë e të rrashurave të zemrës arriti gjë më $95-100$ në minutë me deficit të vogël të pulsit periferik. Më 5/III/1963 d.m.th. pas fillimit të kurës me preparate kardiake, e sémura u ngrit nga shtrati dhe dolli në koridor; në të ecur, ndjeu një dhimbje të theksuar në kofshën e djathë dhe pësoi një impirje të këmbës. Mjeku i rojës, i thirrur urgjentishë, e vizitoi pacienten dhe konstatoi se ajo vuante nga dhembje të artit të djathës inferior dhe se nuk mundte ta lëvizte këmbët. Egyzamin i vërtetoi se këmbë e djathë ishte më e ftohtë nga këmbë e majtë, se ajo kishte ngjyrë cianotike; arteria femoralis poplitea dhe dorsalis pedis nuk prekeshin.

U mendue se kishte ndodhur një tromboemboli e arteries femorale të djashthë. Kjo u konfirmua dhe nga të dhënat e oscilografisë, lu zbatua kura me heparinë 4 hirë 10,000 unite intravenoze, me solucion novokaine $0.5\% \times 2 \times 10$ cc, me eufilinë 3×0.2 , me antibiotike dhe borsa të ngrohta. Gjendja e të sëmûres u përmirësua gradualisht dhe më 7/III/1963, 20 orë pas fillimit të mjezikimt, arterja prekej mirë.

Te n'jë numur të sëmurësh ritmi është irregulluar dhe po përdorim

Tek disa pacientë efekti bradikardik shkaktohet shumë shpejt, tashmë që përdorimin e kinidinës.

në 60 në minutë dhe dhënia e mëtejshme e digitalinës vështitësohej. Në këto raste të sëmurëve ua kemi pakësuar shumë dozën, por asnjëherë nuk ua kemi ndërprerë.

Hepari, sic dibet, luaj një rol shumë të madh veçanërisht në qarkullimin e gjakut të vete zemrës, prandaj gjëndja e këtij organi gjatë dekompenstimit është një tregonjës që përcaktion të një farë shkalle perspektivën e përruirësimit.

Të mbështetur në faktin që tek të sëmuret, të cilët praraqitën edema me etiologji të ndryshme, për një kohë të gjatë edhe pas përmirësimit klinik, vihen re ndryshime të metabolizmit, dës posaçërisht të atij të proteinave, kemi përdorur të dhënët e elektroforezës në letër kryesisht tek pacientë me dekompensim të gradës së tretë. Në të gjitha rastet koeficienti albumino-globulinë nuk ka kaluar më shumë se 0,5, që shprehet me uljen e frakcionit të albuminave dës morriten e frakcionit të globulinave, sidomos të gama-globulinave (35,6%) dhe, në mënyrë të moderuar, të alfa-globulinave (8,8%) dhe beta-globulinave (16,8%).

Elektroforeza në letër shërben dhe si njët diagnostikimi diferençial për të caktuar etiologjinë e edemës në ato raste kur dyshohet se etiologjia e saj mund të ketë rrjedhur nga ndonjë organ tjeter përvç zemrës d.m.th. për të ditur kush ka mbisunduar në shkaktimin e edemës. Kemi injekuar vetëm një pacient, që u shtrua me dekompensim të zemrës, por gjatë hospitalizimit, dekursi klinik ndryshoi dhe lindi idcja se edema tek ay mund të kishë etiologji hepatike, sepse në të vërtetë i sëmuri vuante prej një ciroze të vjetër të hoparit të formës atrofike, e cila edhe vdiq. Elektroforeza në rastin konkret fliste më shumë për një hypo dhe disproteinemi prej origjine kardiake.

Hypo dhe disproteinemia janë pasqyra që reflektojnë ndryshimet në inđet, prandaj egzaminimi i proteinave të plazmës lejon të vlerësohet biotonusi i inđeve dhe organeve, reaktivi i përgjithshëm i organizmit të të sëmurtit dhe, rrjedhimi i ky është një tregonjës me shumë rëndësi prognostike.

Tek të sëmuret tanë më e vështirë është paraqitur terapia e atyre që kanë pasur dekompensimë me etiologji kor pulmonare, sepse infekzioni në mushkëri është rijaft rezistent për shkak të lezonave në rrjetin e vazave, gjë që vështirëson depërtimin e nevojshëm të antibiotikëve, sado që të rititet doza e tyre në rruje parenterale. Sipas autorëve të huaj, injekimi me antibiotikë në formë aerosoli është më i përshtatshëm dhe më efikas, (Lerner I.P. 1963), por ne, nuk e kemi përdorur.

KONKLUZIONE:

- 1) Nga 41 të sëmuret me insuficiencë kardiakë me natyrë të ndryshme, nën veprimin e digitoksinës 30 ose 75% janë kompuesuar plotësisht, kurse 11 të sëmuret ose 27% janë përmirësuar.
- 2) Më rezistente kundrejt terapisë janë paraqitur të sëmuret me cor pulmonale.
- 3) 12 të sëmuret osc 30% e rastëve paraqitën turbullimë të ritmit prej këtyre në 10 veta arritma është zhdukur pa patur nevojë që digitoksinë të kombinohet me kinidinë ose prokainamid.

(Paraqitur në redaksi me 10/I/65)

BIBLIOGRAFIJA

- Chirone, E.: La digitale, në Il Policlinico, 1962, 69, 45, 1957.*
Cerviakovskij, N.A.: Problema otjoka v klinike vnutrenjih boleznej, Moskë 1964.
Félix, N. dhe Dupré, N.: Glucosides totaux de la digitale pourprée, në La semaine des hôpitaux, 1962, 38, 3287.
Lang, G.F.: Boleznji sistemi krovobrashçenja, Moskë 1958.
Lenci, F.: Balans elektrolitov i sohrashçenije miokarda, në Dostizhenija kardiologii, Moskë 1959, 153.
Lerner, I.P.: Lečenije kroničeskovo legočnovo serca, në Voprosi legočnoj patologii i legočnovo serca, Kiev 1962, 308.
Levine, S.A.: Cardiologia clinica, Torino 1957.
Ostapiuk, F.E.: Efektivnost primenjenja serdečnih gliukosidov v sočetaniji s hloristim kalijem, në Voprosi serdečnih gliukosidov na obmenveshchestv miokarda, nē Dostizhenija kardiologii, Moskë 1959, 185.
Rothlin, E. dhe Taeschler, M.: O dejstviju serdečnih gliukosidov na obmenveshchestv miokarda, nē Dostizhenija kardiologii, Moskë 1963, 47.
Selye, H.: The chemical prevention of cardiac necroses. New York, s.d.
Slama, R.: Digitalisation et troubles du rythme, në La semaine des hôpitaux, 1962, 38, 1785.

TREATMENT OF 43 HEART CASES WITH DIGITOXIN, A GLUCOSID OF DIGITALIS PURPUREA

(Summary)

This work analyses the treatment of 43 heart cases with digitoxin «Digitaline Nativelli».

The cases : different degrees of cardiovascular insufficiency.

The method: the treatment was applied almost exclusively with digitoxin for 15 to 60 days, with different doses that ranged from 0.5 mg to 0.2mg daily, per os or by injection.

In some cases the treatment was accompanied with calcium chloratum 5g daily in solution, with the purpose of preventing some toxic side effects, observed in some cases of prolonged administration of digitoxin.

The purpose of the treatment was, firstly, to achieve full compensation, secondly, to determine the doses needed for compensation and maintenance.

Conclusions: 1. Digitoxin in its compensating-maintenance doses does not cause toxic side effects, as believed previously, but it should be taken under periodical control.

2. The observation of the patient during the treatment should be constant.

3. The treatment is safer if applied under the control of electrocardiography,

**DISA TË DHËNA MBI FREKUENCËN E SIMPTOMEVE RADILOGJIKE TË ULÇERËS
PILORIKË DHE DUODENALE**

LAVDIM H. GIONCA

(Spitali Përgjithshëm Ushtarak. Kabineti Rëntgendiagnostikës
Shtëpi Kabinetit Major Mick Ilo Kole)

Sēmundja ulčerozē ze nji vēnd me rēndēsi nē sēmundjet e traktit tretēs. Diagnoza e pēr-
vāsai ja rēndēsi praktike. Nē kētē drejum rol me rēndēsi luan egzaminīti radiologi.

Francesi Cruvél, në tridhjet vjetët e parë të shkullit të kaluar, që i pari që e përshtroi si sëmundje, dha për shumë kohë u quajti me emrin e tij. Deri në zbulimin dhe futjen në praktikën mjeksore të rrezeve Rëntgen, konsiderohet shumë e rrallë, por më vonë u morrën të dhëna e plate mbi përhapjen dhe u studiuat më intensisht.

Sëmundja ulqroze takohet në çdo moshë, por më shpesh prek moshën e rritur. Simbas P.K. Meshnikov-1953, V.N. Grinjevski-1960, 80-86% të rasteve takohet në moshën 20-40 vjeç. Prek njerëz të profesioneve të ndryshme, më shumë meshkujt se femrat duke ruajtur afersisht raportin 9:1.

Një mbështetje e fortë për diagnozen e uçlertës është radiologjia, e cila bazohet në simptomat direkte dhe indirekte. Nisha është simptom i më tipik dhe më i sigurt radiologjik i përshtuar parë herë të parë nga H. Haudecke në 1910. Simbas V.A. Fanardxhan - 1951, V.A. Diaçenko - 1956, në kondita spitalore, nisha është gjetur në 70-95% ; në konditat e poliklinikës 45-60%. Nisha zë vënd në pjesë të ndryshme të stomakut dhe të duodenit. Për sa i përket lokalizimit të saj në duoden takohen në 74.4% të rrasteve simbas G.T. Grigorjan dhe A.M. Dëxhamollaqi ngërë këto në murin e përparshëm të tija 32.1% ; në murin e pasëm 51.6% dhe nisha që ju takojnë të dy mureve 16.3%.

Për diagnozën, topikën, evolucionin si dhe për të orientuar radiologët në gjetjen e nisjes, kanë rëndësi të madhe deformimet e bulbit si rezultat i retraktimit të tij nga ulcera. Simbasimtë dhëname të P. Selenicës -1961 simptomi Colé takohet në 27.7%, ai i Hart-it në 30% dhe simptomë Akerund në 20%.

Ndryshimet e reliefit të mukozës se stomakut në ulcerat e pilorit dhe të duodenit, me gjithë se janë morfologjike, simbas mendimit të L.G.Shlifer -1935, I. M. Llazofski- 1945, V.A.Fanarashian, -1951-64, V.A. Djaçenko- 1956, I.A. Shepter - 1959, kanë karakter të thellë funksional, që nuk shumë faktore rreth kësaj patologji.

Të dhënat e literaturës për sa i përket ndryshimeve funksionale janë shumë kontradiktore. I.T. Kurcin - 1953 ka konstatuar 80-85% të rrasteve me shhtim të tonusit dhe të peristaltikës, evakuacioni normal; Ndërsa S.N. Popova - 1954 të kundërën, dobsim të tonusit e të peristaltikës në 64% të rrasteve me ngadalsim të zbrajës të stomakut. S. A. Badilkes dhe I.F. Loric - 1955, kanë konstatuar shhtim të sekrecionit. Funksioni motor-evakuatori simbas J.N. Sosina - 1955, O.S. Parhmenko - 1957, V. M. Kogan - 1956, I.M. Gagan - 1959, varet nga tonusi, peristaltika, sekrecioni, por rolin kryesor e luani pilori; ngacmimi i tij me rruge mekanike, kimike dhe reflektore shpejton ose ngadalson atë.

Ndër simptomet indirekt bëjnë pjesë dhe pilorospazmat dhe lokalizimi i qumës gjatë palpjacionit mbi duoden; V.A. Fanardxhan dhe G.A. Zedgenidze ju jepin një rëndësi të veçantë këtë re simptomeve.

Për një studim të gjithanshëm të kësaj sëmundje nga ana radiologjike, bëmë studimin e historive të sëmundjeve të ulçerave pilorike dhe duodenale në ushtri të mbështetur në matematikat.

Materjal i marrë në studim përbën 507 trastë shtruar me *ulcus pilori* dhe *duodenit*, prej të cilave 50-ja nuk operuar tek ne dhe diagnoza radiologjike është konfirmuar plotësisht bëtë e vlefshme.

七

Për një studim të gjithanshëm të kësaj sëmundje nga ana radiologjike, bëmë studimin e historive të sëmundjeve të ulçerave pilorike dhe duodenale në ushtri të mbështetur në matematikat.

Materjal i marrë në studim përbën 507 trastë shtruar me *ulcus pilori* dhe *duodenit*, prej të cilave 50-ja nuk operuar tek ne dhe diagnoza radiologjike është konfirmuar plotësisht bëtë e vlefshme.

shumë raste dhe topika e nishës. Materiali i takon viteve 1958-1963 (përsfbi) dhe është heterogen mbasi 112 raste që i takojnë viteve 1958-1960, janë egzaminuar nga mjek radiolog të ndryshëm, ndërsa 325 raste i takojnë viteve 1960-1963 të egzaminuar nga L. Gjonça dhe I. Kole. Në materiali nuk përfshihen ulcerat e stomakut.


Në materiali nuk përshtohen vlerat e stonimave:
 Në repartin e terapisë, të spitalit tonë, sëmundja ulceroze përbën 4.4% të numurit të përgjithshëm të sëmurrëve dhe 6.9% në repartin e kirurgjisë. Në kabinetin e radiologjisë sëmundja ulceroze përbën 34.2% të personave që e zgjamojnë traktin e tretjes. (të dhënat tonë-1963)

Shpërndarja e rasteve simbas moshës është si më poshtë: Rastet më të shumta i takojnë moshës 21-25 vjeç d.m.th. 27%. Mbës saj vjen moshë 31-35 vjeç me 99 raste ose 19,5% dhe moshë tjetër ka shpërndarjen dhe përqindjen si në pasqyrën dhe grafikun Nr. I. Ashtu si dhe në literaturën e konsultuar, edhe në rastet më të shumta i takojnë moshës deri në 40 vjeç. (82,3%). Duke i mbështetur në të dhënat e anamnezës dhe pjesërisht në përrshkrimin radiologjik, 22,2% të rasteve janë akute dhe i takojnë moshës së re.

SHËRNDARJA E RASTEVE SIMBAS MOSHËS

Pasvra Nr. 1

Grafiku Nr. 1



| mosha | rrastet | % |
|-------|---------|------|
| 16-20 | 31 | 6.1 |
| 21-25 | 137 | 27.0 |
| 26-30 | 83 | 16.5 |
| 31-35 | 99 | 19.5 |
| 36-40 | 67 | 13.2 |
| 41-45 | 50 | 9.8 |
| +46 | 40 | 7.9 |

Nisha, (fig. 1) është gjetur dhe përkruar në 352 raste; 69.65% të rasteve terapeutik dhe 74.28% të atyre kirurgjikalë, nga këto nisha duodenale 308 ose 87.1%; nisha pilorike 26 ose 7.3% dhe nisha postbulbare 18 ose 5.6% (fig. 2).

Për sa i përkët lokalizimit bulbular vëndin e parë e zënë nishat e murit të pasëm me 116 ose 37,6% të rasteve, në murin e përparrshëm 78 ose 25,5% dhe nisha që jen takojnë të dy mureve 16 ose 5,2%. Në material 98 ose 31,7% e nishave nuk është përcaktuar se ku janë vendosur. 12 ose 3,9% e nishave 8 ose 2,3% të rasteve me nisha në stormak dhe duoden.

Në material janë përgjithshme 8 ose 2.3% të rasteve me nisha ne stomak dhe duoden. 12 ose 3.4% të rasteve me nisha duplike (Kissing-ulcus) nji rast ose 0.28% me *ulcus* dhe prolaps të mukozës së stomakut në duoden. Ndërsa nisha me gardh inflamator 13 ose 3.6% të rasteve (fig. 1) dhe nisha radiare 6 ose 1.2% të rasteve.

Symptomi tjetri direkt i sëmundjes ulceroze, deformimi i bulbit, është takuar në 480 ose 94,6% të rasteve nga këto vetëm 26,4% e tyre nuk është përektuar. Si symptom Cole (fig. 5) është përskruar në 25,8% të deformimeve, me defekt në kurvaturën laterale në 65,5% dhe në atë mediale në 34,5%. Si symptom Hart në aspektin e xhepit ose të pseudodivertikulit është takuar në 24,4% të deformimeve duke pasut 54% në *recessus lateralis* dhe 46% në atë medialis. Symptomi Holtznecht është përskruar në 10,9% të deformimeve. Symptomi Akerlund është takuar në 9,5% të deformimeve. *Microbulbus* ose *cryptostomia* është përskruar në 3% të deformimeve.

Esstë vrejtur se ndryshimet e karakterit hipertrofik të reljeftit të mukozës së bulbit nga një herë simulojnë simptomin Colé, prandaj duhet përmendur se në vlerësimin real të këtij simptomi duhet të kihet parasysh dhe kjo.

Për ma i përk ndryshimeve të relicvit të mukozës stomakut në ulcerat e pilorit dhe të duodenit me plika hipertrofike disa herë rigide, serpingiforme të lokalizuara më shumë në regjionin antral janë përshtkuar në materjal në 58.8% të rasteve. Raste me hipotrofi nuk janë përshtkuar. Nuk janë marrë në konsideratë rastet kur aspekti i reliefit është ndryshuar gjat egzaminimit ose në ekzaminimet e përcirritura. Është vrejtur në disa raste tek të sëmurët ulcerik se megjithëqë radiologjikisht nuk është konkluduar për ulçer dhëmbjet dhe ankesat e tjera të sëmurit vazhdojnë përfundimisht.

Ndër ndryshimet funksionale të stomakut në sëmundjen e ulqinës rënës së vëçantë ka funksioni motor evakuator i cili varet për veç të tjerave dhe nga ngacmimi i pilorit me rrugë kimike mekaniko dhe reflektore. Fenomeni i pilorospazmës që ngadalson këtë funksion në materjal është përshkruar në 37.7% të rasteve, ndërsa mbushje shumë e shpejtë e bulbit, që në porcjonin e parë, në 25.8% të rasteve.


Për sa i përket ndryshimit të tonusit të stomakut janë përshkruar me hipotonji 31.5% të rasteve, hipertonia është vrejtur në 16.5% më karakteristike për moshat e reja. 0.4% e rasteve kanë pasur heterotoni, ndryshim të tonusit gjatë egzaminimit dhe rë egzaminimet e përskritura. Normotonia është vrejtur në 51.6% të rasteve.

Me gjith se të dhënat mbi peristaltikën janë simbas përshkrimit aproksimativ të radiologëve dhe jo të kronometruar mund të themi se peristaltik e tipit të ngacmuar është vrejtur në 5.7% të rasteve; e tipit të ngadalsuar (dembel) 15.2%; e tipit të frenuar (superficiale) 15.3% dhe peristaltik të tipit stenozi 4.5%. Peristaltika me valë dhe thellsi normale është vrejtur në 59.3% të rasteve.

Me hipersekrecion janë përshkruar 57% të rasteve.

Për sa i përket evakuacionit të stomakut, në materjal me evakuacion normal 70.4%, me evakuacion të shpejtuar 19% dhe me evakuacion të ngadalsuar 10.6% të rasteve. Nga këta të fundit me insuficencë evakuatore të gradës parë 4.8% të rasteve, të gradës dytë 1.9% dhe me insuficencë evakuatore të gradës tretë 3.3% të rasteve. Me të dhënat e autorëve të tjerë ka diskordancë të madhe për rastet me insuficencë evakuatore, kjo mësoj se vjen përfaktin që në rastet e avancuara të sëmundjes ulcerose me insuficencë evakuatore nuk mbahen në spitalin tonë.

Ndryshimet funksionale të stomakut në materjalin tonë së shifën dhe në grafikun Nr. 2, nuk vënë në dukje vagotoninë, por kanë një tendencë të lehtë hipovagotonike me dobësim të ehtë të tonusit dhe të peristaltikës.



Grafiku Nr. 2. Ndryshimet funksionale të stomakut në ulcerat e pilorit dhe duodenit në ushtri.

Ndër ndryshimet funksionale të bulbit duodenit janë përshkruar spazmat ose «injizura bulbare» (fig. 9) në 3.7% të rasteve Zbrasjet e shpejta të bulbit në 25.8% të rasteve. Gjithashtu janë përshkruar raste të retropropulsione (mbushje retrograde) të bulbit dhe bulbostazë. Raste të motilititetit tipit duodenal Kretzux janë përshkruar, në 0.8% të rasteve.

Komplikacionet: Peridudenit janë takuar në 7.7% të rasteve Stenoza e pilori të gradës parë 4.8% të gradës dytë 3.3% dhe të gradës tretë 1.9% të rasteve. Raste të malinjizimit, të penetrimit në organet fqinje nuk janë përshkruar në materjal. Rastet me perforacion nuk u morën në studim mbasi në kartellat e tyre nuk ishte bërë egzaminimi radiologjik. Nuk i vura vete detyrë të studjoj në këtë materjal hemorragjite nga ulcera.

KONKLUSION.

1. - Në spitalin tonë rastet më të shumta të ulcerave të pilorit dhe të duodenit takohen në moshën 21-25 vjeç dhe mbas saj në moshën 31-35 vjeç. Më shumë në ushtarët e vitit të dytë dhe në ushtarakët e karjerës. 22.2% të rasteve janë akute dhe i takojnë kryesishë moshës së re.
2. - Simptomi i nishës është konstatuar në 69.65% të rasteve terapeutikë dhe në 74.28% të rasteve në kirurgji.
3. - Ndryshimet cikatricjale të ulcerës së pilorit dhe të duodenit janë takuar në 94.6% të rasteve dhe janë shumë të rëndësishme për vënien e diagnozës.
4. - Ndryshimet e reliefit të mukozës së stomakut janë të karakterit hipertrofik dhe takohen si të tillë në 58.8% të rasteve.



Fig. 1. Afér bazës se buori, një depo bariumi (nissen e Hancke), me një zonë të lërë për rrath (garth inflamator), en face.



Fig. 2. Në një të tretën e mesme të bulbit, në të dy kurvaturat duken dy depo bariumi. Ulcus duplex (Kissing —ulcus)

5. - Frekuenca e roedhe dhe rjedhimisht, rëndësi të magje për diagnozën kaqë dhe simptomat e lokalizimit të dhimbjes gjatë palpacionit; pilorospazmat dhe zbrazjet e shpejtë të bëubit.
6. - Ndryshimet funksionale të stomakut karakterizohen nga peristaltika e tipit të ngadaluar, hipertonji në 31,5% të rasteve dhe hipersekrecion në 57% të rasteve.

(Paraqitur në redaksi më 20/Ill/1965)

—oo—

LITERATURA

1. - *Badiķes S.O.* Jazyjenaja balezi zhelludka i 12-pjerstnij kishki Medgiz. 1956.
2. - *Bikov K.*, *Kurcik I.I.* Vzaimnootnoshenia kortiko-visceralno v normi i patologii. Klin. Med. 1961.9
3. - *Djačenko V.A.* Rentgenodiagnostika zabolovanii vnutrennih organov. Medgiz 1956.192-310.
4. - *Grigorjan G.T.* Oxfampollag A. M. cituar nga Fanardxhian Rentgenodiagnostika zabolovanii pishevariteini trakta. ARMGOSISDAT (Erevan) 1964 fage 77.
5. - *Fanardxhian V.A.* Rukovotsvo po rentgenodiagnostike Medgiz 1951 T. II 182-307.
6. - *Fanardxhian V.A.* Rentgenodiagnostika zabolovanii pishevaritejno trakta ARMGOSISDAT. (Erevan) 1964.
7. - *Grinovski V.N.* Bogatirjev M.F. O jazvenij baljezni mnozhestvijenoj lokalizaciji u mushchin malladovo vozrosta. SOV. MED. 1960, 10, 49, 55.
8. - *Kagan I.M.* Seleskaja I.S. Rentgenollogjikeskoj djestva izuchenija morfina ne motorno evakuatorno funksiju zhelludka. Vopr. Rent. Rad. Medgiz 1958 14-18 X
9. - *Kagan V.N.* K voprosu ob evakuatornuju funksi zhelludka. Klin. Med. 1956.
10. - *Kurtckin I.T.* cituar nga Parhamenko O.S. ob izmenenija dvigatelnoj funksi zhelludka u balnih jazvenoj bolezni vlijanje bromiste natri KLIN. MED. 1957.5.
11. - *Parhamenko O.S.* e njejtë veprer si më lart.
12. - *Llazovski I.M.* Funkcionalnaja morfologi zhelludka v norme i patologii IZD. A. M.N. 1947.
13. - *Llorie P.F.* Jazvenij bolezni Medgiz 1958.
14. - *Mesnikov F.K.* Jazvenaja balezn po materjaljam klinik za pjatnacat let. Klin. Med. 1953 II.
15. - *Popov. S.N.* Kliniko-rentgenollogjiceskoj nabludenija nad morfologi i funksi zhelludka i 12-pjerstnoj kishki pri jazvenoj bolezni. Vjes. Rentg. Rad. 1954 I.
16. - *Sosina V.M.* Centralno nervnaja regulacija motorno evakuatorno funksi zhelludka celloveka. Vap. Rentg. Rad. 1955
17. - *Shechter I.A.* Značenja rentgenollogjiceskoj isledovanije diagnostike gastrita Vep-Rontge. Rad. 1959 T. 10.
18. - *Shlifer I.C.* Reliev slizistoje zhelludka i 12-Pjerstoj kishki Gos. Med. Izd. 1935.
19. - *Selenica P.* Vepriimtarija motorre e traktit tretes dhe e kolecistit në ulcerën e pilorit dhe të deudenit 1961 (Dizertacion për gradën e kandidatit të shkencave mjeksore.)

THE OCCURENCE OF X-ray SYMPTOMS OF PILORIC AND DUODENAL ULCER

(Summary)

From the examination of 507 case histories of piloric and duodenal ulcer in the military hospital archive, the author reviewes the frequency of roentgenological symptoms of these diseases.

The "antrum" was observed in 69,65% therapeutic cases and 74,28% of surgical cases. After that the author discusses the other symptoms. The bulbus deformations have been met in 94,6% cases, and the changes in the mucos relief of a hypertrophic character have been met in 58,8% of the cases. Among others a case is described of duodenal ulcer, in which there was a prolapsus of the gastric mucosa in the duodenum.

The author points out that the localisation of the pain by the patient in the duodenal region is of a particular diagnostic importance. An equal great importance have the piloric contractions and the rapid evacuation of the bulbus. The functional changes of these cases, according to the case histories, are characterised by a weakening of the peristaltic, hypotonia, hypersecretion and normal evacuation.

MJEKIMET E DERMATOMYKOZAVE ME MJETE POPULLORE NË SHQIPNI

K.S. KERÇIKU

(Katedra e Dermato - Venerologjisë — Shef. Prof. K. S. Kërçiku)

Mjekimet popullore në vendin tonë janë mjaft të vjetra. Disa nga këto përmendën edhe në kohën antike prej Plinit (C.P. Plinius secundus 32 deri 79 të erës tonë). (15). Albaniologu Dr. Nopca i cili asht orvat me i klasifikue mjekimet popullore shqiptare, shprehet se këto janë me prejardhje të ndryshme, ilirjane, romake, bizantine etj. (14). Edhe ne jemi të mendimit se nji pjesë e tynë ka ardhë nga Jashtë, por ka edhe nji pjesë që asht e trashiguar nga kohët e vjetra prej të parve tonë dhe asht zhvillue në kushte e kohë ma të reja. Mjekimet tona popullore janë të shumta dhe interesojnë sëmundjet ma të zakonshme të popullit tonë. Edhe për nji sëmuodje të vetme ka mjekime të ndryshme, dhe kjo, pas mendimit tonë, deshmon për nji zhvillim të pandëpremë të mjeksisë empirike. Por cila ka qenë piknisa e këtij ose e atij mjekimi, cila ka qenë rruga e zhvillimit të tij, nuk ka mundësi të thuhet. Mund të themi se origjina dha zhvillimi i këtyre mjekimeve asht ba në kushte konkrete dhe në raste reale, në bazë të shumë provave dhe vrojtimeve gjatë sheku jsh. Kështuqë mund të përfundojmë se ata ashtu si kanë mbërritë deri tek nç, janë fryt i shumë gjeneratave.

Detyra e jonë soi konsiston, në grumbullimin shkencor të tynë, ashtu si kanë veprue edhe popujt e tjerë; me i pastrue ato nga disa mjote të njohuna të damshme, nga bestytiu e mystikat religioze dhe thelbën e pastërt që mabet, me e studjuar në mënyrë të hollësisht. Në readin tonë shoqnot, mjekisia popullore babet objekt studimi i mjeksisë shkencore. Me këtë studim, mjekisia popullore i jep shkencës fitoret e veta, të cilat vihen vazhdimish në shërbimin e popullit. Shumë mjek të huej kanë mujt me përfitue nga mjekisia popullore dhe kanë nxjerrë medikamenta me vlerë për terapiën moderne (16).

Mendojmë se, me pasuninë e padiskutueshme të mjeksisë sonë popullore, me fitoret e saj që janë në themel të eksperiencës shumë shekullore, me veçanit të ambjentit tonë dhe të popullit tonë, edhe mjekisia jonë shkencore, do të ketë mundësi me veprue e me nxjerrë rezultate të kënaqëshme.

Tani, me shumimin e kuadrit mjekos, të pasunuem me mjekët e rinj, ka ardhë koha që të interesohemi për këtë problem dhe të krijohet bërtthama e parë ku të marrin pjesë të gjitha disiplinat e ndryshme të shkencave natyrore.

Këtij qëllimi i shërben, si prove, edhe ky artikull modest, mbi ato mjekime popullore të dermatomykozave, që deri diku, kanë edhe baza shkencore. Mjekimet janë mbledhë nga krahinat e ndryshme të Shqipnisë gjatë ekspeditave të shumta të ndërmarruna mbas çlirimit për lufsimin e sëmundjes shoqnotë të sifilizit.

* * *

Sëmundjet e ndryshme mycetare kanë ekzistue vazhdimisht në vendin tonë. Fjala qere asht e vjetët dhe ka prejardhje greke antike. Kjo fjalë asht përdorë për të parën herë nga Hypokrati (460-337 para erës tonë), i cili e quen «Kerion», dhe ma vonë Galeni (201-129 para erës tonë) e quan me fjalën «Keria». Me këto fjalë, ata kuptonin veitëm qeren e vërtetë d.m.th. favusin, sikur e njeh edhe populli jonë. (13)

Sëmundjet e tjera mycetare, si mikrosporine dhe trihofitine, empiriket tanë nuk dijnë me i dallue. Këta veçojnë infeksionet superficiale mycetare të kokës (Trichophytia superficialis aphleg.) nga ato profundet (Trichophytia profunda-Kerion Celsi), dhe flasin përgjithësisht për qeren e thatë dhe për qeren e njomë. Trihofytine e thellë ata e quajnë, me të drejtë, edhe «Qeria e viçave». Në disa krahina të jugut quhet edhe «kacidhe» d.m.th. qërs me vatra të rrumbullakta të shumta, si në formë monedje (kacidhe=monete e vogël).

Për infekzionet mycetare të lëkurës së lëmuert (*Trichophytia cutis glabrae*), përdoren nga populli shumë fjalë të ndryshme simbas krahinave. Ma tepër ndeshen fjalët: urth, pa-emën brenjë minish, ur lije, hurdhës, urdhja e keqë (Këlcyrë), uraze osse urëz (Gramshi-Pull), pulle-gurje lehine, lishë, lishanje (Tropoje), zhele (Shengjergj), rrethore (Xiber), rregoshe, rregoshe viçash, larze (Guri i Bardhë), rrumbulake, rrethje rrethje etj. Disa fjalë kanë preardhje silave si për i përdor shpesh edhe për sharje si p.sh. «Hik moj teshnadhë (Kavajë)», «Të hangërt teshi», «Të rafte qerja», «Hik more qeros», «Të rafte tenja» etj....

* * *

Mjekimet populllore të dermatomykozave janë të shumta dhe të ndryshme, disa domosdo edhe të pavleshme. Ngandoujherë empirikë i përcjellin këto mjekime me vargje kabalistike ose me bestyti. Këtu, do të rradhishim ma tepër ato mjekime popullore që na duken ma të randësishme dhe që kanë vlerë shkencore, pa pretendue se i kemi mbledh të gjitha mënyrat e mjekimit kundër infeksioneve mycetare.

Për qeren e vërtetë «*Tinea vera*», *savusin*, populli nuk ka ndonji mjekim të mirë, sikurse zeve «X» (Sabourantd - Noire 1901). Populli ynë, shërimin e savusit e quen të vështirë, ose ma dhe të tjerë përdorin aji përzjerje prej dylli duë çamçakizi (*Coprophilum*), përzjemje e njashë të pushit (lanugo), grata empirike përdorin shqeria e ziem «akda». Këto e zjene shqeria, kokës së fëmijës dhe, si ia lanë përi një kohë deri sa të ftohet, ia heqin. Në këtë masë ngjite, imbetet gjithë pushi i koks (Kjo metodë për pastrimin e pushit të lëkurës përdoret edhe udërt shëtë. Sintas profesoresh Dr. Marchionini dhe Gotz-i në Anatolinë e Turqisë, ky lloj mjekimi përdoret gjanaçisht nga empirikët për shërimin e qures (Hans Rieti 1962).

Për qeren e thate ose të butë (*Trichophytia superficialis et profunda capillitii*), empiriku i mirlenjofton i kryeqytetit, Mahmuti i Hasnajt, përdorte një përzjemje katrami me vaj dhe me ziente, i rihta mirë, dhe pastaj i aplikonte fëmijës në kokë për shtatë ditë e ma tepër, deri sa ti binin flokët krejtësisht. Me këtë metodë kërkohet, pra me shkaktue nga vatrati torpide superashtu si pat provue një kohë Buschke dhe Klemm (H. Fuhs 1934 1). Thuhet se kështu rriten faktoret imunobiologjike tek të sëmuat, gja kjo e randësishme për shërimin e tyne. Mbas kësaj procedure, ai këshillonte me i a la kokën fëmijës shpesh herë me ujë finje të ngrohtë dhe sapun. Ky lloj mjekimi asht i ujashëm me ate të Dr. Judejivit në Moskë, që në kohën e tij bani aq sikur do ta shpëjgojmë ma poshtë, katrami.

Në qytetin e Shkodrës, grata empirike përdorin mjaft zhiven, të cilën e shbytin, dhe si e përzjene me dhjam derri ose yndyre, i aplikojnë përfitësuar folikular që ka si rjedhim rambjen e flokve, e plotë të tij (Metoda e empirikes Age Gurash Nallbanit). Zhiva njihet si mijeti ma i vjetër antiparazitar dhe dëfton në vitro veti fungostatike (Hopkins Weid, dhe Kesten - citue nga H. Rieti), veçanërisht përkundrejt dermatofytëve dhe *Candida albicans* (18).

Në Lezhë e Mirditë nuk njoftin ndonji mjekim për qeren, sikurse e pojnjë edhe vetë empiriket, por disa mundohen me e përmirësuar dhe me e lehtësuar gjendjen e të sëmuat, duke i aferkuar shpesh herë vatrati e sëmuar me raki rrushi të fortë dhe mandje me ja lidhi kokën krejtësisht me dhjam derri. Ky lloj mjekimi vlen vetëm për pastrimin e koreve dhe eventualisht përvitimin e infeksioneve pyogene sekundare.

Për infekcionin mycetar të lëkurës. - urthi, populli vetë dhe empirikët përdorin disa metoda të thjeshta e të mira populllore, që kanë bazë shkencore. Mjetet e aplikuese kanë veti antimykotike dhe si rjedhjan e sherojnë praktikisht sëmundjen.

Në veri të Shqipisë, ma tepër, asht mjaft përhapun përdorimi i katramit vegjetal, që nxirret me anën e një distili primativ nga disa drunj dhe shkurre. Dihet se mjekimet populllore të të gjitha vendeve shtijnë në punë bimë e produkte, që ka vendi përkates. Kështu edhe për katramin oso peshkven që përdoret në këto taste, shënojnë se zona mafore, e njohur me emrin Dukagjin që shtrihet nga lugina e Drinit dhe arrin deri në Mat, ka qenë e përmendur për produktin e katramit të butë, që shpesh herë e sillnin në skeletin e Lezhës qysh në vitin 1570 për eksportim (Starine XII, 197). Ky zanat, ka qenë i përhapun edhe para qëllimit. Fshatarët e veriuut nxirrën katramin nga rrënjet e degot e pishës dhe e përdorin zakonisht për lyerjen e qerreve dhe për luftimin e rrinqave të bagtive. Prodhuimi, duhet të ketë qenë mjaft i madhi mibasi eksportohesh në Shkup, Monastir dhe në shumë krahina të vendit tonë. Në Silove e Peshkopit konstatuem, se për këtë distili, përdorin krahjetën (*Betula verrucosa*), që shtrihet në malat

e veriut (Shihtavec) dhe vazhdon tē gjindet me pakicë deri nē Shpat tē Elbasanit (10). Disa krahina tē tjera përdorin pér këtë qëllim dëllenjën (*Juniperus oxycedrus*) pishen (*Pinus nigra*), breshin (*Abies alba*), lajthinë (*Corylus avellana*), thanen (*Cornus mas*), vidhin (*Ulmus campestris*), trandafilin e egër (*Rosa canina*) etj. (12). Siç shifet, nji pjesë e popullit përdor edhe drunj halorë nga tā cilët, njihet se nxirret *oleum cedrinum* (18). Pér këtë qëllim preqatiten shkopinj prej *Juniperus oxycedrus* ose nga illojet e ndryshme tē drunjive dhe i ndezin nē njenën majë. Si tē këtë marrë flakë shkopi, sillon tē dal i nji lang i hollë i ujshëm së bashku me nji pjesë viskoze që fshatarët e mbledhin ne nji pjatë osc nē sépatën e tyne. Me këtë lang tē nxehët atë lyejnë vratat mycetare tē lëkurës dy deri tri herë nē ditë pér 3-5 ditë. Ky mjekim primitiv shkaktion, sikur e konstatuem edhe ne vetë nē Slovë, nji deskuamin tē fortë tē lëkurës dhe njikohësish pra edhe largimin e parasiteve. Populli i jep nji randësi tē veçantë faktit që langu i nxjorrë nga drunjti (*Pix liquida*), ti aplikohet tē sënuvë nē çast, mbasi thonë ata, se shërimi nē këtë mënyrë asht ma i shpejtë dhe i sigurtë. Pér tē dhanë nji gjykim mbi këtlë, vejmë re se, siç dihet, qđ proces kimik shpejtëhet mjaft nē gjendje nxchësise, por deri sot nuk njihon ndryshimet qđ ndodhin gjatë aplikimit të katramit, mbasi edhe substancat vepruese tē tij janë ende tē pa përcaktueme mërrë. Fakt asht se, me anën e kësaj metode empirike shkaktohen shumë shpejt nji deskuamacion i lëkurës tē deshiriue nga ana mjekoujëse, se sa me përdorimin e katramit tē stohitë dhe tē distiliuam, sikur përdoret nē dermatologjinë shkencore. Katramet vegetale kanë nji përzjerje substancash tē ndryshme me veprimë antimyotikë dhe me reaksion acid. Ato kanë benzol, toluol, xylol, naftalinë, saponiuë, metanol, aceton, fenol, kresol, acid acetik, acid fenilkarboksilik etj. Fundrina viskoze e katramit ka hidrokarbure parafinike dhe oleofenike (6). Drunji halorë nxjerrin nji illoj katrami qđ ka edhe vajna eterike dhe rrëshine qđ nuk mund tē pertifoten nga druni i ahut (*Fagus silvatica* — *oleum fagi*), dhe nga mështekna (*Betula verrucosa* — *oleum ruscii*) (18). Në përgjithësi pra, katramet kanë nji përzjerje tē ndryshueshme (variabel) dhe veprojnë si rrjedhim dhe nē mënryrë tē ndryshme (Perutz, Siebert dhe Winter-nitz — citue nga Hans Rieth) (18). Katrami dhe përbamjet e tjera tē tij kanë veti antimyotikë, veçanërisht acitet, vajnat eterike, rrëshinat, kresoli, fenoli etj. Përvëç kësaj katramet vegjetale kanë edhe veti antiprurigoze dhe antieczematoze dhe nē dermatologji jepen nē formë pastash ose pomadash dhe disa herë tē kombinueme me sulfuri. Kresoli asht tri herë ma i fortë se fenoli si mjet antiparasitar, por asht ma pak helmonjës. Fenoli asht nji helm i fortë i protoplasmës dhe gjen përdorim nē mjekimin e dermatomykozave si solucion Castellani (4% fenol dhe 8% resorcine) (18). Shkencërisht katrami vegjetal (*Pix liquida*), dhe ai i nxjorrë nga qymyr guri (*Pix lantharacis*) kanë veti antimyotikë (H. Rieth). Historikisht dihet se nē Apolloninë e vjeter empirikët e përdorin nji përzjerje katrami me asfalt pér mjekimin e ekzemës ragadiforme tē gjive (Plinius sec. XXIV 7 (25) (15). Edhe sulfuri qđ njihet me kohë si antimyotik, përdoret mjaft nga populli përkundrejt mykozave. Disa horë empirikët e përzjegjnë sulfuri me pjesë tē barabarta me barut, pér tē pasë nji efekt tē mirë. Shkencërisht dihet se sulfuri vepron veçanërisht kundër dermosyteve dhe *Candida albicans*.

Mjaft i përhapun asht edhe mjekimi i urthit me hi duhani ose hi thengjilli, tē ngjeshun me bështymë. Mc këtë illoj pomade, tē sëmuët fërkognë vratat mycetare dy tre herë nē ditë pér 5-6 ditë rresht dhe, nē Tirane, asht zakon me e krye këtë illoj mjekimi me shenja mystike dhe me vargje kabalistike, invokacioni etj si p.sh.

Zhele zhelo buba zhele
Mjella dy ara me me!
Njana mbini dhe njana s'bini
Në se mbini, i ra hini, e lcpini

Në fshatrat e Lushnjës i lyejnë ma parë vratat mycetare me ajkën e qumëshit dhe mandej i fërkognë me hinin e duhanit. Këtu pra kemi tē bajmë ne nji irritation lokal dhe mo veprimin antimyotik tē hinjt. Hinj përbahet zakonisht prej klorit, prej anhydriteve sulfurike dhe fosforike, prej kalchumit, magneziumit, sodës, potasit, acid salicylikut etj, tē cilët kanë nē pjesën nra tē madhe veti antiparazitare (2).

Në malisnë e veriut pamë tē përdoren edhe mjaft bimë qumëshore si rryli ose reni (*Euphorbia*) dbe gjakqumëshi (*Chelidonium majus*). Gjakqumëshi qubet edhe tembla gjaku (*Dugagjin*) edhe bar jodi (*Shirokë*). Nga populli praktikohet pér mjekimin e urthit dhe tē lytheve (*Verruca vulgaris*). Bima, kur këputet, nxjerr nē çast nji lang me ngjyrë e portokallit, pak nē tē kuq si ai i gjakut, prej kah sigurisht duhet tē vijë eçhe fjala. Malsërit e aplikojnë nē vratat e sëmuëmen jenjherë mbasi ta kerë këput, sepse thonë se vetëm kështu langu i saj ka nji shërim tē sigurtë.

Chelidonium majus ka mjaft alkaloidë si protopine, alokriptopine, kelidonin, kelidoksanine, kelirytrine etj. dhe asht mjaft kaustike. Lokalishët shkaktion shpejt nji eryteme deri bulë nē lëkurë. Shkencërisht njihet se ka veti fungostatike. (Alkiewicz e bashkëpuntorë — citue nga H. Rieth) (18).

Rryli (*Euphorbia*) njihet si bimë helmonjëse, qumëshi i bardhë i tij ka anhydrite tē acidit euforbiniq, euforbone, rrëshinë, kaupuk, acid galik, malik, acetik, vajna eterike dhe ndoshta dhe alkaloidë. Në gjendje tē njomë si bima ashtu edhe qumëshi, përvëç kësaj kanë edhe oleine,

alkooli cerlik, fruktoze dhe kripna të ndryshme (12). Simbas kohës së qëndrimit të qumshtit të bimës në lëkurën e sëmueme, shkaktohen eryteme, vesikula deri ulcacione. Nga kjo arësy pra përdoret nga populli edhe përkundrejt kalove. Prekja e mukozave dhe e korneshë së syt nga qumshti i rrylit, shkaktor distruksione të thella me rrjedhime mjaft të rënda (verbim) (3). Substancat e tjera kimike, veçanërisht acidet, vajnat eterike, rrëshnina alkooli etj. veprojnë si antimykotike.

Në qytetin dhe fshatarësinë e Shkodrës si dhe në Lushuje, e në shumë vende të tjera të vendit tonë, përdorin gjanësishi për shërimin e urthit badren - bathër (Luar), bathë, prasboile (Tiranë - Fushkrujë), presh gjarpni (Burrel), që iritet kudo (*Asphodelus microcarpus*). Empi-rikët e çajnë rrjanjën e badres dbe, me sipërsaqen e pjesës së preme i fërkojnë vratat e rrumbu. Ikkata të urthit dy herë në ditë për disa ditë rresht. Thohet se me siguri shërhohet sëmundja. Rranja e badres asht e rrumbullakët në madhësinë e uji patateje dhe prej asaj nxirret kryesish kole (qirish). Ka edhe sheqer të invertuem, glykoside, sheqer të reduktuem, substancë minerale, *natrium*, *calcium*, *calcium ferum*, *circum*, *silicium*, *phosphorus*, *sulfur*, *chlorum*, *magnesium*, *calcium phosphoricum* dhe *acidum carbonicum* (8). Në mjeksinë popullore badra, disa herë, përdoret përkundrejt inflamacioneve. Me sa kam mundun me u konsultue me literaturën përkatëse, badra nuk ka ndonjë substancë kimike të sortë të njohur antimykotike, por ndoshta vepron këtu si e tillë, mbasi ujihet se në përgjithësi barishtet, frutat dhe tranjet e bimës të shumë llojeve, kanë, ku më pak e ku ma shumë, substanca të forta antimykotike. Hans Rieth i quen këto si butime të vërteta për sigurimin e lindëve antimyçefare, megjithëse deri sot nuk kan arrrij me pas një randësi terapeutike në mjeksi. Ndoshta veprojnë këtu halogenet, sulfuri, zinci, chloruri ($ZNCl_2$), hekuri ose lidhje kimike të tjera, qofshin këto edhe në përgjindje të pakta. Mëgenës kjo metodë ashtu mjaft e përhapun dhe empirikët besojnë me kambëngulje se badra i shëron infeksionet myçetare, mendojnë se duhet shikue mundësia e nji thellimi shkencor të këtij mjekimi, dhe, në disa prova të bamë në klinikë, mundet që do të vlerësohej efikaciteti i mjekimit për shërimin e këtyre sëmundjeve.

Në malsinë e Tiranës, veçanërisht në Shëngjeri, përdorin kokrat e murizës (*Crataegus monogyna*) për shërimin e zheles — urthit. Kokrat e murizës shtypen mirë dhe në langun e nxjerrë prej tyme, fërkohen vratat e infektueme. Organet e ndryshme të bimës së lulet, frytet dbe levoret përbajnjë përvç vajnave eterike, kuercitrinë, substancë të idha si kratëgjinë, acid kratëgjik, substancia tanike, sheqernë, laktion kratëgjik, me karakter farmakologjik të saponineve, acide organike të ndryshme, acid citrik, acetik, vitamin C., karotinë, etj. Kur bimët janë të reja kanë edhe Trimethylamin dho nji glykosid cianogenjetik oksialantine (20,12). Ma tepër pra, kokrat e murizës, simbas përbëmjes kanë veti antimykotike por edhe antispasmatike dhe sedative. Si substanca antimykotike veprojnë acidet, vajnat eterike, tri-metylaminë, glykoside etj. Në se vitamina C vepron si antimykotik nuk dihet. Ajo njihet se ka veti antiinfeksioze. Me veti antimykotike njihet në literaturën mjeksore vetëm Vit. K3 dhe K5, Vit D2, eventualisht Vit B12, laktotoflavina (Nekam, Ito, Bonilla – citue nga H. Rieth). Vit K3 (2 Methyl 1,4 – Naphtokinon) dhe Vit K5 (3 Methyl – 4 Amido – 1 naphtol – Hydrochlorid) që nxirren nga njyrrat e bimës dhe që janë fungostatike (18, 19). Ata pengojnë tritjen e trichophyton mentagrophytes dhe të mikrosporid. Gjajnë edhe përdorim të gjërë në mjekimin e mykozave të thella. Në formë tinkture, ekstrakte etj. përdoret edhe në sëmundjet e zemrës dhe në *morbus hypertonicus*.

Po në fshatarësinë e Tiranës përdorin për mjekimin e shperketjesë – urthit, langun e nxjerrë nga kokrat e kuqe të rrushkulit (*Ruscus aculeatus*). Asht nji bimë e zakonshme në Shqipëri që përmbar rrëshinë, vajna eterike, krypna potasi, kalcium etj. Plakat empirike i çajnë kokrat e rrushkulit dhe në sipërsaqen e preme, i fërkojnë fort për disa ditë rresht vratat e infektueme myçetare. Edhe levozhgat e njoma të arrës (*Juglans regia*) përdoren për këtë qëllim. Populli i fërkon vratat e urthit, sikur vepron edhe për mjekimin e ekzemes kronike, për disa minuta dbe disa ditë rresht. Si të fillojë me u deskuamue lëkura e sëmueme, e lyejnë me gjalpe të patetun, ma tepër për të pastre skumat. Meqenëse levozhga e njomë e arrës ka acid citrik, acid malik, shumë substanca tanike dhe vajna eterike, mund të besohet pra se ka veprim shërimi, mbasi lëkura tkurret, deskuamohet dhe njikohësisht veprojnë substancat kimike si antimykotik (3,12).

Në fshatarësinë e Koplikut përdoret vetëm Kulpra (*Clematis vitalba flamula*) për shërimin e urthit. Populli i shtyp në havan gjethet, kërcylljet, lulet dbe si i fut pak kripë, i a vendos të sëmuinet në vratat myçetare. Ky lloj mjekimi shkaktor nji inflamacion të sortë të lëkurës dbe ma vonë nji deskuamin simbas kohës së qëndrimit nbi lëkurë. Në vendet e tjera, empiriket, e përdorin kulpres per os kundër sëmundjeve kronike të lëkurës. Fshatarët tonë e përdorin edhe për mjekimin e reumatizmës. Njihet si bimë me veti të forta fungicide (K.W. Kalkoff 5). Lloje bimësh të përtengjashme (të nji fisë) përdoret edhe në Himarë për shërimin e urthit. Atje merret bima sharnije që shkencërisht quhen *Anemone stellata* (sharnije yllore), *Anemone pratensis* (sharnije llavdhesh) ose *Anemone nemorosa* (sharnije gemushash) që hyjnë në famjen e zhabinave. Kjo e fundit nep rezultatet ma të mëra fungostatike. Gjethet djegse të tyne shtypin dbe i vendosin në lëkurën e prekun. Kulpra ka disa lloj glykosidesh dhe acide organike amfor, alkaloide etj, kurse Anemonet e ndryshme i kanë të gjitha pjesët e tyne helmonjëse,

Këto përmabjnë anemonel, anemonin, acid anemonik, acid izoanemonik dhe saponine (rranjat dhe shkaktojnë në lëkurë nji eryteme, vezikula, ulcera dhe disa herç odhe gangrene. Në mukozat e hundës dhe të syut, shkakton inflamacione të forta kur vijnë në kontakt me të. Njihen shkençerisht si bimë me veprime fungicide (Madans, Schindler dhe Möbus-citue nga K.W. Kalkoff), veçanërisht veprojnë mbi *oidium laetis* dhe *aspergillus niger* (5).

Nji metodë originale kemi ndesh në Bicaj që Peshkopi tek empirikja e njoftun për mjekimin e sëmundjeve të lëkurës Gjyle Dedja prej Palamani. Ajo gjërvishje sipërfaqen e vatrës së urbit në drejtëme të ndryshme me anën e nji maje të gjylpanës dhe mandej, pak larg kandit të vatrës së rrambullakët mycetare, gervishje përsëri po në atë mënryë nji rreth të hollë prej 3-5 mm për të pengue zhvillimin e sëmundjes, që rricot vazhdilimisht në periferi. Lokalishët ajo përdorë katramin e nxehet vegjetal të nxjerë nga drunjë halore ose shkurre të ndryshme.

Në Tropojë na tërroqi vërejtjen nji mjekim i barjive të kësaj krahine. Barinjt, kur infektohen dhe iu qfaqet urthi në lëkurë, i lyejnë vratat me krypë dhe i lanë të lëpihen me gjuhë nga lopa për disa minuta për 2-3 diqe rreshjt. Ata janë të sigurt se shërohen shpejt dhe me siguri. Këtu kemi të bajmë me aji irritacion lokal të lëkurës dhe ndoshta me ndonjë veprim të dobët fungostatik të bështymës (Rieth, H.). Në jugë të Shqipnisë përdorin gurine kalit (*Cuprum sulfuricum*) për shërimin e vatrave mycetare. Fshatarët ma parë e shtypin mirë gurine kalit dhe me pluhën e tij si e njomin pak me bështymë, i férkojnë pjesët e infektuime për disa herë deri në shërimin e plotë të tyne, ashtu sikurse veprojnë edhe për shërimin e *leishmaniosis cutis*. Këtu ata e lanë pluhuni mbi plaqë të lidhur për disa orë. *Cuprum sulfuricum* përdoren në mjeksi si një ms veti antimykotike për shërimin e sëmundjeve mycetare (18). Disa të tjera e férkojnë fort urthin me langun e hudrës (*Allius sativus*, var. *vulgare*) që njihet si fungostatik, dhe anti-septik mbasi ka vajna eterike, me nji glykocid të *sulfuruem* (*Aliina*), që shkaktojnë lokalishë irritacione dhe inflamacione (3). Mjete të tjera empirike antimycothare përdoren me siguri në vendin tonë, por vetë nuk kam pasë mundësi me i mbledh të gjitha, vegenërisht ato të Shqipnisë së jugut. Me interes do të ishte me ditët në të ardhurat në se përdoren në mjekimet e tjera populllore të vendit, bimë dhe ekstrakte drunjsh me veti antimykotike si p.sh. të renës ose krenes (*Cochlearia armoracia*) të kerpit ose kaupit (*Cannabis sativa*), të Lotzojes (*Convalaria majalis*), të torbës (*turfa*), të lisres (*Thymus*), të shtogut (*Sambucus nigra*), të lule blirrit (*Artemesia absinthium*), të sherbelës (*Salvia officinalis*), të monaferrave (*Rubus fruticosus*), të boronicave (*Vaccinium myrtillus*), të brendit të zi (*Picea excelsa*), të vajnave të ndryshme eterike (vaj kaneli, sinapi, lisre, laboti, kikiriku, hidershaje etj) dhe të langjeve të nxjera nga plepat (*Populus*), katalpa (druzbukurimi në Tiranë), limonat, portokallat, bizelet, qepët, hurdyhat, domatet, (tomatin dhe tomatidin) etj, që njihen shkencërisht me veti fungostatike dhe fungicide (H. Rieth dhe K.W. Kalkoff) (8,15).

Sot bahan përpjekje të shumëanësime me diktuc sa ma tepër substancat antimykotike dhe me i vje këto në shërbim të popullit, qofshin të nxjerruna nga bimët, drunjit, mineralet ose sekretet e ndryshme. Në ket drejtëm njihen si antimykotikë: sulfuri, klori, fluori, bromi, jodi, acid boriku, permanganati, uji i oksigjeue (H_2O_2), ozoni (O_3), zhiva, formaldehydi, alkoolet, katramst, acidet karbonike alifatika, sapojet invertë, fenole, kresolet, sulfidet dhe diamidinet aromatike, ngjyrat e anilinës, derivatet e cikloheksanit, chinonet, vajnat eterike, sulfamidet, sulfonet, derivatet e chinolinës, të benzimidazolit dhe të acidit izonikotinik, histaminet, antihistaminet, hormonet, sekretet, Vit K, ekstraktet e drunjve të ndryshme, barishtet, frutat, rranjat bimore dës së fundi antibiotikët e njoftuna sikur asht grizeofulvina, nystadina, trichomycina, amphotericina, actidioni etj. të cilat dhanë nji kontribut të vlefshëm praktik përliftimin e sëmundjeve mycetare (Marrë nga K.W. Kalkoff (5) dhe H. Rieth (18) Wülf (19)).

Me këto vërejtje dhe të dhana që nxorrëm nga nji pjesë e mjekisë popullore të vendit tonë, mendojmë se asht me interes të merren në studim serioz shkencore disa nga këto mjekime.

Ne kemi bindjen se pjesa ma e madhe e mjekimeve empirike përkundrejt dermatomykозe zave kanë veti antimykotike dhe mendojmë se nga ato mjekime mund të nxirren konkluzione shkencore me vlerë praktike.

(Paraqitun në redaksi me 2/III/65).

LITERATURA E PËRDORUN:

1. *Fuchs H.* Durch Pilze bedingte Hautkrankheiten pflanzlicher Aetiologie Nr. Die Haut und Geschlechtskrankheiten von L. Arzt und K. Ziehler. Vol. III. Wien 1934.
2. - *Guareschi Irillo*: Encyclopédia di chimica. Torino U.T.E.T. 1927. (Composizione e chimica del tabaco Vol XIII).
- 3) *Gessner Otto Dr.* : Die Gift und Arzneipflanzen von Mitteleuropa. Heidelberg 1931.
- 4) *Hegi Gustav Dr.*: Illustrierte Flora von Mitteleuropa, München.
- 5) *Kalkoff K.W.* dhe *D. Janke*: Mykosen der Haut. Ne Dermatologie und Venerologie. Band II/Teil 2. Stuttgart 1958. von Gottron u Schönfeld fq 1140-1148.

6. - Kambo Qesqep Ing.: Kurs i shkurter i kimisë organike. Tiranë 1961.
7. - Kirk E.R. Otmer: Encyclopdia of chemical technology Interscience. Vol. 13. New-York.
8. - Kosta M. (udhëheqës Prof. Kol Popa.) Tezë diplome: Disa konsiderata mbi përbërjen kimike dhe vlerën praktike të bimës spontane Asphodelus microcarpus. (Material i daktilografue).
9. - Miescher G: Trichophytien und Epidermophytien. Ne Handbuch der Haut und Geschlechtskrankheiten von. J. Jadassohn, Vol. XI Berlin 1928.
10. - Mitrushi Ilja Ing.: Drurët dhe shkurret c Shqipnisë. Tiranë 1955.
11. - Mitrushi Ilja Ing.: Të dhana mbi përbapjen dhe ekologjinë e mështcknës (betula pendula Roth) në Shqipni. Buletin i Universitetit Shtetor të Tiranës. Shkencat natyrore Nr. 3 1964.
12. - Negri G. Erbario figurato. Milano 1943.
13. - Neuburger M. u. Julius Pagel: Handbuch der Geschichte der Medizin. Jena 1902.
14. - Nopcsa Franz Dr.: Zakonet dhe bestyinitë në Shqipni. Djalëria viti i II-të Nr 11. 1921 Wien.
15. - Plinius secundus C. Naturalis historiae. Edidit Carolus Mayhoff Lipsiae inae, B.G. Teubner. Vol. 1-5 1924
16. - Petrov B.D. Geschichte der Medizin. Berlin 1957.
17. - Popa K. Bimët mjeksore të vendit tonë, Tiranë 1952
18. - Rieth Hans: Die Antimycotica. Ne Handbuch der Haut und Geschlechtskrankheiten (Ergänzungswerk von. J. Jadassohn). Vol V/I Bandteil B. Berlin 1962 fq 1172-1317.
19. - Wulf Karl. Vitamine. Ne Handbuch der Haut und Geschlechtskrankheiten von J. Jadassohn (Ergänzungswerk von J. Jadassohn). Vol. V/I Bandteil A. Berlin 1962 fq. 382-457.
20. - Zemlinskii S.E. Bimët mjeksore në Bashkimin Sovjetik. Moskë 1949.

TRADITIONAL POPULAR METHODS OF TREATMENT OF DERMATOMYCOSIS IN ALBANIA.

(Summary)

After mentioning briefly the importance of traditional medicine and its origin in Albania, the author speaks of the necessity of collecting the different empiric methods of treatment, using for this purpose the doctors and other specialists of the natural sciences. He mentions also the different names used by the population of different regions for favus, microsporia and trichophytia, as well as for the other mycotic infections of the skin, which names in many cases have a very old history.

After that the author describes the different empiric methods of treatment of dermatomycosis in the country and in the cities. He begins with the local treatment of phlegmatic trichophytia of the head with oil and tar and the method of epilation of lanugo hairs with boiled sugar, which is very similar to that described by professor Marchionini and Gotz for Turkish Anatolia. This method is used also for cleaning the skin of the face of girls before marriage. In favus the empirics use mechanical epilation after cleaning the skin with grape brandy. Different methods are used in the treatment of mycotic lesions of the smooth skin. Widely used is resin extracted from different trees, like Pinus nigra, Betulla verrucosa, Abies alba, Corylus colurna, Cornus mas, Ulmus campestris, Rosa canina etc. The vegetal resins were used hot, soon after epilation, and by local application. The most used resins were oleum cadinum, oleum fagi, oleum ruscii. The hot resins cause a more rapid desquamation of the skin. In the past the production of these resins was highly developed, and many of them were used as medicines by the population. Besides resins, the empirics used ashes from tobacco plants; from ruphorbia, coledonium majus, Asphodelus microcarpus, Crataegus monogyna, Ruscus aculeatus, Juglans nigra, Clementis recta, Anemone pratensis, Anemone nemerosa, as well as copper sulphate etc.

Each method of treatment is analysed in detail, pointing out the antimycotic activity of the plants, of the extracts from trees and shrubs, of different chemical substances, as well as the secrets of preparations used by the Albanian people for the treatment of mycotic infections, using substances with fungostatic and fungicidal action, which for this reason could have a scientific basis.

Lastly the author describes two original ways of treatment of herpes tonsurans by the population of the northern regions of Albania.

The shepherds of the North apply salt on their skin lesions and then expose them to be licked by the cows. It seems that this method gives satisfactory results. In another region of the North a woman, renowned for her skill in healing skin diseases, uses puncturing with a needle the surface of the mycotic lesion as well as its circumference with the purpose of «limiting the spread of the infection»; then she applies hot pitch on it.

KUMTESA

LEPTOSPIROMBARTSHMËRIA NË KAFSHË (KUAJ), BURIM INFEKSIONI PËR NJERËZIT

Prof. N. DUSHNIKU

(Katedra e sëmundjeve infektive — epidemiologjike — Shef N. Dushniku.)

Nga kërkimet e derisotëshme në vëndin tonë rezulton se bartësit e leptospirave të ndryshme të depistuar janë kafshët: lopët, derrat, viçat, dhitë, qingjat dhe minjtë. (2,3,4)

Nga këto kafshë janë izoluar:

aglutininë per shtamet *L. icterohaemorragiae*, *L. grippotyphosa*, *L. sejro*, *L. heb domadis*, *L. autumnalis*, *L. pomona*, *L. mitis*, *L. australis*, *L. bataviae*, *L. ballum* dhe *L. poi*. (5)
Për të vijuar studimin në lidhje me infeksionin prej leptospirave në kuaj, përvëç depistimeve personale, iu drejtova Institutut të Kërkimeve Veterinare të cilët më dërguan 13 kampionë gjakrash marë në kuajt nga bashkëpunorët e atij Institutit: M. Dervishi dhe Aledin Ruseti, dhe i dërgova në Institutin e Serumeve dhe vaksinave Dr. I. Cantacuzino në R.P. të Rumanisë. Resultatet e titrit të serumeve janë si më poshtë:

4 serume 1/100, 8 1/200, 7 1/400, 3 1/800.

Titulli dhe lloji i aglutininave për leptospira, që kanë predominuar në gjakrat e kuajve paraqiten si më poshtë:

L. pomona 1/800, 1/400, 1/400, 1/400, 1/400, 1/200, 1/100
L. australis 1/800, 1/400, 1/400, 1/200, 1/100, 1/100
L. autumnalis 1/200
L. ballum 1/100
L. poi 1/400, 1/200, 1/200, 1/200, 1/200
L. icterohaemorragiae 1/800

Interesant është se në serumin e kuajve tanë numuri i llojeve të aglutininave për leptospira ka qënë i lëvizshëm nga 1 deri në 4 lloji tipe për çdo kalë duke predominuar më tepër *leptospira pomona*, *australis*, më pak *autumnalis*, *ballum* dhe *poi*.

Kuajt infektohen zakonisht nëpërmjet plagëve të vogla, veçanërisht në afersitë e thundrës së këmbës duke gërmuar dheun, nëpërmjet mukozës orale gjatë ushqimit (1) në afersitë e shtallave të derrave të cilët paraqesin një përqindje të lartë të infeksionit 37% (5).

Në kuaj infeksioni paraqitet me manifestime të një hepatiti ikterogjen ose me një iridociklit ose në formë të lehta të cilat nuk diagnostikohen. (1)

Autorë të ndryshëm si Gasparidis në Itali (cituar nga 1) ka diagnostikuar prezencën e *L. icterohaemorragiae* në kuaj të kafshuar nga qëntë, në sa Hensser (cituar nga 1) në Sveciç, konstatoi se 95% e kuajve të smurë uga sytë paraqesin aglutininë për leptospirë 1/400 dhe disa të tjera 1/1000. Në disa të tjera titulli ishte më pak se 1/400.

Në 66 rraste subakut dhe kronik pozitiviteti ishte 100% me titull 1/400.

Aglutinina në këto rraste kanë qënë për *L. grippotyphosae*, *L. pomona*, *L. australis*, *L. sejroe*.

Në Amerikë Jager, Gochenour e Wetmore (cituar nga 1) kanë konstatuar prezencën e aglutininave në serumin e kuajve.

Sëmundja paraqitet gjithashtu në Bashkimin Sovjetik (Kuzmin e bashkëpunorët) në sa Gjernani (Rimpau, Wagener dhe Kath cituar nga 1)

Vlen të theksojmë se të 13 serumet kanë aglutinë të ndryshme të leptospirave me tituj të ndryshëm aglutinacioni. Kjo tregon se këta kuaj gjat jetës së tyre kanë pësuar infeksione prej

leptospirave disa me forma më të theksuara për një lloji leptospirc ose më tepër, disa në forma më të lehta, disa pak kohë para se tu merresh gjaku, për këtë janë edhe titull të lartë: 1/400, 1/800; disa të tjerë vjetë më parë duke dhënë tituj më të ulët 1/100, 1/200 sepse me faktoria kohë aglutinatin janë ulur, si trjedhim edhe titulli është ulur (1).

Ka autorë (6) që pranojnë se titujt nën 1/400, 1/200, 1/100, mund të konsiderohen si të dyshimtë.

Përsë i përket mënyrës së përhapjes së infekzionit, si në gjithë kafshët e tjera edhe kuajt eliminojnë leptospirat me anë të urinës.

Njerëzit infektohen duke punuar zbathur në tokë të infektuar nga urina e kafshëve dhe leptospirat hyjnë në organizëm nëpërmjet ulceracioneve që ndodhen në këmbë, nga traumat, ose infektohen me anë të traktit gastrointestinal duke mare ushqime të infektuara nga urina, ose me anën e ujit të infektuar ose nga kontakti direkt me kafshët e sëmura.

KONKLUZIONE.

Përveç mbartësve të leptospirave në kafshë, si derrat, viçat, lopët, dele, dhitë, qingjat dhe minjt, shtojmë si burim infekzioni për njeriun edhe kuajt.

Në scrumin e gjakut të 13 kuajve janë konstatuar aglutinina për leptospira/: *Pomona*, *australis*, *ballum*, poi, ichtero haemoragiae.

(Paraqitur në redaksi me 5/3/1965)

LITERATURA

1. Austoni. M. Le leptospirosi. *Minerva Med.* 537 – 544. 1953.
2. Dushniku. N. Leptospirozat në Shqipëri. *Shëndëtësia Popullore* 5, 1956.
3. Dushniku N. Disa të dhëna të leptospirave në kafshë. *Buletini U. SH. T. № 2*, 1958.
4. Dushniku N. Kërkimet epidemiologjike të leptospirozave – *Shëndëtësia popullore* Nr. 12, 1959.
5. Dushniku N. Epidemiologjia e leptospirozave në Shqipëri – *«Shëndëtësia Popullore»* Nr. 5, 1962
6. Mackie. T.J. dhe McCartney T.E. *Manuale di batteriologia pratica*. UTET – I-1956

ANIMAL CARRIERS OF LEPTOSPIRAE AND THEIR IMPORTANCE AS SOURCES OF INFECTION TO MAN.

(Summary).

The animals commonly known to be carriers of leptospiroae in our country are pigs, cows, sheep (lambs), goats and rats. It has been proved that these animals can be carriers of *L. icterohaemorrhagiae*, *L. grippotyphosa*, *L. seiro*, *L. hebdomadis*, *L. autumnalis*, *L. pomona*, *L. mitis*, *L. australis*, *L. bataviae*, *L. ballum*, *L. poi*.

Later it was supposed that the horse could also be carrier of some leptospiroae, and to that purpose the author sent 13 samples of horse blood to be examined in the Cantacuzino Institute for serums and vaccines in Roumania.

Two gave positive agglutination tests with *L. poi* at 1:200 titre, two others at 1:100 with *L. australis*, and so on as can be seen in the accompanying table.

It is suggested that horses get infected from pigs; the way of entrance are usually some small lesions the horses have near the hooves or the mouth mucosa, especially when horses are kept near the pig-sties. It is a known fact that the carrier rate of pigs for leptospiroae is very high – about 37%.

In horses the leptospiro infection may present the clinical manifestation of an icterogeneous hepatitis or iridocyclitis.

ENCEPHALITIS PERIAXIALIS DIFFUSA SCHILDER

(Një rast anatomo-klinik)

RROKU ÇESK

– Shërbimi i Anatomisë Patologjike të spitaleve — Tiranë

Doc. PREZA BAJRAM

– Katedra e neuropsikialrisë (Shef Prof. Gjata Xh.)

Encefaliti periakzial difuz i Schilderit bën pjesë në grupin e leukoencefaliteve, afeksione këto, që karakterizohen me praninë e procesit demielinizues primar progresiv me lokalizim në lëndën e bardhë. Ky lokalizim e ka shtyrë Levaditin që ti quaj «deukoneuroaksit» (5). Boyd W. (2) e klasifikon në grupin e sëmundjeve demielinizuese hashkë me sklerozën multiple, encefalitin akut të diseminuar dhe encefalitin akut hemoragjik nekrotizant. Sipas Merrit H.H. (8) sëmundja e Schilderit është më e njojhura dhe më e përhapura midis sklerozave difuze, karakteristikë kryesore e të cilave është humbja difuze e mielinës në hemisferat cerebrale (leukodistrofia). Në këtë grup a fuit: encefalitin periakzial difuz të Schilderit, encefalitin periakzial koncentrik të Balo, sklerozën cerebrale progresive të Grinsfeld (Greenfield), sklerozën cerebrale Pelizaeus-Merzbacher, sklerozën cerebrale Scholz dhe sklerozën cerebrale të Krabbe.

Grinker dhe të tjerë (6) vënë në dukje se klasifikimi i sëmundjeve demielinizuese është jashtëzakonisht i vështirë për arsyen e polimorfizmit të madh klinik të tyre; ato mund të ndryshojnë si për sa i përket fillimit, larmisë simptomatike, zhvillimit të remisioneve dhe akutizimeve, ashtu dhe përfundimeve. Kurse, nga ana tjetër, reperti i tyre histopatologjik, paraqitet shpesh uniform.

Qysh në vitin 1939, Ludo van Bogaert dhe de Buscher, cituar nga de Morsier (10), i ndajnë këtë sëmundje në tre forma, Kurse Seitelberger, (12) fut në grupin e sëmundjeve demielinizuese gjashtë entitete nosologjike.

Në vitin 1912-1913, Schilder, në dy artikuj, izlooi nga grupi i sklerozave difuze cerebrale, sëmundjen që mban sot emrin e tij dhe e quajti atë «encephalitis periaxialis diffusa» (cituar nga Lereboullet-13).

Kjo sëmundje, në pikëpamje anatomo-patologjike, karakterizohet nga një proces demielinizues i lëndës së bardhë të të dy hemisferave cerebrale, me ruajtje të neuroaksoneve - prandaj quhet leukoencefalit periakzial. Është proces demielinizues primar progresiv, sklerotizues që shtrihet në të dy hemisferat në mënyrë simetrike ose asimetrike dhe që nuk prek koren dhe ruan fibrat arkuate në formë U-je. Kuadri morfoligjik, i cili ndryshon edhe sipas stadiut të procesit, në fillim karakterizohet nga demielinizim difuz i hemisferave, me ruajtje relative të neuroaksoneve, manifestime të trupzave granulo-dhjamore, infiltrate limfo-monocitare të hapësirave perivaskulare, qeliza granulare, çfaqje të qelizeve të mëdha gliale hipertrofike si dhe proliferacion të neuroglies. Sipas Dragănescu St. (5), de Morsier-G, Feldmann H. (9), Bednar B. e të tjerë (1), Cummings J. (4), Bouman L. (3), Poser J. (11).

Aspekti makro- dhe mikroskopik ndryshon sipas vjetërsisë të procesit. Në fazën akute ajo paraqet nekroza, material të bollshëm sudanofil. Në fazën subakute, krashtë procesit demielinizues, çfaqet dhe procesi reaktiv përkatës me elemente të proliferacionit gjal. Në formën kronike vërehen procese proliferative në trajtë plakash me konsistencë të fortë. Kur hiperplazia e neuroglies nuk arrin të mbushë defektin e krijuar, formohen edhe pseudociste. Gjithashtu janë përshtkrue edhe disa forma kalimtare ndërmjet sëmundjes së Schilder-it dhe të sklerozës multiple. Bednar B. dhe të tjerë (1), de Morsier G. (10). Nga ana makroskopike, në raste akute, truri është i zmadhuar, edematoz; në format kronike vihet re forcimi i pjesës më të madhe të trurit, zakonisht i të dy hemisferave.

Paraqitura e rastit. – Autopsia nr. 43/63, dt. 20.2.63.

Ekzaminimi i jashtëm: kufomë e sekssit femër, 32 vjeç, me nutricion të mirë.

Ekzaminimi i brëndshëm: Hapja e kokës: mbulesat e buta, të njoma, rozë, kalva pa ndryshime. Dura mater lehtësishët e tendosur, e hollë, e pastër. Hipofizia në normë. Baza e trurit e pastër. Vazat e bazës të holla, të lëmuara, të buta, të lira. Gjatë heqjes së trurit rrjedh sasi e shtuar likuori cerebrospinal. Hemisferat simetrike, gjruset në madhësi dhe konfiguracion të zakonshëm, kortikalja e ruajtur. Ventrikulat në volum të zakonshëm, ependima e ventrikulave laterale, në pjesën anteriore e ruajtur, në atë posteriore e përfshime në masën e zbutjes cerebrale; përbmajnë likuid cerebrospinal lehtësishët të turbullt. Truri, në lobet frontale në të dy anët dhe në lobet okcipitale po në të dy anët, paraqet zona të mëdha zbutjeje, të gjëra, të cilat praktikishë përfshijnë të gjithë materjen e bardhë; në lobet okcipitale me ngjyrë rozë me nuancë gri dhe të kuqe, në lobet frontale me ngjyrë rozë-gri me pamje gelatinore (Fig. 1). Zonat e zbutjes janë simetrike, në pamjen e futurës me krahet e hapura. Në regionin e ganglioneve bazale të anës së majtë e gjithë struktura e bardhë është e përfshirë në zbutjen e tipit të laripërmendur. Pons dhe medulla oblongata pa ndryshime. Cerebellum më lobin e djathë potuajse krejtësisht e përfshirë nga zbutja, ngjyra rozë-gri, me pamje të gelatinës (Fig. 2). Kortikalja në të gjithë gjërsinë e saj e paprzekur nga procesi në fjalë.

Në ekzaminimin makroskopik të organeve të brëndshme nuk u vunë re ndryshime të vlefshme për tu shënuar me përjashtim të ateletizazave të gjëra pulmonare bilaterale. Është për tu vënë në dukje autolizimi i thclë i organeve parenkimateze dhe të muskulaturës me gjithë që autopsia është bërë vetëm rreth 18 orë pas vdekjes, në stinën e dimrit dhe në kondita të mira të ruajtjes së kusfomës.

Ekzaminimi histopatologjik. – (Hemat. – Eosin, Sharlah-hematoksilin, Bielchowsky). Copë të ndryshme të prelevuara nga lobet frontale dhe okcipitale dhe nga cerebeli.

Në të gjitha pjesët vihet re ruajtje e substancës gri, e cila, paraqet tek-tuk vetëm vaza të zgjëruara, të mbushura me eritrocite. Struktura histologjike e saj e zakonëshme e ruajtur. Në zonat e zbutjes vihen re: zona nekrotike me ruajtje të vazave, rreth disa prej të cilave vihen re infiltrate të dendura limfo-monocitare dhe elemente gliale (Fig. 3). Rreth disa vazave të tjera materjal abundant sharlah, i vendosur në qeliza të mëdha të granulara (Fig. 4). Elemente të mëdha të granulara sharlah-pozitive gjinden me shumicë në të gjithë preparatin ku në sasi shumë abundante dhe ku më pak. Ngjyrimi me Bielschowsky ven në dukje ruajtjen e neuroaksoneve (Fig. 5), në zonat me nekroza të dendura, bashkë me rrjetën pericelulare fibrilare. Shumë qeliza glifale në zonat e demielinizimit kanë karakter ithesit spongior me protoplasmë të hollshme të vakuolizuar (Fig. 6). Në disa zona paretet e vazave paraqesin proliferim fare të lehti të endoteliut; paretet e tyre janë të pluhurosoara nga material granular i imtë që ngjyroset në blu të errët me hematoksilin. Edhe me ngjyrim të zakonshëm (hematoksilin-eosin) në disa zona vërehet proliferim dhe hiperplazi e astroglieve fibrilare. Vërehen fenomene shumë të shprehura të stazës me mbusje të vazave të zgjëruara me eritrocite.

Në bazë të këtyre të dhënavë makro- dhe mikroskopike u vu diagnoza: encefalit periaksal difuz Schilder në fazën subakute.

Nga ana klinike: Pacientja L.GJ., e martuar, me pesë fëmijë, vjeç 32, shtrohet më 24.1.963 në klinikën e neurologjisë, me nr. kartele 696. Pacientja nuk është në gjëndje të japë të dhëna anamnestike, prandaj ato mblidhen nga i vilai i saj. Sipas tij, shenjet e para të sëmundjes i kanë filluar para tre vjetësh me dhimbje koke të durueshme. Më vonë filloj të ketë ndryshime në sjellje, ishte euforike, por herë-herë qante shpejt, qeshët pa shkak, lëvizte shumë, fliste pa ndërprerje. Ajo ankohej përmarrje mendësh dhe gjatë ecjes paraqiste deviacion nga ana e djathë nuk i duronte fëmijët e saj. Më vonë shprehej me fjalë të papërshtatëshme ciniike, bënte shaka pa kripë. Gjatë javëve të fundit kishte filluar të shkonte në peshë, paraqiste turbullime të vetëdijes, defekonte dhe urinonte në mënyrë të pavullnetëshme. Në ekzaminimin e organeve të mbrendshme nuk paraqiste ndonjë patologji të dukshme.

Në momentin e shtrimit paraqiste turbullime të theksuara psikotike dhe neurologjike: vëtedjë auto-dhe allopsikike ishte e alteruar. Paraqeste stereotipi verbale, kopolrali, reagonë me të thirrura ndaj çdo lëvizjeje pasive dhe fjalë që i thubej, nuk ishte në gjëndje të qëndronte në këmbë. Vihej re ptozë palpcolare e majtë, reflekset kornecale të ulura, pupillat, izokoriki, reagonin shumë dobët ndaj dritës, parezë faciale centrale e djathë. Reflekset osteotendinoze në anësitë e djathës të ulura, po ashtu toni dhe forca muskulare rrafshi të reduktuara në të njëjtën anë. Vërehet tendencë për Babinski. Kurse në anësitë e majta clonus pedis, hiperefleksi osteotendinoze, hipertoni muskulare dhe Babinski. Vihen re reflekset të automatizmit oral i mjaft të theksuara: refleksi bulldog, refleksi nasolabial dhe palmomental Marinesco-Radovici. Gjatë qëndrimit në klinikë gjendja e saj shkoi vazhdimisht duke u keqësuar, vazhdonte të ishte e ekeciuar, nuk hante ushqimin, nuk flente mirë, urinonte dhe defekonte në shtrat. Ekzaminimet paraklinike: eritrosedimentacioni 49mm/orë, limopeni (12% limfocite) dhe monocitozë (10% monocite). L. csp.: Pandy +++, alb. gr 2,70%, celula 3/1mm, klorur 7,30%, glukoza 0,70%. Fundus oculi: Papilla pa konture të qarta, nga ana superonasale dhe inferonasale konturen e dekolotuara, me shumë vase të ngushtuara.

Diagnoza: atrofia fililestre e papiliës së nervit optik. Kraniogramat në dy projekte pa patologji. Ditët e fundit gjendja e saj u rëndua vazhdimisht e më shumë, filloj të ketë temperaturë febrile dhe me 20.2.963 bëri exitus letalis.

Diagnoza klinike: Tumor frontobazal me interesim tō diencefalin, tē lobit frontal tē djath me penetrat nē lobin frontal tē majtē.

Paraqitja anatomo-klinike e këtij rasti po bëhet:

1-se kjo sëmundje nuk është c shpeshtë, prandaj nuk na duket pa vend që tē tërheqim vëmëndjen e kolegëve mbi këtë entitet nosologjik.

2-se mosha tridhetedy vjeçare e pacientes sonë nuk është ajo e zakonëshme dhe më frekuentja nē tē cilën takohet kjo sëmundje.

3-se larmija dhe polimorfizmi i simptomatikës nuk lejuan që tē vihet diagnoza e saktë klinike.

Medje, në lidhje me diagnozën diferençore, Merrit shprehet nē këtë mënyrë: diagnoza e sëmundjes së Schilder-it mund tē jetë jashtzakonisht o vështirë. Diagnoza diferençiale, sipas këtij autorit, duhet tē bëhet me dy sëmundje: me sklerozën multiple dhe me tumorin cerebral.

BIBLIOGRAFI

- 1 - *Bednar B. et alii* - Patologicka Anatomie. Praha 1963. Dil II, Çast 2 Ff 1369-1374.
- 2 - *Boyd W.* - A Textbook of Pathology. Leu & Febiger. Philadelphia 1961. Ff. 1181-1187.
- 3 - *Bouman L.* - Diffuse sclerosis, encephalitis periaxialis diffusa. Bristol John Wright Sons, Ltd, 1934. Fq 164 (citar nga Merrit).
- 4 - *Cumings J.* - Abnormalities of lipid chemistry in cerebral lipidoses and demyelinating conditions. Modern Scientific Aspects of Neurology. 1960. Ef 330-354.
- 5 - *Draganescu St.* - Morfologia Sistemului Nervos. Editura Medicala. Bucuresti 1957. Ff 339-360.
- 6 - *Grinker R.R., Bucy P.C., Sahs A. D.* - Neurology. 1960. Ff. 947-973.
- 7 - *Hennar K.* - Specialni neurologie. Praha 1952. Ff 299-302.
- 8 - *Merrit H.H.* - A Textbook of Neurology. Second edition. Lea & Febiger. 1959. Ff. 649-657.
- 9 - *de Morsier G., Feldman H.* - Scleroze diffuse et multiple. Un cas anatomoclinique. Acta Neurologica et Psychiatrica Belgica, 1953. No. 4. Ff 279-297.
- 10 - *de Morsier G.* Format «tranzitor» kryesisht hemisferike tō sklerozës cerebrale (Schilder) me fillim apoplektiform. Livre jubilaire de Dr Ludo van Bogaert. 1962. Ff 208-214.
- 11 - *Poser J.* - Diffuse Disseminated Sclerosis in the adult. J. Neuropathology Exper. 1933, 13, 289 (citar nga Merrit).
- 12 - *Seitelberger F.* - Histochemistry of demyelinated diseases proper including allergic encephalomyelitis and Polizaeus-Merzbacher's disease. Modern Scientific Aspects of Neurology. 1960. Ff 146-187.
- 13 - *Schilder* - Zur Frage der sogennanter diffuser Sklerose (Ueber Encephalitis periaxialis diffusa). Citar nga Lereboullet in Traité de Médecine. Tome XV. Paris 1949. Ff 987-990.

A CASE OF PERIAXIAL ENCEPHALOPATHY OF THE SCHILDER TYPE.

(Summary)

A case is presented of periaxial encephalopathy of the Schilder type in its clinical and morphological aspect. A 32 year old woman with an extremely confused clinical picture. The diagnosis of the clinique was a «brain tumor», but during the autopsy was discovered a symmetrical necrosis of the brain in both hemispheres, which did not interest the grey substance, as well as a large necrotic zone in the right hemisphere of the cerebellum. In some places the necrotic zones had a gelatinous consistency, elsewhere they appeared like bright hard ribbons.

The histological picture shows a necrosis with abundant sudanophil substance and an extensive demyelinising process. Together with the sudanophilic matter there appear some perivascular inflammatory infiltrates and proliferating zones of the glia, which gave the author sufficient ground to diagnose a case of periaxial encephalitis of the Schilder type.

Literature data on the classification of the demyelinizing processes are discussed, together with their etiopathogenesis, morphology and clinical picture, which are compared with those of the discussed case. This case is considered a rarity, especially considering the age of the patient.



Fig.1. Zona të gjana zbutjeje të matericës së bardhë të lobeve frontale dhe atyqe oksipitale me rrejtje të kortikales.



fig.2. Lobi djathi të cerebellar me zonë të gjanë nekroze.




fig. 3. (Ngjyrimi: Bielshovski). Ruejtje e neuroaksoneve në zonat me nekrozësive, bashkë me rrjetin fibrilar pericellularar.





fig. 4. (Ngjyrimi: Sharlah-haematoxilin). Material abondant sharlah pozitiv, në zonat e nekrozës.



↑ fig. 5. (Ngjyrimi: Hemat - Eosin). Hyperplasi dhe proliferacion i astroglieve fibrilare.



← fig. 6. (Ngjyrim: Sharlah-hematoksilin). Ruejtje e strukturës histologjike të kortikales, nën të substanca e bardhë me nekroza të gjana ruejti të vazave. Rreth vazave infiltrate të denduna sëmfoplasmoditare dhe elemente gliale.

DY RASTE ME PYLOROSTENOSIS CONGENITALIS¹⁾

FATOS HARITO

(Katedra e patologjisë së përgjithëshme; -
Shef i katedrës : Doc. Pullumb Bitri)

Pilorostenzoza kongenitale është një sëmundje e rrallë. Sipas Jacoby ajo përbën 0,4% të autopsive të të porsalindurve. Gjatë vitit 1963 në e kemi takuar dy herë këtë sëmundje që mbi këto raste po komunikojmë.

Duhet thënë që në fillim se pilorostenzoza dhe pilorospazma janë dy sëmundje të veçanta, me prejardhje dhe morfologji të ndryshme, por me simptomatologji të ngjashtme, që nuk duhet të ngatërhohen me njëra tjeterën, sepse mjekimi i tyre është i ndryshëm. Kështu, ndërsa pilorospazma i nënështrohet trajtimi konservativ, pilorostenzoza duhet të trajtohet votëm me metodë kirurgjikale (6,12,15,18,19,21,22).

Nobecourt P. ndan tre kategoritë vështirësisë së kalimit të masave ushqimore prej stomakut në duoden (12):

1. Atrezi kongenitale, si një vicium zhvillimi fort i rrallë.
2. Stenozë nga hipertrofia muskulare.

3. Stenozë spazmodike (indipendente nga të gjitha lezonet e mëparëshme).

Pilorostenzoza kongenitale është sëmundje e laktantëve në muajt e parë të jetës. Sëmundja karakterizohet me simptomat e pakalueshmërisë së pjesëshme të pilorit dhe manifestohet me të vjella të papërmbarjëshme dhe rënje të shpejtë progresive të peshës së pacientit, që çon në kahesi dhe vdekje.

Përshtkimet e para mbi simptomat e kësaj sëmundje i përkasin Armstrong më 1777, i cili tregoi se në një familje tre fëmijë vdiqën nga një «tumor» i veçantë i pilorit (cit; 15,17). Më 1887 Hirschsprung në Copenague, studtoi sëmundjen dhe njoftoi mbi karakteristikat anatomiche të dy rasteve të tij, në shoqërinë gjermane të mjekëve pediatër në Wiesbaden (cit. 12-17).

Sëmundja takohet më shpesh tek meshkujt në raport 80/20 (15), por që ndryshou pak si- as autorëve të ndryshëm. Pilorostenzoza takohet në të gjithë popujt, por është vënë re se raca anglo-saksone ka një predispozitë të veçantë në krahasinë me racat sllave dhe latine (12).

Mbi etiopatogjenezën e pilorostenozës janë dhënë mendime të ndryshme dhe divergjente: Thompson, Wernstedt dhe shumë autorë francezë janë të mendimt se pakalueshmëria pilorike shkaktohet vetëm dhe vetëm prej spazmës nervore, kurse trashja e muskulaturës pilorike është sekondare (cit. 11). Sipas tyre spazma shkaktohet nga influenca toksiko e lipideve jo normale qumështit të uënës, nga ulcerat e traktit gastrointestinal, në terren të një predispozite neurologjike etj. Më 1923 Skvorcov M.A., pasi i bëri një analizë embriologjike dhe studim morfoligjik pilorostenozës kongenitale, arriti në përfundimin se sëmundja ka karakter kongenital. Në fakt fundit të muajit të parë dhe fillimit të muajit të dytë jetës intrauterine (cit. 15). Kurse Frangkenberger Z. tregon se muskulatura cirkulare e stokat zhvillohet në mënyrë të dukëshme në muajin e tretë të jetës embrionale (7).

Sot shumica e pediatreve dhe e kirurgëve mbrojnë pikëpamjen e prejardhjes kongenitale (8,11,17,19,23). Në favor të kësaj teoric flasin rastet me pilorostenzoze në autopsitë e fëmire (2.).

Letullo M., i cili ka patur raste me dëmtime inflamatore subakute të paretit pilorik, supozit se pilorostenzoza mund të shkaktohet prej një infeksioni në muaji e para të jetës ekstraterine (10). Ndërsa Cohen dhe Broitbart thonë se prejardhja e pilorostenozës kanë bazë e nekrobiotike në pleksuse nervore dhe qelizat ganglioze të pilorit (2). Raia A. dhe bashkëautorët shprehin mendimin se në patogjenezin e pilorostenozës, momenti kryesor është mos

1) Falenderojmë prof. S. Bekteshin për ndihmën e dhënë të konsultimin e materialit.

zhvillimi i fijeve të pleksuseve nervore miinteriko si në sëmundjen Favalli-Hirschsprung (14) Herbst tregoi se degjenerimi i fijeve ganglionare, kurse hipertrofia e muskulaturës pilorike kompensatore sekondare (cit. 17). Steinicke-Nielsen konsideron primare dhe kongenitale hipertrofizme e pilorit (20).

Termat «*Hypertrophy pylori*», «*Pylorostenosis hypertrophica*» nuk janë të drejta sepse nuk pasqyrojnë escencen dhe gjenezën e sëmundjes. Termi «*Hypertrophy*» përdoret zakonisht lidhur me kuptimin e ngarkesës funksionale. Davidovski I.V. thotë: «Në fund të fundit çdo hipertrofi është hipertrofi punëtore» (4). Veset kongenitale të zhvillimit bëjnë përjashtim nga kuptimi i hipertrofisë (1). Prandaj është më e drejtë që sëmundja të quhet *pylorostenosis congenitalis*.

PARAQITJA E RASTEVE PERSONALE

Rasti Nr. 1. – Nr. i protokollit A.P. 140, datë 20/VII/1963. Lulëzim L. një muajsh në hyrje, shtrohet në spitalin Nr. 3 me 20/6/63 me temperaturutë, të vjella menjëherë pas matrjes së qumështit të nënës. Në spital të vjellat persistonin 1-2 orë pas përljes. Fëmija vdiq me 20/VII/1963 dhe u përcoll në autopsi me diagnosten «*pylorospasmus* Atrofia». Gjatë autopsisë u konstatua: Kufoma e gjinisë mashkull me konstitucion të irregulli, nutricion shumë të ulët, shtresa dhjamore subkutane e zhdukur. Lékura e pastërt, e zbehtë, e fishkur. Truri pa ndryshime të rëndësishme. Vlijat respiratore dhe pulmonet në normë. Në zemër, ndërmjet dy atriumeve, komunikim nëpërmjet foramen ovale, që mbulohet përgjysëm nga një cipë e hollë gjysëm transparente. Sistemi urogenital pa ndryshime të dukeshme. Stomaku me konfiguracion të irregullit, mjast i zgjeruar, përbap sasi të madhe leng ushqimor me ngjyrë të bardhë. Pilori nga jashtë ka formën e një tubi rigjid me konsistencë mjast komakte, gati kartilagjinoze. Mukoza ngjyrë roze plikat e saj të shprehura mirë, kalimi në kardia i lirë. Kalimi nëpër pilor shumë i ngushtuar, mezi kalon një sondë metalike e hollë. Pilori me parete të trashura që arrinjë 0,6 cm.. me konsistencë shumë të fortë. Duoden, vezika ditnjë dhe vijat trashura që arrinjë 0,6 cm.. me konsistencë shumë të fortë. Duoden, vezika ditnjë tâ errët. Intestini pa ndryshime.

Studimi histopatologjik. – *Pars pylorica ventriculi* paraqet trashje të të gjitha shtresave të tij. Mukoza me hipersekrecion të gjendrave (Mikro-foto Nr. 1). Submukoza mjast e trashur, e shkrifët, e pasur me bërtama. Muskulatura shumë e trashur, sidomos shtresa e brendëshme cirkulare. Miofibritë kanë dimensione më të mëdha se në normë. Pjesërisht në to konstatohen vakuole. Nukleuset gjithashu paraqesin volum të shtuar (Mikro-foto Nr. 1-2). Pulmone, zemër, rene dhe lieni asgjë me rëndësi. Hepati manifeston fenomene staze në kapilarët sinusoidale. Diagnosa anatomopatologjike: *Pylorostenosis congenitalis. Gastroctasia. Atrophia. Foramen ovales latens.*

Rasti Nr. 2. – Nr. i protokollit A.M. 71, datë 21/XII/1963.

Bebe T. e gjinisë mashkull. Lindi para kohë, me 10/XII/1963 nga një bairë binjake me dekur të mirë, nga prindër që gjëzojnë shëndet të mirë. Pesha e lindjes 1600 gram, shtati 42 cm. Pas pesë orësh dhe 15 minutash në gjendje asfiksje dhe përcillet në morge me diagnosten: «*Asphyxia Praematuritas grada e II-të*». Gjatë autopsisë u konstatua cianoze e buzëve e gjishtave të duarve dhe të këmbëve. Pulmonet ngjyrë të kuqe vishnje me konsistencë të pa ajrosur. Stomaku i zgjeruar, përban ajër me pak mukus me shkumë. Plifikat e tij mezi dukën, mukoza rozë e lëmuar e pastërt. Kalimi në duoden i ngushtuar. Pilori i trashur, i fortë me trashësi 3,2 mm. më duoden kalon në formë shkalle. Organet e tjera pa ndryshime me rëndësi.


Studimi histopatologjik. – Pilori mjast i trashur në të gjitha shtresat e tij. Mukoza me gjëndra të zmadhuara. Shtresa cirkulare e muskulaturës pilorike shumë e trashur, miofibritë dhe nukleuset e tyre të shtuara në volum (mikro-foto Nr. 3). Pulmonet: në to u konstatuan membrana hialinore në bronket e alveola si dhe vatra atelektaze masive. Diagnosa anatomopatologjike: «*Sëmundja e membranave hialinore*». *Asphyxia. Acrocyanosis. Pylorostenosis. Praematuritas*.

Duke patur parasysh se shtresa muskulare e stomakut tek të porsa lindurit është e zhvilluar dobët dhe në pilor nuk i kalon dimensionet 1-2 mm (13), del e qartë se në të dy rastet tonë, por sidomos në të parin, trashja e paretit pilorik është shumë e madhe. Grada e trashjes relative për të gjitha shtresat e stomakut është gati e barabartë, dhe ky fakt, sipas shumë autorëve, flet kundër teorisë spazmatike, sipas sëcilës duhej të hipertrofiohej vetëm shtresa muskulare. Njëkohësisht, ky është një argument në favor të teorisë kongeniiale, sepse dihet që patologjia nuk një shembuj të veseve të zhvillimit të një shtrese të vteve.

Në favor të teorisë kongeniiale flet edhe rasti i pilorostenozës në një fëmijë prematur që vdiq 5 orë pas lindjes nga një sëmundje tjetër (Rasti Nr. 2). Këtu është e pa mundur të spjegohet trashja e pilorit nga pilorospazmat primare, sepse në këtë moshë sistemi nervor është i zhvilluar në mënyrë të pa mjafueshme për të shkaktuar spazmën (11). Në rastin tonë Nr. 1 u konstatua një atrofji ekstrem. Kjo pajtohet me mendimin se pilorosteniza është një prej faktorëve etiologjik në prejardhjen e hipotrofisë (16).

(Paraqitur në redaksi më 5/III/1965)


Mikrofoto Nr. 1
(egjirimi hematoksiline-eozine), glandulat e mukozës në gjendje hiperskretioni, submukozë e shkriftët. Muskulatura shumë e trashur, fibrat e saj dha nukleuset me volum të shtuar



Mikrofoto Nr. 2
(ngjyr. hematoksilin-eozine). Trashja e konsiderueshme e shtresës cirkulare të muskulatures pilorike.



Mikrofoto Nr. 3
(ngjyr. hematoksilin-eozine). Të gjitha shtresat e pareut pilorik paraqiten të trashura por sido-mos muskulatura cirkulare. Miofibritet duken të zma-dhuara.



BIBLIOGRAFIA

1. Abrikosov A.I., Strukov A.I. Patologicheskaja anatomija, Medgiz, 1961, f. 172.
2. Alarotu H. Le altérations histopathologiques du plexus myenterique du pylore dans la sténose hypertrophique du pylore des nourrissons. (pěrmbledbje) La presse medicale N. 26, 1957, f. 604.
3. Bednar E., Fingerland A., Sedlicka V.: Patologicka anatomie, díl II, cast I, Praha 1963, f. 921.
4. Davidovski I.V.: Obsjekcija patologija celovjeka, Medgiz 1961, f. 264.
5. Dogliotti G.C.: Diagnosi precoce in medicina interna vol. 15, 1956, f. 52.
6. Dulicki S.O.: Boljezni rannjevo djetskovo vozrasta, 1950, f. 178-181.
7. Frangkenberger Z. Embriologie, Praha 1952, f. 144.
8. Gabaj A.B.: Pediatria. N. 11, 1962, f. 44-46.
9. Gavrilov K.P.: Osobjennosti razvijanja djetjei perioda novorozhdjenosti, 1951; f. 84-85.
10. Letulle M.: Anatomie pathologique, tom II, Paris 1931, f. 144.
11. Levin A.S.: Očjerki po pediatriji, Minsk, 1961, f. 106-112.
12. Nobécourt P.: Precis de medecine des enfants, Paris, 1942, f. 530-533.
13. Ostrovskaja I.M.: Anatomo-fisiologiceskie osobjennosti djetskovo vozrasta, Moskva 1953, f. 125-131.
14. Rata A., Curti P., de Almela A.C. et Fry W. Le pathogenie de la stenose hypertrophique du pylore chez le nouveau-né et l'adulte. La presse medicale N. 20, 1957; f. 453.
15. Rozanova N.A. Vrazhdjonij pilorostenoz u grudnjih djetjei i jevo operativnoje liječenje, Medgiz, 1960.
16. Rozenzial A.S.: Hroničeskie rastrojstva pitania i pishčevarejnenja v ranjem djetskom vozrastje, Moskva 1948, f. 229-240.
17. Rukovodstvo po patologicheskoj anatomii, tom IV, kniga 1, Redaktor toma Akad. A.I. Abrikosov, f. 313-315.
18. Sikl H.: Pathologicka anatomia specialni, Praha 1951, f. 43-44.
19. Silkin N.I.: Slučaj vrazhdjonnova pilorosteniza. Pediatria N. 7, 1959, f. 86.
20. Steinicke Nielsen O.: Lesions histologiques de plexus myenterique du pylore dans la sténose pylorique infantile. Etudes sur des prélèvements biopsiques chirurgicaux (pěrmbli). La presse medicale N. 30, 1957, f. 694.
21. Tirone S., Pagliano L., Caprotti G.: Considerazioni cliniche e statistiche su dieci anni di chirurgia gastrica. Minerva Chirurgica, vol. 18, N. 10, 1963, f. 409.
22. Ternovskij S.D.: Hirurgija djetskovo vozrasta. Moskva 1953, f. 271.
23. Tosovsky V., Vychytil O.: Ostrije processi v brushnoj pollosti pri vrazhdjonnih anomalijah u djetjei, Moskva, 1957, f. 27-39.

TWO CASES OF CONGENITAL PYLOROSTENOSIS.

(Summary)

After a short survey of the history of this disease, opinions of different authors are given on its etiopathogenesis. After that two personal cases are discussed. Morphologically they present thickening of all the layers of the pyloric wall. This fact may serve as an argument against the spasm theory of pylorostenosis, according to which only the muscular layer should be hypertrophic. The author mentions a case of pylorostenosis in a premature child, which died from the «disease of hyaline membranes» 5 hours after birth. This also speaks in favor of the congenital theory of pylorostenosis. The author accepts the idea that pylorostenosis can be one of the causes of child hypotrophy.

KONTRIBUT NË STUDIMIN E TË ASHTUQUAJTURIT «SINDROM LYELL» OSE «NEKROLIZA EPIDERMKE TOKSIKE»

QAZIM CERGA

(Spitali i shtetit Hier—Drejtor Thimi Miltonash)

M.N.B. vjeç 18, kartela klinike Nr. 679, datë 29/4/1962, kooperativist. Shtrohet në repartin infektiv ditën e pestë të sëmundjes. Sëmundja i ka filluar me të mbërdhitura, temperaturë, ftyrë dhe në trup, Kurohet ambulatorisht me bipenicilinë por pa efekt. Gjendja keqësoshet qfaqen hemoragjira të vogëla nga goja dhe hunda, fliktena dhe vezikula në ftyrë, trup dhe anesi si dhe një bulë në qafë dhe në tabanet e këmbëve. Nuk rezulton që të ketë përdorur ndonjë medikament para se të sëmuraj.

Anamneza epidemike: Në fémijëri ka kaluar *pertussis*, varicela morbilllo dhe prej 8-9 vjetesh vuan nga epilepsia. I jati është me tbc pulmonar.

Në hyrje gjendja ishte impresionuese: Ftyra e mbuluar me vezikula dhe fliktena, të linte përshtypjen e një të kombustionuar. Goja (buzet, xinxhixhat), bunda (naret) ishin të mbuluar me krusta, kurse e tërë lëkura e ftyrës e konxhestionuar, sytë të skelesura dhe sklerat hipopremike. Në gushë si dhe vende vende në kraharor dhe shpinë shihen petekje e sulfuzione të vogëla gjaku. Në të gjithë lëkurën e trupit vrchen (me përjashtim të lëkurës së kokës) vezikula polimorfë mbi një lëkurë të konxhestionuar (shif fig. 1.) Në qafë shihet një bulë e madhe plot me likid serocitrine (shih fig. 2.) Të dy tabanet e këmbëve paraqesin bula të mëdha të mbushura me lëng ngjyrë vjolle të hapur. Shenja e pickimit pozitiv. Nga ana e aparatit respirator duc kardiovaskular nuk paraqiste asgjë përtu shenuar.

Barku me formë dhe volum normal, i butë në prekje. Mëlciqja dhe shpretkat preken rreth dy centimetra nën harkun brinjor.

Sistemi nervor: Kostiuencia e turbulltë, pyetjeve u përgjigjet me vonësë dhe përtaci. Pupila izokrike, reagojnë mirë, reflekset fotoluminoze normale. Shenja meningcale nuk paraqet është febrili.

Zhvillimi i sëmundjes dhe terapi: Që në ditën e parë të shtrimit iu aplikua një terapi e kombinuar me 1 gr. streptomycinë dhe 1.200,000 u bipenicilinë gjatë 24 orëve. Gjithashtu pacientit iu aplikua glukozë 40%; vitamina C 5% dhc vitamina B₁ injektabile. Bashkë me këtë terapi iu dha dhe prednizon 200 mgr., vitamina K, vitamina P, kalcii clorati etj.

I sëmuri qëndroi gjithsej uë repartit tonë 30 ditë. Dekursi i sëmundjes që i kënaqshëm dhe vetëm ditën e 12 të hospitalizimit pacientit filloi ti bjerrë lëkura dhe thozi i gjithët të pestë të këmbës së djathië. Dy ditë më vonë bie lëkura e të dy të këmbëve me gjithë thonjët e gishtërinjëve.

Analizat: 1) Hemograma 29/4/1962-Hbl. 40%, eritr. 3. 950.000, leukoc. 5.900, neutrofile 49%, euzinofile ska, bazofile ska, linfocite 48%, monocyte 3%, erpiksed. 52 mm.

Mc 28/5/1962: Hbl 60%, eritrocitet 3.900.000, lekokit 8.000 neutrofilet 75%, euzinofilet 1%, bazofilet ska, linfocite 26%, monocyte 1%, erpiksed. 5 mm.

Urina me 29/4/62: Albumina pozitiv i lehtë, bili., urob., neg. sed. norm. Analizat e urinës me 28/5/62 rezultuan normal. Azotemia me 3/5/62 24 mgr.%, analizat e tjera objektive rezultuan neg. Kurse kultura e likuidit të bulave etj. për arsyq objektive nuk qe e mundur të bëherëshin.

* * *

Vitet e fundit në literaturën mjekësore botërore janë përshkruar raste të nje sindromi të ri që u njojt me emrin «sindromi Lyell ose nekroliza epidermike toksike». Por me sa duket sindromi nuk është edhe aq i ri sepse gjëndet i përshkruar edhe nga Sevill dhe Rusell (9-10) që me

1891 të cilët e kanë pagëzuar me emrin «dermatitis exfoliativa epidermika» dhe e konsideruan këtë sindrom si një sëmundje infektive me etiologji të panjohur.

Në fillim edhe në rastin tonë kështu e pagëzuan. Por duke u nisur nga të dhënat e leteraturës së mëvonëshme e pamë më të arsyeshme që ta quanim «sindrom i Lyell» ose «nekroliza epidermike toksike».

Me 1956 Alan Lyell (7), përshkroi këtë sindrom duke e quajtur «nekroliza epidermike toksike» erupzion që përgjegjen e lëkurës. Sindromi karakterizohet me erupzion që përkohet dhenë mukozat. Pacienti paraqet bule të mëdha të prodhuara nga shqipja e epidermit që i jepin të sëmurit pamjen e një të djegurit dhe që karakterizohen me një gjendje toksike të rënë, e cila shpesht mbaron me vdekje.

Përvkrimi i një rasti të ri sjell me vete edhe pikpamje të ndryshme, interpretimet dhe afirmime që ndryshojnë nga një autor tek tjetri. Kështu Garnier G. (6) e përmblehdh këtë sindrom në penfig akut ose subakut dhe bëu një studim të hollësishëm të kësaj sëmundje duke përmblehdur 30 raste deri në 1962. Me të drejtë Gagliardi B. dhe Ricciardello P.T. (1) pretendojnë se duke u nisur nga emërata ndryshëm që i kanë dhënë këtij sindromi autorë të ndryshëm, rastet duhet të janë shumë më tëpër se sa ato që takohen me këtë emër dhe, pikërisht këtu lind dhe vështirësia në kërkim të bibliografike. Ky afirmim na duket sa i drejtë po aq dhe me vend dhe mendojmë se raste sindromi «Lyell» pa tjetër do të janë takuar edhe në vëndin tonë por që me siguri janë pagëzuar me emërata të ndryshëm ashtu siç që edhe djagonza janë në fillim ose siç është rasti i Debrë, Lami, Lamotte (3), të cilët e konsiderojnë këtë sindrom të njejtë me rastet e tyre, të përmblehdhura më parë nën emrin «critroderma buloze me epidermolizë».

Sëmundjet që kanë një kuadër klinik të karakterizuar me erupsione të mukoza dhe lëkurë janë të shumta. Kjo nijheit mirë nga të gjithë dhe, nuk është një «zbulim» i ri. Por sindromi «Lyell», paraqet një interes të veçantë dhe ka ngjallur diskutim jo vetëm përsë i përket njohjes së individualitetit të këtij sindromi, por edhe klasifikimit të tij nozografik.

* * *

Në përvkrimin që ka bërë Lyell ka shumë ngashmëri me atë të bërë nga Sevill dhe Russel (9-10), të cilët në publikimet e tyre kuadrin klinik të këtij sindromi e kanë futur në grupin e eritrodermive infektive akute të karakterizuara me një zhvillim të ndarë në tre periudha: Periudha e parë është ajo papulo-eritematoze dhe që zgjat nga 3-8 ditë. Periudha e dyte karakterizohet me vazhdimin e proceseve eksudative. Kjo periudhë zgjat nga 3-8 javë, zgjat kësaj kohe vezikulat dhe papulat shkrihen dhe pëlcasin. Periudha e tretë karakterizohet me kthimin gradual në gjendje normale të pamjeve së lëkurës.

Autorët përvkruanjë si komplikim në mes të tjerave edhe rënien e thonjve dhe të flokëve. Po ashtu autorët e mësipërm kanë mundur të izolojnë nga vezikulat e të sëmurëve një diplokok i cili nga pikpamja morfologjike është i ngashëm me stafilokokun e bardhë, ndryshon nga ai në vetë biokimike.

Fardye (5), Winfield (12) kanë publikuar raste të njëjtë me ato të Savill-it e Russell-it, kurse A.I. Pospelov (8) 1905, në botimin e një traktati të sëmundjeve të lëkurës e përmend këtë sindrom dhe e konsideron si një entitet nosologjik të veçantë. Ky sindrom përmendet edhe në botimin e 1955 «Zarazne bolezni çlloveka» (11), këtu këjo sëmundje konsiderohet si një entitet morboz infektiv i ralle dhe i pa njohur mirë.

Duhet menduar se rastet e publikuara nga Sabilli, Russell, Fardice, Wienfeld të mos janë tjetër veç se të ashtuquajtura sindrome «Lyell», por që për një periudhë kohe të gjatë ky sindrom ka marrë emërata të ndryshëm për deri sa më 1956 Alan Lyell e përshkroi dhe e përcaktoi edhe një herë si një entitet nosologjik të veçantë.

Na duket interesant dhe mendojmë se duhet përmendur edhe një çeshtje tjetër që ka të bëjë me etiopatogjencën e kësaj sëmundjeje. Nga të dhënat statistikore rezulton se në pjesën të madhe të rasteve është konstatuar përdorimi i ndonjë medikamenti disa ditë përparrë shfaqies së sëmundjes. Kështu Lyell (7), në të rastet e përvkruarra prej tij, kishte gjetur se pacientët përparrë se të sëmureshin kishin përdorur aspirinë dhe fenilbutazon.

Garnier (6) në tridhjetë rastet e përmbledhura nga ai ka konstatuar se pacientët e tij kishin përdorur përparrë se të sëmureshin medikamente të ndryshme. Po ashtu ve në dukje dhe De Toni Jr. (4) se në të sëmuret e tij ishin përdorur sulfamide. Në rastin e përvkruar nga Gagliardi B. dhe Ricciardello P.T. (1), fëmija kishte përdorur preparate me përbajtje sulfamidi etj. medikamente të cilat ishin përdorur edhe me përparrë por që nuk kishin dhënë fenomene anësore.

Nga këto del edhe hipoteza që sindromi «Lyell» të jetë një çfagje jashtëzakonisht e rënd farmakoalergjike. Në këtë drejtim slet edhe observimi i Coricciati e Friggeri (2), të cilët në një rast sindromi «Lyell» me origjinë peniciliane arritën të kanë rezultate pozitive në bérjen e intradermoreaksionit. Vlen të përmendet fakti, ashtu si Garnier me të drejtë ve në dukje, që në rastin e sindromit «Lyell» nuk është fjalë edhe aq për një intotsikacion të tipit helmues ose të një indiosinkrazie, por duhet menduar që sëmundja të jetë pasojë e një sensibilizimi të më parshëm.

Interesant na duket edhe supozimi i Debrë e bashkëpuntorë (3) të cilët për rastet kur sindromi çfaqet në përdorimin e parë të preparatit, tërhcqin vëmendjen dhe orientojnë që shkakun ta kërkojmë tek një disenzimopati kongjenitale që është vërejtur tanë afér në rastet e intolerancës individuale kundrejt agjentëve egzogjene.

Para se ta mbyllim problemi e etiopatogjenezës, do të ishte gabim të linim në heshtje edhe disa vrejtje dje konstatime që kanë të bëjnë më karakterin infektiv të këtij sindromi.

Me që këjo sëmundje shkoi duke u studjuar, dualnë edhe observime të reja që shpesh herë bien në kundërshtim njera me tjeterën. Kështu p.sh. në rastin e Gagliardit B. e Ricciardello P. T. mundën të izolojnë nga likuidi i butave një stafilokok nga një anë, kurse nga ana tjeter po këta autorë janin një rezultat pozitiv të fiksimit të komplementit për adenovirus nga +1/4 - 1/16 dhe me gjithë këtë, rastin e tyre ata e konsiderojnë si një farë farmakoalergje dhe, mund të thuhet se pjesa më e madhe e autorëve janë po të këtij mendimi.

Në rastin tonë nuk mundem të arrinjme në asnjë perfundim përsa i përket shkakut të shfa qjesë së sindromit «Lyell» sepse i sëmuri ynë nuk rezultoi të kishte përdorur ndonjë medikament përparrë se të sëmurej. Me gjithë atë, duke u nisur nga disa elemente klinike (flikten, vezikula bulë), fenomene këto që takohen në mjaft sëmundje të tjera infektive si p.sh. erezipela buloze, penfigus, variçella etj.) nga njëra anë dhe nga ana tjeter nga të dhënët laboratorike (rezultatet e arritura nga autorë të ndryshëm si Savill, Russell, Gagliardi etj.), na duket më e drejtë që këtë sindrom ta inkluadronim në grupin e sëmundjeve «infektive toksiko-alergjike». Duke lënë më një anë se kujt i takon prioriteti që këtë sindrom ta ketë përshkruar dhe të marrë emrin e tij,

(Paraqitur në redaksi me 5/XI/1964)

LITERATURA

- 1) Gagliardi B., Ricciardello P.T. - Miner. Medica 1964, 40, 1616.
- 2) Caricciati L. Frigeri L. - Minerv. Dermat. 1962, 37, 150
- 3) Dobre R., e coll. Press Medic. 1963, 7, 509
- 4) De Tani Fr. - Minerv. Pediatri. 1962, 14, 1202
- 5) Fardyce - Journ. cut. dis. 1897, 141
- 6) Garnier G. - Press Medic. 1962, 29, 1457
- 7) Lyell A. (Cit. nga Gagliardi B. et coll.) Minerv. Medic. 1964, 40, 1616
- 8) Pospišilov A.I. - Rukovodstvo k izucheniu kozhnih bolezni - 1905, 515
- 9) Savil T. - Brit. Med. Journ. 1891, 2, 1197
- 10) Savil T., Russell - Brit. Journ. Derm. 1892, 4, 105
- 11) Zhdanova M. et coll. - Zaraznie bolezni cellovaka 1955, 631
- 12) Winfield - Journ. cat. Dis., 1898, 73

A CONTRIBUTION TO THE STUDY OF THE SO CALLED «SYNDROME OF LYELL», OR «TOXIC EPIDERMIC NEGROLYSIS».

(Summary)

The case is analysed of a 18 year old boy, received in the hospital on the 5th day of illness in a state of emergency : the face, covered with vesicles and phlyctene, gave the impression of a severe burn. The mouth and nose (nares) were covered by dried crusts, the skin of the face was congested, the sclerae - hyperaemic, the eyes - sealed by dried exudation. On the neck and breast could be seen isolated petechiae. Over the whole surface of the skin (with the exception of the scalp) could be seen numerous small vesicles. Larger vesicles were seen on the neck and the skin of the soles. The pinch symptom was positive. The treatment began with Bipenicillin, streptomycin, glucose 40%, vitamin C, vit. B₁, prednison. The patient was released on the 34th day of illness, after desquamation of the skin and fall of the nails o the fingers and toes. It can be concluded that this was a case of the «Syndrome : Lyell».

On the basis of many observations by different authors and the available literature, we think that the diagnosis of a syndrome of Lyell is correct, since were no indications of the patient's having used drugs capable of giving intolerance complications.



Fig. 4



Fig. 2

PËRMBLEDHJE NGA LITERATURA E HUAJ

TE DHËNA TË LITERATURËS MJEKËSORE MBI RËNDËSINË KLINIKE
TË PËRCAKTIMIT TË PEPSINOGENIT NË URINË.

KLEMENT SHTETO

(Laboratori Biokimik Qëndror)

Prej shumë vjetësh prezencia e këtij fermenti në urinë ka tërhequr vëmëndjen e autorëve të ndryshëm.

Veprimi proteoletik në urinë është konstatuar që me 1861 nga Brucke (cituar nga 10, 19) me 1887 nga F.A. Vasiljevski (2) dhe më 1890 nga V. Bruner (2) dhe u dyshua qysh atëherë për origjinën gastrike të këtij fermenti. Fermenti u quajt nga M. Mya (2) dhe S. Belfanti uropepsinë (cituar nga 10).

Për një kohë u mendua se ky ferment ndodhet në urinë si përzjerje e pepsinës dhe e pepsinogenit si p.sh. nga A. Ellinger, H. Scholtz më 1960 (cituar nga 10). Në të vërtetë uropepsina në urinë rezultoi ngritorë të tjerë si W. Sahli me 1895, E. Gotthieb, D.S.Jr. Belfour me 1894, E. Nadean me 1915, W. Peak më 1956 se ndodhet në formën e profermenrit «pepsinogen» (10).

Prezencia e pepsinogenit në formë profermenti u vërtetua eksperimentalisht nga A. Mirski, i cili duke injektuar pepsinogenin në rrugë endovenozë shkaktoi eliminimin e tij në urinë (cituar nga 10).

Në të është vetë pepsinogeni që eliminohet në urinë dhe jo ndonjë ferment tjeter me origjinë ekstragastrike kjo konfirmohet nga fakti se uropepsina në urinë zhduket pas gastrotomisë; N. Henning (cituar nga 9), R. Calcar, A. Frouin, C. Ful, Matthes, G.R. Bucherova, A.C. Ivy, E. Goitlieb H. Spiro, O. Gregor, K. Takeda, R. Bieling, D.C. Balfour (cituar nga 7). Nga ana tjeter uropepsina çdakuqet në urinë dhe kur kemi sëmundje të stomakut që çojnë në asnjësimin e të gjitha qelizave që prodhojnë pepsinogen siç janë disa forma të kansrit, gastrik dhe anemija perniczoze. Të këtij mendimi janë edhe autorët C. Podore, H. Janowitz dhe O. Gregor. (7).

Pepsinogeni siç dihet prodhohet prej celulave principale dhe simbas H. D. Janowitz, P. I. Hollander (cituar nga 10) afro 1% e tij kalon në gjak, kalon në renet dhe eliminohet me anë të urinës.

Kalimi i pepsinogenit në gjak mendohet se ndodh në stomak nga sasia e inkretuar prej celulave principale kurse sasia e ekskretuar prej tyre në kavitetin gastrik kthehet në pepsinë nga acidi klorhidrik dhe ushtron veprim proteolitik përmes tretjen e ushqimeve. Edhe M.N. Langly I. Grober dhe M. Iooper (cituar nga 7) mendojnë se sasia e pepsinogenit ose e pepsinës që shkon në duoden ose në intestin shkatrohet prej reaksjonit alkalin të këtij ambjenti.

Metoda që përdoret në shumë vënde është ajo e autorëve P.M. West, F.W. Ellis, B. L.

Scott e cila përdor si substrat qumështin e homogjenizuar. Metoda është si vijon:

Merret 2 ml. urinë e mbledhur prej pacientit në një kohë të caktuar dhe i shtohet 0.10 ml. HCl 2n dhe 0.05 ml. metiloranx 0.2%. Solucioni vihet në banjo Maria 370 për 60° dhe pastaj nga kjo urinë që përbën pepsinogenin të kthyer në pepsinë me anë të acidit kloridrik, 2n, merret 0.1 ml. i shtohet 0.9 ml. ujë të destiluar, 1.0 ml. pufer acetat me pH 4.6-G.D. Simbur-ejeve përdor 1 ml. pufer (19,20) ndërsa J.F. Greh dhe E.A. Gohnibov vazhdojnë të përdorin nga 1 ml. (8). Nga 1 ml. pufer përdorin edhe O. Kusakcoglu Osman Barlas dhe Jalcin Erketin (1). Më tutje shtohet 0.5 ml. qumësht të homogjenizuar dhe të përzjerë 1:1 me pufer acetat, shlypet sekundometri dhe matet koha deri në precipitinim e Kazeinës nga pepsina. Përbajtja e pepsitogjenit në urinë jetet me unitete në orë simbas formulës.:

$$U = \frac{1}{10} \cdot \frac{V}{vt} \cdot \frac{100}{T} \cdot 1.32$$

ku T është koha që duhet për prerjen e qumështit, v volumi i urinës së përdorur për "precipitum", V — volumi total i urinës së eliminuar nga pacienti gjatë një kohe të caktuar, t është koha në orë gjatë së cilës është mbledhur kjo urinë dhe 1,32 raporti ^x në letër logaritmike i rezultuar

në aktiviteti i solucionit pepsinë në koncentracione të ndryshme.

Në fillim në vend të substratit janë përdorur lende të ndryshme si lirrina nga Bruck (cituar nga 10,19) F.A. Vasiljevski dhe V.Bruner (cituar nga 10) edestina nga E.D. Iserson më 1914 dhe Gottlieb më 1925 (cituar nga 10) Pas luftës së dytë botërore M.I. Anson cituar nga (10) dhe G.R. Bucher më 1947 kanë propozuar hemoglobinën si substrat duke matur amineacidin tirozinë që gjithashtu gjatë veprimit të fermentit. Metoda u perfektionua më 1952 nga A. Mirsky më 1956 nga E. S. Hoar dhe I.R. Browning (cituar nga 10) duke u bërë e përshtatësime për të përcaktuar dhe profermentin në plazmë, por metoda e propozuar nuk gjeti përhapje të gjerrë përk shkak të teknikës së saj të koklavitur. Vetëm më 1952 F. V. Ellis, P.M. West, B.L. Scott arritën të zbulojnë duke përdorur qumështin e homogenizuar metodën që përdoret sot në shkallë të gjerrë dhe në laboratore të vogla pa qenë nevoja për reagentë të rrallë dhe pajisje të komplikuara dhe që është mjaft e saktë.

Kufijt e normës, shtrihen zakonisht midis 12-35 unitete në orë (13, 19, 20) në njëzit e rritur. Në të posalindurit pepsinogjeni çfagjet që në ditën e dytë të jetës (17); prej moshës 5 muaj deri në 3 vjeç lëkundet midis 1 dhe 5 unitete simbas Graeves (cituar nga 6). Simbas Koch dhë Beckman gjatë moshës shkollore sasia e pepsinogjenit në urinë arrin gradualisht atë të adultit (20). Në vajzat konstatohet një sasi më e vogël se sa në djemt (17).

Të dhenet e literaturës mjekësore tregojnë se në sëmundjen ulceroze veçanërisht në *ulcus duodeni*, vicerë paralelisht me shtimin e skresionit të lëngut gastrik dhe shtimi i pepsinogjenit në urinë: C. Podore më 1948, P. Mazure R. Webbe më 1956 (cituar nga 10) H.D.Janowitz, W. Sircus, S. Gray më 1954, M. Nowka, Aschner, A. Kamonik (cituar nga 7), A. Mirsky, Brob Kahn (19); L.P. Smirnov e konstaton në 56 raste (22), I.E Sofjeva në 36 raste (23), V. K. Karnaughov, gjen mezataren 46 unitete në 25 raste (19), G.D. Simbircjeva në 17 prej 29 rasteve në *ulcus ventrauli* dhe në 37 nga 47 me *ulcus duodeni* (21), O. Sizov në 25 raste në *ulcus duodeni* (21), O. Gregor gjen mezataren 35,1 unitete në 30 raste me *u. ventriculi* dhe 55 unitete në 10 raste me *u. duodeni* (7).

Në gastritet që kanë tendencë hypersekrecioni të lëngut gastrik shpesh ka dbe një shtim të pepsinogjenit në urinë. Kështu O.E.Sofjeva në 7 paciente me gastrit iperacide ven re se 4 prej tyre kanë mbi 44 unitete në orë (23), I. Smirnov konstaton shpesh me shtimin e pepsinës në lëngun gastrik dhe shtimin e pepsinogjenit në urinë në 68 raste me gastrit kronik dhe 21 raste me çrrëgullime nervoze të stomakut (22).

Në gastritet me tendencë të hyposekrecionit të lëngut gastrik konstatohet një ulje e eliminimit të pepsinogjenit në urinë. O.E.Sofjeva në 9 prej 12 rasteve (23); L.I. Idelson në 20 prej 24 rasteve (10) si dhe autorë të tjera si K.H. Karnaughov (12), H. Spiro (cituar nga 10), M. Vovsi (24) mendon se mungesa e pepsinogjenit në urinë mund të ndihmojë në diagnostikimin e akilisë.

Në *cancer ventriculi* konstatohet një ulje ose një mungesa e plotë e eliminimit të pepsinogjenit në urinë nga njaft autorë si p.sh.: Arias Vallejo (2) G.D. Simbircjeva në 16 prej 18 rasteve (19), O.G. Sizov në 14 raste (21), V. K. Karnaughov gjen 2-6 unitete në 3 prej 7 rasteve (3). Por rezultatet varen dhe nga shkalla e dëmtimit të celulave principale prej indit tumorali. Kështu autorë të tjera konstatojnë raste me sasi normale si p.sh. K. Strauss, R. D. Goodman (cituar nga 8) Sofjeva (23); J. Bondarski; në sasi të shtuar (cituar nga 8) ose pa paralelizim me përbërësit e lëngut gastrik si p.sh. : I. Lorthiori, C. Fossoul më 1957, (cituar nga 19)

Të dhëna të ngjashme në afeksjonet e stomakut konstaton edhe D. Kusakcegull (1).

Në *anemine pernicioze* konstatohet gjithashtu një ulje e pepsinogjenit në urinë nga E. G. Olmstead, I.S. Hisbeck më 1953, M. Aitken më 1954 (cituar nga 10), nga A. Mirsky, Podore, Brob Kahn (cituar nga 19), nga K.O. Janowitz, M. Levy, F. Hollander G.D. Simbircjeva e konstaton në 15 prej 16 rasteve (19). D.E. Sofjeva gjen 3.5 deri në 11 unitete në dy raste (23). L. Idelson në 3 prej 4 rasteve. Për tu vënë në dukje është mesatarja 2,01 unitete, në 131 raste të studjuara nga O. Gregor (7).

Në *hemorragjë profuse të stomakut*, ku nuk është i mundur as sondazhi gastrik as ekzaminimi radiologjik, eliminimi i pepsinogjenit është i shtuar në ulcer, normal ose i pakësuar në *cirrhosis hepatis* ose varice esofagiale. A. Batcu (2), S. Gray, N. Keller, C. Weiss (cituar nga 7) O. Gregor gjen në 20 cirotike me hematemezë mezataren 16.9 unitete dhe në një *uleus hemorrhagicus* 56 unitete kurse në varicet esofageale 9.2 unitete në orë (8). Në këtë perfundim arrijnë dhe autorë të tjera si W. Sircus, H. Spiro (cituar nga 7).

Mbas rezeksjonit të stomakut mund të ndiqet evolusioni postoperatoriv nëpërmjet përcaktimit të pepsinogjenit në urinë, sasija e të cilët pakësuhet mbas interventit (16) G.D. Simbircjeva gjen se prej 18 rasteve në 10 ulct në normë ose ndën normë (19). O. Sizov e gjen në 10 raste ndën 10 unitete por ka dhe përfjashtime. Karnaughov gjendet raste mbi 16-45 unitete mbas operimit. Sizov shtimin e pepsinogjenit në urinë mbas operimit e gjen në 15 raste dhe e shpjetoperimit.

gon në infektimin e anastomozës duke u krijuar kushte për një absorbim më të madh të fermentit (21).

Është interesant fakti se gjëndrat endokrine sidomos gjëndrat surenale influencojnë menjëherë eliminimin e pepsinogjenit në urinë meqënë se hormonet kortikosurenale dhe ACTH nixisin prodhimin e lëngut gastrik. Në të vërtetë injekimi me ACTH dhe kortizon ose prednizor shqerohet me shtrimin e eliminimit të pepsinogjenit në urinë: R. Beckman, F. Koch, S.J. Gray, S. Fitz (cituar nga 12) C. Ramsay cituar nga (19); I. Walter; I. Schwartz, M. Siler, E. Sofjeva në 16 nga 22 rastet (23). Prandaj M. Cachin, M. Coute, I. T. Freeman (23) rekoman dojnë përcaktimin e pepsinogjenit në urinë si test që mund të shërbejë për të prevenuar para kohe formimit e ulcerave «esteroidë». O.E. Sofjeva citen tre raste prej 22 pacientëve të injekuar me kortikoidë në të cilët nuk u ul pepsinogeni në orisë dhe pas ndërpërjes së injekuar midis katër të treve në njërin e qfaq hematemeza (23). M. Jancic e ven re mbas dhënies së 25 mg. ACTH se pepsinogeni në urinë shihet tre herë më shumë në rastet normale dbe 3-8 herë më shumë në rastet me shtrim të eliminimit të këtij fermenti në urinë (11).

Disa autorë si p.sh. I.B. Fritz, dhe S. J. Gray (cituar nga 10), I.V. Westfal (cituar nga 7) mendojcë që të vlerësohet ritja e pepsinogjenit në urinë mbas injektimit të ACTH si shënjë e ruajtjes zë funksionit të gjëndrës surenale dhe Ascher (cituar nga 7) e vlerëson njëjjo si testim i Thornit dhe ritjen e eliminimit të 17 ketosteroidëve mbas ACTH.

Shumë autorë si M.H. Slesinger, C. M. Lewis, M. Lipkin, Wierum cituar nga (23) H. Spiro, S. Gray, I.V. Westfal, W. Keiderling (cituar nga 7) vënë në çukje se në morbus Cushing sikur se në injektim me A.C.T.H. ekziston parafisihi shtrim i eliminimit të 17 oksikortikosteroideve të pepsinogjenit në urinë. S. Gray dhe Westfal (cituar nga 8) nga ana tjetër në M. Addison kostai, në përkohës paralel të tyre në urinë. Edhe në asimë bronkiale ku supozohet nga B.B.Kogan dhe të tjerë për hypofunksion të gjëndrave surenale, konstatohet ulje e urepepsinës (cituar nga 5).

Për shkak të shtrimit të pepsinogjenit në urinë H. Mogenia dhe F. Arrieta në sëmundjen ulcerose supozuan për një lidhje patogenetike midis një hyperfunkcionit të surenaleve edhe kësaj sëmundjeje por kjo nuk u vërtetua nga fakti se në shumicën e rasteve në ulcer nuk kemi një shtrim paralel të oksikortikosteroideve në urinë krahë me atë të pepsinogjenit siç vejnë në dukje M.H. Slesinger, C.M. Lewis M.Lipkin, Wierum (cituar nga 7).

Nga kjo nënkuptohet se ka dhe faktore të tjerë veç këtyre hormoneve që shfojnë eliminimin e pepsinogjenit në urinë.

I. Todorov cituar nga (6) ven në dukje se edhe në *diabetes mellitus* konstatohet një shtrim i pepsinogjenit në urinë. Shtrimi paralel në urinë dhe i hormoneve steroideve do të përbënte një argument tjetër në favor të rolit me rëndësi të hyperfunkcionit të hipofizës dhe të gjëndrave surenale në patogjencën e kesaj sëmundje me rëndësi të metabolizmit.

A.J. Frolova ven në dukje shtrimin e urepepsinës mbas injekimit me tiroidinë (3).

K.H. Karnauhov ven re shtrimin e pepsinogjenit mesatarish mbi 55 unitete në orë në *colitis ulcerоза*. Ky shtrim theksohet edhe më shumë gjatë periudhës së ekzacerbimit (12), R.J. Zeis referon se në fëmijt me diatezë hemorrhagjike ka ritje të urepepsinës në akutizim dhe ulje gjatë agravimit (25).

Ulja e eliminimit të pepsinogjenit në urinë është konstatuar edhe në fëmijt me *rachitis*, dbe distrofi (4,6,17).

Në sëmundje të tjera sasija e pepsinogjenit në urinë nuk tejkalon kufijt e normës në përgjithësi, në studimet që janë bërë nga autorë të ndryshëm. D.E. Sofjeva konstaton sasi normale në 15 nga 20 pacientët me *vitium cordis*, reumatizëm, pl. exudativ, infarkt miokardi, kapilarotaksikoze pa komplikacione renale (23). G.D. Simbircjeva (19) gjen sasi normale në pacjenjtë me nefrite dhe kolecistite.

Është e këshillueshme që në përcaktimin e pepsinogjenit në urinë të merret parasysh fakti se në pacientë me lejzone renale, nund të influencojnë në sasinë e eliminimit të fermentit gjëndja e funksionit ekskretor.

Përcaktimi i pepsinogjenit në urinë ndihmon për qëllime diagnostike. Për këtë mund të përmendohen dëshën e më poshtëme:

Ekziston një paralelizëm midis sasisë së pepsinës gastrike dhe pepsinogjenit në urinë (7,12,14). Ekziston një paralelizëm midis aciditetit gastrik dhe pepsinogjenit në urinë (12,13). V.K. Karnauhov e konstaton këtë në 34 prej 37 rasteve (12) dhe L.I. Idelson në 35 prej 45 rasteve (12). Është e natyrëshme që ky paralelizëm të jetë më i madh përsë i përkët pepsinës sesa përsa i përkët aciditetit gastrik sepse pepsinogeni në urinë rrjedh drejt nga pepsinogeni gastrik marrë «in situ».

Nuk mund të mohohet kursesi rëndësia diagnostike e dorës së parë të studimit të lëngut gastrik me anë të sondës sepse studimi bëhet direkt në përbërësitë lëngut gastrik që është marrë «in situ».

Metoda e përcaktimit të urepepsinës nuk mund të zëvëndësojë ekzaminimin e lëngut gastrik (23). Por dhe në ekzaminimin e lëngut gastrik të marrë me anë të sondës ekzistojnë një seri të metash.

Sondazhi gastrik është një manipulacion jo fiziologjik, procedura e sondazhit në

shumë njerës neuror neurolabile shoqërohet me një gjëndje eksitabiliteti të theksuar, me një gjëndje vështirësie në frysëmarrje dhe sensacioni të vjellash të cilat e bejnë ekzekutimin e tij të pamundur në disa raste. Veri i sonda shkakton një eksitim mekanik herë në fundus, herë në pylor dhe në pjesë të tjera të mukozës gastrike duke nxitor herë më pak herë më shumë, sekrecionin e langut gastrik. Sondazhi gastrik nuk mund të bëhet fare në rastet me hematemezë, në gjëndjet e kancerit të stomakut dhe të sëmundjes ulcerozë, në aneurizmat e aortës, në së-mundjet e rënda të zëmërisë dhe në sëmundjet e tjera të shoqëruara me stenozë të esofagut.

Nga ana tjetër, gjai i sondaçhit mund të takojë shpesh herë që të kemi një hiperskrecjon të mukusit ose një refluksi të biles dhe të lëngut duodenal rezultatin. L.I. Idelson citon 4 raste që kishin përbaltje acidiq kloridrik dhe të falsifikojnë rezultatin. L.I. Idelson citon 4 raste që kishin përbaltje normale të pepsinogjenit në urinë ndërsa në lëngun gastrik anaciditet dhe përsëritja e sondimit tregoi se anaciditeti kishte karakter funksional (10).

Sasia e pepsinogjenit në urinë sikurse dhe e lëngut kanë variacione nuktemrale dhe post-prandiale - siç vejnë në dukje O. Fodor (12), E. Gottlieb G.R. Bucherova, R. Morten (cituar nga 12) Por këto variacione për të njëjtin individ janë të vogla: G.D. Simbircjeva i gjen 1 deri në 5 unitete në ditë (19). Gjëndrat pepsinoprodhoni jë janë më shumë rezistente kundrejt eksitonjësve ekzogenë ose endogenë sesa gjëndrat që prodhojnë acidi klorhidrik (12). Mendohet se oshillacionet individuale të pepsinogjenit në urinë janë specifike për çdo individ (18).

Nga të dhënët e literaturës të paraqitura më lart rrëth natyrës, origjinës, ekskrimimit dhe percaktimit të pepsinogjenit në urinë dhe aplikimit të këtij testi në ulcus, gastrite, anemini per-nicioze, status postresectio ventriculi, gjatë mjekimit me ACTH dhe korriko steroidë etj. mund të nxirren këto:

KONKLUSIONE:

1) Përcaktimi i pepsinogjenit në urinë nuk mund të zëvendësojë ekzaminimin e lëngut gastrik të marrur me anë të sondës për diagnostikën e *ulcus duodeni* dhe sëmundjeve të tjera të stomakut, me gjithë anët negative që paragjet manipulacioni i sondaçhit.

2) Përcaktimi i pepsinogjenit në urinë nuk mund të kryhet pa qenë nevoja përpaisje të komplikuara.

3) Ay është një test jo traumatik dhe i lehtë për pacjentin.

4) Testi mund të përdoret me qëllim orjentonjës në vënd të ekzaminimit të lëngut gastrik të marrur me anë të sondës kur sondazhi nuk mund të ekzekutohet ose është i kundrainduar.

5) Duhet akoma studime të mëtejshme për të gjetur faktorët e ndryshëm veç hormoneve të hipofizës dhe të gjendrave surenale që çojnë në shërimin ose pakësimin e sekrecionit të pepsinogjenit gastrik dhe në eliminimin e tij në urinë.

LITERATURA

- Barlas O., Kusakcoglu O., Jalcin E. - Përcaktimi dhe vlera diagnostike e uropepsinogjenit PRESSE MEDICALE faqe 601, Nr. 11, Teme 72, 29 Fruer 1964).
- Bacu A. - Stratu C. - Rascu C., Popescu N. (Studii si cercetari de Biochimie Nr. 3/1963)
- Frolova A.J. - Përbaltja e uropepsinës në pacientët me tireotoksozë dhe sëmundje të tjera para dhe mbas mjekimit (ARHIV TERAPEUTIÇESKIJ Nr. 5/1964 faqe 68)
- Ganic O. - Mbi metodën e përcaktimit të uropepsinës (LABORATORNOE DJELLO Nr. 5/1963 faqe 42)
- Gluhenkij T.T. - Melnicki V.B. - Dinamika e ekskrimimit të uropepsinës në astma bronkiale (ARHIV TERAPEUTIÇESKIJ - Nr. 7 1962 faqe 40)
- Goldscmidt V.K. - Marganova A.M. - Niveli i uropepsinës në të posalindurit (LABORATORNOE DJELLO Nr 11/1962 faqe 51)
- Grecor O. - Mbi uropepsinën (KLINIÇESKAJA MEDICINA - Nr. 2/1958 faqe 51)
- Grem I.F. - Bognibov E.A. - Mbi modifikimin e metodës së përcaktimit të pepsinogjenit të propozuar nga G. D. Simbircjeva (LABORATORNOE DJELLO N 5/1963 faqe 41)
- Meilmeyer L. - Tratat de fiziotopatologie faqe 304
- Idelson L.I. - Përcaktimi i uropepsinës në urinë, një nga metodat e diagnozës funksionale të stomakut (ARKIV TERAPEUTIÇESKIJ Nr. 2/1958 faqe 52)
- Jançiq M. - Veprimi i ACTH në eliminimin e pepsinës (MED. GLAS. v. 1960 f. 406)

- 12) *Karnauhor V.K.* - Rëndësija klinike e përcaktimit të pepsinogenit (SOVJECKAJA MEDICINA Nr. 3/1959 faqe 79)
- 13) *Lempert M.D.* - Metoda të analizave biokimike Viti 1964 faqe 192
- 14) *Lesinkina L.* - Enciklopedija e madhe mjekore - faze 714 - Vol. 23 - Viti 1961.
- 15) *Mangenko I.* - Uropepsina në fëmijt e moshës shkellore (PEDIATRIJA Nr 7/1962)
- 16) *Martinov S.M.* - Simbirceva G.D. - Ekskretimi i uropepsinogenit në mjekimin e sëmundjeve ulceroze (KLINICESKAJA MEDICINA Nr. 2/1962 faqe 31)
- 17) *Okulova E.M.* - Sultanova L.E. - Vlerësimi i funksjonit sekretor të stomakut në eliminimin e pepsinës në fëmiji me rahiis (PEDIATRIJA Nr. 4/1962 faqe 58)
- 18) *Pjatnickij N.P.* - Mbi përcaktimin e pepsinogenit (LAB. DJELLO nr 5/1963 faqe 40)
- 19) *Simbirceva G.D.* - Rëndësija diagnostike e përcaktimit të uropepsinës (KLINICESKAJA MEDICINA nr. 2/1959 faqe 46)
- 20) *Simbirceva G.D.* - Edhe një herë mbi metodën e përcaktimit të uropepsinës (LABORATORIOJE DJELLO Nr. 3/1962)
- 21) *Sizov O.G.* - Mbi vlerën diagnostike të dozimit të uropepsinës në sëmundje të stomakut në klinikën kirurgjikale (LAB. DJELLO nr. 11/1962 faqe 45)
- 22) *Smirnov I.P.* - Mbi çeshtjen e vlerësimit të funksjonit pepsinoforjnës të stomakut nëpërmjet përcaktimit të pepsinës në lëngun gastrik dhe të uropepsinës në urinë në disa sëmundje të stomakut (TERAPEUTICKESKIJ ARHIV Nr. 5/1961 faqe 63)
- 23) *Sofieva I.E.* - Rëndësija e përcaktimit të uropepsinës në sëmundjet e stomakut (ARHIV TERAPEUTICKESKIJ Nr. 5/1961 faqe 65)
- 24) *Vovsi M - Geeter* - Zubanova - Enciklopedija e madhe mjekçore - faza 134, vol. 19, viti 1961)
- 25) *Zeits R.J.* - Ekskretimi i uropepsinës në fëmijë që vuajnë nga diateza hemorragjike dhe disa forma të anemive (PEDIATRIJA nr. 2/1962 faqe 18

KRITIKÉ E BIBLIOGRAFI

EKSPERIMENTE NË KAFSHË MBI ETIOLOGJINË E MELOPATISË

(Animal experiments on the aetiology myelopathy)

T. LEOCZKY, J. SOS, M. HALASY Budapest 1964

Punimi përbëhet prej 216 faqesh dhe ndahet në katër kapituj të mëdhenj. Seçili nga këta kapituj ndahet në nënkapituj dhe qdo nën kapitull në fund ka bibliografinë përskatëse. Libri filion me një hyrje, në të cilën autorët përshkruajnë me hollësi të dhënërat e literaturës mbi mielopatinë e njeriut, që nga punimet e para të Leichteim Nonnc, Sander, Weil dhe Davison, Balo, Juhasz dhe të tjerë. Ata përshkruajnë tipin fokal të mielopatisë, format marginale, cirkulare ose subpiale të degjeneracioneve në mielopatitë njerëzore si edhe format simtrike të degjeneracionit spongioz. Pastaj ndalet me hollësi mbi terminologjinë e mielopatisë.

Po né hyrje autoré përskriva jnë me Hollési tē dhénat bibliografie mbi miejopathie eksperimentale tek kafshét. Késhu p.sh. Winrobe et al. prodhoi nē derrat avitaminozé tē kompleksit B dhe si rjedhim tē periodiksinés dhe tē acidit pantotenik, duke fituar nē tē njéjtēn kohē demielinizm tē nervave periferik tē rrjenjéve posteriore dhe tē *funiculi posteriores* tē palcés kurrizore. Kurse Swank dha Adams duke prodhuar avitaminozé B₆ dhe tē acidit pantotenik arritén tē fitojnē demielinizm komplet tē funikujuve posteriorē tē palcés kurrizore dhe degjenerism tē nervave periferik. Den Hartog, Jager prodhuau nē kobejtē lezione tē theksuara (piknozis, satelitosis eti.) nē britrēt anteriore tē palcés kurrizore.

Mellamby, Gildea et al. fituan degjeneracion tek qentë nga avitaminozoë A. Zimberi si Gowgill dhe Fox observuan degjeneracione të membranave mielinike dhe të aksoneve si dhëzëvendësimi i gliasës ngrënat periferikë gjatë palçës kurriroze dësidomos para se gjithashu në *funiculi posteriores*, gjatë avitaminozës B₂ tek qentë. Sidomos tek minjë të dhënati patologjike janë fituan me një polimorfizëm dëshirueshueshëm shumë të madhe edhe atëhere kur simptomet klinike ishin mjaft të ngjashme si p.sh. humbja e peshës, ataksia, paralizat etj.

Në eksperimentet me minjtë duke shkaktuar avitaminoze B_1 , B_2 ose B_3 komprimit rezultate. Në nervat periferikë katër autorë ose nuk gjetën ndryshime patologjike, ose gjetën pak. Tre kërkimtare përshtuajnë hemoragjite dhe ndryshime neuronike në trunkun cerebral, në trurin e vogël, dhe në palcën kurrizore; tre autorë të tjera nuk gjetën asgjë. Church nuk gjieu asgjë në nervat periferikë, por gjeti ndryshime ne aparatin vestibular. Kurse në palcën kurrizore vetëm Davison dhe Stone kanë observuar prishje të membranës mielinike dhe në disstrukte një strukturë të ngajshme me atë spongiozen. Por ato i konsiderojnë këto ndryshime të diskutueshme.

Zimmerman prodhoi ndryshime si në nervat periferike ashtu që n'e palcen e përmjet avitaminozës A. Einarson dhe Ringstef gjetën degjjeracione spongioze të ngajshme me ato të m'elopatisë, degjeneracion të nervave periferike dhe degjeneracion të muskujve gjat avitaminozës E. Po ashtu mjaft interesante janë eksperimentet e Ferraro dhe të Lumsden me cianur të potasiumit. Ferraro observoi demielinizim në lëndën e bardhë të trurit dhe në palçen kurizore në macet dhe majmunët eksperimentale, kurse Lumsden përshtikuara degjeneracion spongioze dhe demielinizim në lëndën e bardhë të trurit, sidomos në *corpus callosum* të minjve rreth 10 vjeçare. Dëshironi te referuar mbi mielopatisë njërezoresh dhe atë

Autorët, mbas eksperimentit të tij dhënave të literaturës mbi mielopatiqë gjerezore të kafshëve përshtuan 19 seritë e eksperimenteve të bëra në minjtë e bardhë duke shkaktuar turbullime gastrike ose avitaminozë B₁, B₂, H, E, duke përdorur substancë neurotoksike siç janë alkooli, tetrakloruri i karbonit, fosfori, sulfamidet. Ato gjithashtu përshtaujnë eksperimentet e tyre dhe nryshimet përkalojnë në medulla spinalis e disa herë në organet e brendëshme dhe në trurin e madhi duke shkaktuar diabet me *alloxan* ose *dithizone* ose me lëndë të tjera metabolike për shembull me acid antiglutaminik, me tiroksinë me acid diklorofeno-oksiacetik. Ata

gjithashu në seri të tjera minjsh prodhuar latirizmin eksperimental me anën e *lathyrus oleratus* dhe beta - aminopropionitril.

Në të gjitha këto seri eksperimentesh, autorët i vunë vetes si detyrë kryesore që të studjojnë ndryshimet e shkaktuara nga lëndët e përmëndura më sipër në *medulla spinalis* megjithëse ata disa herë s'kanë munguar të studjojnë edhe ndryshimet në organet e brendëshme në cervebrum dhe në cerebellum.

Meqënësë dhet që sistemi gastro-intestinal luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mielopative dhe të neuropative, autorët eksperimentet e tyre të para i bënë për të vënë në dukje rëndësinë e këtij sistemi në zhvillimin e mickopatisë. Për këtë qëllim ato u ekstirpuan dhjetë kafshëve eksperimentale mukozën e stomakut në pesë nga ato u zhvilluan fenomene degjenerim spongios si dhe degjenerim i motoneuronave të *medulla spinalis*. Në një grup tjetër eksperimentesh ato deshën të hedhin drithë në rolin e vitaminave në shkaktimin e lezonave spinale. Përkëtë arsyse ata shkaktuan avitaminozë B_1 , duke i privuar kafshët eksperimentale nga vitamina B_1 në ushqim, kurse në disa eksperimente të tjera ato fituan hipovitaminozë P e cilë duket se luan një rol të rëndësishëm në fosforilimin e vitaminës B_1 , dhe në mënyrë indirekte në a vitaminozën B_1 . Në një grup tjetër kafshësh eksperimentale avitaminoza B_1 u kombinua me ekstirpacionin e mukozës gastrike dhe në një tjetër me ate të P -së. Mielopatia u fitua në të gjitha grupet dhe ndryshimet më të theksuara u vunë re në grupin ku ishte bërë ekstirpacioni i mukozës gastrike plus avitaminozë B_1 si dhe në grupin e avitaminozës B_1 + avitaminozës P .

Më këtë grup eksperimentesh, autorët vunë në dukje rolin e madh që lot trakti gastrointestinal si dhe vitamina B_1 dhe fosfori për organizmin.

Roli i vitaminës B_2 u studjuan nga autorët nëpërmjet të intoksikacionit me acid monoiodoacetik nga të katërmëdhjetë kafshët eksperimentale, tek gjashtë u vu në dukje një mielopati e theksuar.

Një grup tjetër eksperimentesh, u bë me avitaminozo nga biotina (vitaminë H) Nga 32 kafshët eksperimentale, tek 19 i vunë re ndryshime karakteristike për mielopatinë. Përveç ndryshimeve në *medulla spinalis* u vunë re ndryshime edhe në tërë sistemin nervor qëndror.

Në grupin e avitaminozës E në gjysmën e kafshëve eksperimentale u takuan ndryshime karakteristike për mielopatinë përveç motoneuroneve spinale, në disa raste u gjetën ndryshime edhe në qelizat ganglionare kortikale. Nga 14 minjtë e intoksikuar me alkool në 6 u vunë re ndryshine të palces kurrirore kurse qelizat nervore spinale dhe kortikale qenë të degjeneruara në të 13 kafshët eksperimentale.

Në intoksikacionin kronik me tetraklorur të karbonit në dy nga dhjetë kafshët eksperimentale u vunë re mielopati kurse në të gjitha kafshët u vunë re ndryshime të qelizave nervore në palces kurrirore, korteksin dhe trunkun cerebral. Ai gjithashu dha ndryshime në organet e brendëshme dhe nekrozë të pankreasit.

Në intoksikacionin me fosfor u vunë re mielopati në gjysmën e kafshëve eksperimentale kurse në çdo rast pati degjenerimi të theksuar të qelizave nervore spinale si dhe degjeneracioni në organet parenkimatoze më shpesh në hepar.

Intoksikacioni kronik me sulfanilamide dha ndryshime të theksuara në organet e brendëshme dhe në katër nga njëmbëdhjetë kafshët eksperimentale degjeneracion të palces kurrirore. Leziona në trurin e madh dhe në trunkun cerebral. Në tre rastet demielinizimi i palces kurrirore ishte i karakterit spongios. Përveç këtyre autorët kanë shkaktuar dhe një varg mielopatish të tjera. P. sh. në katër nga nëndë kafshët eksperimentale u gjetën ushqyer me *lathyrus sativus* dhe beta - amino - propio - nitrile e në grupin e parë nuk u gjetë degjeneracion spongios, në tre kafshë nga grupi i dytë, u gjetën leziona degjeneracion spongios, kurse demielinizimi i trakteve posteriore u observuan në dy raste të grupit të parë dhe në 7 të grupit të dytë. Në intoksikacionin e 35 kafshëve eksperimentale mu triortokrezilfosfat, u vu në dukje se ky është një helim jo vetëm për mielinën, por edhe për neuronet. Kështu në katër nga ato u vunë re mielopati, kurse në gjysmën e rasteve degjeneracion i theksuar në neuronet spinale dhe kortikale.

Në gjashtë kafshë eksperimentale dha dhjetë të tjera u shkaktuan diabet eksperimental me aloksan dhe ditizon. Në katër nga 16 kafshët eksperimentale u observuan ndryshime në palces kurrirore. Në eksperimentet për hipertireoidosis duke dhënë tyroksinë në nëndë kafshë eksperimentale u takua mielopatia në dy raste, kurse ndryshimet në qelizat nervore në shkallë të ndryshme u vunë re në tërë raste.

Shitë minjje ish dha acidi antiglutaminik, tre uga ato u trajtuan me acid p-nitro-benzoil-glutaminik, kurse katër me acid disulfuror alfa-tiopropionik për të produhuar deficencë të acidi glutaminik. Vetëm në dy kafshët të trajtuar me lëndën e fundit u vu re mielopatia.

Në tëtë kafshë eksperimentale u dha acidi 2,4-diklorofeno-okso-acetik. Nuk u vunë re fenomene të degjeneracionit spongios, por vetëm demielinizimi evident në traktet posteriore aterale dhe anteriore të palces kurrirore të dy kafshëve.

Kështu pra autorët me një varg eksperimentesh, duke aplikuar substancë të ndryshme neurotoksike dhe duke shkaktuar avitaminozën u përpqoën që të studjojnë ndryshimet patologjike dhe të thellohen në mëkanizmat patogjenetike si dhe etiologjike të mielopatitës eksperimentale për të hedhur drithë në këtë mënyrë në mielopatitë njerëzore.

Në faqen 208 dhe 209 autorët midis të tjerave vejnë në dukje se «për më të shumtën e inter-

vencioneve të përdorura nga ata, dhe pikërisht për ekstirpcionin e mukozës gastrike, deficiencës p - intoksikacionit të acidi mono-jodo acetik, deficiencës së biotinës, intoksikacionit me tetraklorur të karbonit, intoksikacionit p-, intoksikacioni me sulfanilamide, diabetit eksperimental hipertireoidozës eksperimentale, trajtimit me acid antiglutaminik dhe acid diklorofenoooksiacetik, na ishim të parët që të shkaktonim sëmundje të *medulla spinalis*. Në të vërtetë së paku përsa i përket intoksikacioneve sulfanilamide, edhe autorë të tjera përpara tyre kanë arritur të vejnë re në kafshët eksperimentale ndryshime të *medulla spinalis*.

Më në fund, vlen të thikesohet se ky punim është i paraqitur me një gjuhë mjafë të qartë, i ilustruar me kishë të pasura dhc i dokumentuar mjafë mirë. Ai gjithashtu është i argumentuar me të dhëna mjafë të pasura eksperimentale dhe bibliografike. Për të gjitha sa u tha më sipër, kjo monografi është një kontribut i mirë eksperimental në fushën e mielopative, të cilat vazhdojnë endë të kërkojnë spjegime dhe interpretime më të thella për mekanizmat e tyre intime.

Doc. B. Preza

RËCENSION OF THE BOOK OF T. LEHACZKY M. HALASY
J. SOS

«*Animal experiments on the etiology of myelopathies*» – Budapest 1964.

This book, in 216 pages and 4 chapters, presents the data published in the medical literature on the subject of study of the authors and describes the focal type of human myelopathy, the circular meningeal forms of degeneration. After that it describes a voluminous experimental work done by the authors on laboratory animals.

RECENSION

i monografsë «*Trichophyton violaceum*» (Bodio 1902) të Prof. P. PINETTI,
nga shtëpia botonjëse Rassegna Medica, në Cagliari, 1962.

Në veprën e tij Prof. P. Pinetti, që asht drejtë i klinikës se dermatologjisë che i qendrës së studimeve mykologjike të Universitetit të Cagliarit, fregon se asht jo vetëm një njoftës i thelli i mikologjisë, por edhe një kërkues në këtë degë të dermatologjisë. Me studimet e tijë ai ka mbërëtë në disa konkluzione mbi infeksionin parazitar të lëkurës. Ky libër që ka 348 faqe, asht ndam në disa kapituj dhe në shumë nënkapituj, ku trajtohen probleme të ndryshme të infeksionit nga paraziti *tric. violaceum*. Materiali asht paraqitë me një gjuhë të kuartë dhe të kuptueshme. Libri asht i illustruem me shumë figura të bukurë dhe të karta, me gjithse janë pa ngjyrë. Për çdo kapitull, autori ka dhënë bibliografinë, e cila asht e autorëve të shteteve të Europës perëndimore dhe anglo-amerikane. Bibliografia në përgjithësi asht shumë e pasur, gja që ia ngren edhe ma tepër vlerën veprës, por mendojmë se do t'i shtohej vlera akoma ma tepër po të ishin konsultuem edhe autorë të vendeve socialiste.

Autori, në këtë veprë me rëndësi të veçantë për mykologjinë, ka bamë një studim të gjithështimës të *trch. violaceum*, i cili gati në të gjithë botën përmban specien ma të shpeshtë të fisit të trihofytoneve. Për më e barnum veprën e tijë sa më të plotë, autori nuk asht kufizuar vetëm me klinikën, ekzaminimet mikroskopike dhe bakteriologjike të këtij trch. por ka prekë edhe problemin e patogenezes, epidemiologjisë dhe të mjekimit.

Në qoft se do t'i vihej si detyrë dermatomykologjise studimi dhe botimi i të gjitha specieve dhe fisave të këpurdhavë parazitarë, në radhë të parë duhet të studjohej kjo specie, të cilën autori e ka kryemë dhe i ka mbërritur qëllimit ma së miri.

Përsë i përkert epidemiologjisë, autori flet për rëndësinë e formave kronike të trihofitës, sidomos të trihofitës kronike të kokës në të rritur. Me sa duket, ai nuk ka patun rast me vërejtje shumë të sëmuarë me këtë formë, prandaj ma tepër rëndësi i ep infektimit të thonjve për përbajjen e këtij infeksioni në fëmijë.

Trch. violaceum asht izolue për herë të parë nga R. Saboeraud në vitin 1892, në Paris, i cili i është emrin «*Trichophyton à culture violet foncée*». V. Mibelli në vitin 1895 e zbuloi në Parmë dhe e quajti «*Trichophyton à culture rosso-violetta*». E. Bodin e zbuloi në Amerikën e Veriut në 1902 dhe i është emrin që zbulan edhe sot «*Trichophyton violaceum*».

Autori asht marrë me studimin e kësaj specie të fisit të trihofytoneve, me qenë se në vendin ku ai punon (Sardënia), ky parazitë konstatohet ma shpesh (50%, 1941-1959).

Materiali patologjik i mbjellun në terenin, Saburo, fillon të mbijë mbas 4-5 ditëve dhe kolonia arrin zhvillimin e sajë të plotë mbas 45-50 ditëve. Në fillim kolonia ka ngjyrë të bardhë gri ose të bardhe-në të verdhë, por shpejt fillen të marri ngjyrën e kuqe-violet ose si purpur. Ngjyra e kolonive të zhvilluene komplet asht violet, prej nga ka marrë edhe emrin, por kjo ngjyrë mund të ketë nuanca të shumta tue fillue prej violet e zhet deri në violet-bojë qëllë, violet të errët. Shpesh periferia e kolonië mund të marrë edhe ngjyrë të bardhë në të verdhë. Në koloni mund të ketë edhe zona pa pigment, të cilat rriten ma shumë.

Kolonia ka konsistencë të fortë. Sipërfaqja asht e ndame në shumë brazda të thella apo superficiale, të drejtë apo ma shpesh zig-zage, prandaj ajo paraqitet me protuberanca të vogla ose gryuse të holla. Kulturat e reja (5-10 ditë) mikroskopikisht paraqesin mycelia të holla, të gjata, të gërshteturme, me majë të trumullakët që ngandonjëherë janë të fryeme si shkopat e trumpetës. Kolonië e vjetra kanë mycelia me shumë nyje afér njena tjetrës, me madhësi të ndryshme. Myceliat janë zakonisht të shkurtëna, në formë të cregullit. Citoplazma e tyne është e granuluese me pigment ngjyrë roze-violet. Sporulimi asht i tipit endokonidie, nga formohen mikrokonidjet.

Për zhvillim ma të mirë të koloniive asht vlerësue temperatura 25-370 (Paldroch H.), Szulmeister thotë se temperatura nën 17 dhe mbi 30° asht absolutisht e pa favorshëm për zhvillim.

Ndërmjet *trch. violaceum* dhe disa bakterieve che mycetave të tjera, zhvillohen relacione të ndryshme, të cilat stimulojnë apo inhibojnë njena tjetrën. Moszhvillimin e pyokoake të zakonshëm, Uri dhe Poljada e shpjegojnë me prodhimin nga myceteve e një substance antagonistë. Catanei, Falchi thonë se shpesh zhvillohen *micrococcus pyogenes aureus*, i cili inhibon disa dermatofyte. Catanei ka konstatuar se kur zhvillohet ky mikrokop, kolonia e *trch. violaceum* rritet ma keq, kurse Pinetti dhe Contini kanë dokumentuar eksperimentalisht ekzistencën e një antagonizmi midis tyne. Dostrowsky dhe Raubitschek kanë mbjellë afér njena tjetrës kultura të *trch. violaceum* dhe *trch. schenckii*, dhe kanë konstatuar se i pari ka vepru si anta-

gonist nē tē dytin. *Trich. violaceum* nē këtë mënyrë vepron edhe nē *epidermophyton floccosum*, *trich. megnini*, *tonsurans* si edhe nē atë vetë (Vilanova dhe Casanova Ceppo). Filtratet e *aspergillus clavatus* kanë dhanë efekt fungistatik dhe fungicid nē *trich. violaceum* (Loewenthal), kurse nē *trich. tonsurans*, *schoenleinii*, *mcr. canis* dhe *epid. floccosum* ka aktivitet ma modest (Spada). Nga *trich. violaceum* nuk kanë nxjerrun ndonjë substancë me veprim antibiotik.

Përhapjen e *trich. violaceum* autor i lidh me konditat hygjeno-sanitare, klimaterike, të ushqimit (nungesa e proteinave die e vitaminave) me infeksionin kronik nē familijs (nē thonj apo nē kokë), me grumbullimin dhe dendösini e popullsijet etj. Wanbreuzeghem ka folua përmundësinë se toka asht nji rezervuar i madh, nga e cila nisen dhe nē tē cilën rikethchen tē gjithë dermatofytet. Për këtë arsyë ai thot se krahas originës humane dhe zoofile mund tē jetë edhe një origjinë geofile (toksore) e dermatofyteteve. Megjithë janë izoluar nga toka edhe dermatofyte tē tjera, *trich. violaceum* nuk kanë mundun me e kultivue asnjë herë.

Autori sjell përqindjen e morbozitetit nga *trich. violaceum* nē shumë qytete tē ndryshme. Po sjell disa prej tyre: Roma 40%, Cagliari 50% (1941-59), Paris 75% (1957), Lavonio (Belgjikë) 69% (1957) Beograd 95% (1950), Tuzla 62% (1956), Sofia 70% (1928), Bukuresh 80% (1959), 90% (1960), Athinë 77% (1937), 93% (1939).

Zhvillimi i infeksionit nē lëkurë ashtë i lidhun me aftësinë keratofile tē parazitit, por ky kocept ka fillue mos me i qëndrue zbulimeve tē reja. Kufizimi i infeksionit nē qelizat e vdekuna apo nē ato qē kanë pësue ndryshime tē mëdha, mund tē tregojë se, nē mungesës tē aftësise së tyc me reague, ata kanë mundësi dhe gjiejnë teren me q̄ zhvillue dhe me u shthue pa u përhap nē qeliza më tē thellë, me aftësi vitale tē theksueve. Për këtë arsyë flasin jo për keratofili, por për «necrofili». E lidhim këtë edhe me prezencën e *hydrossiproline* nē qelizat e thellës, tē gjalla dhe me mungesën e saj nē qelizat e vdekuna (Pinetti, Lostia, Scheffer ctj.). Autori i librit mendon qē nga njena anë parazitët kanë tendencë me penetruar thellë, kurse nga ana tjetër celulat e reja kanë tendencë me u ngjift nalt dhe jashtë. Në saje tē këtyre dy forcave tē kundërtia infeksioni qëndron nē nji vend tē caktuem.

Mënyra e infeksionit simbas Kligman A.M.: Faza e I-të - faza kutane e pastër; faza e dytë - faza folikulare, stadi ekstrapiliar; Faza e II-të - faza folikulare, stadi intrapiliar; Faza e IV-të - faza pilare, stadi i invazionit; Faza e V-të - faza pilare, stadi i artrosporieve; Faza e VI-të - Faza e evolutonit.

Infektohet më shpesh mosha nga 6-10 vjeç, më shumë meshkujt. Kur autor i flet për format klinike, ndalohet edhe nē atë formë tē trihofilisë qē shkaktohet nga *trich. violaceum* varianti decalvans (Castellani, 1913). Kuadri makro dhe mikroskopik i këtij variantit nga ana bakteriologjike është identik me atë tē *trich. violaceum* Klinikisht konstatohen rallime definitive tē flokëve, cikatrice tē vogla tē diseminuese, deskuamacion dhe flokë tē këputun nē periferi tē vatrave qē kanë pësoen ndryshime atrofike-cikatriciale. Castellani e ka konstatuar shpesh nē Hindi tendencë për cikatrizim tē trihofilisë superficiale tē kokës, sikurse edhe Ota nē Kinin Qëadore (1929) Kjo është theksue edhe nga Acton dhe McGurie. Carroso (Portugali) përkruan një rast me alopeci totale tē kokës tē cikatrizuer, e shkaktueme nga *trich. violaceum* tek nji fémén 54 vjeç. Ballabanov dhe Ncves sjellin observacione tē ngjashme.

Autori konsideron terenin e Georg, Ajello dhe Gordon ma tē mîrë për deprimin e mykove tē huej dhe tē baktereve. Ky teren përbënban: Glukoza 10 gr., Clorur tē sodës 5 gr.m, Pepton 5 gr., Agar 20 gr., Ujë tē destiluar deri 1.000 cc. Mbës sterilizimit shtohet Penicilinë 40 UI/cc, streptomycinë 40 gamma/cc dhe cikloeksimidë 0.1 - 0.5 mg./cc.

Infekzioni i shkaktuar nga *trich. violaceum* ashtë ma rezistente se infeksionet e tjera nga mjeqimë me reze Rontgen, Degoz e bashk. kanë pasë sherim me grizeofulvin 90%. Rezultate analoge kanë referuar Desai, Grin, Nikolau. Midana dhe Zina kanë pasë rezultate tē shkel-qyeshme tue e përdorë nga 20-40 mlg./Kg. për 1-4 muaj., sikurse edhe Rinaldi që e ka përdorur 500-700 mg. nē ditë për tre javë.

Grizeofulvina është gjetë nē shtresat korneale, ku arrin nga lëvizja e qarkullimit tē celulave epidermale (Gentles e bashk.). Ky autor ka ekstraguar ma tepër se gjysmën e sasisë së grizeofulvine tē vendosun nē flokë (5-6 gamma për 1 gr. flokë), me ujë tē nxehjtë. Kjo flet për depozitim e thjeshtë dhe jo për kombinimin e sajës kimik nē flokë. Grizeofulvina ka veprim mykostatik dhe ndryshimet nga ajo janë reversibël. V

Vepra ka nji interesë praktik dhe shkencor për dermatologët tonë, sidomos për mykologët, sepse do tē ndihmojë nē punën e tyne tē përditëshme.

M. Caridha

RECENSION OF THE MONOGRAPHY OF PROF. P. PINETI «TRICHOPHYTON VIOLACEUM», PUBLISHED IN CAGLIARI - 1962.

In this monography, of great importance to mycology, the author studies the most frequent species of the agents of trichophytia. He analyses the clinical picture, the microscopic and bacteriological diagnosis the epidemiology and treatment of the affection. In this work the author has realised completely his purpose and has given a very valuable help to student of dermatology

LAJME NGA SHTYPI I HUAJ

COR PULMONAL KRONIK NGA EMFİZEMA: SHENIME TË FIZPATOLOGJISË DHE TË TERAPISË.

Pino G., Anfossi F., Veronesi G., Martinetti L.
Minerva Medica 1965, 56, 3-4, 53.

Me zhvillimin që kanë marrë kërkimet funksionale të sistemit kardiorespirator, kanë bërë që të përcaktohen disa aspekte karakteristike të insuficiencës së këtyre sistemeve.

Autorët thonë se duhet të diferencohet kor pulmonal kronik parenkimal, sekondar, nga kor pulmonal vaskular si rezultat i lezioneve primare të vazave pulmonare.

Kardiopatia pulmenare kronike e cila vjen si konseguencë e shtrimit të rezistencës së flukosit të gjakut në qarkullimin pulmonar, bën që të shtohet puna mekanike në ventrikulin e djathës dhe si rezultat të hipertrofizohet muri i tij. Kështu shkaktohet një shtrim i presionit në arterien pulmonare.

Këto ndryshime shikohen në shumë sëmundje ndërmjet të tjerave në emfizemën pulmonare, fibrozën pulmonare, fibroza intersticiale, bronkiti kronik etj.

Emfizema pulmonare është pneumopatia që të con më shpesh në kardiopati pulmonare, kështu sipas Sodemann 60%, Spatt e Grayzel 68%. Emfizema pulmonare shkakton një insuficiencë respiratore si rezultat i pakësimit të shkëmbimit të oksigjenit dhe gazit karbonik midis alveolit dhe gjakut.

Më poshtë autorët thonë se evolacioni i kor pulmonar bëhet në shkallë të ndryshme, prej të cilave në shkallën e pestë hipertensioni pulmonar është ireversibël.

Terapia e kor pulmonar mund të përmblidhet në:

1 - Terapi antiinfekcioze e vijave ajrore: kjo është më kryesorja dhe konsiston në zhdukjen e shkakut që bën një pakësim të ventilacionit pulmonar. Për këtë është i domosdoshëm përdorimi i antibiotikëve të cilët mund të përdoren dhe në formë aerosoli. Përdoret gjithashtu terapia antiflogjistike me kortikosteroide sidomos në ato që shoqërohen me bronkospazma dhe akcese të rënda të astmës.

2 - Terapia broncodilatatore: ka efekt mukolitik. Kështu mund të përdoret tritonit që ul tensionin superficial. Kurse substancë me veti bronkospazmolitike është izopropilnoradrenalinë.

3 - Terapia respiratore: kjo përmirëson respirationin alveolar, favorizon oksigjenimin, ndihmon në eliminimin e gazit karbonik, duke evituar acidozën respiratore. Respirimi i oksigjenit me presion inspirator është pjesërisht efikas në emfizem, dhe kjo lën që të përdoret oksigjeni në koncentracione të ndryshme. Aplikimi i oksigjenit shkakton një shtrim imediat të saturimit të hemoglobinës me mundësinë e çirrimit të oksigjenit në inde, përmirëson proceset oksiduese të muskulit kardiak, modifikohet refleksi vazokonstriktor pulmonar nga hipoksia me paksim të hipertensionit. Ndryshme viven re dhe në rene, ku nga aplikimi i oksigjenit komi një diurezë të bollëshme.

Autorët të ndryshëm kanë përdorur preparate si Micoren, Romeflia të cilat tolerohen më mirë kur përdoren gutta-guttë intra venë dhe bëjnë që të mbahet qëndra respiratore nën efektin e stimulacionit për një periudhë më të gjatë.

4 - Terapia e hipertensionit pulmenar dhe e dekompensimit të zemrës: acidi nikotinik influencon në qarkullimin pulmonar. Digitalisi pak modifikimi jep mbi ngarkesën e zemrës së djathës. Salasio nuk pakëson volumin në minutë por përdoren për të pakësuar vizkozitetin e gjakut. Përdoren diuretikët si Diamox, acetazolamidet etj.

Rëndësi në kardiopatitë pulmonare ka dhe profilaksia e sëmundjeve të aparatit respirator.

Margarita Vullkaj.

MBI DISA TREGUES FUNKSIONAL TË GJENDJES SË HEPARIT GJATE INFARKTIT TË MICKARDIT.

Salimon F. L., Bjellous S. R., Usvatova I. Ja. Kliničeskaja medicina. 1964. 7,109.

Gjatë infarktit të miokardit lindin dëmtime serioze dhe të ndryshme të proceseve të metaboliqit. Hepari si një nga pjesmaraçit kryesorë të proceseve të metabolizmit, nuk mund të ndodhë i intact gjatë këtij procesi.

Në infarktin akut të miokardit hepari sikurse dhe miokardi dhe veshkat ndodhen në gjendjen e hipoksisë. Scile vrejtë gjatë kësaj zhvillimin e nekrozave në hepar. Plioc, Evans e lidhën dëmtimin e funksionit të heparit gjatë infarktit me faktorin stres. Ndërsa të tjerrë e shpjegojnë me infarktin kardiovaskulare, me fenomenet e stazës në hepar.

Autorët vrejtën 37 të sëmûrë me infart akut të miokardit, në moshë nga 30-70 vjeç që ka vuanin më përparrë nga moshët e heparit. Tek të gjithë diagnosta ishtë konfirmuar me elektrokardiogram. Tek 31 të sëmûrë u ekzaminua bilirubina në gjak dhe urobilina në urinë. Në 10 prej 31 kishte fenomene të insuficencës kardiakë. Krahas ngritjes së temperaturës dhe leucocitezës u vrejt dhe ngritja e biliрубinës dhe urobilinës në urinë. Në ditën e 7 dhe të 9 me uljen e temperaturës dhe zhdukjen e leukocitezës u arrit normalizimi i nivelit të bilirubinës në gjak dhe atëherë kur fenomenet e insuficencës kardiovaskulare ruhen.

Sipas opinionit të autorëve hiperbilirubinemia mund të shpjegohet jo vetëm me stazën në hepar pse shënjat e hiperbilirubinemisë shihen dhe në infarktin e miokardit me fenomene të insuficiencës kardiovaskulare. Nuk përjashtohet dhe mundësia e hemolizës gjatë prezencës së vatrave nekrotike në miokard. Por për mungesën e saj flet sasia normale e retikulociteve. Autorët mendojnë se dëmtimi i funksionit pigmentar të heparit në periudhën akute të infarktit mund të spjegohet si rezultat i hipoksisë së heparit që zhvillohet në kuadrin e një stresi.

MIEKINI I INSUFICIENCIAS RENALE AKUTE

Kullakov B. P.

Klinicheskaja medicina 1964, 8, 64

Insuficiencia akute renale më shpesh lind si rezultat i dëmtimit të kanaleve dhc indit intersticial renal. Më shpesh insuficiencia renale zhvillohet si rezultat i shokut ose i vepërmeve toksike të shkaktuara nga agjentë të ndryshëm. Dekursi klinik insuficiencës akute mund të ndahet në katër perioðe:

cen akute (shok, hemolizé, intoksikación, inieksion et.).
Periudha e oligurisë, anurisë.
Periudha e rivendosjes së diurezës, ku ndodh jo vetëm nxjerrja e tepert e ujrave por dheri.

Periudha e rivendosjes së diurezës, ku ndodh jo vetëm rryshja e veshes, por edhe rritja e përpjekjeve mund të zhvillohet hipokalemia.

humja e elektrolitëve, në të cilën mund të zhvillohet hipokalemia.

Periudha e shërimit.

Tek tē sēmūrēt me sepsis post abort që shëqërohen me anuri duhet të apikohen serum antiangrenoze, antibiotikë, kryesisht penicilinë. Gjatë hemolizës intravazale që zhvillohet shpejt duhet tē bëhet transfuzion i gjakut i cili ndihmon në largimin e shokut, në doza të mëdha 4-5 litra. Gjatë mungesës së hemolizës duhet tē bëhen sasira të vogla gjaku për të stabili-

zaar anemini. Në ato raste kur nuk largohen fenomenet e kolapsit rezultat jep aplikimi i noradrenalinës me glukoza guta gut.

Sipas rastit që çon në insuficiencën renale bëhet lavazhi i stomahut dhe futja e antidotit gjatë helminut me kripa të metaleve të rënda.

Gjatë insuficiencës renale akute rëndësi ka dëmtimi i sistemit qarkullues renal. Për këtë qëllim duhen aplikuar mjete që përmirësojnë qarkullimin e gjakut. Disa autorë propozojnë dekapsulimin e veshkës se me këtë metodë uilt prestoni intrarenal dhe përmirësohet qarkullimi i gjakut. Të tjerë mendojnë futjen e sasisë të mëdha të solucioneve kripore me qëllim që të stimulolet diureza nga njera anë dhe të trojet substanca toksike nga ana tjetër. Në kohën e sotme është treguar reziku i kësaj metode në lidhje me zhvillimin e edemës së trurit, pulmos nare etj. Ulja e proteinave të karbolizmit është një prej detyrave në mjeqimin e insuficiencës akute renale, prandaj të sëmurëve u jipen ushqime që nuk përbajnë proteina.

KOMPLIKACIONET GJATË MJEKIMIT ME KORTIKOSTEROIDE

Shulcye G. P.

Kliničeskaja medicina 1964, 8, 145.

Dihet efekti i lartë farmakologjik i kortikosteroideve gjatë shumë formave të sëmundjeve, por krahas me këtë njihen fenomenet anësore, komplikacionet dhe efekti negativ i kësaj terapi. Autori përshtruan shkurt komplikacionet gjatë terapisë së zgjatur me kortikosteroide. Sipas çfaqjeve klinike komplikacionet janë:

1. Reaksioni hipertonik ku maksimalja arrin 150-170 mmHg.

2. Dëmtimi i qarkullimit kardiovaskular me çfaqjen o dhëmbjeve në regionin e zëmrrës, palpitacione, takikardi.

3. Edema pulmonare akute që kondicionohet nga retensioni i natriumit, i ujit, edema e miokardit.

4. Dëmtimet gastrointestinale me dhëmbje në regionin epigastrik, hemoragji gastrointestinale, me hepatit që shoqërohen me ikter.

5. Ndryshimet në kocka në formën e osteoporozës së shprehur të kolonës vertebrale, shtimi i kalciumit në gjak dhe pakësimi i tij në kocka.

6. Komplikacione infekcioze si cistite, riaikutizime të perikarditeve, pleuriteve etj.

7. Dëmtime neuropsiqike, psikozat janë akute që shoqërohen me eksitim psikomotor që vazhdon 20-60 ditë dhe zhduket gradualisht.

8. Siindromi i «heqjes» së preparatit konsiston në reaksiionin e organizmit gjatë ndërprires së tij ose uljes së dozës. Ka mundësi zhvillimi i atrofisë së suprarenaaleve.

9. Mund të vrehen fenomena dermatitesh.

Mund të kemi dëmtim të pankreasit në formën e pankreatitit steroid, komplikacione septike etj.

Esenca e komplikacioneve qëndron në hiperkorticizmin. Baza e lindjes së këtyre komplikacioneve konsiston në fuqizimin e aktivitetit fiziologjik të preparateve glikokortikoide dhe minealkortikoide.

EKSPERIENCA E TERAPISË KORTIKOSTEROIDE NË GLOMERULONEFRITE

Ratner M. Ja.

Kliničeskaja medicina 1964, 8, 26.

Medikamentet e aplikuara deri kohët e fundit në glomerulonefritet kanë dhënë çrekje lidhur me disa simptome të sëmundjes, kryesisht mbi hipertonië dhe edemat, ndërsa veprimi në precesin e sëmundjes bazë mungonte.

Në vitin 1949 Farnscurd konstatoi se aplikimi i ACTH në doza të mëdha ndihmon në lartim e sindromit nefrotik gjatë glomerulonefriteve. Gjithashu aplikimi i steroideve sintetikë si prednizonit deksametazoni etj. në doza të larta dhe për një kohë të gjatë siguron sukses të dukeshëm. Në fillim jipen doza ACTH të mëdha 200 mg në ditë ndërsa prednizon 60-80 mg. Gjatë 3-4 javëve, pastaj këto preparate aplikohen me cikle tri ditëshe dbe nga 4 ditë pushim. Të tillë cikle vazhdojnë 12-18 muaj.

Bredë e bashkëpuatorët vrejtë se gjatë glomerulonefriteve pa sindrom nefrotik pakësimi i simptomeve urinare nën influencën e terapisë hormonale bëhet me të njëjtën shpejtësi sikurse dbe kur ekziston sindromi nefrotik.

Autori paragjith analizën e rezultateve të mjeqimit me kortikosteroide të 180 të sëmurëve, prej tyre 34 me glomerulonefrit akut dhe 146 me glomerulonefrit kronik. Në akutin zgjatja e sëmundjes që nga 3 muaj deri në një vit, në kronikun nga 1 vit deri në 12 vjet. Të sëmurët me nefrit kronik u ndanë në tre grupe: në grupin e parë me sindrom nefrotik, në të dytin në he-

maturi; në të tretin proteinuri 1 gr, në dritë dhe hematuri. Tek të gjithë të sëmurët funksioni renal ose ishte i padenuar ose pak i ulët. Doza injekuese e prednizolonit ishte 60 mg. në 24 orë për 3 javë. Nëçperja e preparatit është bërë gradualisht gjatë 7-14 ditë. Gjatë këtij injekimi u aplikuan antibiotikë si tetraciklinë, sintonicinë, oksitetraciklinë, kallë kloratit për preventimin e edemave është përpunuar djeta ku kufizohet vatriumi.

Terapia kortikosteroidë shkakton remisiën, të cilat shbaktojnë zhdukjen e simptomeve urinare, sindromit nefrotik, ngren koncentrimin e proteinave të gjakut, ngritet filtracioni glomerular. Ulja e proteinurisë është dhjet herë, e hematurisë 2-3 herë.

Remisiçna si të pjesëshme ashtu dhe të plota janë dritë të glomerulenesritin akut ashtu dje në atë kronik, veprim se në aktin janë më të larta se të kronikus. Gjilbachtu mund të thuhet se terapia kortikosteroidë është efektive në të gjitha çfarëjet e sindromit nefrotik në një shkallë mesatare, por është pa rezultat në edemat anasarke. Zgjatja e remisiçneve mund të lëkundet nga 2 muaj deri në 3 vjet. Këto rezultata janë më efektive gjatë kurseve të përsëritura të terapise.

Terapia kortikosteroidë tek të sëmurët me glomerulenesrit shkakton fenomene anësore negative si shtim në peshë, lodhje, ngritje të apeiutit, rrëregullime të gjumit, hemoragji gastroe intenstionale, ngritje të presionit të gjakut etj.

INFLUENCA E TONSILEKTOMISË NË GJENDJEN FUNKSIONALE TË SISTEMIT KARDIOVASKULAR

Kireiev J. K. Kliničeskaja medicina 1964, 7, 79.

Rëndësia e problemit të tonsillit kronik kondicionohet kryesisht me dëmtimin e sistemit kardiovaskular. Tonsilektomia si metoda në radikale e injekimit të sëmurëve me tonsilit kronik ka marrë një përhapje të gjërë. Autori ka studuar 104 të sëmurë me tonsilit kronik me moshë nga 19-24 vjeç para operacionit dhe 3-7 ditë pas operacionit, ndërsa 72 të sëmure për një periudhë të largët mbas tonsilektomisë (2-22 muaj).

U studjuar gjithashtu zëmra e sistemit periferik i qarkullimit të gjakut, u përcaktuari shpejtësia e qarkullimit të gjakut, u bë prova funksionale Shiąnge, u aplikua EKG., bali stokardiograma, rendgenokimografja, oscilografja etj.

Studimi i gjendjes funksionale të sistemit kardiovaskular në një periudhë të afërt mbas tonsilektomisë tregon për influencën favorizuese të këtij operacioni në aparatin qarkullues.

INFLUENCA E STROFANTIKËS NË ZGJATJEN E PERIUDHËS SË SISTOLES

Svjerckova T. S. Kliničeskaja medicina 1964, 7, 53.

Vitet e fundit kanë çmuar funksjonin kontraktues të miokardit me arën e rrugës së përcaktimit të zgjatjes së sistolës, e cila siç dihet përbëhet nga periudha e tendosjes dhe e lëshimit.

Disa autorë kanë konstatuar se në normë zgjatja e periudhavë të kontraktimit të zëmrit është e qëndrueshme, ndërsa kufijt e ndryshimit të saj janë të kufizuara. Në kondita patologjike ndryshimet e zgjatjes së periudhës së sistolës varen kryesisht nga faktori hemodinamikë (vese të zëmrit) ose nga dëmtime primare të miokardit (miokardite, kardiosklerozë).

Gjatë injekimit të insuficiencës kardiovaskulare një aplikim të gjërë ka gjetur strofantina. Mirë është studjuar influenca e saj në proceset biokimike të miokardit — në metabolizmin e fosfatideve, në kërkesën për oksigjen, glukozës, acidi laktik. Influenca e strofantinës në zgjatjen e periudhës së sistolës ose (mbi funksionin kontraktues të miokardit) është studjuar pak.

Autori ka observuar 20 të sëmure me insuficiencë kardiovaskulare të gradës së II-të, 8 vuanin e të sëmurëve nga 20-59. Me strofantinë u injekuan 14 të sëmure, me korglikon 3, digoksinë 3. Dinamika e zgjatjes së periudhavë të sistolës u vrejt pas 5-10 minutash pas fujcs së strofantinës ndryshimet arritën maksimumin pas 30-45 minuta dhe u ulën pas 1-1,5 orë. Kjo tregon se vepru i strofantinës zgjat më shumë se një orë e gjysëm.

Tek të sëmurët me pneumosklerozë dhe cor pulmonal ndryshimet e zgjatjes së periudhës së sistolës nën influencën e strofantinës nuk u vrejtën kjo shpjegohet siç duket se insuficiencia kardiovaskulare tek këta të sëmure shkaktohet nga dobësimi i fuqisë kontraktuese të ventrikut të djathitë.

Pastaj autorë merret me përkrimin e një rasti.

Nën influencën e korglikonit dhe digoksinës vrehen ndryshime analogjike por më pak të shprehura sesa gjatë aplikimit të strofantinës.

**MJEKIMI I TË SËMURËVE TË MOSHËS SË KALUAR ME MORBUS
HIPERTONICUS (FORMA CEREBRALE) ME HIPOTIAZID DHE
RESERPINË**

Mankovski N.B., Draçeva Z. N., Vainashtok J. B.
Kliničeskaja medicina '965, 1,92

Morbus hipertonicus forma cerebrale më shumë takohet tek njerëzit e moshës së kaluar. Mjekimi i tyre është i vështirë se ajo shoqërohet me aterosklerozë. Mjetet e ndryshme vazo-dilatatore tregojnë pak efekt.

A. Ll. Miasnikov propozon kombinimin e preparave hipotiazid, rezerpinë, dibazol, nembutal nën emrin «depresin», kjo shpejt ul tensionin arterial dhe në ato raste ku preparatet neurolegjike nuk kanë patur rezultat.

Sipas Morison, Schroeder etj. në moshën mbi 60 vjeç është i kundërndikuar aplikimi i preparave ganglioplegjikë.

Autorët kanë përdorur kombinimin e hipotiazidit me rezerpinë gjatë mjekimit të të sëmureve mbi 60 vjeç. Hipotiazidi u dha në doza të ndërrprera 12.5 mg. 1-2 herë në ditë (mëngjes ose mëngjes dhe ditën). Rezerpinë u fillua me 0.1-0.12 mg. nga një herë ose dy herë në ditë (para gjumit). Së bashku me hipotiazidin jepet kalii klorat ose kalii acetat. Gjatë këtij aplikimi u arrit një efekt diuretik vetëm ditën, u përmirësua gjumi, të sëmuret u mjeckuan ambulatorisht, zgjata e mjekimit nga 3-4 muaj deri në një vit. Nën mbikqyrje autorët kishin 52 të sëmure me moshë 60-75 vjeç me formë cerebrale të morbus hipertonicus, prej tyre 24 burra dhe 28 gra. Tek 43 stadi i dytë i *morbus hipertonicus* ndërsa tek 9 stadi i tretë. Në 38 të sëmure sëmundja zhvillohej sipas formës cerebrale, ndërsa tek 14 cerebrokardiakë. Sklerozë e enëve cerebrale u vrejt tek gjithë të sëmuret.

Para mjekimit të sëmuret ankokeshin për dhëmbje koke në regionin fronto-oksipital pagjumi, vertigo dhe nauze, zhurmë në veshë, dhëmbje në regionin e zëmrrës dhe palpitacione. Nga ana e ekzaminimit të sistemit nervor tek shumica nuk kishte patologji organike, vetëm tek 6 paraliza dhe pareza të ekstremiteteve nga insultet cerebrale të kaluara. Në zemër zgjerimi i ventrikut të majtë dhe akcentim i tonit të dytë, në E.K.G. ndryshime tipike për *morbus hipertonicus* dhe aterosklerozë. Niveli i tensionit arterial mesatar 204/113 mmHg.

U bë mjekimi gjithashtu në 31 të sëmure grupe kontrolli, më moshë nga 26-58 vjeç, atherosklerozë ishte më pak e shprehur, tensioni arterial 195/118 mmHg.

Efekti hipotiazidit tek të sëmuret e moshës së kaluar ishte absolut tek të gjithë. Presioni sistolik u ul rreth 41 mmHG dhe diastoliku 22,3 mmHG. Në gjendje neurologjike nuk u vrejtën ndryshime të dukëshme. Tek shumica u zhduk dhëmbja e kokës, u vendos gjumi normal, u pakësua ose u zhdukën vertigot, dhëmbja në zemër dhe palpitacionet. Edhe tek grupi i kontrollit u muarën të njëjtat rezultate. Mjekimi tek të dy grupet nuk dha ndonjë komplikacion.

Prandaj kombinimi i hipotiazidit me rezerpinë mund të përdoret me sukses në mjekimin e të sëmureve në formë cerebrale të *morbus hipertonicus* stadi II-III, në ato raste kur mjetet e tjera nuk janë efekt. Kjo mund të rekomandohet dhe ambulatorisht. Dozat e vogla të hipotiazidit dhe të rezerpinës në moshë të kaluar janë të njëjtin efekt me doza dyfishe në moshën e re dhe mesatare.

**LËKUNDJET DITORE TË GJENDJES FUNKSIONALE TË KORTIKOSUPRARENALËS-
TEK TË SËMURET ME ASTME BRONKIALE.**

Alekperov M. A. Tarapevtičeskij Arhiv 1964, 8,90

Autori përcaktoi eliminimin e 17 ketosteroideve dhe 17 oksikortikosteroideve në orë të ndryshme të ditës dhe natës duke e marë urinën në 4 porcione (mëngjes, paradite, mbasdite dhe natën). Studimi u bë në 37 të sëmure me astme bronkiale, 16 gra dhe 21 burra, 23 me formë të lehtë dhe 14 me formë të rëndë.

Ekzaminimet treguan se tek gratë në formë të lehtë, përbajtja e 17 ketosteroideve lëkundje nga 30-35% në mëngjes, 28,24% para dite, 23,4% mbas dite dhe 16,2% natë. Këto të dhëna tregojnë pakësimin e eliminimit në të gjitha porcionet. Pas mjekimit u vrejt rritja e eliminimit të 17 ketosteroideve në orët e mëngjjezit, paradesë dhe mbas dites.

Tek të sëmurët me formë të lehtë vrehet rritja e eliminimit të 17 oksikortikosteroideve në të gjitha porcionet por më tepër në orët e natës. Pas mjekimit u normalizua eliminimi.

Tek gratë me forma të rëndë rë astmës bronkiale eliminimi ditor i 17 ketosteroideve ishte shumë i ulur në porcionin e mëngjjezit, para dites, mbas dites dhe natës. Pas mjekimit në të gjithë të sëmurët u pa rritja e 17 ketosteroideve në të 4 porcionet. Eliminimi dhe lëkundjet ditore të 17 ketosteroideve tek burrat me astma bronkiale të formës së lehtë dhe të rëndë pak dallohet nga gratë.

Në kohën e akutizimit kemi ulje të eliminimit të 17 ketosteroideve dhe 17 oksikortikosteroideve dhes pjesa më e madhe nuk eliminohet në mëngjes si në njëzit normalë por para dites. Pas mjekimit eliminimi i tyre fillon të normalizohet dhe pak dallohet nga njëzit normalë. Ndërsa 17 oksikortikosteroide e eliminohen më shumë gjatë akutizimit që sidomos në porcionet natës.

Gjatë akutizimeve së duket korja e surenales ngrë veprimtarin e saj dhe rritja e 17 oksikortikosteroideve konsiderohet si proces kompensator. Akcesi i dispnesë mobilizon sistemin korikor seroideve konsiderohet si proces kompensator. Akcesi i dispnesë mobilizon sistemin hipofizosurenal.

Ngritja e 17 oksikortikosteroideve mund të lidhet me atë që organizmi ndodhet në gjendjen e mobilizimit të mekanizmave mbrojtëse duke përfshirë në këtë mënyrë dhe koren surenale. Mbës mjekimit dhe në kohën e remisionit 17 oksikortikosteroide është normalizohet dhe nuk dallohen nga norma.

Tek të sëmurët me astmë bronkiale pra ekziston një regjim ditor i caktuar në krijimin e hormoneve të surenales. Duke i studjuar ato, shohim që lëkundjet janë në orët e ndryshme të dites. Kjo bëa që të përdoret në mënyrë më racionale hormonoterapië.

STEROIDET ANABOLIKE PROTEINIKE NË MJEKIMIN E INSUFICIENCËS RENALE AKUTE

Novikov Ju. I., Skaçillova N. N. Terapevtičeskiy Arhiv 1964, 8, 79

Aplikimi i steroideve anabolike në mjekimin e insuficiencës renale akute paraqet interes se proguzo e kësaj sëmundjeje mvarët nga metabolismi i proteinave.

Mbi efektin e testosteronit gjatë uremisë eksperimentale i pari ka folur Selye 1940. Blagg dhe Parsons panë uljen e katabolizmit proteinik nën influencën e testosteronit 37% dhe progesteronit 24%.

Disë autorët nuk kanë marrë rezultate pozitive të hormoneve anabolike gjatë insuficiencës akute dhe kronike (Gerber, Cottier).

Autorët përmendin rezultatet e mjekimit me steroid e anabolik të 20 të sëmurëve me insuficiencë renale akute që zhvillohet si rezultat i hemotransfuzionit. Është përdorur testosteron propionati dhe prodhimi i tij dianaboli. Të gjithë të sëmurët ishin gra me moshë 22 deti 49 vjeç.

Hormonet u aplikuan në 10 të sëmurë në periudhën oligoanurike në ditën e tretë dhe të pestë të sëmundjes me simptome të uremisë që rritesh progresivisht. Të sëmurët në këtë periudhë në mbajtjen me dietë dhe regjim hidrosalin, gjithësesi 1500-1600 kalori, jo më shumë se 26-28 gr. proteinë.

U përcaktua urea, elektrolitet në gjak dhe urinë, presioni osmotik, EKG, rezervat alkaline. Testosteroopropionati u aplikua në doza 25 mg.-150 mg. në 24 orë në periudhën e oligoanurisë. Kursi i mjekimit zgjat 5-14 ditë.

Metandrosterolon në periudhën e oligoanurisë u aplikua në doza 20-30 mg. dhe në poliuri u ul në 10 mg. Në ditët e para ky preparat nuk pati efekt, ndërsa kur u kombinua me progesteron 20-30 mg. pati efekt të dukshëm sidomos në uljen e azotemisë.

Hormonet anabolik u aplikuan tek 6 të sëmurë me insuficiencë akute renale që ishin komplikuar me procese infeksione (peritonit, laringit, urenik me asfiski dhe trakeotomi, qelbësim i plaqës eij). Morën testosteron propionat 100-150 mg. dhe 400-500 ml. glukozë 40% në 24 orë kombinuar me insulinë. Njëkohësisht u aplikua dhe hemodializa. Pas mjekimit u shtua oreksi, shtuan në veshë, u përmirësua gjendja e përgjithësme e pacientëve. U rrit sasia totale e proteinave përllogari të shtimit të albuminave dhe uljes së globulinave e cila u ruajt gjatë gjithë kohës.

Këto steroidet dhanë disa fenomene anësore që shpejt u zhdukën si ulja e timbrit të zorit, hemoragji nga mitra, ndjenjë nekhtësie në fytyrë eij.

Dianaboli nuk është përdorur në doza më të larta se 25-30 mg. në 24 orë me fillimin e periudhës së poliuriqës dozat u ulën gradualisht deri në 10 mg. në 24 orë. Këqësimi i funksionit hepatic siç eiton Schnack dhe bashkëpunorët, nuk u vrejt.

MBI FUNKSIONIN E KORTEKSIT SURENAL NË SINDROMIN NEFROTIK

GALEOTTI I

Minerva Medica 1963, 54, 1941

Në sindromin nefrotik ka një shtim të sekrecionit të natriumit. Gjithashtu është parë se tek nefrotikët kemi një shtim të eliminimit të aldosteronit. Aldosteronija varet nga shtimi i retencionit të hormonit të kortekosit surenal.

Sot mendohet se hipovolemia stimulon receptorët e vendosur në karotidet dhe prej këndëj impulset nervore shkojnë në «sistemin limbik» (gjendrat pineale, komisura posterior), ku çlirohen «adrenoglomerulotrofina», që stimulon zonën glomerulare surenale për prodhimin e aldosteronit. Edemati nefrotike nuk rravaren vetëm nga hipo dhe disprotidemia por edhe nga një absorbim i madh i natriumit në nivelin e tubulave renale e shkakuar nga hiperaldosteronizmi.

E. Fjaschi dhe L. Campanacci kanë dozuar aldosteronin në urinë dhë 17 hidrokortikosteroidet e lirë të plazmës dhe ato që eliminohen me urinë, 17 ketosteroidet në urinë, dhe kanë vrejtur se aldosterenia është e shtuar vetëm në sindromin nefrotik pa insuficiencë renale. Në qoftë se ka insuficiencë renale atëherë aldosteroni është normal. Autorët kanë vrejtur që ekilibri hidrik dhe elektrolitik janë independent nga ekskrecioni i aldosteronit.

Gjithashtu ka një shtim të eliminimit urinar dhe të adjuvetinës Ndërsa kemi pakësimin e koncentrimit plazmatik të 17 hidrokortikosteroideve të lira gjë e cila mund të shpjegohet me pakësimin e aktivitetit sekretor të gjëndrës së korteksit surenal. Në personat me sindrom nefrotik pa insuficiencë surenale kemi një shtim të eliminimit të 17 hidrokortikosteroideve dhe 17 ketosteroidet. Në këtë të sëmuarë kemi një pakësim të sekrecionit të glukokortikoideve dhe të hormoneve androgenikë. Në sindromin nefrotik ka një disekvilibër të funksionit renal që karakterizohet nga një predomnim i mineralkortideve mbi glukokortikoidet dhe androgenikët.

ASTMA BRONKIALE DHE IKTERI

Rafes Ju. I. Terapevticëski Arhiv 1964, 9, 114

Për shumë vjet me rradhë autorë ka vrejtë kombinimin e astmës bronkiale me hepatitin epidemik. Gjatë kësaj ka vënë re influencë të kënaqëshme në dekursin e astmës bronkiale.

Autorë përsbkruan rastin e një të sëmurë që i u ndërprenë krizat e astmës bronkiale në periuadhën e ikterit dhe u zhdukën plotësisht për 6 vjet pas kalimit të hepatitit epidemik.

Ai përsbkruan gjithashtu rastin e një pacienti që vuante prej 30 vjetësh nga astma bronkiale me akcesë të shpeshta dhe kur ju bashkua hepatiti epidemik iu zhdukën gjatë dekursit të tij akcessit dhe 3 muaj pas kalimit të hepatitit.

Pra ikteri vepron pozitivisht gjatë astmës bronkiale, paralizon faktorët që vënë në lëvizje mekanizmit që kondicionojnë lidjen e atakeve.

Pastaj autorë flet se ikteri dhe më mirë bille tregojnë efekt klinik gjatë të tillë alergjive si astma bronkiale.

Venulet, Kadlubovski flasin mbi veprimin e shprehur desensibilizues të bilës në bazë të eksperimenteve që kanë bërë në kavje. Cilësi i antianafilaktike zotron një prej përbërësve kryesorë të bilës acidi kolik dhë acidi dehidrokolik sintetik. Në eksperiment Kadlubovski ka treguar se acidi dehidrokolik ka një veprim shumë më të dobët se bila.

Bila e plotë frenon qfaqjen e shokut histaminik më mirë se derivatet e saj, kështu dhe astmën bronkiale. Pra rëndesi në veprimin e bilës ka jo vetëm acidi kolik por edhe komponentë të tjera që nuk dihen prej nesh.

Venulet dhe Kadlubovski mendojnë se influenca e ikterit ka genezë hormonale dhe lidhet me funksionin e kores surenale. Mundet që bila forcon funksionin e sureneve dhe sipas tyre hormonet e kores surenale lidhen me bilën dhe me përbërjen kimike. Këta treguan varësinë e sekrecionit surenal me madhbësinë e nxjerrjes së tillës.

PATOGENEZA E DHËMBJEVE TË KARAKTERIT STENOKARDIK NË ATAKET E ASTMËS BRONKIALE

Vasiljev P. N., Rovinski V. J. Sovjetskaja medicina 1965, 1, 123

Në disa pacientë me astmë bronkiale dhe kryesisht në atakët e rënda dhe të gjata vrehen dhëmbje në regioninë zëmërës cse prapa sternumit dhe nganjëherë me iradim në shpatullën e majtë. Këto dhëmbje sidomos në persorë të moshës së vjetër klinicistët e kanë shikuar si *angina pectoris* të kondicionuar nga faktorë emocionalë dhe lodihi fizike në kohën e astmës bronkiale dhe me refleksin pulm koronar.

Të tilla dhëmbje mund të lidhen me hipoksinë e miokardit si rezultat i hipoksisë së përgjithëshe gjatë dëmilitimit të kalushmërisë bronkiale në kohën e gjendjes astmatike. Një prej shkaqeve të hipoksisë së miokardit janë ndryshimet që lindin në arteriet e vetë muskulit kardiak në kohën e atakut astmatik. Këto dhëmbje nganjëherë zhduken shumë pak ose ndërpriten nga nitroglycerina dhe më mirë nga terapi me oksigjen.

Pa marrë parasysh se ajo çshëtë vetëm komponerit hipoksik alergjik, ndryshimet e muskulit të zëmërës tek të sëmurët me astma bronkiale duke shkaktuar ndryshime të arterieve fiton një rëndësi të veçantë.

Margarita Vullkaj.

STUDIMI I EFEKTIT SPAZMOLITIK TË DIETIFENIT GJATË STENOKARDISË

Levina S.A., Gruzinia E. A. Sovjetskaja medicina 1964, 12, 103

Ky preparat ka dhe emra të tjerë si korargil, trimanyl etj. Bën zgjerimin e eneve koronare si në eksperiment tek kafshët ashtru dhe tek zemra e izoluar. Autorët kanë bërë studimin mbi 53 të sëmurë (25 gra dhe 28 burra) në moshë nga 40-70 vjeç. Stenokardia mund të shoqërohet me *morbus hypertonicus* të stadeve të ndryshme, aterosklerozë, infarkt. Tek 18 u konstatua insuficiencia kardiovaskulare e gradave të ndryshme. 40 të sëmurë morën preparatin nga 0.025 gr. 3 herë në ditë në tabletë, ndërsa të tjerët 0.2% 5 ml. I herë në ditë intravenoz.

Tek të gjithë të sëmurët para aplikimit të preparatit persistonin krizat e stenokardisë. Tek shumica kishte ndryshime nga ana e EKG. Pas njeqimit kemi përmirësim të indekseve të EKG. sidomos nga ana e kompleksit ventrikular, intervalit ST dhe dhëmbit T. Më tepër efekt kanë sidomos nga ana e kompleksit ventrikular, intervalit ST dhe dhëmbit T. Më tepër efekt tensioni arterial u ul. U rrit tek shumica e të sëmurëve kapaciteti vital, prova e mbajtjes së frysës. Treguesit e kapilaroskopisë në shumicën e të sëmurëve tregojnë për zgjerim të rrjetës kapilare në membranat mukoze.

(Përbledhur nga Margarita Vullkaj)

KLINIKË E ASKARIDOZËS

Llimahina M. A. Kliničeskaja medicina 1965, 2, 16

Sipas klasifikimit të V. P. Podjapolskit në klinikën e askaridozës duhet të dallojmë stadin e migracionit, intestinal që stadin e komplikacionit të askaridozës.

Gjatë studit të parë askaridoza mund të zhvillhet pa simptome, në raste të tjera në përmjen e infiltrave fokolare pulmonare që shoqërohen me euzinofili, pneumoni dhe bronkite akute, urtikarie. Në rastin e infiltrave pulmonare ka zakonisht temperaturë subfebrile, antohen për lodihi, greks jo të mirë, dhëmbje në gjeks, pak kollë të thatë. Perkusioni është e madhe. Në gjak vreten auskultacioni jep të dhëra vëtëm kur siperfaqja e infiltratit është e madhe. Në gjak vreten euzinofili me sedimentacion të rritur. Sputumi përmban shpesh gjak, euzinofile, kristale të Charcot-Layden.

Të sëmuët erëkohen për rritje ese pakësim të oreksit, vjellje, nauze, dhëmbje në bark, në epigastër cse rrëth kërtfizës, rrallë në cekun, të cilat ruk lidhen me marrjen e ushqimit, në disa vrehet kertipacion ese diare, nganjëherë shoqërohet me temperaturë të lartë 40°. Në raste të vëçanta ajo mund të siqullojë një apendicit, ulcer duodenalis ese vcntrikuli dhe sëmundje të tjera.

Shpesh kemi dëmtim të sistemit nervor. Vrehen dhëmbje koke, eksitushmëri gjum jo i qetë, lodhje e shpcjtë, apati, ulje c kujtesës, rënje c astësisë për punë. Në disa raste mund të zhvillohet gjendje depresive, atake epileptike dhe histerike, simptomokompleksi Menier, feno-meno meningçiale. Tek fëmijëtë disa herë forma të korea minor. Vrehen ndryshime në fundus oculi, anizokoria, ataksi etj. Edhe në këtë fazë mund të kemi fenomen të urtikaries, astmë bronkiale, bronkit astmatik.

Nga ana e sistemit kardiovaskular mund të kemi zmadhimin e zemrës, zhurmë sistolike, tone të shurdhëla, bradikardi, ulje e presionit arterial dhe venoz.

Komplikacionet e studit intestinal të askaridozës mund të janë shumë të rënda dhe të çojnë në vdekje. Komplikacioni më i shpeshë është është ileusi.

Shumë autorë kanë vrejtur askaridozë të heparit dhe të kolecistit, me mungesë të ikterit dhe prorëzë të leukocitozës. Në hepar mund të formohen procese purulente ose purulente nekrotike.

Është pëershkuar dhe rasti i askaridozës së pankreasit. Nga 64 raste të askaridozës së rrugëve biliare të pëershkuara në literaturë në 3 është vrejtur penetrimi në *ductus pankreaticus*. Gjatë askaridozës së pankreasit ka dhëmbje të forta që shoqërohen më kolaps, shpesh ka të vjella.

Janë të njoftura rastet e depërlimit të askaridit në rrugët urinare, vaginale, tubin eustakit, në organe e inde të tjera.

DISTIREOZA NË ASPEKTIN E SOTËM

Nikolajev O.V., Kasavina B.S., Kolcińska T.A.
Kliničeskaja medicina 1965,2,13

Gjatë studimit të patologjisë së strumës nodulare, endemike osc sporadike dhe proliferimit sekondar ndryshime regressive dhe destruktive, dcl se prishten proceset e metabolizmit të indit të gjendrave dhe sinteza e hormonave të saj.

Janë vrejtur devijime nga norma në fraksionet jo proteinike të gjakut në të sëmurët me së-mundje të gjendrës tiroide dhe sidomos gjatë strumës cutiroide. Treguesi i aktivitetit të qelizës së gjendrës tiroide sipas De Groot dhe Devis është përbajtja e sukcindehidrazave. Krahas jdot ekzogen rendësi ka dhe hormoni tireotrop, niveli i elektrolitëve dhe kompleksi i mikro-elementeve në organizëm.

Është e rëndësishme të konstatohet rapporti midis ndërtimit morfoligjik të sektorëve të ndryshëm të gjendës dhe këmiznit të saj duke ekzaminuar me anë të metodave biokimike. Rëndësi ka përcaktimi i heksaminoave që pasqyron sasinë e përgjithshme të acideve mukopolisaharide:

Gjatë strumës nodulare eutiroide në të gjithë të sëmurët u vrejt rritje e përbajtjes së heksaminave deri në 230 mg% nga 100 mg% që është në normë. Studimi i acidit ribonukleik është dezoksiribonukleik ka rëndësi të madhe për të përcaktuar aktivitetin funksional të gjendrës dhe proceset proliferative (Mills, Prise).

Eksaminimet kanë treguar se në studet e herëshme të përbërje kimike të nyjes strumike kemi rritje të acidit ribonukleik dhe dezoksiribonukleik, ndërsa kolageni dhe mukopolisaharidet në krahasim me normën ndryshojnë. Kolageni ndryshon nga 6-24 mg%.

Në qofshi se struma nodulare do të shikohet si gjendje prekanceroze atëherë indikacionet për operacion profilaktik kanë shpjegim patogenetik.

DISA ÇESHTJE TË DEKURSIT TË PNEUMONISË KRUPOZE NË VITET E FUNDIT

Rejkvin B.A. Kliničeskaja medicina 1964,12,22

Morboziteti nga pneumonia dhe format e veçanta të saj gjatë dhjetë vjetëve të fundit ka ndryshuar në mënyrë të dukëshme.

Është ulur vëndi që zen pneumonia krupoze në numrin e përgjithshëm të pneumonive nga 36,3% në 1956 në 0,3-0,5% në këto 3 vjetë e fundit (N.S. Moljanov). Ka ndryshuar përbërja e moshës të të sëmurëve me pneumoni krupoze, nëqoftëse më 1949 deri më 1955 më të rinj se 50 vjeç ishin 63,9% 70% vjet e fundit arriti në 44%.

Pneumokoku i tipit të parë baset 1,5 herë më shumë në pneumoninë krupoza, ndërsa letaliteti më të madh sjell pneumokoku i tipit të I dhe II Ulja e përqindjeve të pneumonisë krupoze me mbizotërim të bronkopneumonisë lidhet me ndryshin e karakterit të mikroflorës

sidomos të pneumokokut që është më i ndjeshëm ndaj antibiotikëve se sa të tjerët. Apikimi i terapisë antibakteriale ka ndryshuar kuadrin klinikomorfologjik të sëmundjes dhe shumë tërë pneumotia merret si bronkopneumoni.

Në kohën e sotëme, gjatë aplikimit të herëshëm të antibakterialeve, pneumonia krupoze paraqet zakonisht karakter segmentar por janë dhe mbeten karakteristike edema mikrobiale, infiltracioni dhe mungesa e ndryshimeve peribronkiale.

Terapija bakteriale dëmtont zhvillimin ciklik të sëmundjes, rrit numurin e formave të lehta dhe abortive, ul komplikacionin dhe letalitetin, formai e lehta mund të çfaqen vetëm po të fillohet mijekimi 48 orët e para të sëmundjes, ndërsa ato të pa mijekuarat kanë simptomatologji klasicke. Kjo terapi çon në shkurtimin e periudhës së temperaturës, rallë takohet rënia kritike, dëmtohet dekursi ciklik i simptomave klasike fizike.

Symptoma bazë sot qëndrojnë kolla, dnëmbja në gjoks, fillimi akut, temperatura, eliminimi i gëlbazës, dispneja, rafe krepitante, gëlbaza ngjyrë ndryshku, herpes. Dëmtimet hemodinamike shprehën jo në mënyrë të theksuar dhe kanë karakter të përkohëshëm. Leukocitoza është jo e shprehur në 30%, kurse leukopenia vrehet në 10%. Në periudhën akute vrehet ndryshme nga ana e heparit, rënia e sheqerit në gjak, utja e proteinave dhe e albuminave, ngritja e globulinave dhe e fibrinogenit, rritja e azolitës bilirubinës, mbajtja e klorureve, rritja e urinës në urinë, 8 vjetë e fuadit letaliteti nuk kalon 0.03-0.058%.

Me mijekimin racional që u bëhet të sëmurëve shërimi i plotë vrehet në 64%, pneumosklezoza në 10.3%, pneumopatiat kronike në 25.6%.

DINAMIKA E C-R. PROTEINAVE TEK TË SËMURËT INFETTIVË

Bolshun I.I., Bejlinkina E.M. Kliničeskaja medicina 1965,1,39

Proteina C-R reaktive në serumin e gjakut të njerëzve të shëndoshë mungon.

Ajo është e lidhur me lindjen në organizëm të proceseve patologjike që karakterizohen me ndryshime inflamatore dhe destruktive në inde dhe nuk mvarret nga etiologjia e sëmundjes.

C-R proteina çfaqet në ditët e para të sëmundjes, pastaj ulet shpejt, zhduket nga gjaku shumë më shpejt se sa shërimi klinik. Koncentrimi i saj mvarret nga rëndimi i procesit patologjik prandaj përcaktimi i saj në gjak kanë rënësi jo vetëm diagnostike por edhe prognostike.

C-R proteina u zbulua më 1930 nga Tiley dhe Frensis. Nga ana e përbërjes kimike është e ngjashme me albuminat dhe ka cilësinë e antigenit M.C.Carty (1947) e morri në gjendjen e kristallë dështo e kjo bëri prodhimin e serumit anti C.R.P.

Punime mbi përcaktimin e saj në gjak gjatë sëmundjeve infektive kanë bërë Ash, Havens, etj. Janë pak punime më lidhje me përcaktimin në skarlatinë.

Autorët kanë përcaktuar C.R.P. në serumin e gjakut të 471 të sëmurëve me sëmundje infektive (1560 analiza me metodën Anderson dhe Makart). Të sëmurët ishin me infeksione të ndryshme pneumokoksiqe, virusale, rikecizo, infeksione kronike etj.

Në periudhën akute të sëmundjes në të gjithë të sëmurët C.R.P. u vrejt me të njëjtën shpeshtësi, nga koket 69% pozitiv, infeksionet virusale 63% dhe bacilare 61%. C.R.P. vrehet më tepër tek të sëmurët me formë të rëndë dhe mesatare të sëmundjes, në format e lehta më pak.

Gjatë formave të rënda dhe mesatare të sëmundjes C.R.P. përcaktohet për një kohë më të gjatë se sa në format e lehta.

Autorët kanë vrejtë paralellizëm midis intensitetit të raksionit dhe shifrave të larta të bilirubinës, aktivitetit të aldolazës dhe transaminazës në gjak. Si rregull intenzitetit i raksionit vrehet dhe gjatë shpejtimit të sedimentacionit më shumë se 12 mm në orë. Gjatë dekursit krontik të sëmundjes (dizanteri kronike, brucelozë etj). Vrehet raksion negativ, gjatë akutizimit dhe recidivës përsëri çfaqet C-R-Proteina.

ELIMINIMI I UROPEPSINËS GJATË MJEKIMIT TË ASTMES BRONKIALE ME HORMONE STEROIDE.

Frenkel G. N. Kliničeskaja medicina 1964,12,82.

Uropepsina është një ferment proteolitik që formohet në mukozën e stomakut. Sekrecioni i saj rregullohet nga sistemi hipofizo-adrenalik. Ndryshimet në sasinë e uropepsinës shumë autorë i shpjegojnë me pakësimin e punës së korteksit surrenal. Ka punime që lidhën sekretimin e saj me ACTH dhe kortikosteroidet.

Më 1956 Fritz përcaktoi eliminimin e uropepsinës para dhe pas injekcioneve të ACTH' dhe rezultatet e marrë u gjykan lidhur me funksionin e surenales. Gjatë kësaj prove shumë autorë kanë vrejtur paralelizëm midis uropepsinës dhe 17 ketosteroideve.

Përcaktimi i sasi të uropepsinës së ekskretuar gjatë astmës bronkiale mund të shërbejë si një nga testet për gjykimin e gjendjes funksionale të korektës surenal. Sipas B.B. Kogan, eliminimi i 17 ketosteroideve ullet në kohën e atakut astmatik dhe ngritet gjatë remisionit të pas injekimit me kortikosteroide, megjithëse të fundit frenojnë funksionin e kores surenale. Ai thekson se ulja e funksionit të kores surenale gjatë astmës bronkiale lidhet me gjendjen alergjike të organizmit gjatë kësaj sëmundjeje.

Autori ka studjuar 76 të sëmurë me astmë bronkiale në moshë nga 18–72 vjeç, në 51 të sëmurë formë e rëndë, në 10 formë e lehtë dhe në 15 gjendje remisioni.

Në 40 të sëmurë të rëndë nga 51, uropepsina ishte ndënnë nivelin normal. Për injektim u përdorën doza të vogla prednizolon 5 mg, 3 herë në ditë gjatë 3 ditëve, pastaj 4,5–5 mg dho pas 3 ditëve 3,5 mg. Në periudhën e atakeve dhe në fund të injekimit me prednisolon nuk tritet nivelet e uropepsinës, dho pas 3–5 ditësh nuk u vrejtën ngritte të qëndrueshme dhe të gjata.

Rëndësi paraqenit pacientit me astma bronkiale dhe patologji gastrike dhe në ato ku gjatë injekimit kemi fenomene të gastritit. Tek të gjithë këta pacientë u rrit niveli i uropepsinës.

Rëndësia e testit të uropepsinës si tregues i gjendjes funksionale të kores surenale tek të sëmurët me astma bronkiale mund të jetë vetëm mbas ekzaminimit të hollësishtëm të të sëmurit të gjendjes së traktit digjestiv. Rritja e uropepsinës në kohën e injekimit të astmës bronkiale me hormone steroide gjatë mungesës së efektit terapeutik flet për fenomenc anësore të kortikosteroideve.

PIRILENI NË KOMPLEKSIN E MJEKIMIT TË ULKUS VENTRIKULI DHE DUODENI

Kreçtova E.P. Sovjetskaja medicina 1964,12,68

Studimet e shumta kanë treguar efektin e madh të injekimit të të sëmurëve me *ulcus* me pre-parate ganglio-bilokuse (S.M. Riss, A. R. Lluzhis, Kay etj.)

Mjetet ganglio-bilokuse njëkohësisht me ndërprerjen e rymës së impulsive krijojnë kushte të favorëshme për funksionin e atyre organeve të cilët ndodhen nën kontrollin e sistemit vegjетativ.

Autori ka aplikuar në të sëmurë me *ulcus ventrikuli* dhe *duodeni* preparatin e ri sintetik pirilen, pak toksik dhe efektiv në përdorimin parenteral, në 35 të sëmurë (33 burra dhe 2 gra), 3 me *ulcus ventrikuli* dhe 32 me *ulcus duodeni*. Të gjithë të sëmurët më përparran kanë përdorur injektim kundër ulcerës.

Injekimi u bë në doza 0,0025 gr. 4 herë në ditë ose 0,005 herë ditën dhe të gjithë mernin intra venoz 10 ml. 10% natrium bromati. Kursi i injekimit 2-4 javë. Gjithësejt kanë marrë në një kurs 0,15-0,3 gr. U përdor dieta e Pcvznerit 1-2, në regjim shtrati. Rezultati i injekimit vlerësohet nga zhdukja e dhëmbjeve dhe e çregullimeve dispeptike, dinamika e dëmtimeve objektive dhe zhdukja e simptomit të nishës.

Pirileni dha një afak të mirë të qetësimit të dhëmbjes tek shumica e të sëmurëve, në ditën e III dështë V-të u pakësuan ose u zhdukën çregullimet dispeptike, u arrit ulja e aciditetit të lëngut gastrik dhe mo anë të rontgenologjisë u tregua se ndihmon në proceset reparative. Zhdukja e nishës u vu re në 12 të sëmurë nga 20.

Shkakton fenomene anësore si konstipacion, thatësi të gojës pakësim të shikimit. Më tepër vrehen këto në ditët e para të injekimit dhe zhduken pas 4-5 ditësh. Jep lëkundje të tensionit arterial që shoqërhohet me kolaps ortostatik prandaj pas marrjes rekombinohet 45-60 minuta pushim. Kombinimi me brom jep rezultate shumë të mira.

KLINKA DHE DIAGNOSTIKIMI I RETIKULOSARKOMATOZËS DHE LIMFOSARKOMATOZËS

Allutova G. I. Sovjetskaja medicina 1964,9,118

Të dhënat statistikore flasin mbi rritjen e mortalitetit nga neoformacionet në sistemin limfatik dhe mictoid (retikulolimfo-sarkomatoza, limfogranulomatoza, mielomatoza etj.)

Diagnozat ambulatorore të këtyre sëmundjeve në asnjë rast nuk ishin vendosur drejt dëshumica e të sëmurëve injekoheshin për limfadenita të nyjave limfatike, gastrit, hepatit, radi-

kutit, reumatizëm dhe sëmundje të tjera, kështu, që të sëmurët drejtosheshin në klinikë në statjet e fundit të sëmuadjes.

Zgjatja e jetës në këta të sëmrrur lëkundet nga 2-3 muaj deri në 2-2,5 vjet. Sëmundja zakonisht zhvillohet gradualisht dhe pastaj evoluon shpejt.

Autori ka obseruar 72 tē sémurë prej vitit 1952-62 prej tē cilëve 29 u diagnostikuani përshtatje. Retikulosarkomatozë dha 43 limfosarkomatozë. Prej këtyre 53 ishin burra dhe 19 gra. Moshë e tē sémurëve ishte prej 2 në 60 vjeç, 18 ishin në moshë deri në 15 vjeç. Në tē sémurë sémundja filloj në mënyrë akute dhe karakterizohet me dhërbimë në bark, nauze, tē vjella, temperaturë. Në 25 raste dhëmbjet e forte abdominale cuan në laparatomë.

3 të sëmuri dhëmbjet e forta abdominale çuan ne kujtimin. Fillimi akut i sëmundjes nganjëherë vrehet dhe me lokalizimin periferik të sëmundjes. Kështu do të kemi zmadhim të shpejtë dhe dhëmbje të nyjave limfaticke periferike të qafçës, tempe: aturë të lartë deri 40°, pastaj këto fenomene qëndrohen, nyjet limfaticke zgogëlohen dhe sëmuri është ndiqenë vechten më mirë.

Autori më pshjtë tregon se jo gjithmonë limfosarkomatoza dhe sidomos reliukosarkomatoza paragjitet me shënjat lokale të tumorit. Në 11 të sëmurë psh. ajo filloj me temperaturën e dëbjesi, marrje mendsh.

Zmudhim i nyjave limfatike në abdomen shqërohet me dhëmbje barku, zbulimi te abdomeni, konstipacion, nauze, dhëmbje në dy regionet hipokondrike. Në toraks jep dhëmbje krahoreti, kollë, hemoptoe.

Më shpejt preken njyjet limfatiske të qafës, pastaj aksilaret, inguinallet, abdominalet dhe mediastinalet, ato aderojnë në mës tyre të konglomeratë të mëthesh, rrithen shpejt dhe në palojm janë dolente.

Né traktin gastro intestinalis əfaqəz simptomata sıxas lokalizasiya p.sh. nə sənədlik osz-zorrə, kù quadri kliniko radiologik rəkajtton kanceria. Diagnoza e tyre əsətə və vəştirirə qəndəsət yetəm me nüfumən e operacionit eñ ekzamini neve histologikite.

Né gjak, ná shumicén e té sémurëve, zhvillohet anemi hipokromë ulet hemoglobjuli, ja kocitet normale ose té fritura, neutrofilozë, ná një pjesë té té sémurëve euzinofili (5-13%). Sedimentacioni i rritur 20-71 mm/orë.

Pra diagoza e retikulozave është e vështirë dhe ajo mund t'ë vendoset vetem ne dave me punktuesit dhe ekzaminimit histologjik.

Mjekimi me Ro/terapi tek tē sōnarët që ka patur nën obsevacioni autorit ka dhenu teknikat e nevojshme.

Mjekimi me Ro/terapi është e përshtatshme kundrejt rezistencave rrezeve rontgen. Mjekimi me sarkolizinë nuk ka dhënë rezultata zhvillohet rezistencë kundrejt rrezeve rontgen. Mjekimi me sarkolizinë nuk ka dhënë rezultata pozitive, kurse kombinimi i saj me Ro/terapi përmirëson gjendjen, kombinimi i Ro/terapisë me endoksan (50 mg 3 herë ditën) forcon veprimin e rrezeve rontgen.

**VEÇORITË E DEKURSIT TË VESVE REUMATIZMALE
NË MOSHË TË KALUAR.**

Nestrov V. S., Konoplijeva Li. F. Klinicheskaja medicina 1964, 11, 133

Gjatë dhjetë vjetëve, autorët studjuan të sëmurë me vese reumatizmale me moshë mbi 45 vjeç (prej tyre më shumë se 60 vjeç 40 veta dhe 260 të vdekur në po atë moshë, prej tyre mbi 60 vjeç 102 veta). Simbas të dhënave të literaturës moshë mesatare e jetës në të sëmuarët me sic nozë mitrale është 45-46 vjeç. Për këtë u morën dy grupe të sëmuarësh në njërin bënin pjesë 160 veta dhe në grupin e dyte 80. Në grupin e parë 22 ishin me moshë mbi 60 vjeç, kurse në grupin e dytë nga 80 të sëmuarë 20 ishin mbi 60 vjeç.

44% e të sëmërvë nuk dinin mbi sëmundjen e tyre dhe «asnjëherë nuk kishin dhenin jo-reumatizmal», Shumë prej tyre bënin punë të rëndë fizike dhe gjysma e grave pothuajse kishin natur nga 3 lindje,

Diagnosa e veseve reumatizale të zemrës në moshën kaluar nuk është e leje gjithashtu Shëpsh ato maskohen nga aterosklerozë, kardiosklerzo, emfizëm dhe pnuemosklerzo Vështirësi ka kuri i sëmurë vjen me insuficiencë kardiovaskulare dhe aritimia perpetua.

Sipas autorëve, diagoza mund të bazohet në disa shënja klinike prçj të cilave me më të rëndësi është pulsacioni në regionin epigastrik, konus pulmonar, përcaktimi i akcentit të tonit të dytë në arterien pulmonare. Rëndësi ka kur me anë të auskultacionit nuk mund të përcaktojmë ritmin e galopit ose zhurmës diastolike. Për këtë qëllim përdoret ekzaminimi fono-kardiografik.

I rendészis hém összefüggésekkel, atherosklerózis, hipertrofia, ventrikulit, majték, megalomájú, hyperthyreosis, hypothyreosis, kardiolipin, immunoglobulin, sedimentáció.

Përcaktimin e aktivitetit të procesit rënësës ka karakteri i temperatulares, sedimentacionit, i rritur, leukocitoze me neutrofilozë, prova pozitive e difenilaminës, ngrija e litrit të antistreptolizinës dhe antißiahuaronidazës. Pozitiviteti i këtyre indekseve tek të rinj është më i vjetër se tek të vjetrit

Prognoza mund të mvarët: 1 - Nga që procesi reumatizmal aktiv haset më rrallë tek të vjetrit 51% ndërsa tek të rinjtë 80%, 2- Nga mungesa ose sasia e pakët e recidivave, 3 - Nga shpeshtësia jo e madhe e hipertoniqës pulmonare, 4. - Ngushëumi nö shkallë të dëkshme i vrimës venozë të majtë tek të vjetrit.

GJENDJA E VESHKAVE DHE METABOLIZMI ELEKTROLITIK

Shulga Ju. D., Belinskaja LI. P. Terapevtiçeski Arhiv 1964,8,74

Renot janë rrugë bazë e eliminimit të tepricës së natriumit dhe kaliumit. Sipas Birchel, Bricker etj. natriumi lehtë filtrohet në glomerula dhe në sasi të mëdha, duke përbërë 99% të pjesës së filtruar, reabsorbohet në kanale. Në konditati c'hiponatremisë reabsorbimi i natriumit rritet dhe eliminimi i tij ndërpritet Reabsorbimi aktiv i natriumit direkt mvarët nga influenca hormonale dhe neurohormonale.

Në dallim nga natriumi, kaliumi lehtë filtrohet dhe absorbohet plotësisht, pastaj sekretohet në pjesët distale të kanaleve. Në konditati fiziologjik proceset e filtrimit, reabsorbimit dhe eliminimit të kaliumit dhe natriumit lidhen ngushtë me bilancin hidrelektricitik të organizmit dhe në masë të caktuar përcaktohet nga influenca hormonale në rast. Por në dëshmi të ndryshme renale edhe në qoftë se mëkanizmat regulatorë nevrohormonale janë të rrujtura, vuaz metabolizmi hidrelektricitik.

Autorët përfshinë këtë gjithë studjujan kliniksin, reabsorbiminë dhe eliminiminë e natriumit, kaliumit, koncentrimin plazmatik tek të sëmurët me *morbus hipertonicus*, nefrit kronik dhe pielonefrit kronik. U ekzamuan 77 të sëmurë, me *morbus hipertonicus* 41, me pielonefrit krolik 28 dhe nefritkrolik 8. Në të gjithë të sëmurët me pielonefrit u vrejt baciluzia, saumë leukocite, fenomene dizurike etj.

Ulje e koncentracionit renal u vrejt në 17-18 sëmurë me pielonefrit.

Madhësia e filtracionit glomerular tek sëmurëve me *morbus hipertonicus* dhe pielonefrit është 90-130 ml, ndërsa me nefrit krolik 52-90 ml. Filtrimi, reabsorbimi dhe eliminimi i natriumit dhe kaliumit nga veshkatështë i ndryshëra dhe varet nga proceset e ndryshme biologjike.

Në të sëmurët me *morbus hipertonicus* u vrejt përmbytja normale e natriumit në urinë dhe plazëm. Në fenomenet e nefrosklerozës reabsorbimi i natriumit ulët 94-96% ndërsa madhësia e filtrimit ulët, koncentrimi në plazëm rritet dhe eliminimi ditor ulët.

Rezultatet e ekzaminimit të sëmurëve me nefrit krolik tregojnë mbi ulje e filtracionit glomerular, kjo lidhet me zhvillimin e insuficiencës renale dhe pakësimin i filtrimit të natriumit dhe kaliumit. Koncentrimi i tyre në plazëm është i lartë. Eliminimi ditor i elektrolitëve pak ulët, po kështu dhe reabsorbimi.

Më tepër lëkundje të metabolizmit elektrolitik u vrejtën tek të sëmurët me pielonefrit. Përbajtja e tyre në gjak (natriumi) më e ulët se në nefritin krolik dhe *morbus hipertonicus*. Reabsorbimi i natriumit më i ulët. Gjithashu dhe eliminimi më i ulët. Koncentrimi i kaliumit në gjak ulët po ashtu dhe reabsorbimi, eliminimi ditor i rritur gjë që pasqyron pakësimin e rezervave elektrolitike. Ulët reabsorbimi i kaliumit dhe natriumit në periuðdhënë e rriakutizmit të pielonefritit sidomos tek të sëmurët rëndë dhe me ulje të funksionit koncentrues renal.

Ndryshime të reabsorbimit dhe eliminimit të natriumit dhe kaliumit mvarët nga gjendja e sektorëve të ndryshëm të nefronit. Tek të sëmurët me *morbus hipertonicus* reabsorbimi dhe eliminimi i natriumit dhe kaliumit është i dëmtuar. Në nefritin krolik kur pakësht masa funksionuese e parçnikës renale, ulët filtrimi i natriumit dhe i kaliumit, ulët reabsorbimi, ndërsa koncentrimi i tyre në gjak është në nivel të lartë.

Pielonefriti kronik sidomos në akutizim karakterizohet me dëmtim të pjesës së kanalit të nefronit dhe më shumë në pjesën distale. Kështu prishet reabsorbimi dhe eliminimi i elektrolitëve me hiponatremi, hiponatriemi, hipokalemji dhe hipokaliemi.

Lëkundjet e metabolizmit të natriumit dhe të kaliumit sidomos tek të sëmurët me nefrit dhe pielonefrit kondicionohen me proceset patologjike në rane. Ndryshimet e reabsorbimit dhe eliminimit janë studjuar në pacientë duke i dhënë dietën e zakonëshme.

INFLUENCA E PREDNIZOLONIT NË AKTIVITETIN KARDIAK GJATË SËMUNDJEVE TË HEPARIT, RENEVE DHE REUMATIZMIT

Andrejev A.I. Kliničeskaja medicina 1965,1,79.

Deri më sot nuk ka mendime të njëjta mbi influencën e kortikosteroidave në muskulin kardiak. Sipas të dhënat kliniko-eksperimentale, kortikosteroidet nganjëherë tregojnë influencë negative mbi muskulin kardiak. (J. A. Kasirski, Lutz, Selys etj.).

Të 20 të sëmurët nga hepari morën mjekim me prednizolon kombinuar me vitaminë C, B₁₂, E₆, riboflavinë, me antibiotikë që dietë, doza e kurrit mesatarisht 330 mg. prednizofen. Gjatë terapiës u panë disa ndryshime nga ana e zemrës (palpitacione, arimi, tonë të shurdhëta, ndryshime në E.K.G.) dhe disa devijime nga ana e bilancit elektrolitik. Tek 10 të sëmurët u vrejt ulje e kaliumit në sasi jo të konsiderueshme.

Midis të sëmurëve 16 ishin me nefrit kronik dhe 4 me nefrit akut.

U bë mjekimi me prednizolon, 8 të sëmurë që kishin hipertoni kombinuar me rezerpinë. Në fillim u dha 5-10 mg. dhe pas 5-6 ditësh rritje doza deri në 50 mg. për 15 ditë me rradhë. U vrojnë re ndryshime nga ana e zemrës, në disa raste dhëmbje në formë stenokardicë, palpitacione, ndryshime në EKG, sidomos të dhëmbit T që flet për fenomene të hipoksise të miokardit. Në gjithë ditëshin e parë të mjekimit vretet rritje e kaliumit, natriumi apo ndryshe.

Të sëmurët me reumatizëm u mjekuan me prednizolon 617 mg. mesatarisht në kurs, kombinuar me salicilat që antibiotikë gjatë 4-8 javë u pa një ndikim pozitiv, dhëmbjet në zemrë u zhduken u zhduk dispneja, në atë që kishin ekstrastola, u vendos ritmi normal, tek shumica u ndërprënë palpitacionet dhe u vrejt inaktivizimi i procesit reumatizmal për të cilin flet normalizimi i sedimentacionit, temperaturës dhe shkuftimi i intervalit PQ.

Në EKG intervali që ishte nën vijën izcelektrike u ngjith mbi të. Dhëmbi T, nga negativ ose bifazik u bë normal. Bilanci elektrolitik nuk pësoi ndryshime.

Prednizoloni në zemër ndikon pozitivisti, ndërsa gjatë sëmundjeve të heparit dhe veshkave influencë negative. Por në proceset reumatizrale që rrjedhin bruske me forma recidivuese, gjatë prezenccës së miokardiosklerozës dhe shënjave të insuficencës kardiovaskulare shpesh vrehen reaksione negative të prednizolonit. Fenomenet anësore vrehen më tepër tek të sëmurët mesëmundje renale.

Sipas autorëve gjatë mjekimit me prednizolon si rezultat i ngritjes së ndjeshmërisë ndaj katekolaminave nga njera arë dhe grumbullimi i tyre në miokard nga ana tjetër, krijuhen kondita jo të facorëshme për miokardin, katokolaminat ritmit kërkësën për eksigjen dhe çojnë në hipoksinë e tij gjë që qëndron në bazë të fenomeneve anësore të kortikosteroidove.

MBI DISA VARIANTE KLINIKO-PATOLOGOANATOMIKE TË TETANISË GASTRIKE.

Klejn E.G. Sheinis M. I. Kliniqeskaia medicina 1965,2,58.

Vitet e fundit janë vënë re një numur i madh punimesh dedikuar tetanisë gastrike. Në punimet e tyre autorët kanë paraqitur studimin e tetanisë gastrike nga ana patologoanatomike shoqëruar me të dhënat klinike. Bazë për këtë shërbjen dy raste të tetanisë gastrike me dekurs mortal.

Më poshtë autorët paraqilin hollësicht rastet e studjuara.

Tetania gastrike vretet më tepër në stenozat e pilorit nga ulqera ose gjatë formave cirkulare stenozante të kancerit pilorit të stomakut dhe në disa raste në kuadrin e gjindjeve psikoneurologjike në mungesë të ndryshimeve anatomike.

Stomaku zakonisht është i zgjeruar dhe disa autorë kanë matur distancën midis kurvatuarë minor dhe major e cila arrin 45 cm, dhë pesha e stormakut 300-350 gr.

Të dhënat anatomopatologjike tregojnë se tetania gastrike nuk lind vetëm gjatë stenozës së dekompensuar të pilorit për dhe gjatë formave të subkompensuara që se rëndesi vendimtarë në zhvillimin e saj kanë faktorët funksionalë (vjetlljet e shpeshta, pilorospazmat dhë dobësimi përgjithëshëm i organizmit). Nga ana anatomopatologjike gjatë tetanisë gastrike vrehen fenomenet e një nefroze, me ndryshime distrofike dhe nekrotike në epitelin e kanaleve.

MBI ANEURIZMAT E ZEMRËS TEK PERSONAT E MOSHËS SË RE

Lebedjeva R.N., Kun I. S. Terapevtičeski Arhiv 1964,9,42.

Vitet e fundit është vënë re se shtohen rastet me infarkti miokardi tek të rinjtë (M.N. Gureviç, Dufan etj). Disa autorë sjellin raste të zhvillimit të aneurizmës tek të rinj pas infarktit të miokardit të kaluar. Nga 67 të sëmurë me aneurizmë të zemrës të vrejtur nga autorët në 11 ajo u vrejt në moshë nga 25-34 vjeç (pas infarktit):

Sipas A.I. Abrikosov dhe LL. M. Rahlin vënd me rëndesi në etiologjinë e infarktit zë spazma funksionale dhë kanë vrejtur tek shumica aterosklerozën e herëshme.

Sipas disa autorëve rol midis faktorëve patogenetikë që ndihmojnë infarktin në moshë të re është lodijs fizike me lindjen e nekrozave në muskulaturën e zemrës gjatë aterosklerozës koronare. Sipas Raab në lindjen e insuficiencës akute koronare gjatë lodijs fizike rëndësi ka agjitia e përmbytjes së katekolaminave, (noradrenalinë, adrenalinë) në gjak që çon në hipoksinë e miokardit.

Në rastet e studjuara nga autori statusi anginoz tipik që shoqërohej me kolaps u vrejt në tre raste. Ndërsa tek të tjerrt u vrejt dekursi i lehtë i periudhës akute të infarktit të miokardit.

Diagnoza e aneurizmitës në të gjitha rastet ishte vënë në bazë të klinikës dhe metodave speciale të ekzaminimit. Në rontgen njolla aneurizmatike duken në formë fryje të konturit të ventrikulit të majtë. Me anë të elektro-rontgeno-kimografisë u vnuë re pulsacione paradoksale.

Gabimet diagnostike konsistonë në atë që infarkti i miokardit zhvillohet në moshë të vjetër, mungesa tek këtë të sëmurë të periudhës së pre infarktit, mungesa e anamnezës kardiake dekursi i lehtë klinik i infarktit të miokardit.

MJEKIMI I ARITMISË PERPETUA.

Cernigorov I. A., Terapevtičeski Arhiv., 1964, 8, 9.

Sinteza dhe ndarja e lëndëve të ndryshme ushqimore dhe transportimi nëpërmjet membranave celulare lidhet me rregullimin e elektrolitëve, më tepër të kaliumit dhe natriumit. Në këtë ambient jonesh rëndësi ka kaliumi. Luan roj kryesor në procesin e eksitimit dhe frenimit veçanërisht të celulës së miokardit duke përcaktuar shkallën e cksitimit të celulës. Antagonist i kaliumit në organizmin e gjallë është natriumi që është një kation i rëndësishëm intercelular.

Lidhjet normale të kaliumit dhe natriumit përcaktojnë funksionin normal celular. Insuficiencia e kaliumit bën ngritjen e eksitabilitetit të celulës ndërsa teprica e tij bën frenimin e celulës muskulare.

Më shumë rëndësi ka mijekimi i aritmisë së përhershme që është e prezikeshme për funksionin e zemrës dhe dobëson punën e saj deri në insuficiencë, ose çon në emboli të enëve të organeve osc indeve.

Wenokebach i pari tregoi veprimin e favoreshëm të kinidinës gjatë aritmisë perpetua dhe Frey përpunoj metodën e aplikimit të kinidinës. Më e arësyeshme është përdorimi sipas Bider, Goldberger etj. 4-6-8 gr. në 24 orë.

Nga autorët janë mijekuar 45 raste me kinidinë dhe kanë arritur efekt në 13 persona me doza 0,8-3,2 gr. në 24 orë. Koncentrimi i kinidinës në gjak përcaktion dhe efektin e saj. Koncentrimi i saj maksimal arrin pas 2-3 orës aplikimi dhe gjysma e koncentrimit arrin pas 8 orë. Ulja e aritmisë shkon paralel me ndryshimin e koncentrimit të kinidinës (Sokolov, Adgard etj.). Prandaj kinidina duhet të aplikohet qdo 2 orë.

Autori ka aplikuar kaliklorat 10%-40 cc 3-4 herë në ditë dñe është zhdukur aritmia perpetua në ditën e parë dhe të tretë (me origjinë pas infarktit). Rezultatet janë arritur në takiaritmë perpetua të mijekuar me kinidinë 2-3 gr. në ditë gjatë dy ditëve.

Prokainamida është më efektive për të ndërprerë paroksizmat e aritmisë perpetua. Intravenoz ajo aplikohet në raste të tralla p.sh. gjatë infarktit të miokardit kur aritmia përpeta keqësion prognозën dhe çon në zhvillimin e insuficiencës kardiovaskulare. Intravenoz aplikohet 0,2-0,5 gr. dhe në qoftë se nuk ka efekt përsërijet pas 20-30 minutash. Përdoret intramuskular 10% 5 cc qdo 4 orë. Kursi i mijekimit 3-18 ditë. Autori ka mijekuar 24 të sëmuar me takiaritmë perpetua dhe në 19 ka marrë rezultate të mira. Në disa raste për ndërprerjen e paroksizmave efekt të mirë ka përdorimi i kaliumit në formë kaliklorati.

Në 26 të sëmuar është studjuar niveli i kaliumit dhe i natriumit dhe është parë se jashtë krizave kaliumi është baraz me 16,9-19 mg. natriumi 308,4-348,4 mg%, në kohën e krizave u rrit kaliumi 20,6 mg% dhe natriumi nuk ndryshoi. Përdoret sot dhe kofermenti kokarboksilazë e cilë nga autori u aplikua tek 18 të sëmuar me aritmë perpetua 100-200 mg. intramuskular, rezultati i saj ishte jo fortë i mirë.

(Përbledhur nga M. Kostaqi)

NDRYSHIMET ELEKTRO-KARDIO GRAFIKE GJATË HEPATITI VIRAL

Romano V. Caputo A. Di Stasio G. Manzillo G. Mattano F. Squame G.
«Giornale di Malattie Infettive e Parassitarie» 1964, 4, 233

Gjatë hepatitit viral paraqiten raste me dëmtime kardiak që çfagen me ndryshime elektro-kardio-grafike. Këto raste janë vështirë në dukje nga shumë autorë dhe përgjindja e paraqitjes së tyre ndryshon sipas autorit. Lonis ka konstatuar 51% të rasteve, Abendroth 79%, kurse Schenethen 9%.

Këto ndryshime e.k. grafike janë pëlhavaje gjithmonë të kalueshme, dhe e.k. grama normalizohet në kohë të ndryshme nga çasti i çfagies.

Azajt shpjegon i sigurt nuk është dhënë për këtë iövizio patologjike, përvç se në disa raste që ka konstatuar Zaphire. Ky, në repertin istologjik niste për një myokardit nga lokalizimi i virusit në nivelin e elementove të tesuitit muskular dhe n'atë specifik. Në fakt ka shumë mendime përfi interpretimin e tyre. Këto mendime konsistonë: në paraqitjen anormale të kripave biliare në zarkullim, në një gjendje disprotoneimike, në çregullimë metabolike të oksidimit të myoka dit ose në një gjendje auto-agresivë imunitare (Dekitis, Reichert, Sternung). Nga ana tjetër rënditet ndryshojnë nga karakteri, mekanizmi putogjekik ashtu dhe nga ana etiologjike.

Autorët e këtyrë artikulli kanë studjuar raste të tyre përfi përcaktuar lidhjet e këtyre ndryshimeve me moshën, me nivelin e disa enzimeve serike dhe me nivelin e bilirubinës. Këta autorë kanë studjuar 82 pacienta me hepatit viral me formë ikterike dhe anikterike, gjith'ashtu dhe dy raste me komë hepatike. —

Rezultatet e tyre janë si vijon: 43 raste me e.k. grame normal 2 me ekstrasystole ventrikulare, 1 rast me vonesë konduktim atrio-ventrikular (P.Q.=0,23), 27 me ndryshime të difuzionit intra-ventrikular dhe 3 raste me zgjatjen e traktit QT.

Nga ana e moshës ndryshimet çfagen me tepër midis 1-10 vjeç (70%), gjith'ashtu paraqiten si një forma ikterike ashtu dhe anikterike, gjë që shpjegon se faktori ikter nuk ka një rrol në këto ndryshime, edhe ato elektroliktikë nuk kanë luajtur rrolet. Autorët në fjalë shprehin mendimin se dëmi që i shikaktohet Myokardit dhe tesuitit specifik, ka lidhje me sasi të plasmatike të enzymeve, të shiuar nga nekroza e epatocyteve. —

NJI RAST ME KARCINOMA TË TYROIDES NË NJI FËMIJË TE PORSALINDUR

E. Merues dhe M. Ross
«British Medical Journal» 1964/ Vol. I Nr. 5377 224.-

Karcinoma të gjendrës tyroide në fëmijë të porsalindur janë të rralla, me gjith'se janë përshtkuar disa raste të tillë nga Winship, Hayles etj.

Rastin që përshtkuajnë autorët i përket një fëmije të porsalindur, i cili ka lindur në term, me sekstin fémor, afrikana nga Rodezia; u aplikua seksio se paraqiste placenta previa e cila shkaktoj hemoragi paralindje. Paraqiste gjëndlën tyroide shumë të rritur e cila e detyronte fëmijën të mbante qafen në ekstension. Përpjekje reanimonjëse rezultuan pa efekt dhe fëmija vdiq. Nutk ka patur azaji herë eksponuese radiologjike.

Në autopsi u konstatua se gjëndra tyroide ishte shumë e rritur (5.3 cm. përmes lobeve laterale). Në anën e majtë të trakeës shifjet një tumor i butë i cili shkaktonte okluzionin e saj. Rotull saj tesuti i tyroides kishta ngjyrë jeshile kurse pjesa tjeter ngjyrë mavë. Mushekëritë ishin ajresan mirë. Anomali të tjera nuk paraqistën.

Nga ana histologjike rezultoi një adeeno-karcinomë papilare

Pa mundësia e fëmijës për të qarë në çastin e lindjes dhe paraqitja histologjike e mushkëtive shpjegohen nga obstruksioni i trakës i cili pengoj ekspiracionin duke krijuar një enfizemë obstruktive që konsiderohet shkaku i vdekjes.

Në territoriu ku jeton nëna e fëmijës ka nji struma epidemike dhe rritja e tyroides asht e zakonshme; thuhet se struma ka lidhje me karcinomën e tyroides, me gjith'se nga shumë autorë nuk pranohet. Faktor hormonal tyroido - stimulues dhe shumë faktorë të tjere mund të kenë një lidhje për të përcaktuar këtë gjendje.

MJEKIMI I PORTATORVE TË TIPOS ABDOMINALE ME AMPICILINE

A.B.Christie «British medical Journal» 1964 VOL. I, nr. 5398, 1609

Efekti i Chloramphenicolit në terapinë e tifos abdомinale është një triumf terapeutik në fushën e antibiotikëve, por ky mjekim pas kalimit të periudhës akute, nuk siguron konvaleshenëcën e lirë nga infeksioni dha nuk garanton që pacienti të mos bëhet një portator.

Per mjekimin e portatorëve janë përdorur medikamenta të ndryshme si penicillino-terapia e bashkuar ose jo me sulfonamide, antibiotike të tjera të kombinuar ose jo me kortizonet, por të gjitha këto kanë rezultuar pa efekt dha kolecystektomia mbetet, në kohën e antibiotikve, metoda më e sigurt për zhdukjen e kësaj gjendje.

Autori ka mjekuar 8 raste portatore, prej të cilave 7 ishin të sëmurë psikike të shtruar në një spital psikjatrik, për femra dhe me kohën e ospitalizimit prej 7-47 vjet, prej tyre 6 ishin portatorë të vjetër, depistuar prej 7-27 vjet ma parë dha ishia rrejkuar me periudha të ndryshme me penicilinë, streptomisinë, sulfonamide, farazolidone dhe kloramfenikol të kombinuar ose jo me kortizone, por pa patur asnjë efekt. Pacientja e 7-ta ishte ospitalizuar para 36 vjetësh dhe si portatore u verifikua vonë, me 1962.

Pacienti i 8-të pëntor në kantinen e një shkolle, në kohën e zbulimit të tij si portator, ka patur të sëmurë me tifo abdominale dy pjestarë të familjes së tij dha një oxenëse të shkollës ku punonte vetë, por pësonali i nuk ka patur asnjë histori tifike.

Të 8 portatorët janë mjekuar me ampicillinën me doza të larta dhe për një kohë të gjatë, për tre muaj rrjesht me anën orale, me përashtim të javës së parë, ku ampicillina asht përdoren me anën parenterale.

Medikamenti paraqiti në dy pacienta efekte toksike të tipit erytematoz, me elemente petekjale, por mjekimini vazhdoi pa ndërpërje.

Rezultatet e kësaj terapije paraqitet në këtë mënyrë:

Të 8 portatorët u negativizuan ditët e tretë dñe 7 prej tyre mbeten vazhdimi i negativ për një vit. Pacienti i 8-të mbeti në fillim për tre muaj negativ, pastaj u bë pozitiv për një muaj; u negativizua prap pas një cikël mjekimimi me ampicillinë për t'u rikthyer prap pozitiv. Me një fjalë me këtë pacient mjekuar nuk ka patun efekt.

Salmonella typhi asht një parazit intracelular dhe organizmi duhet të jetë për një kohë shumë të gjati nën influencën e medikamentit; por dozazhi i nevojshëm dhe koha e zgjatjes së terapisë me ampicillinë nuk janë ende të caktuara. —

Vazhdimi i terapisë për tre muaj ka dhënë rezultate inkurajuese. — Ampicillina duket se asht një medikament që nuk jep kaa efekt të mirë sa kloramfenikoli në format akute të tifos abdominale, por asht i kësilluarshëm të përdoret si plotësues pas mjekimit me kloramfenikol.

NJI BARAZIM TERAPIJE MIDIS AMPICILLINËS DHE KLORAMFENIKOLIT NË PARATIFO.

R. A. Sleet, G. Sansster dhe J. Mc Murdoch
«British Medical Journal» 1964 Vol. 1, Nr. 5376, 148

Roli i kloramfenikolit është skjaruar këto 10 vjetet e fundit. Ampicillina nuk është përdorur për mjekimin e tifos abdominale në një stil të gjërë për të vlerësuar superioritetin e saj eventual karshi kloramfenikolit.

Per këtë arsyë janë aplikuar të dy antibioticët në një epidemi, që u ç'faq pak kohë më parë me paratifo B phage tipi *Tauerton*- në zonën e Edinburgut ka patur frejt 200 raste, i infektuar nga nën produktet e miellit. —

Aktiviteti in vitro e tijhe në koncentrime të larta biliare rrefen se ampicillina vjen pas kloramfenikolit. Autorë si Maddock, Trafford, Patel, kanë referuar rezultate të mira në pacienta me *salmonella Typhi*, kurse n'infeksione nga *salmonella* të tjera efektet ndryshojnë

Barazimi direkt me doza të përdorura dhe me kohën e zgjatjes së terapisë nuk asht e mundur, por ampicillina asht përdorur midis 50 dhe 200 mg/Kg/ditë; doza akoma më të forta kanë dhënë rezultate më të mira. —

Të dy antibioticët, si kohë zgjatje e kurës Bazë janë përdorur për 14 ditë, me ndryshime simbas rastit, si doza për kloramfenikolin asht dhënë 2 kg. për të rritur dhe 75 mg./Kg. për fëmijët; doza përkufizë për ampicillinën ishte 6 gr. dhe 200 mg./kg. në rast deshtimi të nji antibiotic pas 10 ditë, asht zavendosuar me antibioticot tjetër. —

Janë mjekuar 145 të sémurë, prej të cilëv: 31 me forme të lehta, 88 të mesme dhe 13 të rëndë, gjithashtu 13 portatorë. Mosha e tyre ishte midis 6 dhe 87 vjeç, 91 femra dhe 54 meshkuj. Janë mjekuar me radhë pa seleksionim, 65 raste me kloramfenikol dhe 80 me ampicillinë.

Efekti i ampicillinës ka qënë me i ngadalshëm se sa i kloramfenikolit dhe normalizimi i temperaturës nuk ka qënë shpejt. Mesatarja 3 ditë normalizimi i temperaturës për kloramfenikol dhe 6 për ampicillinë. —

Ndonse nuk ekzistojnë kritere klinike për të patur si bazë për të çmuar efektin në nji barazim midis të dy antibioticëve për autorët paragjin këto të dhëna: 1) ampicillina nuk ka dhënë rezultate tek nji i sémurë me 10 ditë terapi, 2 recidiva kliniko-bakteriologjike ndodhën tek nji pacient, mjekuar me ampicillinën dhe dy me kloramfenikol, 3. recidiva bakteriologjike në 5 raste të mjekuar me kloramfenikol dhe nji me ampicillinë, 4. recidiva klinike në nji rast mjekuar me kloramfenikol. —

Nga ana e toksicitetit, ampicillina me doza të mëdha mund të shkaktojë sensibilizim të tipit penicilline, me rreziqë të njohur: këto janë paraqitur nji herë në 5 raste të mjekuara, paraqësht, nga përdorimi i kloramfenikolit në raste të rralla shkaktojnë rreziqë si asht aplazia medulare. —

Paraqitura e fenomeneve me sensibilitet kundrejt ampicillinës në mjekim me doza të mëdha asht nji pengesë sidomos në raste portatorësh nga ana biljare. Mjekimi me kloramfeuikol me cikle ose në mënyrë të vazhdueshme jep nji siguri definitive. —

EMETINA NË TERAPINË E GJENDJEVE SEPTIKE TË RANDA P. DHE V. SYNEK

«British Medical Journal» 1964, I, 1550

Emetina, alkaloidi ipekakuanas ashtë e njehur si medikament kundër dysenterisë amerike; gjithashtu si ndihmës për injekimin e alkoolizmit kronik dhe të herpes zoster.

Në 1958, Melchior ka raportuar se ka mjekuar disa raste me gjendje septike të randa; me emetime hydrochlorike, duke e përdorur atë si medikament të vetëm.

Autorët e këtij artikulli i kanë shpikuar këtë medikament në 10 të sémurë në gjendje septike të randë (të cilët kishin këto karakteristika; sëmundja e tyre ishte bakteriologjikisht e përcaktuar dhe nuk u nevojitesh terapija tjetër si p.sh. kirurgjikale; paraqitnin nji kuader klinik septik të randë gjithashu cmetina ashtë shpikuar në pacienta në 16 cilat pas përdorimit sistematik të antibioticëve të ndryshëm këto të fundit paraqitechin pa efekt. —

Si dozë iniciale emetina asht përdorur 2-3 ditë në 30 mg. 3 herë në ditë intramuskulare; pastaj doza ashtë paksuar në 20 mg. prap 3 herë në ditë, kura vazhdon për 10 ditë. Cjatë kësaj terapije nuk asht përdorur asnjë medikament me përmbytje kimike ose antibiotike. —

Efekti i terapisë çfaqet me zbritjen e temperaturës në të dytën ose në të tretën ditë, duke u normalizuar në të katërtën ditë, gjëndja e përgjithshme përmirëseshet dhe kultura pozitive e gjakut bëhet sterile. —

Duke komentuar këto rezultate të mira autorët shkrujnë se përdorimi i emetinës si agjent anti-mikrobiyal ashtë i jashlëzakonshëm; mbassi mjekimi me antibioticët ashtë nji irregull dhe rezultatet e tyre janë të njohura prandaj në nji periudhë prej 5 vjetësh kanë patur vetëm 10 raste që plotësonin konditit e laripërmendura për aplikimin e terapisë me emetine.

Mjekimi me këtë medikament me doza të mëdha mund të shkaktojë toxicitet çfaqur me vomitus, arytmie, hypotermi; në disa prej këtyre rasteve ka shkaktuar vëtëm nausea e cila nuk u ba pengesë për vazhdimin e terapiës. —

Raste të mjekuara me emetinë kanë patur sepsis me origjinën stafilokoksike, streptokoksi, E. Koli, Ps. aerogeni që proteus. —

Efekti antimikrobiq i emetinis nuk çfaqet vetëm në entameban histolytike (Vadher, 1912). Tani në fund asht studjuar efekti i saj në stafilocok, në nji koncentrim prej 0.0125 mg/ml, emetinës (baza) ka dhënë inhibus në kulturë. —

Efekti antimikrobiq direkt asht në studim e sipër.

PLEURITET ME ORIGJINË PANKREATIKE

J. WITZ DHE PH. REYS.
«La Semaine des Hôpitaux» 1964, 40, 1638

Pleuritet me origjinë Pankreatike konsiderohen ata që rrjedhin si një komplikacion i një pankreatiti akut ose kronik; përjashtohen rastet me plurit hemoragjik shkaktuar nga metastaze ose një kanseri pankreatik dhe ato sero-fibrinoze tuberkolare që paraqiten gjatë një pankreatiti kroistik kahektik.

Gjatë një pankreatitit akut paraqiten komplikacione nga ana e mushkërtive si atelektazia ose edëme lokalizuar në regionin hilar ose të bazave, më të shpeshta janë pleuritët nga një ose nga të dy anët me likuid të pakët ose në sasi në këta të funksionit likuidi më veprim enzymatik të lart jep fenomene inflamatore dhe shtrihet drejt parenkymës së mushkërtive duke kaluar këshfu «barierën» e pieurës.

Zakonisht fenomene pleurale marrin një randësi të dorës së dytë kundrejt atyre abdominale por shpesh dominojnë kuadri i klinik dhe kështu janë një drejtim në diagnozë. Likuidi shumë herë jep shënya të origjinës pankreatike, asht i verdhë ose sero-hemoragjik, albumina asht e rritur dhe ka një shtim të theksuar të eosinofileve. Por ajo që ka një randësi të shëndetë pozitiviteti i amylazas, i cili paraqitet zakonisht më i lartë se sa në gjak. Kjo shënjë nuk asht gjithmonë e besimit se ka raste ku amylaza në likuid është në shifra normale, gjithashtu paraqitet pozitive në pleuritë me origjinë të ndryshme si në Hodgkin dhe në metastaze të kanserit të tubit digestiv ose bronkial.

Diagnoza e etiologjisë pankreatike ka një randësi të veçantë pse lidhet me terapinë etiologjike. -

Mekanizmi patogenik i këtij komplikacioni bazohet: në përrapjen hematogene të enzyeve pankreatike si dhe me anën e trugës lymfatike, gjithashu në brerjej që langu pankreatik i shkaktion direkt kopolës diafragmatike me gjith'se nuk gjindet asoj i herë përforacion i vertetës i diafragmës. -

Terapija me qenë se pleuriti asht sekondar, i drejtuhet kryesisht pankreatitit me arsenalin e njohun, dieta, anti-enzymatike dhe eventualisht ndërryjet kirurgjikal. Ka raste që fenomenet pleurale zhduken pa asnjë terapi të veçantë sidomos në raste të një pankreatiti të lehtë por shpesh në terapinë etiologjike duhet të shtojmë dhe një mënyrë tharje të liquidit me anën e ponksioneve ose me drenazhe. Bashkim i anti-enzymeve në likuidin pleural mund të japi rezultate të mira me gjith'se ky mijskim kundërshtohet nga shumë autorë. Masa e fundit për raste të rëndë ashtë dekortizimi kirurgjikal i pleures, për t'evituar surinfeksione dhe fistula pleuro-pulmonare.

ANKETË MBI REZULTATET E TERAPISË SË HEMOKROMATOZËS ME ANËN E HEQJES SË GJAKUT

M. Tutti
«La Semaine des Hôpitaux» 1964-17-729

Efekti i heqjes së gjakut për arsyen terapeutike në pacienta me hemokromotoza nuk diskutohet por duhet përcaktuar çfar rezultate mund të presim prej kësaj metode. -

Autori ka studjuar 76 raste me këtë sëmundje trajtuar me anën e sallasos i aplikuar periodikisht. -

Sasia e gjakut të hequn dhe frekuencë ndryshon sërëbas autorit që përdor këtë metodë. Conte, aplikon sallasos çdo 5 ditë nga 500 ml, Denis 700 ml, çdo 10 ditë, kurse Caroli 300 ml, çdo javë.

Të sëmurët rezistojnë mjaft në këtë terapi po të marrim parasysh se Woward i ka hequr një pacient 96 litra gjatë dy vjetve, Davis dhe Arrowsmith 50 litra në 60 javë dhe Lind 35 litra në 5 muaj. -

Gjatë aplikimit të kësaj terapije duhet vëzhguar numuri i globuleve të kuqë dhe dozazhu i protidemisë; por mbi të gjitha duhet të kihet parasysh sasia e emoglobinës të qëndrojë në 11-12 g. në 100 dhe kështu të jepet mundësija e regenerimit të medullës.

Kur ritmi i sallasos asht i arsyeshëm (500 ml. në javë) rreziku i anemisë asht i rrallë, me gjith'këtë shkaktimet që kanë relative; por qëllimi i kësaj terapije asht të krijohet një anemi duke synuar në një mobilitizim të shpejt të hekurit nga depozitimet e tij n'organe të ndryshme dhe përdorimi i tij për henopoezën. Hypoprotidemia paraqitet rrallë, në këto raste ka mundësi të korigohet.

Indikacionet e kësaj terapije janë të gjera me përjashtim të rastevt kur ka dëmtime kardiale dhe dekompensive cirotike (ciroze bronzi).

Rezultatet e kësaj terapije në fushën klinike vejnë në dukje një permirësim në vështrim të zhdukjes së astenis dhe shtumin në peshë, gjë që arrin në 77% të rasteve, në vështrim të paksimit të hepatomegalisë në 53, paksimi i pigmentacionit arrin në 47%, kurse ekziston diabeti veprimi i kësaj terapije është i pakët.

Nga ana biologjike kemi një përmirësim në provat hepatike kur ekziston insuficencia hepatike; sidoremia paksoshet në 50% të rasteve dhe në mënyrë specifike në rastet kur heqja e gjakut asht ma tepër se 30 litra.

Nga ana histologjike me anën e ponksionit – biopsihepatik asht konstatuar një paksim i siderozës hepatike i cili arrin në 73% të rasteve kurse skleroza hepatike mbetet e pandryshuar.

Përsa i përket kohës që duhet zgjatur terapija është vështrimi të përcaktohet, si bazë duhet marrë eliminimi i paktën 15 gr. hekur (rrëth 30 litra gjak) dhe mivaret kryesish i shpejtësia e mobilizimit të hekurit, –

Si konkluzion autorit mendon, se sot heqja e gjakut mbetet metoda ma e mirë për mjekimin e hemokromatozes me gjith'se kursi i evolucionit të sëmundjes nuk modifikohet.

(Përmbledhur nga Ll. Dhimitri).

TRAJTIMI I FRAKTURAVE TË DIAFİZËS HUMERALE ME ALLCI TË PËRVARUR

G. Rocco Viscontini A. Magistroni
Min. Ort. 1964, VOL. 15, 285-290.

Autorët jepin një përshkrim të literaturës, në mjekimin e frakturave të diafizës humerale me allci të përvvarur sipas Caldwell.

Metoda që është përshkruar nga Caldwell me 1933 dhe e përdorur nga autorët anglosakson konsiston:

Një bandazh allcje i thjeshtë cirkular që kap ekstremitetin superior nga eksilla deri në dorë duke lënë të lirë pjesën radiale. Parakrahun mbahet në gjysmë pronazion me bryl të flikuar në 90°.

Një unaze allcje fiksohet në nivelin e byzylykut të dorës ku fiksohet një fasho që kalon në qafë.

Autorët me këtë metodë kanë njeruar 34 frakturna diafizare të humerusit, prej të cilave 11 në të tretën superiore, 16 në të tretën e mesme, 7 në të tretën inferiore.

Të gjitha rastet kanë pasur rezultat të mirë. Së fundi konkludohet se metoda e mesipërme në krasim me metodën torakobrakiale ka me shumë avantazhe në një shenjë më të shpejtë dhe funksioni mbas mjekimit do të jetë i mirë. Kjo metodë kësillohet të përdoret në të gjitha frakturat e diafizës humerale.

33 burime

FRAKTURAT NËR FËMIJËT

P.A. Wade Amer J. Surg, 1964, V. 107/3,531-536,

Principet e përgjithëshme në trajtimin e frakturave diferencohen simbas pacienteve që trajtohen, në se janë fëmijë ose të rritur.

Mungesa e observimit ose e mos njojjes të këtyre normave mund të çojë në gabime terapeutike me konseguencia të rënda. Tipat e frakturave si dhe indi kockor i fëmijve janë të ndryshme prej atyre të të rriturve dhe potenciali i rritjes nër fëmijë është më i madh. Kështu që dhe një spostim i konsiderueshëm dhe shkurtim i ekstremitetit të frakturuar nër fëmijët, mund të korigohen nga kallusi që rimodelon kockoren, sipas rrethit të saj normal. Edhe angolaci është deri në 20-30° mund të zhduken, ndërsa deformimi në rotacion të fragmenteve mbetet i pa ndryshueshëm. Për faktin se epifizat janë qëndrat e rritjes, dëmtimet e saj si vihen re shpesh në frakturat e brylit bëjnë mjaft përjashtim nga normat e përgjithshme dhe janë shumë të rezikshme. Rastet e mungesës së konsolidimit janë mjaft të rralla nër fëmijë, me përjashtim të rasteve kur janë përdorur pallaka ose vida metalike, që tolerohen këq nga kockat e fëmijës. Për këtë ndërrhyra kirurgjikale me fiksacion intern të kockës është i dëmshëm.

EKSPERIENCA E PARË NË PËRDORIMIN E FERMENTEVE PROTEOLITIKE NË PRAKTIKËN ORTOPEDIKE

I. I. Talko K.N. Veremenko
Ort. Trav. Protez. Nr. 1964, 11 f. 28-32

Në artikull paraqiten rezultatet e studimit klinik mbi përdorimin e preparateve të trypsinës kristalike dhe kimiotripsinës në 30 të sëmuarë me tuberkuloz osteoartikular, të bëra në Institutin e Ortopedis dhe Traumatologjisë në Kiev.

Preparati i tripsinës dhe kimiotripsinës të pregititura prej K.N. Veremenko janë përdorur në këtë studim, intramuskular. Në studim janë marrë 22 të sëmurrë me tuberkuloz të *articulatio cæxae* dhe të artikulacioneve të tjera; 8 paciente me sëmundje inflamatore akute e kronike të artikulacioneve.

Nga 30 të sëmurrë në 27 raste, veprimi i enzimës ishte i favorshëm: antiinflamator, anti-edematoz dhe antialgjistik. Në rastet me rigiditet të artikulacioneve si rezultat i lëzonit tuberkular, enzima e kombinuar me fizioterapi dhe gjymnastikë ka ndihmuar në restaurimin e lëvizjeve. Preparati është përdorur qdo dit nga 5 mg. për 10-15 dit.

22 burime literature

FRAKTURA E SKAFOIDES TARSALE

R. Garelli, G. Parenti
Min. Ortop. 1964, 10 511-516,

Autorët si bëjnë një përshkrim të etiopatogenezës, klinikës dhe mjekimit në frakturën e skafoïdës tarsale paraqësin 32 rastë e tyre me frakturën e kësaj kockë.

Për mjekimin e frakturës të skafoïdës tarsale kur nuk kemi spostim të fragmenteve, aplikohet çizme e shkurtër allçi e modeluar mirë, sidomos në harkun plantar, për një periudhë 20-60 ditë, sipas rëndësisë së lëzonit. Në dy raste frakturë me luksion autorët kanë përdorur reposicion jo kruent me traksion bipolar mbi *os calcaneus* dhe mbi metatarsare sipas Hohë. Në dy raste fraktura komunitative kanë aplikuar artrodeze mediotarsike. Gjashtë muaj mbas mjekimit në 10% të rasteve kanë patur invaliditet. Autorët janë përmjekim kruent vetëm në rastet kur nuk mund të reponohen konservativisht. Në rastet e frakturës të skafoïdës që indikohet operacioni pothuaj gjithmonë, bëhet artrodeza mediotarsike për të patur një këmbë të fortë pa dhimbje dhe të vlefëshme përfunksion.

35 burime literature

DISA ÇËSHTJE TË MJEKIMIT TË SOTËM KONSERVATIV TË LUKSACIONIT TË FEMORIT NË FËMIJË

Prof. M.N. Gonçarova Ort. Trav. i Protezir 1964, 10,9-14,

Autori në artikull i përbahet mjekimit të hershëm anatomik dhe fukSIONAL të luksacionit të femorit në fëmijs. Kur kanë raste të lehta displazie nër fëmij, përdorin jastëkun e Freikës. Kur fëmija ka displazi të rëndë dhe është mbi 6 muaj përdor për tre muaj imobilizimin me allçi në pozicionin e parë të Lorenz, pastaj po të konstatohet qëndrimi i mirë aplikon aparatin funksional të Gnevkovskit. Tek fëmijët mbi një vjeç deri në 2-3 vjeç në fillim aplikohet ekstension për 8-12 ditë në peshë deri 2,5-3,5 kg. në qdo këmbë. Ekstensioni vazhdon duke rritur abduksionin në 70-80°, në këtë pozicion koka shpesh reponohet vetë. Mbas reposicionimit vihat në aparatin e Gnevkovskit. Kur ka tendencë për reliksim aplikojmë allçi në pozicionin e parë të Lorenz për tre muaj pastaj aparatin e Gnevkovskit. Mbi moshën 2-3 vjeç përdoret operacion.

Rezultati i keq i mjekimit nvaret nga: 1) fillimi i vonë i mjekimit mbi 2-3 vjet; 2) reponimi me forcë në një moment; 3) imobilizimi i gjatë në allçi duke mos funksionuar artikulacioni

NJË METODË E TRAJTIMIT TË FRAKTURËS SË DIAFİZËS TIBIALE

R.R. Rix. Surg. Gyn. Obst. 1953, 117/5, 647—650.

Është përshtkuar një metodë e reponimit të frakturës së diafizës tibiale pa anestezi.

I sëmuri qëndron ndenjur me këmbë të fletkuar mbi koftshën e mvarur. Pesha e këmbës dhe e pjesës distale të kercirit të frakturës janë të mjaftueshme për me arrijetë një reponim të mirë të fragmenteve. Në pozicionin e paraqitur për të zhdukur dhimbjen infiltrojmë lokalisht

nevokainë. Vihet allçi poshtë gjurit, duke lejuar ekuinizëm të këmbës me qëllim që të arrijnd një dobësim të theksuar të muskulaturës. Kur këjo allçi ka bërë një fiksim të mirë të fragmenteve, e zgjasim deri në kofshë, duke e mbajtur të sëmurin në këmbë me ekstremitetin e frakturuar të mvarur dhe pesha mbi ekstremitetin tjetër.

Mos konsolidimi me anët e kësaj metode ndodh rralë dhe kallusi formohet mjaftë shpejt.

RONTGENTERAPIA NË MJEKIMIN E ARTROZËS TË ARTIKULACIONIT SKAPULOOMERALE

G. Repossi Min. Ortop. 1964, Nr. 11, 522-523.

Autori ka paraqitur rezultatet e rëntgenterapisë të bëra në 156 të sëmurë me artrozë të articulacionit scapulo-omeral. Nga aplikimi i rontgenit 62% e të sëmurëve kanë patur shërim, 35% përmirësim. Në artikull konkudohet se duke u kombinuar rontgenoterapia me mjekim antiartritik të përgjithshëm, rezultatet do të janë mjaft të mira. Rontgeni është mire të aplikohet dhe në regionin cervical pse shpesh shoqerohet me artrosë cervicale.

14 burime literatyre

DISA ÇËSHTJE TË MJEKIMIT KIRURGIKAL TË SYNDACTYLIS NË FËMIJËT.

F. Z. Faizullina Ortop. Trav. Protez. 1964, 11, 13-17.

Në artikull është përgjithësuar eksperiencia e mjekimit të syndactylis nër fëmijët.

Autori ka përshtuar metodat e trajtimit të 46 pacienteve, tek të cilët janë kryer 109 operacione për ndarjen e gishtave nga njëri tjetri.

Në 62 operacione është përdorur plastike e lëkure. Në 24 syndactyli është përdorur plastike lokale e lëkurës e kombinuar në plastikë të lirë.

Rezultatet më të mira i ka dhënë kombinimi i plastikës së lirë me atë lokale. Mosha më e preferuar për operacion ka qënë 5-7 vjeç.

33. Burime literatyre

METODIKA DHE REZULTATET E LARGËTA TË MJEKIMIT TË TUMOREVE MALINJE TË KOCKAVE ME REZEKSION BIOLOGJIK

A. Gruca, T. Vitickii dhe G. Leshek - Zapendovska Ort. Trav. Protez. 1964, 9, 51-56

Autorët kanë paraqitur eksperiencën e 64 rasteve me tumore maligne të kockave që i kanë mjekuar me rezeksion biologjik. Rezeksioni biologjik në dallim nga rezeksioni anatomik i kockës, ruan vazhdushmërinë e kockës duke shkatuar në të njëjtën kohë sektori e dëmtuar. Qëllimi i operacionit konsiston në elektrokoagulimin e kockës së dëmtuar. Kocka e nekrotizuar lihet në vënd dhe qëndron si karkasë në bazën e së cilës do të formohet kockë e re nga indet e buta përreth dhe kocka e shëndoshë. Përkëtë përdoret aparat me forcë korenti 15-20 a.më dy elektroda aktive (diametër 2-10 mm). Koagulimi fillon nga kufiri i shëndoshë i kockës, duhet të ruajmë indet e buta dhe tuftën yazo nervoz. Indi kockor nuk duhet djugur krejtësisht, pse pengon veprimin e korentit në thellësi. Mbas koagulimit kocka fiksohet me shtift ose auto apo hënotransplant dhe imobilizim në allçi tretë 3-6 muaj.

Indikacion për rezeksion biologjik: sarkoma osteogene, kondrosarkomë, fibrosarkomë, sinovioma maligna, osteoklastoma maligna dhe metastaza të izoluar brënda organave.

Kontraindikacion: Ekzistencë e metastazave, shtrirje e gjërë që nuk kanë indet e buta, prekja e tufës vazonervore, frakturna patologjike. Rezultatet e kësaj metode nuk kanë qënë me të këqia nga operacionit gjymtoqijëss. Përkëtë autorët mendojnë se ndodh një reaksion imunobiologjik nga thithja e produkteve të metabolizmit nga indi tumoral i koaguluar, e cila frenon zhvillimin e metastazave ose recidiven lokale.

4 burime literat;

MBI METODËN E EKSTENSIONIT SKELETIK NË FRAKTURAT E FEMORIT NË FËMIJË

B. V. Domanskii Ort. Trav. i Protez. 1964, 5, 41-43

Për mjekimin e frakturave të femorit nër fëmijët deri në tre vjeç preferohet törheqja sipas Shede. Deri në këtë moshë çvendosjet aksiale ose gjatësore që mund të mos korrigohen nga ekstensioni sipas Shede, nuk merren parasysh pse mbas 3-6 muaj ato rregullohen vetë. Për korigimin e deviacioneve mbi tre vjeç është e vështirë të bëhet vetë. Prandaj autori në këtë moshë rekomandon ekstension skeletik me spic Kirschner si për epikondylleve. Femori me trupin e shtrirë mbahet në kënd 90° Deviacionet aksiale i korrigojmë me tërheqje anësore. Me këtë metodë janë kuruar 12 fëmijë.

MJEKIMI KIRURGIKAL I RUPTURËS TË LIGAMENTIT KRUCIAT TË GJURIT

Prof. L. G. Shkolnikov, I. A. Vitjugov dhe Rostovskaja Ort. Trav. Protez 1964, 5, 16-21.

Autorët propozojnë mjekimin e rupturës së ligamentit cruciat duke e zëvëndësuar me pjesën mediale të meniskut kur është rupturuar longitudinalisht. Për këtë hapet një kanal në kondylin lateral, pjesa e brëndësimeve e meniskut pritet në *cornu anterior*. Menisku futet në kanalin e kondylijit së basbku me një transplant kocke. 4-6 javë imobilizim në këndin 140°-150°. Autorët kanë operuar me këtë metodë 27 të sëmurë me rupturë të ligamentit *cruciat anterior*. Vetëm në dy raste kanë pasur rezultat të keq.

19 burime literatyra.

EKSPERIENCË KLINIKE ME NJË PREPARAT TË RI ME BAZË TË PIRAZOLONEPIRASOLIDINË NË FUSHËN E TRAUMATOLOGJISË

A. Biondi Min. Ortop. 1964, 15, 409-411,

Preparati me bazë pirazolone- Pirazolidin që në shitje e gjejmë me emrin Tomanol është përdorur me sukses dhe në traumatologji. Autori ka përdorur në tre grupe të smurësh. Grupi i parë prej 35 të sëmurësh 20 prej tyre me gjendje mbas *haemorrhrosis* 11 mbas frakturave të patellës, 4 mbas meniscektomie. Grupi i dytë 20 të sëmurë me forma artrozike të gjurit. Grupi i tretë përbëhet nga 20 raste të sëmurë me lombosciatalgi, 5 raste cervikobrakialgi, 7 raste periartrit të skapulës.

Medikamenti është përdorur një javë intramuskular nga një flakon 2 cm³ në ditë që përmban 0.48 isopirin, 0.24 fenilbutazon. Javën e dytë vazhdojnë suposte një në ditë.

Nga përdorimi i medikamentit në të sëmurët e mësipërme, u pa një efekt i mirë antiflogistik dhe antalgik.

Preparati ka kontraindikacion vetëm në kardiopatite e rënda, lezione hepatike ose renale, ulcerogastroduodenale dhe tendenca për retension hidrik.

KONSIDERACIONE MBI EPIKONDILITET DHE TRAJTIMI I TYRE

B. M. Santolini S. Furlanetto Min. Ort. 1964, 15, 388-391

Autori si flet për etiopatogenecën e epikondiliteve dhe simtomatologjinë që karakterizobet noga dhimbje në faqen anterioreksterne, të brylit në nivelin e epikondylit dhe nga njëherë pak mbi të. Dhimbja shkon poshtë në anën dorsale të parakrahut. Shpesh ka insuficiencë funksionale, ndjen dhimbje sidomos gjat ekstensionit të dorës dhe pronosupinacionit. Pamja e brylit nga

jashtë normale, por kur e shyp me dorë epikondylin ka shumë dhimbje. Për mjekim përdorim qelsi, aplikacione nxehtrësie medikamente antiaritritike, fizioterapi si ultratringuj, Rontgen, infraruzh, fanghjoterapi etj. Shpesh aplikojmë dhe imobilizim me allçi.

Nga me efikaset është rontgenterapia dhe ultratringujt. Me sukses përdorot hidrokortisoni lokal një herë në dy dit nga 1 cc shpesh e shoqëruar me 2 cc novokainë. Në rastet që kjo terapi s'ka sukses bëhet operacion dekorticacion parcial i epikondilit ose fashiotomi e thjeshtë.

Autori ka kuruar 29 raste me epikondilit. Në 24 rastë ka përdorur me sukses terapinë inkruente dhe në 5 rastë terapinë kruçante. Rezultatet mjaft të mira. Dy vjet mbas trajtimit asnjë s'ka patut recidiv.

OSTEOSINTEZA PERKUTANE NË FRAKTURAT KOMINUITIVE TË EPIFISËS DISTALE RADIALE

Miller G. F. Barbieri Min. Ort. 1964, Vol. 15, 318-321.

Autorët tregonin se është mjaft e vështirë për të mbajtur të reponuar një frakture kominutive të ekstremitetit distal të radiusit kjo për karakteristikat e saj anatomike. Ndërt medotat më të mira për mjekimin e saj, në artikull preferohet metoda e De Palmas, e cila konsiston në osteosintezen perkutane me spicën e Kirschner. Për këtë bëhet anestesi lokale ose e përgjithshme. Me tërheqje reponohet frakturna, kur reponimi është i plotë kalohet një spic kirschner oblikisht nga ana ulnare 6 gishta transversal sipër procesit stiloit të ulnes me drejtësim nga lart poshtë në drejtim të procesit stiloit të radiusit deri sa të arrijë ndën lëkurë. Një spicë tjeter kalohet transversalisht në nivelin e *capitulum ulnae*. Ky mjekim është përdorur me sukses në 24 të sëmurë. Mbas osteosintezës mbahet 30 dit allçi, pastaj hiqen spicat dhe fiksohet për 20 ditë të tjera në allçi.

Referat në Kongresin 38
të shoqërisë së ortopedisë
italiane 19 maj 1963.

MBI TRAJTIMIN KIRURGIKAL TË FRAKTURAVE TË FRESKËTA TË PARAKRAHUT ME ANËN E TRANSPLANTIT AUTOPLASTIK

G. A. Lievre V. Salvi P. Bogin Rastel Min. Ort. 1964, V. 15, 342-347

Autorët ndërmjet metodave të mjekimit kirurgjikal në rastin e frakturnave të parakrahut, si më të sigurtë preferojnë fiksimin e fragmenteve me kockë të marë nga tibia. Transplanti mejet me gjatësi 8 cm, gjërësi 1.5 cm. Është pjesa kortikale me pak spongioz, fiksohet nga jashtë kockës së thyer, duke li lidhur me fije nejloni.

Transplanti siuron fiksimin dhe ka një stimul biologjik në sajë të spongiorës. Allcia mbas 10-12 ditëve ndrohet. Pastaj mbahet dhe dy javë. Autoret me këtë metodë kanë mjekuar me rezultat të mirë 15 raste.

Referat në kongresin 38
të shoqërisë Ortop. Italiane
19 Maj 1963

SIRROMI KOMPRESIV I NERVIT MEDIAN TË KANALIT KARPAL NË FRAKTURËN E COLLËS TË KONSOLIDUAR KEQ.

G. F. Manzotti Min. Ortop. 1964 Vol. 15, 351-354,

Sindromi i kompresionit të nervit median në kanalin karpal mund të jetë akut nga një traum që menjëherë provokon komprimimin ose kronik mbas disa muajsh ose vitesh, siç uodoh rrallë dhe në frakturen e COLLËS të konsoliduar keq. Si rezultat i konsolidimit të keq, nervi median mund të komprimohet dhe të lezonobet vëçanërisht gjatë fleksionit dhe ekstensionit ndërmjet radiosit të thyer dhe ligamentit karpal transvers. Në simtomat e para të kompresionit kemi parë

stezi dolorose të dorës në vendin e inervuar nga mediani dhe në veçanti mbi pulpat e tre gishtave të parë. Më vonë kemi hipoestezi të shoqëruar me një pakësim të lëvizjes së pollicit që vështirëson funksionin e dorës. Më von manifestohet hipotrofia e *eminencias tenaræ*.

Për mjekim me sukses bëhet prera longitudinale e ligamentit karpal transvers dhe shenjat e kompresionit do të zhduken. Autori ka paraqitur dy raste me këtë, sindrom.

Referat në Kongresin 38
të Ortopedeve italiane
19 Maj 1963

FRAKTURAT E HERËSHME DIAFISARE TË PARAKRAHUT

C. Rinaldi Min. Ort. 1964, Vol. 15, 294-314

Autori ka paraqitur studimin e 291 rasteve me frakturë të parakrahut të mjekuar prej vitit 1949-1962. Mbassi jep të dhëna statistikore, klasifikimin dhe simptomatologjinë, autorit ndalej në mjekimin e rasteve dhe konklidon: frakturat jo të plota të parakrahut, që ndodhin ndër fëmijë kanë gjithmonë prognozë të favorshme pse i nënështrohen plotësisht mjekimit ortopedik duke i mbajtur në allci për 4-7 javë.

Frakturat komplete të të dyja kockave, qoftë dhe ndër fëmijë, paraqesin gjithmonë një vështirësi mjekimi. Reponimi konservativ i tyre është gjithmonë i pasigurtë dhe shpesht jep spos-time sekondare ose callus të vonshëm. Mjaft i vështirë është korigimi i dislokacionit «ad peripheriam».

Kur nuk kemi rezultat të mirë reponimi konservativ, atëherë bëjmë reponim kirurgjikal. Si metodë me të preferuar për osteosinteza, autorit rekomandon fiksimin me tel të Kirschner.

Tema e mbajtur në kongresin 38
të shoqërisë Piemontese-Ligure-
Lombarda -19 maj 1963

MBI FAVORIN E SHOQËRIMIT TË TRANSPLANTIT AUTOPLASTIK ME TELIN E KIRSCHNER NË TRAJTIMIN E FRAKTURAVE TË PARAKRAHUT

F. Agrifoglio F. Rettaglata P. L. Nai Min. Ort. 1964, VOL. 15, 315-317 .

Autorët paraqesin vështirësitë e mjekimit të frakturave të të dyja kockave të parakrahut, veçanërisht në të tretën e mesne për mos inserimin e muskujve në këtë pjesë dhe si rezultat i mos ushqyerjes së mirë me gjak.

Me qënë se sipërsfaqja e kockave të frakturuara janë të vogla këto mund të largohen shpesht dhe kur i kemi imobilizuar në allci, si rezultat i lëvizjes së muskujve. Për këtë në shumicën e rasteve mjekimi i frakturave të të dy kockave të parakrahut bëhet kirurgjikal, duke i fiksuar me tel Kirschner.

Teli i Kirschner, si qdo fiksator tjetër metalik, vonon formimin e callusit dhe kështu mund të kalojë në pseudoartoze. Për këtë autorët rekomandojnë që dha në mjekimin e frakturave të herëshme të parakrahut, si në pseudoartrozën e tyre, të përdoret transplant kocke i matë nga tibia ose kresta iliakë, duke u shoqëruar me telin iutramedular, ndërsa transplanti vendoset anash. Rezultatet janë mjaft të mira.

DIGITUS V VARUS : KORIGJIMI KIRURGJIKAL.

A. Minione G. Giambelli Min. Ortop. 1963, v.14, 660-663.

Autorët, ekzaminojnë metodat kryesore kirurgjikale të mjekimit të varizmit të gishtit të pestë, si atë të Campbell, Lelievre, Lewin dhe Zanolli Negri.

Duke u bazuar mbi rezultatet e 17 pacienteve të operuar simbas metodave të ruajpërme, konskludojnë se metoda më efikase nga ana funksionale është ajo e Zanolli-Negri

të cilën e kanë aplikuar në 9 paciente. Metoda konsiston në kapsulotominë mediale metatarsofalangeale e shoqëruar me tenodesën e ekstensorit të gjatë të gishtit V-të në abdyktorin e të njëjtë gisht.

21 burime literat.

MBI TRAJTIMIN JO KRUENT TË FRAKTURËS ACETABULUMIT ME LUKSACION CENTRAL TË KOKËS FEMORALE

T. Campagna Min. Ortop. 1963 V. 14, 646-651

Autorët flasin mbi etiopatogenezën e kësaj frakturë dhe diskutojnë për mjekimin kruent dhe jo kruent të saj. Duke paraqitur anët negative të mjekimit kruent si rigiditeti i artikulacionit, arroza deformante nekroza e kokës femorale dhe kalcifikacioni i artikulacionit, rekomandojnë mjekimin jo kruent. Për këtë më e preferuar është ekstensioni skeletik (me narkoze) suprakondylar të femorit me pak abduksion ose në drejtim të qafës femorale. Pastaj allçi coksit për dy muaj.

Duke ju referuar katër rasteve përsone, të mjekuar me këtë metodë, ka pasur rezultat të mirë në 3 raste dhe rezultat të keq në një rast.

8 burime literat.

MBI LEZIONIN E MONTEGGIA

A. Mincione Min. Ort. 1964, Vol. 15, 355-364

Autori përvetë studimit të literaturës bazohet edhe në eksperiencën e 23 rasteve me frakturë Monteggia të trajtuar në institutin ortopedik të Milans. Lezioni i Monteggia që karakterizohet me frakturën e ulnës në 1/3 supériore ose të mesme i shoqëruar me luksationin e *capitulum radii* akoma sot përbën një problem të vështirë në mjekimin e tij, pse shumë herë mbas një reponimit përfekt anatomik, duke qënë e imobilizar në allçi do të kemi spostim të fragmenteve të ulnës dhe sekondarisht reliksim të radiusit. Tek fémijet e vegjël zakonisht mbas një reponimi përfekt konservativ sherimi është i plotë, por tek adultet shpesh kemi recidive. Për këtë rekomandohet primarishët reponimi kirurgjikal i ulnës duke i fiksuar me spic metalike intramedullare dhe reponimi konservativ të *capitulum radii*. Kur fragmentet e ulnës nuk sposten, dhe radiusi zakonisht nuk reliksion. Po qe se më vonë kemi reliksim të radiusit bëhet reponimi kirurgjikal i tij me plastikën kapsulo - ligamentose. Në frakturat e vjetërë ose reziduale veprohet sipas rastit: në luksacionet e vjetërëra të radiusit bëhet rezeksioni i *capitulum radii*. Nuk rekomandohet rezeksioni i *capitulum radii* në frakturat e freskëta.

Në pseudarthrozeën e ulnës bëhet fiksion me spic intramedullar i shoqëruar me autotransplant kockor. Në konsolidimet vicioze të ulnës bëhet osteotomi me osteosintezë. Për kalcifikimet peri-artikulare nuk preferon operacion pse recidivon, por i trajton me fizioterapi.

NEKREKTOMIA INTRAARTIKULARE ME HOMOTRANSPLANTIM NË GONITIN TUBERKULAR

Prof. G. Kovalenko, E. M. Milovanova dhe A. V. Salcenko
Ort. trav. i protez. 1964, 9, 14-19

Autorët kanë paraqitur mjekimin me sukses në 37 të sëmurë me gonit tuberkular, duke bërë nekrektoni intraartikulare dhe defektin e kanë zëvendësuar me homotransplant. Këtë e aplikojnë kur është një vatër e kufizuar në kondyle e femorit ose *tibiae*. Bëhet rezeksion i kapsulës të dëmtuar sinoviale, hiqet indi fibroz i dëmtuar dhe bëhet rezeksion koneiform i vatrës tuberkulare. Defekti zëvendësohet me homotransplant në të njëjtën formë dhe me sipërfaqe kartilaginoze. Rezultatet post operatorë kanë qënë të mira si nga ana kurative dhe funksionale.

SËMUNDJA E DUPUYTRE

G. Repossi - Min. Ortop. 1964, V. 15, 186-195

Në artikull vihet në dukje etiopatogeneza e sëmundjes, të përshtkuar nga Dupuytren në 1931, tregohet klasifikimi i saj në katër stade sipas Myerding dhe veçanërisht fitjet për teorinë patogenetike të Vernon Luck. Autorët për mjejkimin e sëmundjes përshtkuajnë metodat terapeutike si fizioterapi, injeksione lokale me kortizon ose rontgenterapi, të cilat tashit përdoren kryesisht në periudhën postoperatorore. Në mjejkimin kirurgjikal kemi dhe tre grupe ndërhyrjesh:

a) aponevrotomia : b) aponevrektomia parciiale, c) aponevrektomia totale.

Aponevrektominë parciiale kryesisht ka përuar lëshin, i cili heq vetëm pjesën e retraktuar të aponeurozes.

Sot shumica e autorëve rekmandojnë aponevrektomiajë totale, autorët tek njëzet pacientë e tyre kanë bërë aponevrektominë totale sipas metodës Mc. Indoe. Për këtë bëhet një incision transversal në pjesën palmare të dorës në nivelin e kockave të metakarpeve. Hiqet e gjithë aponeuroza palmare duke filluar nga pjesa e shëndoshë. Kur në proces marrim pjesë falanget, bëhet incision në formë zete në falangën proksimale dhe hiqet pjesa aponeurotike. Lëkura e prerë në formë zete nuk lejon defekt. Lëkura duhet të qepet me kujdes. Fashatura duhet të kontrollohet mbas 48 orëve. Po të ketë hematome të punktojme. Lëvizjet i fillou shpejt, gishtat mbas 4 ditëve, dorën mbas 2 javë.

28 burime

PËR MJEKIMIN E EPIKONDYLITEVE TË KRAHUT

V. A. Potkin - Posadskii - Ortop. Travm. i protex. 1964, 8, 51-53

Autorët paraqesin eksperiencën e tyre në 41 të sëmurë me epikondylit, të cilët i kanë mjekuar me hidrokortizon - acetat. Për këtë në vëndin me të dhimbshëm të epikondylit, fusin në periost 1 cc, 25 mg, hidrokortison. Për të patur më pak dhimbje tek 13 të sëmurë e kanë shoqëruar 1 cc 2% novokainë, injekcionin e pësërisin po të jetë nevoja mbas 7 deri 15 ditë. Në 11 të sëmurë kanë bërë vetëm 1 (një) injekzion. Në fund autorët konkludojnë se tek asnjë i sëmurë s'ka patur keqësim osc komplikacion. Tek 30 pacientë është arritur shërim i plotë. Në të tjerët përmirësim.

MJEKIMI OPERATIV I MORBUS SPRENGEL.

V/L. Andrianov. Ortop. Travm. i protex 1964, 5,27-30,

Në artikull paraqitet eksperiencia e mjekimit kirurgjikal të 24 rasteve me morbus Sprengel. Autorët janë shkurtimish metodat e ndryshme operatore për këtë sëmundje si metoda e Putit he pastaj përshtkuajnjë metodën e S.D. Ternovskit që kanë përdorur në 22 raste. Metoda konsiston në prerjen e muskujve rreth scapulës. Osteotomia e *processus acromialis* në bazë dhe zbritjen e osit të skapulës. Pastaj muskujt e prerë qepen përsëri, muskuli *seratus anterior* qepet në këndin poshtëm të skapules, ndërsa muskuli *trapezius* dhe *romboid* fiksohen në këndin e sipërmë medial të skapulës. Mbas operacionit alçji torakobrakjal me krah të abduktuar në 90° për tre javë. Mbas beqies së allcishë për 4-6 muaj vazhdohet gjimnastika. Rezultati postoperator ka qënë mjaft i mirë tek 20 paciente që janë observuar 8 muaj deri në 7 vjet mbas operacionit.

KONSIDERACIONE MBI DISA SINDORME NERVORE NGA PAGET VERTEBRAL

L. Ranieri, G. Cecchieri Min. Ortop. 1964, V. 15 (Nr. 10), 454-460.

Në artikull paraqiten ndryshimet anatopatologjike dhe histologjike që ndodhin në Paget vertebralc dhe jepen me hollësi karakteristikat radiologjike.

Autorët paraqesin tre raste me Paget vertebral prej të cilave dy kanë simptomatologji mono

radikulare që ka simluar një protrusion diskal. Diskutohet mekanizmi patogenetik i çregullimeve nervore dhe i jepet prioritet më tepër fenomeneve të pakimeningit që shtrëngojnë formacionet nervore në murat e kanalit vertebral, se kompresionit direkt nga ana e vertebrës së dëmtuar. Rastet e Pagetit vertebral që janë sindrome nervore më tepër lokalizohen në regionin torakal. Rastet e paraqitura janë në kolonën lombare. Për mjekimin e çregullimeve nervore, autorët kanë aplikuar me sukses laminektominë.

22 burime literatyre

LOKALIZIMI PRIMAR KLAVIKOLAR I TUMORIT TË EWING

A. Mina. Min. Ortop. 1964, V. 15, 469-474,

Në artikull trajtohet problemi i etiopatogenezës dhe diagnoza diferenciale klinike, dhe histologjike që paraqitet mjافتë vështirë në stadiet e para. Në përshtatjen e evolucionit, prognozës dhe terapisë, autorët rekomandon intervencione radikalë si amputacionin. Irradiacioni i thjeshtë me Rontgen siç rekomandon kryesisht Schinz jep shpesh recidiva. Kur operohet në fazat e para dhe rezultate të mira. Rasti që paraqitet në artikull të shëtitë rrethi i rrallë për lokalizimin në klavikul dhe ka filluar menjëherë imbas një kontusioni të shpatullës.

Aspecti klinik i ngjante osteomielitit fistulizant të shpatullës. Rezultat mjافتë i mirë klinik e funksional u arriti me rezekcion sub-total të shpatullës i shoqëruar me rontgen terapi.

LUKSACIONI KOMPLET I TALUSIT

L. De Ponti, A. Sartori Min. Ortop. 1964, Nr. 10, 467-469

Autorët paraqesin një rast me luksacion komplet anterioockstern të talusit tek një pacient 21 vjeçar. Shumica e autorve për reposicionin e një luksacioni të plotë traumatik të talusit rekomandojnë operacion. Në rastin e paraqitur është bërë me sukses reposicioni konservativ, duke e kryer shpejt imbas traumes kur s'është formuar edema dhe organizimi i hematomës. Për këtë është bërë kurarizacioni i të sëmurit që të arrihej një relaksion i plotë i muskujve. Për reposicion, gjuri flektoren dhe ushtrohet têrheqja mbi kalkaneusin me hipërfleksion plantar dhe shtyhet talusi në hapsirë. Imobilizim 45 ditë, i jepen vasodilatator dhe vitamine C.

14 burime literatyre.

(Përmbl. P.Karagjozi.)

APENDEKTOMITË GJATË NDËRHÝRJEVE GJINEKOLOGJIKE URGJENTE

R. V. Gorbuncova, F. G. Dehtjar Hirurgia 1964 8, 98-101

Problemi mbi lidhjen e sëmundjeve genitale dhe të appendixit është gjërësisht i njohur. Hartmann i cili në mënyrë sistematike hiqte procesus vermiciformis gjatë operacioneve gjinekologjike konstatoj në 46% të rasteve ndryshime.

Domosdoshmérinë e kontrollimit të appendixit gjatë operacioneve gjenitale autorë i ilustron dhe me një shëmbull ku një grua u operua për një cyste ovari dhe vdiq pas 6 ditësh; n'autopsi u gjendi peritonitis nga appendicitis gangrenoza perforata.

Autorët kanë grumbulluar materialin e spitalit Nr. 27 të Moskës për 5 vjet e gjysëm (1953-1959).

Gjatë kësaj kohe janë bërë më se 13.000 operacione nga të cilat 462 janë bërë për shkaqe të sëmundjeve akute gjinekologjike, në 333 të sëmurë është bërë në të njëjtën kohë dhe apendektomia.

Në 159 pacienta ishte vepër diagnoza *appendicitis acuta* dhe u bë incizion Volkoviq-Diakonov, në 68 u konstatuan sëmundje gjenitale dhe u kalua në incizion pararektal dekstrë.

Në rastet e tjera ku diagnoza gjinekologjike nuk kishte dyshime u kalua në incizion Pfannenstilla.

Nga analiza që i bëjnë autorët materialit konkludojnë së apendektomia e njëkohëshe me operacionet për sëmundje akutë gjinekologjike nuk keqëson dekursin postoperator, operacioni zgjatet pak, në disa të sëmurë ky operacion është i domosdoshëm. Apendektomia nuk bëhet vetëm në rastet që gjendja e të sëmurëve është shamë e rëndë osc në kondita të vështira.

Pacienti duhet lajmëruar se i u bë dhe apendektomia.

Literatura 27 burime

REZULTATET E LARGËTA TË MJEKIMIT KIRURGJIKAL TË CANCER INTESTINUM CRASUM

L. D. Ostrovcev. Hirurgia 1964, 8, 55-61

Nga viti 1945-1962 u mijekuan në stacionar 146 të sëmurë me Ca të intestinum crasum.

Ndërhyrjes operative radikale i u nënështruan 101 të sëmurë (69.1%), operacioneve palliative dhe ndërhyrjeve probatore 32, u konsideruan inoperabël pas ekzaminimeve klinike 8 të sëmurë, refuzuan operacionin 5 të sëmurë.

Nga 101 të sëmurë që u operuan në mënyrë radikale vdiqën 12.8%. Autori në artikull jep kohën që kanë jetuar të sëmurët pas ndërhyrjeve kirurgjikale si *hemicolonhektomia dextra, sinistra*, rezektion segmentar, kolektomi segmentare e tjera.

Pas analizës së materialit arrin në konkluzionet e mëposhtme:

1. Rezultatet e largëta pesëvjeçare të mijekimit të kancerit *intestinum crasum* përbëjnë 60%, 26 nga 42 pacientët e operuar radikalish rrojnë 5 vjet dhe më shumë.

2. Prezencia e metastazave në lymfoglandulat regionare ul rezultatet e mijekimit. Rezultatet më të këqia i kanë format endofite të kancerit solid dhe tumoret me metastaza në lymfoglandulat regionare. Më e mirë është prognоза e të sëmurëve me forma eksositë të adenokarcinomave.

3. Një nga faktorët kryesorë nga mivaret rezultati i mijekimit është diagnostika e herëshme e sëmundjes ku ka kondita më të mira për kryerjen e operacioneve radikale.

4. Të sëmurët që rrojnë 5 vjet pas operacioneve në më të shumtën e rasteve duhet të konsiderohen të shëruar praktikisht nga *kancer intenstinium crasum*.
Nga 26 të sëmurë që jetuan 5 vjet e më shumë 2 vdiqën në vitin e shtatë dhe një i sëmurë 11 vjet imbas operacionit.

Literatura 22 burime

DEFEKTTET E ZHVILLIMIT DHE TUMORET E REGJIONIT SAKROKO-CYGEAL TEK FËMIJËT

A. F. Zverev dhe Z. A. Shuvalova, Hirurgia 1964, 6, 62-67

Regjioni sakrocygeal është vënd ku shpesht ka difekte embrionale nga të cilat kemi anomli-të zhvillinit dhe tumore. Tumoret e këtij regjioni janë të ndryshëm si nga geneza, struktura histologjike dhe nga dekursi klinik.

Midis 33 fëmijve që janë shtruar për 20 vjet në klinikën e kirurgjisë infantile në Sverdlovsk kanë qënë me tumore të regjionit sakrocygeal si më poshtë: 1) benigne-kiste unilokulare 2, multilokulare 3; kiste epiteliale-dermoide (1), apendazhe kaudale (1); *diverticulum* (1). 2) Të përziera, teratoma 18, embrioma tumore organizmoide (1); 3) maligne serkoma (4), adenokarcinoma etj. (2).

Tek fëmijët midis tumoreve të këtij regjioni, më shpesht takohen neoformacionet e përziera sdromos teromat dhe më rrallë embriomat. Tumoret mund të janë me dimensione të ndryshme, ngandonjëherë arrinë dhe sa koka e fëmijës. Konsistencë zakonish nuk është e njëjtë: në sfondin e masës elastike ose fluktuan mund të palpojmë vënde vënde masë me konsistencë të kërcit ose kockës, gjithashtu dhe forma mund të jetë e ndryshme. Në krahasim me gluetelet masa është asimetrike, lëkura mbi të pa ndryshime mund të ketë zgjerim të rrjetit venoz dhe hipertrikozë. Për të vënë diagozën e saktë na ndihmon ekzaminimi për *rectum* ose rontgenologjik. Funkksioni i ekstremiteteve të poshtme zakonish është i ruajtur. Me anën e ekzaminimit rontgenologjik duhet të sqarojnjë në radhë të parë lidhjen e tumorit me kanalin e medulës spinale. Teratomat nuk janë të lidhura me kanalin e medulës spinale, në grafi mund të vëmë re vënde vënde kërc dhe kockë.

Autorët i konsiderojnë teromat dhe tumoret organizmoide si neoformacione midis atyre benigne dhe maligne. Midis tumoreve maligne më të shpeshta janë sarkomat, më rrallë adenokarinomat.

Autorët janë me mendimin e F.G.Uglovit dhe R.A.Mursalovit që «Reziku i operacionit është më i pakët se ai i pritet»

Nga 31 të sëmurë që u operuan vdiqën 7. Suksesi i ndërryrjes kirurgjikale mvarët shumë nga preqatitja pre dhe post operatorë. Rëndësi të veçantë kanë masat antishok.

Literatura 14 burime

PRINCIPET E TERAPISË ME A.C.T.H. DHE KORTIKOSTEROIDE NË PREGATITJEN PREOPERATORE DHE NË PERJUDHEN POSTOPORATORE

Docent A. I. Pusatov, Hirurgia 1964, 7, 117-120.

Hormonet hipofizare-surenale në kohën e sotme kanë gjetur një përdorim të madh në praktiken klinike. Pregatitja e të sëmurëve për operacion me A.C.T.H. dhe kortikosteroide ngre rezistencë e organizmit karshi traumes operatorë. Autori ka studjuarë në 400 të sëmurë në mënyrë dinamike gjendjen funksionale të korteksit të surenales deri në operacion, me metodat e ndryshme të anestezis, dhe në periudhën postoperatorere. Në lidhje me influencën e këtyre apo atyre preparateve në gjendjen funksionale të korteksit surenales pregatitja e të sëmurëve për operacion mund të jetë aktive, ose pasive. Në metodat aktive të pregatitjes preoperatorore mund të futen masat që kanë lidhje me ngritjen e aktivitetit funksional të korteksit surenales dhe rjedhimisht me mobilizimin e organizmit. Metoda pasive përsaqëson përdorimin vetëm të kortikosteroideve egzogenë kortizon dhe analoget e tij.

Të sëmurët që kan përdorur për një kohë të gjatë A.C.T.H. dbe kortikosteroide për të mje kuar sëmundjen bazë, duhet të marin doza plotësuese Cortikosteroide shërbim përfshirë dbe injektimin e shokut probabel operator. Në mënyrë që të eliminohen fenomenet e pa pëlqyeshme të lidhura me marjen e gjatë të hormoneve kortikosteroide duhet që të sëmurët të marin preparatet por jo më shumë se 3-4 ditë.

Në djegjet termiko, kur kemi gjendje terminale, niveli i 17 oksikortikosteroideve në gjakë ngrihet. Sipas mendimit të shumë autorave në gjendjet kritike të organizmit kur injektimi i kortikostereideve nuk jep efekt rezultate të mira jep përdorimi I.V. i A.C.T.H. i cili mund të përdoret në fuzionë guta-gut.

Literatura 4 Burime.

KONVULSIONET GJATË ANESTEZISË

B. G. Zhilis. Hirurgia 1964, 7, 55-60.

Në vitin 1927 Willson konstatoi vdekjen e 4 të sëmurëve nga atake konvulsive gjatë naç kozes me eter. Më vonë Rosenov, Tovell etj. përshkruan vdekjen e të sëmurëve nga «kontraksionet e sterit».

Autori ka observuar 17 të sëmurë me «konvulsione eterike» të cilat u çfaqen gjatë metodave të ndryshme të anestezisë. Ataku fillon papritur ose siç thotë Pinsen pas një fare çregullimi të frymëmarjes e cila mer një karakter steroidor, fillon lëvizja fibrilare e qçallave, pas disa sekondash fillon fibrilacioni i muskulaturës së rujmës dhe kalohet në muskulaturën e ekstremiteteve të sipërme dhë të poshtme. Pas 20-30 sekondash fillojnë konvulsionet përgjithësime, spazmat tonike zem gjithë trupin dhe vazhdojnë 2-3 minuta, pas disa minuta qetësie ataku fillon përsëri nga e para.

Frymëmarja çregullohet qoftë sikur në trakë të ndodhen tubi, pupillat zgjerohen ose kanë formë jo të regullt, presioni arterjal uljet. etj. Një anestezist pa eksperience mund të ngatëroj fenomenet konvulsive me simptomat e stadiut të eksitimit, shtunë i dozës mund të shpjeri në çfaqjen e konvulsioneve të vërteta. Gjatë narkozës me eter konvulsionet vijnë nga superdizimi i eterit dhe minimi i tyre bëhet duke ndërpër narkotiku dhe duke dhënë doza të mëdha Oksigjeni.

Të ashtuquajturat konvulsione eterike mund të vijnë nga metoda e ndryshme të anestezisë. Hipoksi e trurit, e cila mund të vij për shkaqe të ndryshme, është shkaku më kryesor i këtyre atakeve.

Gjatë narkozës intratrakeale konvulsionit mundt të shfaqen nga blokada e pulmonit prej futjes së thellë të tubit. Fenomene konvulsive u konstatuan dhe në të sëmurët anemikë gjatë admisionit të dozave të mëdha të adrenalinës. Konvulsionet që çfaqen nga anestezia lokale zhduken duke inektuar Tiopental Intravenoz.

Literatura 19 BURIME

REZULTATET E MJEKIMIT TË KOKSITIT TUBERKULAR

F. Lelik Hirurgia 1964, Nr.7, 35-40

Në kohë e sotme, rezultatet e kurimit të tuberkulozit të artikulacioneve janë më të mira. Sipas mendimit të shumë autorëve shkaqet janë: 1) Metoda kirurgjikale dhe konservative nuk janë me antagoniste por plotësojnë njëra tjetrën. 2) Zgjerimi i operacioneve me ndihmën e transfuzionaleve, narkozës intratrakeale, profilaksija dhe mjekimi i shokut. 3). Përdorimi i efektshëm i medikamentave antituberkulare.

Në institutin e autorit nga viti 1955 deri në 1961 janë mjekuar 114 të sëmurë me koksiti t.b.c. e me moshë nga 5 deri 58 vjeç të gjithve iu bë një mjekim senatorial. Ndërhyrja kirurgjikale u bë vetëm kur ishte prezenca e t.b.c. lokal dhe shënjet e përgjithësme të t.b.c. Operacioni bëhej pas zhdukjes së shënjave akute, u operuan 33 të sëmurë.

Autori pasi analizon rastet vjen në konkluzjonet e mëpashtëme. Në kohë e sotme koksiti t.b.c. mund të mjekohet pothuajt në të gjitha rastet me ndihmën e një mjekimi kompleks satorial, ortopedik, operativ dhe medikamentoz.

Në qoftë se i sëmuri shkonë në kohë në një institucion kurativ special pothuaj gjithmon arihet që të fitohen lëvizjet artikulacionit. Për sat të koq nga vështirësia e diagnostikimit ose për shkaqe të tjera, të sëmurët paraqiten me vonesë dhe diagnoza klinike vijet në stadet e vona të sëmundjes, zakonisht vijnë në stadium fibrokavernozi të sëmundjes, në shumicën e rasteve është dëmtuar dhe kartilagua gjë që lejon bërjen veçmë të operacioneve fiksuese. Dhe në proceset destruktive me të rënda pas një mjekimi të mirë, të sëmurët mund të fitojnë lëvizjet. Është e domosdoshme të perfeksionohen metoda e diagnostikimit në mënyrë që mjekimi të filloj në stadet më të herëshme në mënyrë që të mos mbeten të sëmurët invalidë.

KLINIKA DHE RONTGENDIAGNOSTIKA E TUMOREVE NEUROGEVE TE MEDIASTINIT TEK FËMIJËT

E. A. Stepanov Hirurgia 1964, 6, 27-33

Tumoret neurogenë mediasinale tek fëmijët nuk janë të rallë. Ata përbëjnë rreth 29% të tumoreve me karakter neurogen që takohen në mediasinë e të rritura. Midis të tjerash tumoret neurogenë tek fëmijët në krahasim me tumoren e tjera primare të mediasinës, të fëmijëve zënë vëndin e parë. Sipas të dhënave të autorit, tumoren neurogenë zënë më se 50% të të gjithë tumoreve mediasinale të fëmijve, nga 50 të operuar tek 31 konstatuan neoformacione të tipit neurogen. Tabloja klinike e tumoreve mediasinale neurogenë tek fëmijët është shumë e ndryshme dhe pothuajse asnjë herë nuk ka simptoma patognomonike. Ajo në më të shumtën e herës varet jo vetëm nga vëndi i lokalizimit por nga mosha e pacientit si dhe nga përbërja patomorfologjike e masës. Simptomat klinike ndahen nga autorit në tre grupe: a) Në grupin e parë hyjnë simptomat që vijnë si rezultat i kompresionit të tumorit në organet jetësore të kavitetit torakal. Rendësi të madhe ka inspeksioni i toraksit i cili mund të vëje në dukje deformacionin e mureve torakale në regjionin e lokalizimit të tumorit. Prezenca e paketave limfatike të zmadhuara në regjionin supraklavikular duhet ta kujtojë kirurgun për një tumor mediastinal neurogen të malignizuar, shpesh ky është si imponi i vetëm për të cilin fëmijët drejtohen nga prindi të mjeku. b) Në grupin e dytë përmblidhen simptomet me karakter neurogen, prezenca e tyre kondicionot me prishjen ose komprimimin e noduseve ose fibrave nervore nga të cilat tumor shpesh herë merr zhvillimin e tij primar. Mund të konstatohen dhëmbje, pareza të ekstremiteteve inferiore, ndryshime në sy etj. Ngandonjëherë konstatohen ndryshime të dermografizmit të lidhura me rritjen e spazmave të enëve të gjakut të cilat kondicionohen nga lezioinimi i trupavet simpatikë. c) Në grupin e tërte baslikohen simptomat që karakterizon jë gjendjen e përgjithështë të të sëmurit, ato lidhen me intoksikacionin e organizmit nga vetë tumorit ose me prishjen e regularitetit të S.N.C. Nga simptomat e fundit më të shpeshta janë humbia në peshë, dobësi e përgjithështë, fenomene dispeptik, temperaturë e ngritur etj. Shpesh herë vihet re dhe dekursi pa simptoma i cili vështirëson shumë vënien e diagnozës pa metodat ndihmëse.

Literatura 42 burime.

PERITONITET AKUTE ME PREJARDHJE JO ARENDIKULARE TE FËMIJËT

S. R. Shllakuja Hirurgia. 1964, 6, 42-46.

Në klinikën e autorit prej vitit 1946 deri më 1960 u observuan 75 të sëmurë me *peritonitis diffusa purulenta* me prejardhje jo apendikulare. Shikaku i peritoniteve në 6 raste ishte nga inflamacioni i diverticulit Mekkeli, në katër raste nga mesadenitis purulenta non specifica, 2 raste nga salpingitis purulenta acuta, 2 raste nga ileus dhe gangrena e zorrës së hollë, përforacioni i ulcerës tifoze në katër raste nefroza lipoidike 4 raste, përforacioni i zorrës nga trupi i huaj një rast dhe në 52 raste peritonit nga *diplococcus*.

Peritonitet akute tek fëmijët kalonjë më rëndë dhe janë një komplikacion i rëndë i sëmundjeve akute të kavitetit abdominal.

Shumica e të sëmurëve ishin me peritonit nga diplokoku, kjo sëmundje takohet pothuajse vetëm tek fëmijët, shumica e të sëmurëve ishin nga mosha 3 deri 8 vjeç. Deri në përdorimin e preparateve sulfanilamide dhe antibiotikëve dekursi i kësaj sëmundje kalonte rëndë, litaliteti pothuajse ishte 100%. Sëmundja zakonisht fillon pa pritur në çfaqjen e dhëmbjeve të fortë në abdomen, temperaturë të ngritur, të vjella. I sëmuri gjendet në gjendje intoksikacioni; i zëdhë, pulsi i shpeshit, gjuhja e thatë e mbuluar. Abdomeni i kontraktuar dhe i dhëmbëshëm në gjithë regionet, por më shpesh dhëmbjet lokalizohen në *fossa iliaca dextra*. Diagnosa është e vështirë me gjithë se mund të vihet edhe para operacionit. Në klinikë 19 të sëmurëve i u vu diagnoza *appendicitis acuta*, 20 *appendicitis acuta me peritonitis* dhe 13 peritonit diplokoku. Në kohën e sotme të sëmurët operohen jo vetëm në rastet e dyshimit për *appendicitis acuta* dhe për peritonit por dhe atëherë kur peritoniti nga diplokoku është diagnostikuar dhe para operacionit. Nga 75 të sëmurë vdiqën 5, njëri nga peritoniti pas *diverticulum Mekkeli* i përforuar, dy me tifo abdominale nga përforacioni i ulcerës tifoze dhe dy nga peritoniti prej nefrozës lipoidike. Nga peritonitit diplokokal klinika nuk pati asnjë vdekje. Pregatitja preoperatorre në të gjitha format e peritonitit ka një rëndësi të madhe. Në klinikë është përpunuar metoda e mëposhtëme: Kur pacienti ka

temperaturë të lartë i injektohet 1% solucio piramidoni, intravenoz bëhen antibiotikë, gjak dhe plazmë, qdo dy orë matet temperatura, mbas 2–4 orësh pacienti merret pér operacion. Rëndësi, të madhe ka perioda postoperatorore duke pasur sidomos parasysh masat kundër ileusit paralitik.

Literatura 7 burime.

DYSPLAZIA FIBROSE KOCKORE TEK FËMIJËT.

Profesor T. F. Gauzhuleviç. Hirurgia 1964, 6, 80-83

Prej marsit 1957 deri në nëndor 1962 u observuan 36 të sëmurë nga mosha 3 deri më 6 vjec me neoformacione të ndryshme kockore, në 5 prej tyre u konstatuan displazi fibroze.

Më shpesh kapan kockat e gjata tubulare, sëmundja zakonisht fillon në metafizë dhe gradualisht shtrihet në diafizë. Dallohen forma monoosale e displazisë fibrose me lokalizimin e procesit patologjik në një kockë në formën e një ose disa vatrave organike dhe forma poliosale me lokalizime në disa kocka. Sëmundja fillon pa u vënë re, të sëmurët zakonisht drejtohen tek mjeku kur ka ndryshime kockore, nga ndonjëherë ankohen pér dhëmbje të lehta që kalojnë, jo rrallë ndodhë dhin fraktura patologjike. Gjendja e përgjithshme e të sëmurëve nuk ndryshon. Përmbytja e fosforit dhe kalciumit në serumin e gjakut është në normë. Në urinën mungojnë ndryshimet patologjike tabloja anatomopatologjike karakterizohet me prezencën e indit lidhor në kanalin intramedullar; ky s'është ind lidhor i zakonshëm, por ind osteogen, diferencimi i këtij indi nuk është i mundur deri në çafqjen e strukturës kockore të pjekur.

Indi lidhor i marrë në të njëjtën kockë por në vatra të ndryshme ka strukturë jo të njëjtë.

Tabloja rontgenologjike në të gjitha format e displazisë fibroze karakterizohet nga një polimorfizëm i theksuar. Në kockë dallohen një ose disa vatra të ndritura në formë ovale jo të rregulltë me madhësi të ndryshme që rrerohet nga një zonë sklerotike. Në rastet që ka vëtinë një vatrë patologjike diagnoza difereciale me osteoblastoklastomën, osteoide - osteomën cystin kockor, t.b.c. në kockorë bëhet më e vështirë. Dekursi beninjë i sëmundjes nga ndonjëherë bëhet malinje. Për të vënë diagnozën e sëmundjes duhet një observim dinamik.

Mjekimi i displazisë fibroze është vetëm kirurgjikal, reseksioni i kockave në kuqitë e indeve të shëndosha. Indikacione pér operacion mund të shërbjnë deformimi i konsiderueshëm i ekstremitetit, vratat e mëdha ose të shumta, nga ndonjëherë ankimet pér dhëmbje, gjithashu reziku pér fraktura patologjike.

Literatura 9 burime.

MBI KANCERIT MULTIPLE PRIMAR TË VENTRIKULIT

V. M. Voskaja. Hirurgia 1964, 8, 61-65

Studimi i pamjaftueshëm i kancerit primar multiple i ventrikulit, vështirësia diagnostike gjithashtu interes i përmirësohet përmes një studi i cili i ka përfshirë 117 të sëmurë nga të cilët 55 kishin kancer multiple, 32 polipozë dhe kancer të çafqur në bazën e polipozës, 10 të sëmurë me *ulcus callosum multiplex* që ka kaluar në kancer, 18 të sëmurë me polipozë dhe me çafqje proliferimi dhe enterizimi, i i sëmurë me kancer sinron të pjesës abdominale të esofagut dhe kancer kardial të ventrikulit dhe i i sëmurë me kancer sinron të ventrikulit dhe leiomyomë të ventrikulit.

Grupi i të sëmurëve me polipozë dhe me çafqjen e fenomeneve të proliferacionit dhe enterizimit u fut në artikull mbasi në asnjë nga ekzaminimet e mundëshme nuk u bë i mundur ekskludimi i kancerit deri në kohën e operacionit.

Autori konkludon si më poshtë:

1. Tumoret multiple të ventrikulit takohen më shpesh se sa mendohej deri vonë.
2. Simptoma klinike karakteristike që ta dallojnë kancerin multiple nga ai solitar nuk ka.
3. Ekzaminimet rontgenologjike pér tumoret multiple të stomakut sipas të dhënave të autorit lejojnë të vendosësh diagozën e drejtë në 46.1 % të rasteve.

4. Polipoza nuk është fond i domosdoshëm pér kancerin multiple të ventrikulit por shpesh është paraardhës i tija.

5. Me metodat e sotme diagnostike dhe me mjekimin radikal, rezultatet e mjekimit të të sëmurëve me *carcinoma multiplex* primar *ventriculi* nuk ndryshojnë nga ato të mjekimit të kancerit solidar.

Literatura 11 burime.

MBI RËNDËSINË E PARIE TOGRAFISË SË STOMAKUT NË KLINIKËN KIRURGJIKALE.

L. Sh. Rozenshtrauh dhe H. M. Pushkareva. Hirurgia 1964, 8, 65-70.

Pamvarësish nga rëndësia e madhe e ekzaminimit rontgenologjik me kontrast të ventrikuli, ky i fundit ka një sërë të metash se lejon vetëm studimin e murit të brendshëm të stomakut kurse për sipërfaqen e jashtme dhe trasësinë e mureve të ventrikilit nuk jep asnjë të dhënë. Këto të meta ulin mundësinë e ndihmës që mund të japi radioskopja e stomakut në rastet e tumoreve që infiltronë muret e tija.

Në vitin 1933 shkencëtarë japonez Makoto Saito propozoi studimin e mureve të stomakut vetëm me ndihmë e gazit. Kjo metodë (parietografia) gjeti përkrahës mbasi Racchius dhe Procher propozuan studimin me shtresë të stomakut.

Artikulli është shkruar në bazë të 57 observacioneve ku parietografia u bë për qëllime diagnostike në sëmundjet e *corpus*, *sinus* dhe të regionit antral të ventrikilit, në 35 u krye interventi kirurgjikal. Më poshtë autorët jep teknikën e parietografisë me futjen e dyanëshme të ariut si në kavitetin peritoneal dhe në stomak. Një rëndësi të madhe merr këtu dhe kombinimi me tomografi. Autorët konkludojnë si më poshtë: 1) Parietografia është e vërtma metodë rontgenologjike që lejon studimin si të sipërfaqes së brëndëshme ashtu dhe asaj të jashtme të stomakut. 2) Përdorimi i parietografisë për qëllim studimi të gjëndjes së mureve të korpusit, sinutisë dhe regionit antral të ventrikilit nuk është më pak efektiv se studimi i mureve të regjioneve të sipërmë të stomakut. 3) Me gjithë se në konditë të zakonshme muret e regjioneve dalëse të stomakut janë më të trasha se muret e korpusit dhe veçanërisht të kubesë gjatë parientografisë këto mure janë të njëjtë. 4) Parietografia në shumë raste mundet të përcaktojë karakterin e nishevë të mëdha dhe në veçantë të ndihmojë në diagnozën diferenciuese midis nishevë ulceroze dhe kanceroze. 5) Metoda ka rëndësi në diferencial diagnosticë e stenozave të pjesave dalëse të ventrikilit kur metoda e tjera s'kanë efekt. 6) Parietografia mund të jep një ide në lidhje me gjëndjen e stomakut karshi organeve të tjera, por ajo zakonisht nuk mund të dallojë në se është rritje koncerzo apo aderenca. 7) Parietografia është një metodë e vyer plotësonjëse e metodës rontgenologjike të studimit të stomakut

Literatura 8 burime.

SINDROMI POSTINTUBACION

R. D. Satin dhe D. Dejanov Experimentalnaja Hirurgia i anestesiologija 1964 5, -80-82

Përdorimi i narkozës endotrakeale për shkak të të metave të saj mund të shpjeri në një sërë komplikacionesh me shpesh lidhur me rrugët e sipërmë respiratore. Nga këto komplikacione më e rëndë është edemi i kordave vokale. Një komplikacion tjetër i rrezikshëm është çfaqja e granulome të vonshme postintubatore të cilat duhet pa tjetër të operohen. Këto komplikacione janë të rralla; autorët në 2240 narkoza endotrakeale edemë të kordave vokale, që solli si pasojë bërjen e trakeotomisë ndeshnë vetëm një herë, granulomë postintubatore nuk konstatuan asnjë herë.

Shumë të sëmurë ankohen për ndryshimin e zërit në 2-3 ditët e para pas intubimit. Për të koordinuar lidhjen midis ankesave subjektive dhe ndryshimeve objektive, autorët observuan 200 të sëmurë nga mosha 1 deri më 74 vjeç me sëmundje të ndryshme kirurgjikale. Në ankes subjektive u futen dhimbjet në gojë, grykë, gëllitja e thaati dhe dhëmbja gjatë ngrenies dhe të folurit. Ndryshimet objektive u vunë rë gjatë faringeskopisë dhe laringoskopisë indirekte, të rsëmurrës që i u bë intubacioni nga hunda ju bë dhe rinoskopia. Të gjithë të sëmurët u ndanë 4 grupe. Në grupin e parë u futen të sëmurët pa ankesa dhe pa ndryshime të rrugët e sipërmë respiratore, në grupin e dytë të sëmurët me ankesa dhe pa ndryshime, në grupin e tretë të sëmurët pa ankesa dhe me ndryshime dhe në grupin e katërtë të sëmurët me ankesa dhe me ndryshime objektive. Në grupin e parë ishin 7.5% e pacientëve, në grupin e dytë 60.5%, në grupin e tretë 2% që në të katërtin 30%.

Autorët konsiderojnë se ndjenjat subjektive të pacientëve dhe ndryshimet në zë, të cilat zakonisht zhduken pas 48 orëve vijnë si rezultat i dëmtimoreve të terminacioneve të nervave periferikë të mukozës dhe nga edema e lehtë e kordave vokale nga intubacioni intratrakeal. Konkludohet se ankesat subjektive të lidhura më dëmtimin e rrugëve të sipërmë raspirtore dhe me ndryshimin e zërit nuk duhet të konsiderohen si komplikacione të intubacionit intratrakeal por si sindromë postintubacion që konsiston në një shqetësim në grykë dhe me një ndryshim të lichtë të zërit, për eliminimin e tyre s'ka nevojë përmes speciale.

MJERIMI KIMIKOKIRURGIKAL I CANCER VENTRICULI

I. V. Koliajuk, A. V. Taltallajeva, A. N. Nomija Hirurgia 1964, 8, 8-17

Sic dihet rezultatet e largëta të *Cancer Ventriculi* sidomos të stadir të tretë dhe të katërtë nuk janë të mira, shumica e të sëmurëve vdesin brënda pak vjetve nga metastazat dhe recidivat. Sipas materialave të institutit onkologjik Herzen, të bazuara në rezultatet e observacioneve të bërë në 449 të sëmurë të operuar radikalish për *cancer ventriculi*, për 5 vjet e sipër, rezulton se jetojnë brënda 5 vjetve në gjithë stadiet 37.9% e të operuarve, në stadin e parë dhe të dytë 57%, në stadin e tretë 22.5%.

Efektiviteti i operacionit në *cancer ventriculi* është i vogël dhe kryesisht mvarë nga stadi. Në Institut është provuar efektiviteti i një sërë preparateve: tiotef, spirazidinë, ciklofosfan (endoksan) dhe kombinimi i ciklofosfanit me tiotef. Më në fund rezultoi se tiotefi është më pak toksik dhe jep një efekt të mirë klinik.

Mjekimi bëhet duke kombinuar tiotefin intramuskular, intraperitoneal ose për os duke bërë në të njëjtën kohë ciklofosfan intravenoz. Të sëmurët marrin preparatin pre dhe postoperator njëkohësisht dhe gjatë operacionit. Doza ditore 20 mgr, doza totale 300 mgr. Preoperatore të sëmurët marrin 100-160 mgr. tiotef. Në kohën e operacionit 15 mgr. bidhen në kavitetin abdominal dhe 15 mgr. injektohen në ndonjë nga venat e vogla të mezenterit të zorrës së hollë. Mbës operacionit tiotefi përdoret 20 mgr. më interval një ditë deri në fundin e mjekimit. Dy muaj pas operacionit rekomandohet një përsëritje e kursit të mjekimit prej 130-160 mgr. (pothuaj gjysmën e dozës së parë).

Në rast se konstatojmë recidiva ose metastaza mund të bëhet një kurs i tretë mjekimi me gjysmën e dozës ndën kontrollin e vazhdueshëm të kuadrit të gjakut. Autorët studjuan dhe sensibilitetin e ndryshëm të llojeve të ndryshme istologjike të *cancer ventriculi* karshi preparatit, përvç kësaj grada e regresimit të tumorit mvarët nga doza dhe afati i mjekimit. Autorët konkludojnë se mjekimi kimikokirurgjikal i *cancer ventriculi* me përdorimin e tiotefit mund të rekomandohet në kancer të stadir të tretë si gjatë operacioneve palliative dhe radikale, veganërisht në kancerin solid dhe adenokarcinomën.

Literatura 13 burime.

RRUGËT E ZHVILLIMIT DHE KU KA ARRITUR SOT ANESTEZOLOGJIA

Prof. T. M. Dorbinjan. Hirurgia 1964, 7, 8-12

Përdorimi i miorelaksantëve mund të japi komplikacione të lidhura jo vetëm me influencën e këtyre substancave në organizëm por dhe nga një pian taktrik jo i drejtë i përdorimit të tyre.

Autori është dakord me vendimet e simpoziumit të janarit 1963 për anestezilogjët, i cili u bë në Moskë. Në të theksohen të mos përdorim kurrrë miorelaksantë të tipit depolarizues më shumë se 1000-1200 mgr. deri në këto doza të përdoren në operacionet që zgjasin për një kohë deri në dy orë.

Observacionet klinike të autorit kanë treguar se kur përdoren mbi këto doza disa herë në fund të operacionit qfaqet një dobësi muskulare e theksuar në kartinë e një bloku antidepolazant.

Kur operacioni duhet të vazhdojë 2 deri në 5 orë është mirë të përdoren miorelaksante të tipit antidepolarizonjës - (deri 10 mgr/kg. dipräcine). Përdorimi i miorelaksantit depolarizues për lehtësimin e intubimit kur që në fillim të operacionit dihet se do të përdoren antidepolarizuesit ka një efekt antagonist. Efekti antagonist i tyre pas 3-4 orëve zhduket, në këtë mënyrë mund të flitet për një sinergjiëm të preparateve depolarizuese dhe antidepolarizuese. Kjo gjë e lejon autorin të rekomandojë narkozën e kombinuar ku lehtësimi i intubimit të bëhet me ndihmën e miorelaksantëve antidepolarizuese. Kur operacionet zgjasin më shumë se 5 orë mund të përdoren kuraret depolarizuese në fillim pastaj ato antidepolarizuese, në qoftë se operacioni duhet të vazhdojë akoma përdoren përsëri depolarizuesit. Në disa raste kur operacionet janë shumë traumatike duhet të çfrylëzohet dhe efekti ganglionoblokonijsë i miorelaksantëve. Një nga avan-tazhet më të shkëlgjashme të miorelaksantëve është narkoza supërficiale e cila duhet të shqërohet me amincinë retrograde dhe ne rrugjet e autoregularitetit reflektor të organizmit. Në kohën e sotme nuk ekziston një klasifikim preciz i stadeve (ë narkozës me përdorimin e miorelaksantëve. Klasifikimi i Gredellit për narkozën me eter nuk është i përshtatshëm për narkozën me

midopregjik copse nuk përmban një serë veçantish të kësaj të fundit. Artuzio e ndan stadin e parë parkozës sipas klasifikimit të Gredellit në tre grada: grada e parë shqërohet me analgezi pa amnezi, grada e dytë analgezi dhe pjesërisht amnezi që grada e tretë analgezi dhe amnesi të plotë.

Literatura 4 burime.

RÉZULTATET E LARGËTA TË MJEKIMIT KIRURGJIKAL TË CANCER VENTRICULI NË LIDHJE ME LOKALIZIMIN E TUMORIT DHE RËNDËSINË E INTERVENTIT

A. A. Cel dhe L. M. Sidorenko. Voprosi onkologji 1964, Volum i X-të, Nr. 8

Duke studjuar të dhënat e operacioneve radikale të bëra në institut për *cancer ventriculi* nga viti 1947-1958, autorët u përpoqën të bëjnë analizën krahasonjëse të rezultateve të largëta të gastrektomisë totale dhe resorcionit subtotal.

Në këtë periudhë në institut janë bërë 121 gastrektomi totale dhe 435. resectione subtotalë të ventriculit.

Për të marrë të dhëna krahasonjëse të sëmurët u ndanë në dy grupe: në të parin u futën 115 të sëmurë që bënë resection subtotal dhe në grupin e dytë 70 të sëmurë të cilëve i u bë me sukses gastrectomia totale.

Autorët në tablica të ndryshme jepin gradët e shtrirjes së proçesit tumorali, formën e rritjes së tumorit, zgjatjen e jetës së të sëmurit që kanë bërë të dyja ndërhyrjet kirurgjikale të më sipërme e tjera.

Si rezultat i analizës së observacioneve vetiakë dhe të të dhënave të literaturës autorët konkludojnë se rezultatet e largëta të gastrektomisë (gjithashu duke përfashtuar atë «të detyruar») janë 1.5 deri më 2 herë më të këqija se rezultatet e resectionit subtotal të kryera në tumore me përhapje të njejtë.

Gastrectomia totale është e indikuar jo vetëm në përhapjen e madhe të tumorit, kur operacioni është «i detyruar», por dhe në Ca infiltrative që shtrihen në regionin proksimal të ventriculit të quajtura gastrectomi «të nevojshme».

Gastronomisë totale «të detyruar» në cancer jo rrallë duhet ta konsiderojnë si interventi palliativ.

Duke parë rezultatet e largëta të gastrektomisë totale duhet ta ndajmë këtë të fundit në tre lloje në mvarësi nga çfarë gastrektomie është bërë «e detyruar», «e nevojshme», «me indikacione principiale».

Literatura 27 burime.

MELANOMA PARA PUBERTETIT

F. Klaudio, G. Laria Minerva Chirurgia 1964, Nr. 21, Volumi 19, 735-739.

Melanoma malinje në prepubertet nuk konsiderohet sot një sëmundje e rrallë. Duke rishqyrtuar statistikën e melanomave të repartit kirurgjikal i institutit të tumoreve të Napoliit (127 raste) u gjetën 6 raste me malanomë në fëmijë ndëm 12 vjeç.

Në këtë moshë nuk kanë ndodhur akoma ato transformacione endokrine që bëhen shkaktarë të modifikimeve eventuale malinje të një nevusi të pigmetuar. Më poshtë autori raporton shkurtimisht për 6 rastet me melanomë duke dhënë të dhënët kliniko-terapeurike me esenciale. Ekzaminimin histologjik të bërrë në të gjitha rastet ka treguar në katër rastet melanoblastoma dhe në dy rastet melanosarkoma. Lokalizimi në tre raste ishte në anësitë inferiore, në dy raste në kokë dhe një rast në gjenitalet eksterne të femrës. Nga të 6 pacientët 4 ishin portatorë të nevuseve të cilat kishin pësuar transformacione malinje.

Në një rast u bë rontgenoterapi preoperatori si në metastazat ashtu dhe lokal, më vonë ndërhyrja kirurgjikale, në 4 raste u bë rotgenterapi postoperatori, në një rast nuk u bë rontgenterapi postoperatori, në një rast nuk u bë fare rontgenoterapi.

Nga të 6 pacientët e vegjël 4 janë të gjallë dhe gjëzojnë shëndet të plotë respektivisht 9,76 vjet dhe 15 muaj pas paraqitjes së parë të mjeku. Dy vdiqën, njëri ishte portatori i një melanosarkome të syrit dhe i dyti i një melanoblastome të *labbium major*.

Autorët konkludojnë se nevuset e fëmijve dubet të konsiderohen si ato të të rriturve me posibilitetin e evolucionit melanomatoz të këtyre të fundit.

Së dhe në të rriturit midis shkaqeve që mund të determinojnë një transformacion malinj të neuseve janë traumat. Agjentët traumatikë mund të jepin transformacione malinje të nevuseve të fëmijët pothuaj në një përqindje të ojëjtë me të rriturit duke marrë parasysh zgjatjen e shkurtër të jetës së fëmijve në krahasim me atë të të rriturve.

Mjekim është ablacioni kirurgjikal.

Duke marrë parasysh të dhënat e leteterurës sipas autorëve mendimi mbi dekursin beninj, të melanomave të fëmijve duhet modifikuar.

Literatura 21 burime

PËRDORIMI I MASAZHIT INDIREKT TË ZEMRËS NË PRAKTIKËN KLINIKE

A. S. Ermolov, Ju. Z. Krejolin, I. V. Egorov, O. S. Bocarev, I. S. Kalter
Hirurgia 1964, 7,36-39.

Ndalimi i menjëherëshëm i zemrës bëhet shpesh herë shkak i vdekjes i të sëmurëve me sëmundje të ndryshme kirurgjikale. Në një pjesë të rasteve, kjo mund të vij si rezultat i një sëmundjeje, kurse ndonjëher si rezultat i manipulacioneve të ndryshme me qëllim kurativ ose diagnostik. Sipas të dhënave të Milson ndalimi i menjëherëshëm i zemrës në operacion është 1:1009, sipas Dzhudu 1:5000, po këto të dhëna jepin dhe Jude, Konwenhovenë etj.

Deri kohët e sotme përdorëj si metod efektive për rastaurimin e funksjonit kardiak masazhi transitorik direkt i zëmres janë: 1) Torakotomia është operaciona traumatik. 2) Humbja e kohës për bërjen e torakotomis. 3) Mundësija e demitimit të zemrës gjatë masazhit direkt.

Përdorimi i masazhit indirekt të zemrës pothuaj eksklidon ato të meta. Sipas obseruationeve të autorëve nganjëher masazhi indirekt e ngrë TA jo më shumë se 60-80 mm- dhe në rastet e rënies se theksuar të tonusit të miokardit ky masazhi nuk është i efektshëm. Autorët rekomandojnë përdorimin e masazhit të mbyllur në gjendjet agonale, në funksionin e dobët të zemrës në vdekjet klinike që zgjasin jo më shumë se 1-2 minuta. Jepet në artikull teknika e masazhit indirekt të zemrës. Për efektivitetin e masazhit gjykonit nga ndryshimi i ngjyrës së mukozës dhe lëkurës, ngyshtimi i pupilave, restaurimi i frysëmarrjes dhe veprimtarisë reflektore. Autorët kan përdorur masazhin e mbyllur të zemrës në 8 raste të ndalimit të menjëherëshëm të saj dhe ku nga vdekja klinike deri në momentin e ngjalljes nuk u kalua 1 minutë. Ky lloj masazhi mund të bëhet si në konditata ospitaljere dhe ambulatorie.

Literatura 8 burime.

SËMUNDJA PORFIRIKE

Profesor B. HA. Brajcev Hirurgia 1964 7,125-127.

Në praktikën klinike shpesh herë ndodhin raste të sëmundjeve të ralla njohja e të cilave vështirësohet nga mosnjohja e simptomave, kjo gjë shpijtë sëpesh herë në bërjen e laparatomive të kota.

Forma neuro-intestinale e sëmundjes porfirike është një nga sëmundjet e rralla. Porfirinat egzogene njeriu i merr nga mishë dhe ushqimet bimore nga intestini ato shkojnë në hepar ku transformohen në koproporfirina dhe dallin me anën e bilës, një pjesë kalon në gjak dhe eliminohet me anën e urinës. Porfirinat endogene formohen si produkte shtesë gjatë biosintezes së hemoglobinës dhe pjesërishtë gjatë siksakërimit të hemoglobinës, mioglobinës dhe tekromit, në organizëm ato ndodhen në formë protoporfirinë: komponim pa ngjyrë. Kur ka shumë porfirinogen ky ndën efektua e drithës kthehet në porfirinë e cila i jep urinës një ngjyrë të kuqë. Sëmundja porfirike ka dy forme kongenitale (m.Hunter) dhe akutën. Forma akute jep dëmtimë neurointestinale. Një rol të rëndësishëm në zhvillimin e formës akute ka alkoolizmi, përdorimi pa kriter i sulfanilamideve, barbiturateve, kontakti me benzinën etj. Sëmundja mund të komplikohet me nefrit 101

Në kohën e atakut dhëmbjet e forta në abdomen, nauzea, të vjellat etj, mund të simulojnë tablon e një abdomeni akut. Presioni i lart arterjal mund të ngatëroj mjekun për prezencën e feokromocitomës. Prognoza në rastet e lezioneve është e keqe, vdekja vinë nga paraliza e fryshtës.

Në kohën e s'otme mjekimi më kortizon e përmirëson prognozën e sëmundjes në qoftëse kjo diagnostikohet herët. Rekomandohet përdorimi i acidit folik, riboflavinës, vitamines B₁₂ dhe rezorcines.

Autori e ilustron artikullin duke demonstruar një rast me sëmundje porfirike.

MBI TAKTIKËN E KIRURGUT GJATË PNEUMOTORAKSIT SPONTAN ME ETIOLOGJI JØ TUBERKULARE

V. L. Maneviç, T. V. Stepanova Hirurgia 1964, 113-119

Në artikull analizohen të dhënat mbi 37 pacientë, 33 burra dhe 4 gra me moshë nga 19 deri në 70 vjeç me pneumotraks spontan ku etiologjia nuk është tuberkulare.

Të 37 të sëmurët deri në zhvillimin e pneumotoraksit gjëzonin shëndet të plotë; në 33 pneumotraks u çfaq në qitësi, në disa gjatë gjurut, në 4 çfaqja e sëmundjes mund të lidhet me ngarkesën fizike, kurse një pacienti i u çfaq në kohën e fluturimit 10 kilometra lartësi, vetëm një i sëmurë kishte në anemnezë T.B.C. pulmonum të shëruar shumë vjet përparrë.

Tabloja klinike e pneumotoraksit spontan kondicionohet me kolasp të pulmoneve, ajri hyn në kavitetin pleural duke çvendosur me diastinë në anën e kundërtë, çfaqet sindromi i dhëmbjes prishja e-funksionit respirator dhe e veprimtarisë kardiovaskulare.

Në këto raste në toraks çfaqen dhurabje të forta, dispne, cianozë takikardi. Këto simptoma vijnë besa.

Çfaqja e kësaj apo asaj forme të pneumotoraksit mvaret nga madhësia dhe forma e defektit të indit pulmonar, prezenca e aderençave pleurale, nga grada e zhvillimit të emfizemës.

Shkaku më i shpeshtë i pneumotraitit spontan është çarja e bulave emfizematoze ose i cysteve me ajër pulmonar.

Në kompleksiu e masave që merren për shërimin e sëmundjeve hyjnë dhe futja e gjykipërsë në kavitetin pleural dhe kryerja e respiracionit aktiv ose pasiv.

Në rastet që kjo nuk jep efekt duhet odërryrja kirurgjikale. Graviteti i ndërryrjes kirurgjikale duhet të jetë minimale dhe mvaret nga shkalla e ndryshimeve të indit pulmonar. Kistet solitare qepen, në kistet multiple të periferisë bëhet rezeksion periferik; kur dëmtimet janë me të shprehura bëhet lobektomia. Të sëmurët me pneumotraks spontan ku etiologjia është jo tuberkulare, duhet të mjeqohen në stacionar në repartet kirurgjikale dhe të janë vazhdimit shënuar kontrollin e kirurgut.

MBI DIAGNOZËN DIFERENCIALE TË MORBUS BENE-BEK SHAUMAN

M. V. Rogoskina dhe B. M. Zuntov. Hirurgia 1964, 10, 126-129

Shumë autorë e quajnë këtë sëmundje sarkoidozë, etiologjia deri tani është e pa njeri. Disa konsiderojnë shkak të sëmundjes tuberkulozin të tjerrë pranojnë natyrën virusale, disa e fusin sëmundjen në grupin e patologjisë së sistemit retikuloendotelial me predominiimin e lokalisimit në noduset lymfatike pulmonare, lëkurë dhe trallë në organet e tjera.

Bene-Bek-Shauman nga disa autorë ndahet në tre stade. Në stadin e parë të procesit kapen lymfoglandulat e mediastinit sidomos grupi bronkopulmonar, më trallë ai paratrakeal. Nuk ka simptoma klinike të qarta dhe zbulohet rastësisht gjatë egzaminimeve rontgenologjike. Në këtë stadin sëmundja mund të shërhohet vetë.

Në stadin e dytë procesi përhapet në indin pulmonar, rrugët e përrchapjes janë hematogene dhe lymfogene. Të sëmurët mund të kenë temperaturë subfebrile, kollë dhëmbje në gjoks, dobësi të përgjithësme.

Kur përrchapja e procesit bëhet me rrugë lymfatike kemi një forcim të rrjetit pulmonar në ekzaminimin rontgenologjik, në rastet që përrchapja është hematogene mund t'i ngjajë një tuberkulozi hematogen të diseminuar të pulmonit ose me një silikozë.

Në stadin e tretë çfaqen hije në formë dhe dëndësi të ndryshme; çfaqet fibroza intersticiale. Emfyzema buloze e shprehur mund të qo jë në pneumotraksin spontan.

Në proces merr pjesë dhe pleura mediastinale dhe ajo interlobare, më vonë bëhet ciroza pulmonare dhe vdekja vjen nga insuficiencia kardiorespiratore. Para së gjithash duhet bërë diagnoza diferenciale e sarkoidozës me lymfogranulomatozën lymfosarkomatozën, tuberkulozin dhe

me kancerin central pulmonar. Vështirësitet e diagnozës diferenciale lehti sohen kur ka lymf-glandula nën lëkurë ose lymfoglandula të tjera, biopsia e të cilave jep diagnozin. Autorët jepin dhe karakteristikat rontgenologjike të sëmundjes dhë konkludojnë se njohja e mirë e mjekekëve me tablon klinikomorfologjike të sëmundjes dhë përdorimi i gjithë metodave diagnostike mund të ndihmojë të vendoset diagnoza e drejtë, saktësishq diagnoza varet vetëm pasi të bëhet ekzamini histologjik.

Literatura 9 burime.

KOMPLIKACIONET BRONKOPILEURALE POSTOPERATORE DHE PROFILAKSIA E TYRE

R. Z. Badretdinov Hirurgia 1964, 10:129-134.

Deri sot në mjekeimin kirurgjikal të sëmundjeve pulmonare një nga çështjet që mbelet e pa zgjidhur është profilaksia dhe terapia e komplikacioneve bronkopleurale postoperatorore.

Autori ka observuar 778 të sëmurë të cilëve i u bë ndërhyrje radikale nga viti 1956-1961. Komplikacionet postoperatorore bronkopleurale u konstatuan në 106 të sëmurë nga të cilat fistula postoperatorore në 77 të sëmurë. Prej tyre në 62 u konstatuan fistula të kultit të bronkut, në 15 fistula bronk alveolare dhe në 29 emfizema pa fistula.

Mosha e të operuarve nga 9 deri 70 vjeç

Nga 778 të sëmurë u operuan 319 për *cancer pulmonum*, 288 lëdhur me procese purulente, 171 për sëmundje të tjera.

Nga të sëmurit që u operuan për cancer fistulat postoperatorore u konstatuan në 9.3%. Autori jep tabela ku krahasohet shpeshtësia e fistulave postoperatorore lëdhur me karakterin e ndërhyrjes kirurgjikale.

Fistulat janë më frekuente gjatë lobektomive dhe bilobektomive inferiore se sa pas ndërhyrjeve analoge në regjionet superiore pulmonare. Sa më e gjatë ananuseza e pacientave aq më të shpeshta janë fistulat. Autori mendon se këto të fundit çfaqen tre herë më shpesh në të sëmurët mikroflora e të cilëve nuk është e ndjeshme ose është pak e ndjeshme karshi antibiotikëve. Një nga faktorët që këqeson konditati e regenerimit dhe që shpie në paqëndrueshmërinë e kultit bronkial është prezenca e ndryshimeve inflamatore-destruktive në muret afér vatrës.

Për profilaksinë e komplikacioneve postoperatorore rëndësi të madhe ka përpunimi i teknikës kirurgjikale dhe kryerja e interventit me elegancë, rëndësi ka sidomos përpunimi i elementeve të ilusit pulmonar gjatë kohës së operacionit. Pra analiza e komplikacioneve postoperatorore bronkopleurale është aktuale. Aktualiteti diktohet në radhë të parë se këto komplikacione janë të shpeshta dhe në radhë të dytë nuk ka metodë që të garantojë profilaksinë e tyre.

Literatura 28 burime.

PËRDORIMI I LËKURËS HOMOPLASTIKE TË KONSERVUAR NË BETAPROPRIOLAKTONE PËR MJEKIMIN E KOMBUSTIONEVE.

Janosh Novak, Zoltan Zaborski Hirurgia 1965, 2, 77.

Mundësia autoplastikes është e kufizuar sidomos kur është dëmtuar një pjesë e madhe e lëkurës, kur gjëndja e të sëmurit nuk lejon kryerjen e intervanteve të mëdha kirurgjikale, kur është aplikuar një terapi e gjatë antikoagulantë (në rastet e embolisë pulmore ose të trombozës së enëve koronare), gjithashtu dhe në rastet që është kunderindikuar narkoza.

Izolimi i sipërfaqes së plages behet me ndihmën e fashave të zakonëshme, gjithashtu, me anën e heterotransplantave (Vittells). E meta e këtëre metodave është se nuk i jepin një ndihmë aktive proceseve biologjike epitelizuese të organizmit.

Trasplatum urgjent i lëkurës së donatorit paraqet vështirësi ekonomike dhe organizative.

Për djegëjet e mëdha të gradës së III (deri më 40% të sipërfaqes së trupit), gjithashtu dhe me kombinimin e homoplastikës dhe autoplastikës duhen jo më pak se 12-20 donatore, për këtë repartet kirurgjikale që meren me mjekimin e djegëjeve duhet patjetër të ketë lëkurë homoplastike të konservuar.

Për sterilizimin e lëkurës së marë pa ulur vlerën biologjike, përdoren një ser komponimesh - betapropriolaktone, azoiprit, fenol etj, më i miri sipas Le Grippe dhe Brandstela etj. është i pari.

Në repartin e traumatologjisë së spitalit qëndror të Budapestit, prej nëndorit 1960, përdorën lembot homoplastike lekure të konservuara sipas metodës së dhënës në artikull në djegëje të mëdha (në 16 të sëmurë), gjithashtu dhe përmblumim e defekteve të lëkurës për shkak të traumave mekanike në tre të sëmurë.

Në të gjithë të sëmurët që në ditët e para u vrejt një përmirësim i dukshëm. Atyre i u shtrua apetiti, ra ose u ulë temperaturat e trupit, pas 10 ditësh u përmirësuan treguesit e tabelës së gjakut dhe albuminave të sërumit të tij.

Përdorimi i lëkurës homoplastike të konservuar nuk kërkon kondita të veçanta, marja e lëkurës nga trupat nuk ka vështirësi; metodika e sterilizimit dhe e konservimit është e thjeshtë.

Literatura 18 burime

EKSOSTOZAT MULTIPLE KARTILAGINOZE.

Hirurgia 1965, 2, 113.

Eksostozat multiple takohen rallë prandaj s'janë të qarta të gjitha çështjet.

Në klinikën e autorit prej vitit 1959-1960 u shtruan 6 të sëmurë (4 burra dhe 2 gra) me egzos-tozë multiple. Mosha e të sëmurëve ishte si më poshtë: nga 5-10 vjeç 2 të sëmurë, nga 11 deri 15 vjeç 2, nga 31-40 vjeç 1, nga 41-50 vjeç 1.

Egzostozat çfaqen që në moshën e vogël, irritja më e madhe e tyre harrin në moshën 12-15 vjeç.

Autori, pasi jep të dhëna nga literatura, harrin në konkluzionet e më poshtëme: 1) Egzostozat multiple janë sëmundje të moshës fëminore me ndalimin e rritjes së kockës ndalon dhe rritja e egzostozës dhe çfaqja e egzostozave të reja nuk i vihet re.

2) Egzostozat multiple kartilaginoze vihen re në të gjitha kockat e skeletit, por me shpesh në kockat tubulare.

3) Tabilloja klinike e egzostozave multiple është e ndryshme dhe mvarët nga madhësia, lokalizimi i egzostozave dhe grada e kompresionit të organeve dhe indeve fqinje.

4) Eggostozat multiple kartilaginoze duke u rritur në dimensione për një kohë të gjatë shumë rrallë kalojnë në trasformim neoplastike të kockës.

5) Përdoret mjekimi kirurgjikal në rastet e eggostozave të madha ose të mesme, ose në ato raste kur e deformojnë ose komprinojnë organet dhe indet sfjinje.

Literatura 11 burime

PLAGËT KONTUZIVE TË EKSTREMITETEVE DHE MIJEKIMI I TYRE.

Hirurgia 1965, 2, 68.

Mjekimi i plagëve kontuzive paraqet vështirësi sepse shpesh komplikohet me nekrozën e indeve sfjinje. Mikroflora gjen kondita të mira për tu zhvilluar, çfaqja e inflamacionit purulent zgjat afatet e shërimit. Ky kapitull i traumatologjisë, pavarësisht nga rëndësia praktike, është studjuar pak.

Ne artikull janë marrë në analizë 820 persona me plagë kontuzive të pjesëve të ndryshme të trapit, nga ata, me plagë kontuzive të anësive që dhanë një përqindje të madhe qelbëzimi ishin 476 ose 56,4%. Autori në fund të artikullit jep konklusonin e mëposhtëm.

1) Plagët kontuzive të anësive që japojn një përqindje të madhe qelbëzimi dhe kërkijnë një mjekim të zgjatur takohen në 51% të numurit të përgjithshëm të plagëve kontuzive, 57,5% e tyre kanë si shkak traumen.

2) Rezultati i mjekimit të plagëve kontuzive të anësive në shumë raste mivaret nga përpunimi primar kirurgjikal i plagëve, illoji i anestezisë dhe përdorimi i antibiotikeve.

3) Me përdorimin e anestezisë intrakockore dhe injektimit intrakockor të antibiotikeve, krijohen kondita të mira për përpunimin primar kirurgjikal të gjërë të plagës dhe përfundimet plastike.

4) Me përdorimin intrakockor të antibiotikeve dhe novokaines në kohën e operacionit, dhenë ditët e para pas tij dhe me përdorimin e metodave plastike në 100 të sëmurë me plagë kontuzive multiple të anësive u muar në 86% shërim për primum në 14% për sekundan. Përqindja e komplikacioneve u ul 3,9 herë.

5) Kur plaga është shëruar për secundam në 12% u konstatua nekroza e kufive të lembova dhe vetem në 2% qelbëzim atje ku mikroflora ishte pak e ndjeshme karshi antibiotikëve.

Literatura 6 burime.

MBI INFLUENCËN E GLUKOKORTIKOIDeve NË DEKURSIN E PLAGËVE ASEPTIKE OPERATIVE.

Profesor G. M. Sellovjev, O. J. Kutakov. Hirurgia, 1965 2, 91.

Gjatë studimit mikroskopik të një fushe inflamatore mund të shihen ndryshime eksudative dhe alterative, shkaku i tyre nuk është vetëm veprimi i agjentit dëmtues mbi indin, që jep inflamacion, por dhe veprimtaria e produkteve të metabolizmit, që bien në fokusin e dëmtuar.

Për të luftuar proceset eksudative-alternative përdoren shumë metoda dhe medikamente.

Një rëndësi të madhe në praktikën kirurgjikale kohë e fundit ka marrë përdorimi i hormoneve, para se gjithash i glukokortikodeve që kanë përvëç cilësive të tjera dhe një efektivitet të theksuar antiinflamator. Në praktikën klinike shpesh përdoren cilësitu hormonale që të influencojnë mbi fazën produktive të inflamacionit kur predominojnë ndryshimet fibrozo-sklerotike. Mjekimi me kortikosteroidë i plagëve të pastëra operatorë është pak i studjuar. Në bazë të të dhënave eksperimentale të disa autoreve që përdorin doza të mëdha të glukokortikosteroideve, shumë autore nuk i përdorin këto të fundit ne mjekimin e plagëve të pastra mbasi mendonin se voaojë regenerimi i plagës.

Mussgung, Vilain, Pordu mendojnë se hidrokortizoni dhe analoget e tij forcojnë epiteli-zimin e plagëve që për një kohë të gjatë nek janë shëruar. Përdorimi i hormoneve steroidë e rekomandonte edhe P.A. Kuprajnov që kishin venë re shërimin e shpejtë të plagëve operatorë pas përdorimit të kortikoideve.

Përdorimi në doza jo të mëdha i hidrocortizon acetatit ndalon zhvillimin e inflamacionit

alternativo-eksudativ dhe duke ndryshuar karakterin e proceseve biokimike në plagë shpërje në epitelizim të shpejtë. Hqja e shpejt e suturave të lëkurës (në ditën e 2-3) duke përmirësuar vaskularizimin e indeve bëhet shkak për të shpejtuar proceset regenerative të lëkurës.

Literatura 9 burime.

EKSPERIENCA E MJEKIMIT TË OSTEOMYELITIT.

Kish, Kadani Jozha, Tashnadi Lajlo. Hirurgia 1965, 2. 94.

Në klinikën e II kirurgjikale të universitetit mjekësor të Debrecentit prej vitit 1952-1962 u mjetuan 117 të sëmurë me osteomyelit, prej tyre 30 ishin në fazën akute dhe 87 në ato kronike.

Sa me shpejtë të fillohet mjekimi i sëmundjes aqë më e mirë është edhe prograiza. Kur egziston absesi subperiostal dëmtimi i ushqyerjes së kockës luani një rol me rëndësi në dekursin e mëtejshëm të sëmundjes. Në këtë periodë përdorimi i antibiotikut nuk mund të prevenoj zhvillimin e procesit lokal.

Koncentrim i antibiotikut në palcën e kockavc në kondita fiziologjike është më i pakët se në organet e tjera të brëndëshme, kjo gjë theksohet në rastin e konditave patologjike.

Shumë autorë pasi marin antibiogramat injektojnë antibiotikun intra muskular, të tjerë intraarterial dhe infiltrojnë indet për reth me antibiotike.

Në rastet e absesit subperiostal autorët kanë përdorur hapjen dhe mjekimin lokal me antibiotikë. Nganjëherë që proceset inflamatorore purulente të theksuara të kockës mund të shërohen dhe më një hapje të thjeshtë të vatrës pa përdorimin e interventit kirurgjikal radikal.

Sipas të dhënave të literaturës kalimi i procesit në formën kroni-ke ndodh në 10-45% të rasteve - nga të sëmurët që obzervuan autorët vetëm 9 kaluan në formën kronike. Shpeshësia e sëmundjes në kohë e fundit është shtuar, tabloja klinike shpeshtësia e sëmundjes së antibioticive, kjo është e lidhur me shtimin e shtameve bakteriale rezistente karshi antibioticëve, prandaj del si detyrë të kërkohen rrugë të reja për kurimin e sëmundjes.

U muanë rezultatet e mëposhtëne të kulturës së mikrobeve; në 71% u izolua *staphylococcus aureus*, në të tjerat *pseudomonas pyocyane*, *B. proteus*, *B. collis*, *B. paracollis* dhe flore e përzier.

Në 70% të rasteve u konstatuan rezistenza karshi penicilinës, karshi polimiksines në 85% të rasteve, aureomycincs në 40%, streptomycine, kloromicetinës, teramicinës, eritromycinës në 20-30%.

Duke marë parasysh recidivet e shpeshta pas operacioneve radikale ata konsiderojnë më të mirë mjekimin konservativ, vetëm në ato raste kur operacioni është i domosdoshëm kryhet interventi kirurgjikal.

Literatura 13 burime.

MJEKIMI I PLAGËVE DHE DJEGËJEVE ME HEMOPASTE BAKTERIOSTATIKE.

V. P. Sinkevic. Hirurgia 1965, 2, 81-85.

Autori studoi rezultatet e mjekimit të të sëmurëve me plagë të infektuara dhe djegëje me hemopaste bakteriostatike sipas metodës së Profesor M.F.Kamajeva. Baza e preparatit është ekstrati i gjakut të donatoreve, placentar ose umbilikai.

Sipas të dhënave, të Kamajeva, gjaku shërben për ushqimin e indeve si një preparat kompleks biologjik, si stimulator i proceseve regjenerative.

Shëimi i antibioticive në preparatet e gjakut përmirëson në mënyrë të dukshme efektin terapeutik. Një rëndësi të madhe për proceset regenerative ka prezanca e fibrinës në plagë prandaj preparati i shitet dhe Calcii chlorati. Metodika e përdorimit të medikamentit është e thjeshtë: shëresa gaze vihet një shtrës pastë prej 0.5% em trashësi dhe vihet mbi plagë e cilë lidhet.

Autori paraqet rezultatet e mjekimit të 216 të sëmurëve nga të cilët 102 u mjetuan me hemopast bakteriostatik, dhe 114 të tjerë me medikamente të tjera (solucione hipertonike: mikrocidë, gramicidinë, furacilin rivanol, dhe me piomad vishnjevski).

Në plagët që mjetuan me antiseptikë dhe antibiotikë pa përdorimin e hemopastes faza degjenerativo inflamatorë ishte më e zgjatur.

Disa plagë të infektuara, të mjetuara gjatë më preparate të tjera dhe ku proceset regenerative ishin të ngadalta u shëruan shpejtë pas mjekimit me hemopast. Në mjekimin e ulcerave

trofike mjekimi me hemopast shérben si masé paraprake pér mjekimin e mëtejshém kirurgjikal. Autori konkludon se mjekimi me hemopast i plagëve të infektuara dhe i djegëjeve eshtë efektiv. Krijon kondita të mira pér regjenerimin e plagës dhe zgjat efektin bakteriostatik të antibiofitave. Kjo metod mund të rekamandohet gjithashtu mëc pregatitjen e sipërfaqeve të plagëve pér operacione plastike.

Literatura II burime.

MJEKIMI I TË SËMURËVE ME KOMBUSTIONE TË RËNDA.

M. V. Kollokolov, N. I. Atjasov, S. P. Pahomov, N. A. Ponomareva, Leontiev. Hirurgia 1965, 2, 85.

Prej vitit 1953-1962 në institutin e traumatologjisë dha ortopedisë të Gorkit u mjekuan 517 të sëmure me djegëje, në artikull jepen të dhëna mbi mjekimin e 83 të sëmureve të djegur rendë.

Të gjithë të sëmuret u paraqitën në stacionar me shok, ata që u paraqitën në ditët e parapash djegëjes, pér këtë mjekimi filloj me marjen e masave antishokale.

Prej vitit 1962 u abandonua metoda e përpunimit primar të sipërfaqes së djegur sipas Vilbushëvicit pér shkak të traumës së madhe dhe inefektivitetit të saj.

Mjekimi i djegës fillon pasi i sëmuri të dalit nga gjëndja e shokut. Në pavjon ku shpihet i sëmuri vazhdon terapia anti-shok duke përbledhur dhe oksigjeneratapinë, terapiinë medikamentozë dhe në radhë të parë përdorimin e fuzionave.

Në tre ditët e para të sëmureve me djegëje të rëndë u injektojnë; kur nuk kanë shënjat e dekompenzimit kardiak, gutta-gutte 3-4 lit lengje (250 ml gjakë, 250 ml. plazme, i litër poliglukine, 1-2 litra 5% solucion glukoz me koktein shtes që përmban 30-50 ml 0,25% solucion novokanini, 10 ml. 33% solucion tyosulfat natri, 10 ml. 10% Solucion natrii bromati, vitamina të grupit B, vitamina C. Autorët një rëndësi shumë të madhe pér shërimin e plagës i jepin plastikës së lëkurës me ndihmën e transplatareve të marë me dermatom, Zbulimi i dermatomit dhe më vonë i elektrodermatomit hapen një epokë të re në zhvillimin e terapisë komplekse të djegëjeve.

Literatura 6.

ÇFAQJA E DIABETIT MELITUS SI KOMPLIKACION I PANKREATIT AKUT.

A. A. Zakaraja. Hirurgia 1965, 1, 94.

Shpesh gjatë pankreatiteve akute, sidomos gjatë formave destruktive, vihen rre shumë komplikacione ndërmjet të cilave dhe diabeti melitus. Ritja e nivelit të sheqerit në gjak në shumicën e rasteve ka një karakter të përkohëshëm dhe pas qelësimit të fenomeneve akute në pankreas bie në normë. Nganjëher nuk bie në normë dhe kemi zhvillimin e tablos tipike të diabetit melitus.

Autori ka marë në studim 574 të sëmure të shtruar në klinikën e tij dhe që vuanin nga pankreatiti akut. Sheqer në gjak u vu re në 158 të sëmure, në 25 prej tyre u vu re niveli i lartë.

Sëmundja kalon rëndë. Konstatohet zverdhja mukozave, lëkurës, cianoza e buzëve dhe e gishtrinjëve. Kanë dhëmbje të forta në abdomen, shpesh ndërojnë pozicion në krevat, nauze, të vjella që nuk e pushojnë dhe që nuk e përmirësojnë gjëndjen e të sëmure. Vihet rre një shpejtësim i pulsit kur temperatura e trupit është ose normale ose subfebrile etj. rititet diastaza në urinë.

U vu re glukozuri në 5,9% të të sëmureve.

Mjekimi konservativ pér pankreatit akut u bë në 21 të sëmure, ai kirurgjikal në 4. Vdiqën dy të sëmure pamvarësish nga ndërrhyra kirurgjikale; njeri nga pankreonekroza totale akute me intoksikacion të shprehur, tjetri nga një pankreonekrozë hemoragjike.

Pankreatiti akut të personat që vuanin nga diabeti kalon me rende dhe në një shkallë të lartë keqëson dekursiu e mëtejshëm të diabetit melitus (Rossak, Joelson, Rose).

Dihet se treguesit normal të sheqerit në gjak nuk eskludojnë prezencën e dëmtit me sekretore të pankreasit. Për të diktuar format e lehta të diabetit melitus dhe veçanërishtë gjendjet prediabetike duhet patjetër të egzaminohet gjaku pér sheqer pas ngarkesës me sheqer (prova Shatbraugotta).

Hiperglicemija dhe glukozurija në diabetin melitus kan rëndësi prognostike për këtë kryerja e egzaminimeve laboratorike ka rëndësi për përcaktimin e terapisë dhe dietes pas daljes nga spitali.

Rekomandohet që të sëmurët të vijnë në kontroll në mënyrë që të mund të përcaktohen format e lehta të diabetit dhe tu vihet një regjim dyspanserik.

Literatura 20 burime.

KORTIZONOTERAPIA E DISA SËMUNDJEVE TË APARATIT LOKOMOTOR.

K. V. Vladimirov, Ja. S. Semukov. Hirurgia 1965, 2, 74.

Mjekimi i disa sëmundjeve të aparatit lokomotor, veçanërisht i artrozave deformante, ashtë i vështirë dhe jo gjithmonë i harin qëllimit të duhur. Metodat e mjekimit më të përhapura, fizioterapiqë dhe balneoterapike, janë efekt të shkurtët dhe jo të vazhdueshëm. Prej vitit 1961-1962 autorët patën nën mbikqyrje 83 të sëmurië (62 gra dhe 21 burra) me moshë nga 22 deri në 67 vjeç me sëmundje të ndryshme të kockave, muskujve, artikulacioneve, të cilat u mjekuan me kortizon dhe kortizon acetat.

Të gjithë të sëmuriëve iu bë një egzaminim i përgjithshëm para mjekimit. Sipas të dhënave të literaturës mjekimi me hormonin kortikosteroidë është i kundërrindikuar në *ulcus ventriculi et duodenii*, tuberkulozë, diabeti *mellitus*, *morbus hiperthyreus*, epilepsia, njëkohesisht edhe në gravidancë. Midis të sëmuriëve 41 vuanit nga artroza deformante (osteoartrite) të artikulacioneve të ndryshme, të cilat më shumë vështirësi mjekohen dhe bëhen shkak i paftësisë në punë.

Dhëmbjet periodike në këtë sëmundje shpesht janë të lidhura më çfajjen e artikulacion ose periartikular të proceseve inflamatore. Hidrokortizoni i injektuar në kavitetin e artikulacionit ngadalëson zhvillimin e procesit inflamator. Pas disa injektimeve të hormonit të artikulacionit dhëmbjet në shumicën e rasteve zhduken ose paksohen shumë, ristabilizohet lëvizja e artikulacionit. Mjekimi pas kurës me kortizon, me fisioterapi dhe balneoterapi forcon rezultatet e haritura.

Lidhur me efektin bëhen 1-5 injeksione me një interval 2-3 ditësh. Rezultatet më të mirë u harri me përdorimin e hidrokortizonit sesa me kortizon-acetat. Në 1/3 e të sëmuriëve pas injektimi të preparatit u çfaqen dhëmbje të cilat u qetësuan pas pak ditësh. Rezultatet e mjekimit u çfaqen pas disa kohë dhe mvarën nga shtrirja edhe thellësia e procesit patologjik të artikulacionit: sa me të theksuara të janë démtimet aqë më vështirë është të harihet efekti i medikamentit.

Në 4 të sëmurië me artroze deformante pas 9-12 muaj u çfaq rikatuzimi me dhëmbje të forta, përdorimi i hidrokortizonit dha efektin e duhur.

Literatura 10 burime.

ILEUSI AKUT INTESTINAL TE TË SËMURËT NË MOSHË TË KALUAR.

R. M. Nurmuhamedov. Vestnik Hirurgii 1964, 12, 17.

Prej vitit 1954 deri në vitin 1963 në klinikë u mjekuan 356 të sëmuri të ileus akut intestinal, prej të cilave 143 (40,2%) ishin me moshë mbi 50 vjeç. Bura ishin 74 dhe femra 69. Tablloja klinike e të sëmuri të kanë moshë të katuar ndryshon nga ajo e atyre me moshë të re.

Shpesh konstipacionit të pleqëve nuk i jep ndonjë rëndësi e madhe nga mjeket se ky është i zakonshëm për ta. Dhëmbjet e forta në abdomen të mosha e re vijet në 85% të pleqtë në 60% nauza dhe vjellja në të parët vijen në 75-80% në të dytët në 45%. Konstipacioni te të rinjtë u konstatua në 92% të pleqtë në 98% të rasteve. Simtomë i sklerozit u gjet në 58% simptomë Valja në të 18% simptomë, i spitalit të Obuhovit (ampulla bosh) 12%, simptomë i Bajerit (abdomoni asimetrik) 20% dhe gotat e Klojberit në 68%, me 52% u konstatua leukocitozë me devijimin e formulës majtas.

Dianogstika vështirësohet mbasi të sëmuri të vijnë vonë në stacionar dhe se simptomat klinike nuk janë të shprehura mirë, nga 143 të sëmuri vetëm 15 u drejtojnë të mjeku dhe u hospitalizuan në 6 orët e para pas fillimit të sëmundjes dhe 27 në 12 orët e para.

Përqindja e përgjithshme e letalitetit në *ileus acut* të intestinit ishte 16,3%, te mosha e re 9,8%, te pleqtë 25,9% midis të operuarve 44,6% të paoperuarve 11,4%.

Autori e përfundon artikullin duke nën vizuar të mos priten të gjitha simptomat e sëmundjeve të humbjet shumë kohë për metodat konservative. Percaktimi i diagnozës, metodat konservativë

vative dhe preqatja e të sëmurëve për operacion nuk duhet të zënë më shumë se 1/2-2orë. Gjatë kësaj kohe duhet të jetë vendosur dhe çështja mbi indikacionet e operacionit. Qëndra e vëmendjes në periodën postoperatorore duhet të drejtobet te sistemi kordio-vaskularë, sistemi respirator, lufta me intoksikacionin dhe infeksionin.

Duhet pa tjetër të miren masa për të nequlluar ekuilibrin e metabolizmit të dëmtuar të albuminave, karbohidrateve dhe bilancin hidrosalini të organizmit.

PLASTIKA E HERNIEVE TË MËDHA POSTOPERATORE DHE RECIDIVANTE ME RJETË PREJ FIBRASH SINTETIKE.

V. A. Kestin. Vjestinik Hirurgji 1964, 12, 37.

Rezultatet e largëta të operacioneve për hernie, lënë shumë për të dëshiruar. Plastika desekfít aponeuruzomuskulare u bë me një rjetë kopron polifiliq me Nr. 2-3.

U operuan gjithsej 211 të sëmurë, midis tyre 140 ishin të moshës së kaluar, te të cilët siç dihet reaktiviteti i organizmit është i ulur dhe ndryshimet lokale janë me të evidencuara.

Në artikull jepet teknika operatore e plastikës me kapron të lokalizimeve të ndryshme.

Dekursi postoperator kaloj mërrë, penjtë u hoqën në ditën e 8-11, për disa ditë u përdorën antibiotikë. Plaga u mbyll përmirësimi në 198 të sëmurë, në 13 u konstatua hematomë subkutane.

Dihen rezultatet e largëta të 173 të sëmurëve, prej tyre 42 kanë 6 muaj që janë operuar, 33 një vite, 45 dy vjetë dhe 53 deri në 45 vjetë. Në asnjë rast nuk u konstatua recidivë e hernies. Shumë të sëmurë kryejnë punën e tyre të maparëshme, disa merojn që me punë fizike.

Autori e rekomandon aloplastikën me kapron kirurgjikal ligaturjal si një metod që prevenon recidivat hernike. Rjeta e kapronit kontribuojnë regjenerimin e plaqës dhe drejtë formimin e cikatrices e cila nuk rritet në mënyrë kaotike por sipas hojzave të rjetës në gjithë sipërfaqen e saj.

Literatura 2 burime.

MBI DISA ÇËSHTJE TË ETIOLOGJISË, PATOGNEZËS, DIAGNOSTIKËS DHE MJEKIMIT TË PANKREATIT AKUT.

V. Velicenko, K. K. Ivanov, E. G. Epshtejn, V. I. Bogdanoviç G. S. Klimov
Hirurgia 1965, 1, 98.

Në vitet e fundit në literaturën botërore shpesh rihen, probleme mbi etiologjinë dhe patogenzinë e pankreatit akut. Egzistojnë një sërë teorish për patogenezinë e kësaj sëmundje: teoria infeksioze, vazore, alergjike, neurogene, e «kanalit të përgjithshëm» dhe teoria e hipertensionit intraduktal.

Pasi analizojnë të dhënat e literaturës dhe të tyret autorët japosi konkluzonet e mëposhtme.

1) Ritja e vazhdueshme e presionit intraduktal te të gjitha kafshët eksperimentale japosi zhvillimin e edemes akute pankreatike.

2) Mbas lidhjes së venave pankreatike u vu re zhvillimi i edemes akute dhe pankreonekroze e rëndë. Gjysma e kafshve ngordhën.

3) Zhvillimi i infeksionit të përgjithshëm të organizmit nuk shpije në çfaqjen e proceseve purulente të pankreasit. Në qoftë se flora bakteriale bie në gjak ne periodën e edemes akutë, atëherë si tregull çfaqet pankreatit akut purulent.

4) Pankreatitin akut duhet ta shikojmë si një proces dinamik. Zhvillimi i këtij procesi patologjik mund të vijë si rezultat i faktorëve të mëposhtëm: a) gjatë sensibilizimit albuminik, ose pas impulsove nervore intensive të vazhdueshme (nga ana e pleksusit solar) që ndryshon tonusin e vazave të pankreasit. Kjo mund të shpjeri në iskemin e organit dhe në ndryshimin trofike ose në çfaqjen e stazës dhe të edemes indore intersticiale. b) nga ndryshimet patologjike në sfinkter Oddi (spazma të vazhdueshme, papilit stenozant etj.) që periodikishtë ose në mënyrë të vazhdueshme ngren presjonin intraduktal dhe atëherë edema intersticiale e indeve mund të vijë si rezultat i kompresionit të kapilarve vazale.

5) Diagnostika e hershme e pankreatitit akut ka vështirëse.

6) Në shumicën absolute të rasteve të pankreatitit akut një efekt të mirë jep mjekimi konserватiv që konsiston në pakësimin e sekrecionit dhe në eliminimin e lengut pankreatik, gjithashtu masat përmirësimin e qarkullimit të gjakut të pankreasit.

Autorët një rëndësi të madhe i japin përdorimit të kalci chloratit dhe dimedrolit. Të dytë këto medikamente janë një mjetë desensibilizojçës. Dimedroli është gjithashtu dhe mjet antihistaminik. Në rastin e pankreonekrozave dhe flegmones së pankreasit është i indikuar operacioni urgjent me përdorimin e metodave të tjera konservative.

Literatura 43 burime.

MJEKIMI KIRURGJIKAL I KOLECSTITIT AKUT.

A. N. Shabanov. Hirurgia 1965, 2, 53.

Për një kohë të gjatë kirurget janë interesuar për mjekimin e kolecystit akut. Në kongresin e III të kirurgëve ruse në vitin 1962 P.P. Djakonov rekondonante heqjen e kolecystes në stadem e hershme jo vjetëm gjatë sëmundjes por dhe në raste ataku.

Shumë kirurge midis tyre A.T. Lidski dhe B.A. Petrov mendojnë se taktika e mjekimit të kolecystitit akut nuk mund të jetë e njëjtë me atë të apendesitit akut, ata mendojnë se nuk duhet të bëhet ndërrhyrje kirurgjikale në të sëmurën me kolecystit akut gjatë atakut të parë kur dekursi është i kënaqshem shpesh pas atakut të parë dhëmbjet nuk përsëriten më ose përsëriten pas një afati të gjatë. Gjatë vjeteteve të fundit numri i pacientave me këtë sëmundje është shtuar shumë.

Në klinikanë e autorit në 11 vjetët e fundit u shtruan 667 të sëmurë me *cholecystitis acuta* nga të cilët u operuan 241, 40, 6% e tyre kishin moshë mbi 60 vjet.

Në 30-60% të rasteve ataket akute shogërohen me pankreatit deri në zhvillimin e pankreatonekrozave. Një komplikacion i rëndë i sëmundjes është nekroza e mureve të vezikës feje me përforacionin e mevonshëm që sjell peritonitin biliari dhe nganjëherë formimin e fistulave biliare. Profesor B.A. Petrov i ndan ndërrhyrjet kirurgjikale për *cholecystitis* në tri lloje;

a) Operacione ekstreme.

b) Operacione të hershme të bëra 7-12 ditë pas qetësimit të atakut dhe c) Operacione të nevojshme në rastet e komplikacioneve të rënda të sëmundjes.

Autori mendon se të sëmurën me kolecystit akut duhet të hospitalizohen në kolecystitet recidivante të akutizuara, sidomos në atë më moshë të kaluar duhet të përdoret ndërrhyrja kirurgjikale.

Duhet të përdoren operacionet e hershme pas qetësimit të atakut akut të kolecystitit pa i nxjer të sëmurën nga stacionari.

MBI SËMUNDJET HEMORAGJIKE ANGIOEMOFILIKE.

G. Manaj. - Minerva Madika, 1965, 56, 60.

Në vitin 1926 Willebrand pas një studimi të kujdeseshëm në disa familje fillandeze të ishujve Saland vendosi se karakteristikat e sëmundjes eredo-familjare ishin një shtrim i fragilitetit të vazave dhe një zgjatje e kohës së emoragjisë; ndërsa pjastrinat, koha e koagulimit dhe retraksionit të koagulit ishin normale.

Willebrand e konsideronte sëmundjen si një «pseudoemofili» që dallohet nga emofilia që kap vetëm një seks, ka një karakter trashëgues dominant dhe për një ser veçorish të ndryshme të alteracioneve emofilike. Angioemofilia kap gjithë racat, të dytë sekset duke preferuar femrat. Patogeneza ka si bazë një difekt konstant të fyshët zgjatjen e kohës së hemoragjisë dhe alteracione të tromboplastinogenëzës. Adeziviteti i pjastrinave është i alteruar në angioemofilitë, kështu gjënjë shpjegime zgjatja e kohës së homoragjisë në këtë sëmundje.

Më poshtë paraqitet një revizionim kritik i të dhënavëve akutale mbi angioamofilitë, jepet eksperiencë personale e autorit, precizime mbi karakteristikat genetike, simptomet, profilaksine dhe terapinë e kësaj sëmundje që deri vone konsiderohet e ralle dhe që po takohet shpesh nga njohja më e mirë e mekanizmit të hemostazës dhe nga perfeksionumi i metodave laboratorike. Është detyrë informacioni për çdo emofilik, bërtja e egzaminimeve precise laboratorike që të shtrihen në sa më shumë persona të familjes së të sëmurit dhe të bëhet e qartë se martesa e bërtë gjak, kur dhe vëtëm njëri prej tyre është portator i emofilisë është rezik për brezat e ardhshëm.

Literatura 24 burime.

MUNDÉSITË E TRAJTIMIT KIRURGIKAL TË CA MAMMAE.

G. Verinezi, Masa, Spitali Santi Antonio e Slagio Aleksandri.
— Minerva Medika 1965, 156, 127.

Midis tumoreve malinjë të grave Ca colli uteri se bashku me atë mamar janë nga më frekuencat që sjellin vdekjen e të sëmurëve, përkëtë del urgjentistë problemi i studimit të trajtimit sëmundje. Për Ca mammae më shumë se për çdo neoformacion tjetër është e qartë se kurë interventi kirurgjikal bëhet sa më shpejt i sëmuri mundt të shërohet definitivisht.

Mjekimi terapeutik ndodhet akoma në fazën kerkimore, mjekimi radioterapik konsiderohet si një mjekim ndjihmës si në fazën preoperatorre ashtu dhe në atë posteoperatorre. Statistikat e Atkins dhe Haringan japin në 97% recidiva lokale, pas këtij trajtimi ai shumë rali munde të dominoj përnjë kohë të gjatë tumorin primar.

Radioterapia jep shumë favore në mjekimin e recidivave, në metastazat lymfoglandulare si lokale dhe në distancë. Trajtimi kirurgjikal i Ca mammae që mbetet kryesor i sipas autoreve, përmblehdha a) Asportacioni për qellim diangoze të noduseve mamar (biopsia). b) Intervent radikalë të mastektomisë, të kompletuara në svuotimin e kavitetit aksilar omolateral. c) Mamektomit e bëra në subjekte me neoplazi të avancuar të ulceruara bile dhe me difuzion në distancë d) Reintervente të kryera me qëllim eliminimi të recidivave lokale ose dhe në distancë. Autorët janë përmarrjen e biopsise extempore dhe kryerjen e menjëherëshme të operacionit, ata venë re se janë shtruar shumë interventet kirurgjikale për Ca mammae që ze më shumë moshën mbi mesatare.

Në artikull parashtronjë statistikën e të operuarve në 24 vjet e fundit (1940-1963) në spitalin e Aleksandrisë dhe janin disa konsideracione mbi urgjencën e vendosjes së diagnozës prekokse dhe mbi efikasitetin e trajtimit terapeutik.

Literatura 41 burime,
(Përmblehdhur nga Z. Matathia).

MJEKIMI I KOMBINUAR I DIABETIT TË SHEQERIT ME PREPARATE SULFANILAMIDIKE DHE ME İNSULINE

N. M. Mordkovskaja - Kliniceskaja Endokrinologija 1964, 5, 3;

Preparatet sulfanilamidiqe kanë gjötur përdorim të gjërë në mjekimin e diabetit të sheqerit; por mekanizmi i veprimit të tyre nuk është.

Autori ka observuar për 2 vjet 44 pacientë me forma të ndryshme të diabetit. Preparatet sulfanilamidiqe të tipit BZ-55 u përdorën duke filluar nga 1,5-2,5 gr, në ditë të tipit D-860 nga 3 gr. me paksimin gradual deri në dozën efikase minimale.

Përdorimi i sulfanilamideve në pacientët që kanë marrë insulinë, bëhet pas stabilizimit të sheqerit në gjak, esell në mëngjes. Efekti fillon në 7-10 ditët e para, paksohet hiperglicemija dhe glukozurija.

Kura e kombinuar mund të aplikohet edhe në prani të acidozës në anamnezë.

Në qoftë se me insulinën në doza të mëdha paksohet hiperglicemija, me sulfanilamidet e përdorura përkëtë qëllim, paksohet doza e insulinës. Në qoftë se sasia e sheqerit në gjakun asëll qëndron në nivel të lartë edhe me aplikimin e dozave të mëdha të insulinës, atëhershë indikohet mjekimi i kombinuar me insulinë dhe sulfanilamide. Sulfanilamidet favorizonjë çfrtyezimin më të plotë në organizëm të insulinës endogene ose të ardhur nga jashtë.

Kura e kombinuar është më efikase sepse efekti zgjat për shumë kobë basi sulfanilamidet eliminohen ngadale, ato kanë efekt kumulativ në organizëm. Kjo gjë lejon të bëhet mjekimi ciklik. Për çdo $1\frac{1}{2}$ -2 muaj kurë me insulinë shfohet sulfanilamidet për 3-4 javë në dozat minimale efikase; 0,25-0,5 gr, në ditë për tipin BZ-55 dhe 1 gr. për D-860. Me këtë rast në intervalt ndër-mjet ciklave me terapinë sulfanilamidiqe jepen doza të vogla të insulinës të cilat paksojnë në mënyrë të theksuar hipergliceminë. Në terapijin e kombinuar paksohet edhe fenomenet anësore të sulfanilamideve që konstatohen në përdorimin e veguar të tyre, të zgjatur.

16 burime literatura.

OLEANDOMICINA NË MJEKIMIN E SËMUNDJEVE INFLAMATORE PULMONARE

L. S. Riskina, I. K. Llagert Terapeuticeski Arhiv 1964, 12, 102.

Oleandomicina është antibiotik i grupit të majroliidave dhe preparat efikas kryesishë mbi bakteriet gram-positiv, mbi disa bakterie gram-negativ, virusë të mëdha dhe mbi rikeciet. Oleandomicina vepron aktivisht mbi stafilokokët patogenë që janë rezistente ndaj shumicës së antibiotikëve.

Autorët përdorën oleandomicin-fosfatin, në mjekimin e pneumonive, në 100 raste, të formave akute ose kronike të rizikutizuar, me ndryshime të theksuara në pulmone. Klinikisht, pacientët paraqiteshin me kollë e sputun, dispuse me sforsimet fizike, respiracion të vështirësuar, lodihe të theksuar, hipertermi, ndryshime klinike, rentgenologjike pulmonare, leukocitozë dhe sedimentacionin të shpejtuar.

Preparati u aplikua nga 25.000-500.000 U.V., 4 herë në ditë, për 7-10 ditë. Doza për kurs 2.000.000-7.000.000 U.V., të shëqoruar me terapinë simptomatike.

Rezultatet e mjekimit u nxorën në bazë të paksimt të kollës dhe sputnit, zhdukjes ose pak-simt të ndryshimeve fiziçkale në pulmone, normalizimit të temperaturës, tabllosë së gjakut, dhe të dhënave rentgenologjike.

Përdorimi i oleandomicinës infuluncon në sputum, në përmirësimin e dekursit të pneumonisë.

Personenit anësore, nga përdorimi i preparatit takohen trallë, si nauzes, emezis, urtikarie etj.

Autorët konkludojnë se preparati oleandomicin-fosfat jep efekt të mirë në mjekimin e pneumonive akute dhe kronike. Përdorimi i saj me dozën nga 250000-500.000 U.V., 4 herë në ditë tolerohet mirë nga pacientët. Në marrjen e 500.000 U.V. oleandomicinë, koncentracioni bakteriostatik në gjak ruhet për 6 orë, po kaq arrin edhe koncentracioni në sputum.

Për evitimin e formimit të oleandomicino-rezistente, preparati duhet të jetet pas përcaktimit të sensibilitetit të mikroflorës së sputumit dhe antibiotiku të mbahet si rezervë.

Literatura 9 burime

ZHDUKJA E EFEKTIT TOKSIT TË GLUKOZIDEVE KARDIAKE ME UNITIOL

Masluk V. I. Pogosjan L. A. - Sovjetskaja Medicina 1964, 11,89

Në përdorimin e zgjatur të glukozideve kardiake në të sëmurët me insuficiencë të qarkullimit të gjakut, pa mvarësishët nga marrja e klorur-kaliut mit, shpeshi lindin fenomene të superdozimit që shprehën me bradikardinë e theksuar dhe ekstrasistoli.

Në klinikën e terapijisë të fakultetit, të udhëhequr nga prof. V.N. Vinogradov, me propozimin e F.Z. Meerson u bënin eksperimente lidhur me zhdukjen e efekteve toksike të glukozideve kardiake me anë të përdorimit të unitiolit-donorit të grupeve sulfhidrike.

Unitioli përdoret për mjekimin e helmimeve akute dhe kronike nga komponimet e arsenikut, zhivës, kromit dhe bismutit. Këto komponente në bashkëveprim me grupet sulfhidrike të fermenteve proteïnike dhe i inaktivizojnë ato. Unitioli përbënë 2 grupe sulfhidrike të cilat hyjnë në reaksiون me nukleuset tiolike, duke formuar me to komplekse jo toksike. Lidhja e toksinave (helmeve) sjell në rigjenerimin e funksjoneve të sistemeve fermentative të organizmit.

Unitioli u përdor në 16 pacientë me vese kardiale, kardiosklerozë aterosklerotike, etj. të shoqëruara me insuficiencë të qarkullimit të gjakut.

Gjithë pacientët, krahas glukozideve kardiake, kanë marrë edhe klorur kaliumi nga 1 gr. 4 herë në ditë, osë ky preprat iu injektua intravenoz si solucion 2% nga 20-40 ml. Megjithatë, në këta të sëmurë u çlaq bradikardija e theksuar (me frekuencë 56-42 goditje në minutë) ekstrasistolja e theksuar, bife edhe bigeminija. Në E.K.G. ulet segmenti S-T, negativizohet ose bëhet bifazik dhëmbi T në lidhje standarde dhe torakale.

Efekti toksik u konstatua pas futjes së glukozideve me dozat totale, strofantina 0.00075-0.0075 gr., korglukoni 0.0036, gr. digitalis 2-6 gr.

Solucioni 5% i unitoliit u aplikua intramuskular me dozën e njëherëshe 1 ml. në 10 kgr. peshë të pacientit dhe në 2 ditë e para të mjekimit u injektua nga 3 herë në ditë, në 2-3 ditë pasojëse nga 2 herë në ditë, kurse në 3-4 ditë e fundit nga 1 herë në ditë.

Rezultoi se në shumicën e pacientëve bradikardija dhe ekstrasistolja u zhdukën 2-4 ditë mbas fillimit të mjekimit me unitiol, u normalizua rimi i dñe në E.K.G. u konstatuan ndryshime që tregojnë përsëri paksimin e intoksikacioneve me glukozide.

Fenomenet anësore të unitiolit, në këta pacientë, u manifestuan me retension lëngjesh në organizëm, gjë që u korigjua me dhëni e diuretikëve (hipotiazid ose novurit) dhe futjen e një kohëshme në organizëm të klorur ose acetat kaliumit.

Blokimi i grupeve sulfhidrike të fermenteve të membranës miokardiale luan rolin kryesor në mekanizmin e veprimit të glukozideve kardiake. Kështu mund të supozohet se futje e donatorit të grupeve sulfhidrike-unitiolit, sjell në paksimin e sasisë së grupeve sulfhidrike të blokuara dhe në këtë mënyrë paksohen efekti toksik i glukozideve kardiakë.

Përdorimi i më të shkem i unitiolit për zhdukjen e efektit toksik të glukozideve kardiakë duhet të studohet me kujdes në konditata e klinikës.

Rezulton se donatori i grupeve sulfhidrike-unitoli mund të përdoret në klinikë për zhdukjen e bradikardisë, ekstrasistolisë dhe fenomeneve të tjera të kondicionuara nga veprimi toksit i glukozideve kardiakë.

(Përbledhur nga S. Galanxhi)

MBI MEKANIZMIN E REAKSIONIT EOZINOPENIK GJATË PROVËS SË TORNIT

G. Kudravcev, Problemi gematologji i perelivania krovi 1962,3,55-59.

Gjatë provës së Tornit ulja e numurit të eozinofileve në 50% dhe më shumë, fillon mbas 4 orë të injektimit të A.C.T.H. Një reaksion i tillë nga ana e eozinofileve në gjakun periferik mund të ndodhë vetëm gjatë funksionimit të mjefueshëm të gjendjes suprarenale. Prandaj prova e Tornit përdoret gjérësisht në klinikë si tregues i gjendjes funksionale të koresit të suprerenaleve.

Dihet se eozinopenia gjatë injektimit të A.C.T.H. lidhet me rritjen në gjak të kortikosteroideve (hidrokortizon, kortizon) por mekanizmi i këtij reaksiuni mbetet akoma i pa qartë.

Zhdukjen e shpetjë të eozinofileve në gjakun periferik gjatë provës së Tornit, autori e spjegon për këto arsyen:

1. Frenimi i maturacionit të eozinofileve në palcën e kockës ose mbajtja e tyre prej palcës së koskës. 2. Lisis i eozinofileve në gjak ose inde, 3. Kalimi i eozinofileve nga gjaku në inde.

Bibliografia 21 burime.

SPLENEKTOMIA DHE HORMONOTERAPIA GJATË MOBRUS WERIHOF

F. A. Efendijev A. M. Ahundov. M. M. Abdyllojev Problemi gematologji i perelivania krovi 1964,3,11-15

Autori studjoi sistemin koagulues dhe aktivitetin fibrinolitik tek 30 paciente me morbus Werlhof dhe simptomokopleksin e Werlhof. 15 pacientë u njekuan me preparate hormonale (kortizon, prednizolon), kurse 14 të tjerë ju nënështruan splenektomisë. Preparatet hormonale u dhanë në doza mesatare; kortizoni nga 100-150 mg. për 2-4 javë me ulje graduale të dozimit. Remisioni klinik dhe hemoragjik mbas njekimit hormonal filloj kryesisht tek pacientët me të ashtuquajturin simptomokompleks Werlhof që ishte zhvilluar mbas disa sëmundjeve të tjera (grip, angina infeksione gastrointestinale). Në rastet me morbus Werlhof me dekurs të zgjatur (nga 1-6vjet) terapija hormonale u tregua më pak efektive.

Mjekimi hormonal përvet uljet së përshtushmërisë së kapilareve, me kohë jep edhe ndryshimë cilësore tek trombocitet, ata përmirësojnë aftësitë e tyre funksionale për të sekretuar faktorin tromboplastik dhe seritininë.

Nga 14 pacientë që ju nënështruan splenektomisë, 2 vdiqen nga hemoragjia cerebrale. Tek të tjerët recediva u përsërit vetëm tek 2. Ndryshimi i sistemit koagulues të gjakut mbas splenektomisë, sigurisht që është i lidhur më heqjen e «frenës lënciale» gjë që shpie në normalizimin e procesit të formimit të trombociteve dhe në përmirësimin e gjendjes së tyre funksionale.

Autori mendon se njekimi i morbus Werlhof patjetër duhet filluar me hormono-terapinë dhe vetëm kur një mjekim i tillë i gjatë është i pasuksesshëm, duhet të kalohet në splenektomi.

Bibliografia 16 burime.

TROMBOCITOPENIA AKUTE GJATË MORBUS BASEDOW

V. R. Kovalenko Problemi gematologji i perelivania krovi 1964,3,55-56

Autori i attikullit paraqet një rast të rrallë të uljes së trombociteve në shifra minimale tek një paciente me strume *thyreotoxică*.

Pacientja me moshë 40 vjeç me diagnostë e mësipërme i nënështronsh operacionit të strunektomisë subtotalë. Gjatë operacionit kishte hemoragi kapillare. Mbas operacionit hemoragjia vazhdoi nëpërmjet drenazhit dhe suturave. Ju dha vikasol, kalcium, -klorat, xhelatine, por hem-

ragjia nuk u pakësua. Numri i trombociteve 10.000, indeksi i protrombinës 83,4%. Hematoma subkutane përfshiu gati gjithë qafën. Ju fillua ritina me acid askorbinik, kompleksi i vit. B, prednizolon, glukoze, antibiotikë dhe transfuzion masash eritrocitare dhe trombocitare. Ditën e 9 mbas operacionit numri i trombociteve filloj të rrrejt dhe ditën e 10 arriti në 169,000. Koha e hemoragjisë u normalizua. Mbas një viti gjëndja e pacientes paraqitej e mirë. Trombocitet 209,100.

CITOGENETIKA DHE RËNDËSIA E SAJ E SOTSHME NË PATOLLOGJI

S. Pavelski Problemi gematologji i perelivani krovi 1963,11,3-10

Gjatë viteve të fundit me shpejtësi po zhvillohet citogenetika, një nga degët e genetikës, që merret me studimin direkt të kromozomeve me ndihmë e metodave citologjike.

Në vitin 1956 u përcaktua se numri i kromozomeve në qelizën somatike të njeriut të shëndoshë nuk është 48 sëmundje më parë por 46 (Tijo dhe Levan). Ky numur përbëhet nga 22 çifte autozome dhe nga dy heterozome genitale. (Tek grua 2 kromozome tek burri kromozomet x dhe y). Çdo qelizë genitale ka 23 kromozomë (një numur haploid), kurse qeliza somatike normale ka 46 (një numur diploid) kurse çdo qelizë somatike normale ka 46 (një numur diploid);

Në gjëndje patologjike, vërehen ndryshime në kromozomet. Mekanizmi i këtyre ndryshimeve akoma nuk është studjuar krejtësisht. Autori çregullimet kromozomale i paraqet në 4 grupe:

1. Ndryshimi i numurit të kompleteve të kromozomeve. 2. Ndryshimi i numurit të kromozomeve-mungesa e një kromozomi ose prezenca e disa kromozomeve suplimentarë. 3. Ndryshimi në strukturën e kromozomeve. 4. Ndryshimet e strukturës dhe numurit të kromozomeve.

Ndryshimet e grupit të parë mund të jepin aborte sipas Delharty. Në ndryshimet e grupit të dytë autorë përmend sindromin Ultrich-Turner ku kemi mungesë të një kromozomi genitalic. Tek këta individë vërehet mos zhvillimi organeve genitale dhe mungesa e shënjave sekondare në periudhën e maturimit. Gjendrat e tyre genitale ndodhen në gjendje rudimentare dhe nuk funksionojnë, shtati i vogël. Në sipërsfaqen anësore të lëkurës së qafës vërehen palosje të gjera suplimentare (pterygium colli).

Shumica e përsavave me sindromin Ultrich-Turner kanë vetëm 45 kromozome (kromozomet genitale xo). Janë pëershruar edhe rastet e variantit mashkull të këtij sindromi që ka xy kromozome (Chu)/.

Kromozomi i tepërt x(xxy) klinikisht çfaqet me sindromin Klinefelter, që karakterizohet me hipoplazinë e testikulave dhe atrofjinë e kanaleve të spermës, me aspermi, gjinekomasti, pampajtje mendore dhe me rritje të sekretimit të hormoneve gonadotropë.

Ndryshimi i formës së kromozomeve është takuar në qelizat e të sëmurëve me miellole ukozë kronike, ku kemi ndryshimin e formës të kromozomeve të çiftit 21 (ph-kromozomet). Mungesa e ph-kromozomit në mielloleukozën kronike flet për një dekurs më të mirë të sëmundjes. Ky kromozom patologjik nuk duket gjatë leukozave eozinofilike, leukozave që lidhen me rrezet si dhe në disa variante atipike të mielloleukozës kronike. Ndryshimet e formës së kromozomit të 21 bëjnë të supozosh se këtu ndodhet qëndra ose qëndrat e rregullimit të leukopoëzes.

Ndryshimet në të njëjtën kohë të formës dhe numurit të kromozomeve më shpesh takohen në leukozat akute. Ndryshimi i numurit konsiston në shtrimin e kromozomeve nga 46 deri 54 bili deri në 97 (sipas vrojtimit të Sandberg). Këto ndryshime shikohen vetëm në qelizat e palces së kockës dhe të gjakut. Ndryshimet kromozomale nuk shoqërojnë vetëm leukozat. Ndryshimet të tillë kemi edhe në disa raste të makro-globulinës gjatë anemisë Adalison-Birmer si edhe në qelizën kanceroze.

Zhvillimi i shpejtë i citogenetikës do të zgjerojë njohuritë tona mbi patologjinë.

Bibliografia : 34 burime.

NDRYSHIMI I NUMURIT TË LEUKOCITEVE NË GJAKUN E NJERËZVE TË SHËNDOSHË

E. R. Guglin, L. I. Najman Problemi gematologji i perelivani krovi 1963,7,29-32

Autorët kanë studjuar përbajtjen e leukociteve në gjakun e 14.758 njërzve të shëndoshë. Studimet janë bërë nga viti 1958-1961. Në vite të ndryshme shikohen ndryshime në përbajtjen mesatare të leukociteve. Duke ju referuar N.A.Shulc, Z.A.Sençishçev etj. autorët e artikullit flasin për mvarësinë e përbajtjes së leukociteve në gjak me ndryshimet ciklike në aktivitetin

e diellit. Cicli diellor zgjat 11 vjet. Maksimumi i aktivitetit të ciclit të fundit është ndodhur gjatë viteve 1957-1958. Pikërisht në këtë periudhë autorët e cituar kanë parë ritje të rasteve të leukopenisë funksionale. Gjithashtu autorët kanë vënë se gjatë muajve të verës shihet një ulje relative e leukociteve, kurse gjatë vjeshtës një irritje. Shkaqet e lëkundjeve sezionale të leukociteve janë të pa karta.

MBI PËRMBAJTJEN NORMALE TË LEUKOCITEVE NË GJAKUN E NJERIUT.

L. Geller, V. Suhanova Problemi gematologji i perelivanijs krovë 1964, 2, 25-27

Sot përmbajtja normale e leukociteve në gjakun e njeriut është akoma e distukueshme. Ka autorë që sasinë e leukociteve në normë e konsiderojnë 5000-8200 për mm^3 (Vlados.Fajshtein). Vejtuk, kur leukocitet zbrasin nën 5000 e konsideron leukopeni dhe shton se leukopenia e kësaj natyre në 2.5% të rasteve. Kosirski, duke cituar edhe autorë të ndryshëm thotë se kufiri më i vogël i leukociteve në normë është 4000 për mm^3 .

Autorët nuk përjashtojnë edhe mundësinë e influencës së ndryshimeve gjeografike. Kufiri maksimal i leukociteve në sajë të studimit të gjakut të 439 njerëzve të shëndoshë rezultoi të ishte jo më shumë se 9000 për mm^3 .

Bibliografia 4 burime

MBI HEMOGLOBINURIN PARADOKSALE

J. I. Lorie Problemi gematologji i perelivanijs krovë 1962/6. 52-54

Hemoglobinuria është simptom i gjëndjeve të ndryshme hemolitike që vijnë si rezultat i shkatërimit të eritrociteve (intravazal), si p.sh. gjatë hemoglobinurisë post-transfuzionale etj... Në të gjitha këto raste hemoglobina del në urinë mbasi kalon një përqindje të caktuar në gjak. (100-125 mgri. %).

Autori tregon dy raste interesante (nënë dhe bir, në moshë 10 muajsh) ku hemoglobina del në urinë pa e kujuar pragu e saj në gjak dhe pa patur shënjë të shtimit të hemolizës. Për këtë ai propozon që kjo formë të quhet hemoglobinuri paradoksalë. Autori është i mendimit se kjo ngjet nga hemoliza e eritrociteve direkt në renë, në sajë të ndryshimeve neurevazale ose fermentative, ndryshime këto që mund të kenë karakter familial të trashëgueshëm.

Përbledhur nga B.Çako

LIDHJET KLINIKO-BIOLOGJIKE NË MES TË VIRUS-VE DHE BAKTERËVE NË INFEKSIONET BASHKËEKSISTUESE : VARICELLA-DIFTERITË

G. Laterza Min. Ped. 1965. 1., 41.

Raportet klinike në mes të agentëve patogenë infektiv, që studiohen me qëllim zbulimi të shkaqeve të patomorfozit të sëmundjeve infektive, kanë treguar *in vitro* se interferencat (ndërrhyjet) e agjentëve patogenë në të njëjtin teren, çojnë në ndryshime genetike të cilat, mund të shpejgojnë modifikimet epidemiologjike ose shfaqjen e sindromave të reja. Shumë nga këto fenomene biopatologjike, mund të sqarohen me një studim të vëmendshëm të raporteve biologjike në mes të virus-ve dhe bakterëve dhe të veprimitarisë së tyre specifike, kur kontrollohen në një teren organik. Këta rapporte shprehen, nga njera anë, me *interferencën* ose *veprimitarinë imbrojtëse* që infeksioni i pari ien n'organizmu dhe nga ana tjeter, me fuqizimin reciprok në kuptimin që bashkimi i dy aktivitetave patogene përbën një proces simbiotik dhe prandaj të fuqizuar.

Fenomeni i interferencës (që duhet dalluar prej atij të antagonizmit bakterik), mund të studiohet në raportet në mes virus e virus dhe virus e baktere. Qyshe në 1935, Magrassi, duke injektoar në mënyrë të fraksionuar, në trurin dhe nën lëkurë ose në korne të lepurit virusë herpes-i, mundi ta zhdukë herpesin dhe tregoj me këtë interferencën, që sikurse është vërtetuar më vonë, nuk

është një proces imunitar specifik por që bën pjesë në kuadrin e gjërë të imunitetit aspecific dhe që shprehet me çlirim nga ana e qelizës së infektuar, e një substance që quhet interferon. Kjo substancë është veshuar në 1957 nga Isaac e bashkëpuntorë dhe paraqitet si një proteinë me peshë molekulare të ulët, është aktive kundrejt të gjithë virusve në mes të të cilëve ato më sensibël janë virus-ë e vegjël encefalotatogjen ndërsa, ato të murtajës dhe të herpes simplex, janë më rezistente.

Interferoni nuk ka hyrë në praktikë për shkak se, duhet përdorur përparrë se të çfaqet infeksionin dhe se se, është vështirë të mblidhet në sasi të tillë, sa që të ndalojë shumëzimin viral.

Këtu duhet të kujtojmë edhe procesin e interferencës të baktereve kundrejt virus-ve, proces që përfitohet *in vivo*, me introdукtiонin të baktereve ose të estrakteve liposakaride të këtyre. Megjithëse këta studime janë ende në fazë eksperimentale, me sa duket, shtimi i rezistencës antivirale i dhëne nga liposakaridet, i detyrohet fenomeneve imunitare aspecificke që shkaktojnë aktivitetin mbrojtës dhe me efekt të kufizuar (1 milion herë më pak se interferanca në mes virus-ve - Wagner 1959).

Të shumta janë sëmundjet me fuqinë interferenciale në patologjinë infektive; kështu vrehet një ulje reciproke e çfaqejeve të sëmundjeve në mes të fruthit e shytave, fruthit i lisë së dhënëve si dha paksimi, i aksezeve të kollës së mirë mbasi pacienti mori edhe linë e dhene ose fruthin. Gjithashtu është treguar fuqia interferenciale nga infeksioni poliomielitik mbi infeksionin e coxsackie-s.

Problemi më i studiuar dhe më i qartë nga ana eksperimentale dha klinikë është ai i lidhjeve sinergjike të fuqizuarë në mes të virus-ve dhe baktereve dhe që klinikisht çfaqen me superinfekcionet bakterike gjatë zhvillimit të sëmundjeve nga viruse çka mund të tregohet në mënyrë eksperimentale edhe në kafshë.

Autori, mbasi përkruan ndarjen e superinfekcioneve në tre grupe prek studimet e shumta në lidhje me infekcionin e përzier të adenovirus-it osc virusit influencial me stafilokokun, infekcionet e përziera të aparati gastrointestinal dha përqendrohet në bashkëkëzistencën e infekcioneve varicelle difteri.

Simbas vretjeve të Verzner (Pediatría 1960), infeksioni varicelloz provokon shpesh infekzioni difterike akute në portator ose në pacientë me forma të thjeshta riniti sero-ematik kronik dhe se difteriti, në rast varicelle, qoftë edhe në shdukje, jep shkas zgjatjes së periudhës të eliminimit të bacillve në konvaleshtët. Gjithashtu shfaqja e njëkohësme e të dy infekcioneve, jep një kuadër klinik shumë të rëndë, shpesh vdekje je prurës.

Sëfundë autor i përkruan rastin e një fëmije 4 vjeçare me presencë në të njejtën kohë, manifestimesh infektive nga varicella dhe difteria, i vaksinuar dy vjet përparrë për difteri dhe që megjithë kurat e rastit (penicillin streptomycin, sigrimycin, Vit B, B₁₂, C, Kortikosteroïd, strikninë, oksigjen, emotransfuzion), vdiq mbas tre ditësh qëndrimi në spital.

VËLLIMI I ZEMRËS SË NËNËS DHE PREMATURITETI.

E. H. Bishop. M. D. Shila, J.A.M.A. 1964 15, 500.

Duke qënë se zhvillimi bile, dhe vetë ekzistencia e fetusit në përgjithësi, mvarët prej integratit dhe eficencës së sistemit qarkullues matern dhe në mënyrë të veçantë, prej sasisë dhe cilësisë së gjakut të uteru-sit, është llogjike të kërkohen cënime eventuale në sistemin qarkullues si shkak i lindjeve premature. Rahiu e shokë duke punuar në këtë drçtum qysh më 1956, matën postpartum, vëllimin e zemrës materu në një numër të vogël pacientesh dhe gjetën një ngriturje të dukëshme të lidhjeve premature në gra, që kishin madhësinë e zemrës më të vogël se mesatarja.

Duke u nisur nga këto të dhëna autorë ka matur radiologjikisht vëllimin kardiak, 300 pacientëve gjatë periudhës prenatale dhe përfundimet e nxjerra i ka studuar në lidhje me frekuencën e lindjeve prenatale dhe peshën e lindjes. Ai ka konstatuar kështu se fëmijët e grave me vëllim zemër të vogël, janë ujen normë me peshë dhe shumë prej tyre prematurë. Nga ana tjetër, fëmijët e grave me vëllim zemër të madh, janë në përgjithësi me një lindje mbi normë dhe rallëherë, prematurë.

SIJËNIME TË KIRURGJISË INFANTILE.

L. Bussi. Min. Ped. 1964. 16, 26, 992

I) Pankreatiti traumatic në foshnjëri.

Megjithëse kohët e fundit është shkruar shumë mbi lëndimin traumatic të pankreasit, (aq sa, shumë autorë mendojnë që duhet marrë parasysh në diagozën dispecifike të sindromeve abdominal akut), kjo gjendje mbetet ende një problem i vështirë përsë i përket diagozës dhe terapisë.

Duke u bazuar mbi një rast pankreatiti traumatik tek një fëmijë 7 vjeçar, autori përshkruan simptomatologjinë dhe terapinë përkatëse.

Simptomatologjia paraqitet në raport të drejtë me lezionet e pankreasit vetë dhe të organave të tjera, si mushkëritë, hepari, shpretkë, zorrët dhe veshkët. Po për shkak të traumas pankreatike, përvëc një sindromi të lehtë gastrointestinal, mund të kemi rupturë të kanaleve me derdhje të amilasit dhe lipasit në indet intersticiale të tij. Kjo shkaktikon procese autolizi vaskulare e parenkimale dhe nekroze të indit dhjamor. Në rast traumash të lehta, pacienti nuk paraqet ndonjë shenjë leziorimi të dukëshëm por, në qoftë se trauma fillohet nëntë e rëndë, shkaktikon rupturë të trupit të pankreasit dhe njëkohësisht, eliminimin e lëngjeve tretëse me hemorrhagji massive në indet përqark: në këta raste, fëmija është në gjendje të rëndë qyshe në fillim dhe në pamundësi të bëhet diagnoza duke u bazuar vetëm në të dhënrat klinike. Nga kjo del e domosdoshme të përcaktohet qoftë edhe shpesh herë, amillasë në serum, në çdo fëmijë me trauma abdominale.

Në rastet e dyshimitë këshillohet ndërhyrja dhe kura përkatëse.

2) Biopsia perorale e zorrës së hotitës në foshnjët.

Në raste diarreje kronike dhe statorre, indi i marrë nga goja, përbën një ndihmë diagnostike sejon të kryhen kërkime enzematike për të përcaktuar në se karenca e disakardiasit është shikaku i diarreas-

Sonda intestinale e Schiner-it e Rubin-it dhe kapsula e Crosby-it, kanë dhënë deri më sot, përfundimet më të mira në këtë drejtim.

E. Kauder dhe T. M. Bayles («Am. J. Dis. Children» 107, 582, 964) e kanë modifikuar këtë instrument duke përdorur një sondë gastrike polivinilike që nuk acaron aspak mukozën intestinale të fëmijës. Me këtë mënyrë, autorët kanë ekzaminuar 32 foshnjë me diare me etiologji të ndryshme dhe në 80% të rasteve, kanë patur reperte biopsie të qarta. Një procedurë e tillë që zgjat mesatarisht tre orë, nuk jep komplikacione (hemorragji, perforacion) në qoftë se kryhet prej dore të stërvitur. Përqindja e sukseseve është mbi 90%.

FARMOKOLOGJIA E ANTIBIOTIKËVE NË TË PORSALINDURËT

F. Sereni, L. Perletti, N. Manfredi, A. Marini. Min. Ped. 1964. 16, 755.

Autorët, në 5 të porsalindur 1 ditësh dha në 6 fëmijë të moshës së gjirit (3-6 muajsh), kanë studiuar mënyrën e absorbimit, të shpërndarjes nëpër inde dhe ekstremin e antibiotikëve të ndryshëm dhe kanë ardhë në këtë konkluzione:

Tetraciclina (duke e dhënë për os 7 mg/r. kg), u konstatua në plasmën e të porsalindurve me moshë nën 48 orë, në një nivel shumë më të lartë se n'ato mbi tre muaj dhe kjo, për shkak të vlerës shumë të ulët të filtrimit glomerular në ditët e para të jetës. Gjithashtu mund të thuhet edhe për streptomycinën dbe penicillinën megjithëse ky antibiotik i fundit ekskrotohet edhe nga tubulat renale në sasi shumë të pakët.

Siq diket prej shumë pediatrëve, mund të injektojsh në të porsalindurin penicillinë G sodike me intervalle shumë më të gjata se sa në të iritit duke patur po një soj koncentrim të lartë terapeutik të antibiotikut në gjak.

Studime po të këtyre autorëve mbi sasinë e kalimit të antibiotikëve nga shtrati vaskolarë në inde (interstitium) kanë vërtetuar vrejtjet e studiozëve të tjerë mbi akumulimin e tetraciklinave në indet e të porsalindurët (përvëc sistemit nervor), në sasi më të lartë se sa në të rriturit. Gjithashtu patogenëzenë e disa efekteve toksike të tetraciklinave (sindrome i pertensive endokranike transitorë dhe i shënimtë rritjesh së kockave në imaturë), autorët e spjegojnë me dhënien e dozave të larta ose mesatare të këtij antibiotiku në fëmijët e moshës së gjirit ose në imaturë. Këta sindrome nuk lejnë dëmtimë permanent. Të tillë dëmtimë çfagen përkundrazi në zhvillimin dhe strukturën e dhëmbëve kur antibiotiku i jepet dhe të porsalindurit ose nënës *antepartum*. Në rastin e fundit, autorët përmëdlin edhe efektin teratologjik të antibiotikëve.

Sa më sipër, dhënia e tetraciklinave duhet të jetë e kuifizuar në fëmijët dhe, kur është e domosdoshme të jepet, të paksohet doza (4 herë më e pakët se sa ajo e të rriturit, duke marrë si bazë peshën e trupit.)

DHËNIA E AMINAZINËS NË FËMILJËT ME PERTUSSIS.

A. Shvaltko. Vap. ohr. Mat. i diet. 1964, 9, 78.

Duke qenë se pertussis është një nga sëmundjet më të rënda të fëmijëve dhe duke u nisur nga fakti se efikasiteti i mjeteve terapeutike është i pakët për këtë sëmundje, autori ka marrë përsipër studimin e efektit të aminazinës në fëmijët që vuanë prej pertussis. Për këtë qëllim ka studuar 90 fëmijë gjysma e të cilëve me komplikacione inflamatorë të pertussis dho i ka trajtuar me klorpromazine gjatë javës së parë, të dytë dhe të tretë, mbas fillimit të kollës spasmodike.

Autori pohon se megjithë që fëmijët vua jshin prej një pertussis të rëndë, (48 raste) dhe mesatarisht të rëndë (32 raste) të kuruar me klorpromazine, në injeksione i m.më një dozë 24 orësh nga 0.6 (në solucion novokaine) e deri në 4 cc (simbas moshës) për një periudhë 6-10 e deri 12 ditë, pati rezultate të mira sepse gjëndja e përgjithësme u përmirësua, me pakësim të kollës të vjelljeve dhe të konvulsioneve dhe njëkohësisht u vrejt shërimi klinik i komplikacioneve inflamatorë. Për këto arësyte autorë rekomanon përdorimin e këtij medikamentit në rastet me pertussis, sidomos në fëmijët e moshës së njomë.

(Përbledhur nga Xh. Basha.)

TESTI THJESHTË PËR TË DALLUAR IKTERIN MEKANIK NGA AYI HEPATITIT (M. BOTKIN)

S. Ilca, C. Dodica, Z. Joanovici. Presse med. 1964, 43, 17, 765

Autorët kanë eksperimentuar testin që pëershkruanjë më poshtë dhe e kanë gjetur gjithnjë pozitiv, në ikteret e heparit dhe negativ, në 58 raste më iktere mekanike ndër 59 raste të eksperimentuara gjatë 5 vjetëve. Vetëm në 1 rast të këtyre iktereve të fundit (mekanik) testi rezultoi lehtësisht pozitiv dhe kjo pse pacienti kishte lezione hepatiti kronik.

Autorët kanë vrejtë se në 98.4% të rasteve testi është ekzakt kurse Rothenmund e ka konstatuar të tillë në 100% të rasteve.

Prej sa më sipër, atë konkludojnë se testi i tyre është gjithnjë pozitiv, specifik në lezonet parenkimatoze të heparit dhe negativ në ikteret mekanike.

Testi : Në 1 ml. sol. ujor 0.2% citrat ammonium dhe hekur /III/ brum në lamele, hidhet 0.1 ml. serum gjaku jo i hemolizuar; përzehet së bashtku dhe pastaj lehet për 30 minuta. Pastaj kontrollohet qartësia : në ikteret mekanike, përzierja mbetet e qartë ndërsa turbullohet në ikteret me origjinë parenkimatoze aq më shumë, sa më e dëndur të jetë prekja e parenkimës. Autorët kanë përdorur ammoniumeisen/ III/ citrate/ braun Lamellen Merch që qëndron pa u prishur për 10 ditë.

VEPRIMTARIA TERAPEUTIKE ANTIFUNGINE E NJË ANTIBIOTIKU TË RI.

P. Pagna - Min. Derm. 1964, 39, 11, 299.

Në klinikën dermatologjike të Universitetit të Padova-s është eksperimentuar një antibiotik i ri që ka treguar një veprimitari të theksuar antifungine « in vitro » dhe « in vivo ». Ky prodhim i ri - lucensomicina - është nxjerrë nga metabolitet e një shëtme streptomyces dhe karakterizohet prej përbajtjes në molekulën e sajë, të një grupi kromofor tetracnik. Ai përfshihet në kategorinë e antibiotikëve polienikë ashtu sikurse edhe anfotecitina A, antimicoina, fungicidina (nistatina) etj.

Autori e ka përdorur këtë preparat të ri në formë pomade (lucencomicina 5000 U; vaseline anhydride q.s. per 1 gr.) në 32 pacientë (9 të shtruar dhe 23 ambulant), me mykoza të këmbëve, ekzema marginatum, pityriasis versicolor dhe granuloma trichophyticum.

Autori pohon se pranueshmëria e këtij medikamentit nga organizmi ka qenë e mirë në 29 raste ndërsa në 5 ka patur reaksione të lëkurës me formim bullash.

AMPICILLINA NË DERMO-VENEREOLOGJI.

G. B. Cottini, C. Lazzaro Min. Derm. 1964, 39, 196

Autorët, imbasë pëershkruanjë karakteristikat kimike të ampicillinës, pohojnë se ky antibiotik zhvillon veprimin e tij si kundër mikroorganizmave gram pozitiv, ashtu edhe kundër atyre gram negativ dhe ka anë të mira pse absorbohet shpécit nga organizmi, qëndron për një kohtë relativisht të gjatë në qarkullim, (rreth 6 orë), kalon edhe pengesën ematoencefalike. Përsa i përket sominis-trimit të tijë, rezultatet kanë qenë gjithnjë të mira qoftë duke e dhënë çdo 6 orë, siç është provuar në infekzionet e aparatit urinar e të frymëmarries, qoftë çdo orë, siç është konstatuar në proceset infektive të rrugëve urinare, gjithnjë për os dhe nga 500 mgr. çdo herë.

Autorët e kanë kontrolluar efikacitetin e këtij antibiotiku në dermatozat e ndryshme dhe kanë arritur këto përfundime:

Lues / 500 mmgr. ampicilline x 8 orë x 10 ditë :

Në të 20 pacientët (me LI seronegative) dhe në 44 (me LI seropozitive), u vrejt zhdukja e spiroketës nga sifiloma në një kohë prej 8-12 orësh mbas dhënies së antibiotikut, cikatrizimi nga 14-22 ditë dhe negativizimi serologjik me Nelson Mayer mbas 60 ditësh (përveç një rasti me normalizim 32%).

Uretritis gonokosike 500 mmgr. x 8 orë x 2 ditë - ose x 1 ditë

Në 36 raste pacientësh të trajtuar kështu, sekrecioni i pakësua shumë mbas 24 orësh dëshmon se nuk u konstatua. Ndryshimet ishin të dukëshme mbas kësaj kohë, edhe në paraqitjen e sekrecionit që ishte katarral dhe me shumë pak filamente të lehta.

Rikontroli mbas 8 ditësh negative.

Uretritis bakterika (jo gonokosike) - 500 mmgr. x 8 orë x 5 ditë).

Në 22 raste, kontrolli mbas 24-48 orëve rezultoi me zhdukje të florës bakterike.

Pyodermitis dhe ekzema mikrobiqe 500 mmgr. x 8 orë ose 250 mmgr. x 6 orë x ditë simbas procesit.

Në 42 raste u panë përfundime të mira sidomos kur medikamenti u dha në doza të mëdha.

Përfundimit autorë pojnojnë se në sëmundjet e lartpërmendura ampicilina është e vlefshme për pranimin, lehtësinë pranimit të saj nga organizmi dhe për veprimtarinë e gjere që ka.

KONSIDERATA MBI NJË RAST NEKROLISI EPIDERMKE TOKSIKE OSE SINDROME LYELL.

B. Gagliardi, P. T. Ricciardello Min. Med. 1964, 55. 40. 19 1616

Sindromi që njihet me emrin e Lyell-it, pse ky e përshkroi për herë të parë, si nekrolizi epidermike toksike: shpërthim që duket si një djejeje e lëkurës, ka shtuc kapitullin i dermatozave bulloze dhe ka dhënë shkas shumë diskutimesh përsa i përket përcaktimit të shenjave dhe klasifikimit të saj.

Sëmundja duket se prek më tepër femrat (2/3 e rastev), çon në më të shumtën e rasteve në vdekje (49 më 30 rastet e Garnier-it dhe 6 më 20 rastet e kazistikës pediatrike të përshkruar), dhe në shumicën më të madhe të tyre rezulton se përpëra shfaqjes së sindromit, pacienti kish marrë ndonjë medikament të cilin edhe vetë Lyell i atriuante shkakun e nekrolizit. Medikamentet që kishin marrë pacientët ishin, në 2 rastet e Lyell-it, aspirina dhe fenil butazoni, në ato të Garnier-it (30), fenofaleina, antipirina, vaj i kenopodium-it, aktinomicina, penicillina, sulfamidikët, serumi antiskaratinoz, vaksina antipolio dhe sulfamidet me veprim të vonëshëm. Për këtë arësy, është çfaq ipoteza e një forme shumë të rëndë farmakoalergje. Këtu duhet shtuar se shumë autorë, kanë vënë në dukje se shfaqja e lezioneve në shumë raste është konstatuar jo menjëherë mbas marrjes së medikamentit të pandehur si shkaktar i saj por, mbasi ishte përdorur për një kohë të gjatë dhe me përfundime të kënaqëshme. Për këtë arësy, Garnier mendon se kemi të bëjmë jo më me imtoskim në formë helmimi o idiosinkrazie, por me një proces alergjik sekundar, mbas një sensibilizimi të më parëshëm.

Shfaqja e parë e sindromës përbëhet prej një exantheme morbilliforme o skaralatiniforme por me ngjyrë më të eftë, me elemente purpurike dhe me lëkurën që merr nga ndonjëherë, një pamje erytomo-skamuozë. Mukozat preken qysh në fillim: ajo e gojës paraqet emanthemë të ngashme me atë të skarlatinës; buzët dhe gjuhët kanë erozioni që mbulohen shpejt me membrana e kruste; ajo e konjunktivës është e skuqur me sekrecion mukopurulent. Ndonjëherë shihet edhe *Keratitis*. Mukoza vulvare gjithashtu është e skuqur e deskuamar dhe e dhembëshme.

Eritma përhapet menjëherë në të gjithë trupin duke përfshirë edhe shuplakët e duerive dhe shuajet e këmbëve dhe mbrenda pak ditësh, formohen fliktena karakteristike jo shumë të ndera, dhe me një likid që lëviz mbrenda tyre simbas gravitetit. Shpesh Nikolsky është present. Gjendja e përgjithëshme e pacientit është e rëndë, me ethe dhe kolaps kështu që ky dekurs mund të gjatë në vdekje mbas një kohë të shkurtër por, në qoftë se mund të kapërxehet kjo fazë kritike e sëmundjes, epidermisi zëvendësohet shpejt pa lënë cikatrice. Sipërfaqet e lëkurës që nuk ishin transformuar në bulla, paraqesin pigmentim që vazhdon për një kohë të gjatë, deri 7-8 muaj, mbas fillimit të sëmundjes.

Përveç këtyre shenjave, konstatohet shpesh edhe rënia e thonjëve të duarve dhe të këmbëve, mbas dy muajsh nga çfaqja e sëmundjes por më vonë, ato dalëngadalë, zëvendësohen me thonjë të ri e normalë.

Autorët, mbasi japos elementet për diagnozën diferenciale me *pemfigus acutus febrilis*, *epidermolysis bullosae*, *dermatitis herpetiformis* Duhring, sindromin Stevens-Johnson dhe Fiesenger-Rendu apo *ectodermosis erosivae pluriorificiale*, përshkrujnë rastin e tyre: Fëmi 4 vjeçar që kishte marrë për të pestën herë vaksinë antipolio dhe medikamente të tjera (sulfamide dhe suposte bismuti), çfaqi mbas 24 orësh elemente tipike të dermatozës së përshkruar dhe që përfat, shpëtonë vdekja, më bas terapisë së përshtatështëme.

MBI SARKOJDOZAT.

Ramos e Silva, Min. Derm. 1964. 10 - 257.

Autorët, mbasi përmendin se studimet e para mbi Sarkojozoen janë kryer prej Besnier-it. Boeck-ut dhe Schaumann-it, theksojnë se këtij të fundit i përket merita e zbulimit të ripërkuisioneve sistemike të sëmundjes. Sarkojoza është një sëmundje sistemike, kronike që nganjëherë, paraqitet me «pousses» akute dhe remisione, me etiologji dhe patogenezu endë të panjohura, me lezio-niqë vendosen në gjendrat limfatike, mushkëritë, eshtrat e kërcinjëve, lëkurë, sy e tjerë. Ato janë të përbëra prej neformime indesh në formë nyjesh (me infiltratë qëllizore epitelioid), specifike edhe që, nga aua imuno alergjike, paraqesin shpesh Mantoux dhe reaktionet tjera të këtij illoji negativ por që mund të kenë pozitive provën «specifike» të Kveim-it.

Autorët i jepin rëndësi faktit se struktura sarkoide mund të haset edhe në gjendje të tjera morbozo siksuse ndodh shpesh në lebren tuberkuloide dhe prandaj, vetëm prej saj, (strukturës), nuk mund të formulojmë diagnozën e Sarkojozës. Ata vënë në dukje se megjithëqë e përgjithshme ose sistemike, sëmundja mund të paraqitet me lokalizime të veçanta si p.sh.:

Sarkojoze e lëkurës dhe e mukozave,

» e gjendrave, e kockave (sindrome Perthes - Jungling),

» hindeve të veçanta si : mushkëri, gjendra parotide, gjendra të lotimit, me cënimë në sy, në nerva ose në organe të tjera si hepar, tien, muskuj të miokardit dhe së fundi forma të sarkojozës si sëmundje sistemike me prekje të njëkohëshme të shumë organeve siksuse :

a) lëkurë - gjendra linfatike - falange,

b) gjendra mediastinike, lëkurë (erythema nodosum),

c) gjuhë e buzë - sindrome Läfgren, Melkerson - Rosenthal

d) sistem nervor - sy - gjendra të lotimit e të pështymës - Sindrome Heerfordt etj.

Së fundi autorët, mbasi theksojnë se struktura linfoïde (qiliza epiteliode, rrallë herë qiliza gjigante Langhans, pa degjenerim kazeoz), nuk është specifik por një element diagnostikimi me rëndësi, paraqesin tre pacientë me elementa tipike papulatuberkula, të vendosura në pjesë të ndryshme të fytyrës.

ARITMIA NË SARKOIDOSIS.

J.A.M.A. - 1964, 87, 29 671.

Vjetët e fundit është vënë në dukje gjithnjë e më tepër se sarkoidosis prek zemrën me zmadhim të kësaj, me çfarqe çrrëgullimesh elektrokardiografike dhe forma të ndryshme aritmie të përkohëshme.

Rrahjet premature multifokale janë çrrëgullimet më të zakoshme të ritmit. Janë përshtuar edhe tekikardi të sinusve, atriale, të nodusve, ventrikulare si dhe shenja e Wenckebach-ut. Disociacion-i atrioventrikular ka qënë gjithashu një shenje frekuente dhe shpesh bashkë me të është konstatuar vdekja e menjëherëshme e pacientit.

Megjithëse rastet e përshtuara deri më sot me sarkoidosis të miokardit me kurim të përzgjatur janë të pakta, ia vlen të kërkohen sa më parë shenjat e sipërtreguara për të vendosur një kurë me kortikosteroide duke mos haruar se sarkojoza shkakton hyperkalcemi dhe steroidet hypokalemia.

NDIHMA E MYKOLOGUT NË DIAGNOZËN E ALERGJISË NGA MICE-TËT.

A. Green. J.A.M.A. 21 Mars 1964, 187, 12, 28.

Ndihma që mykologu ekspert mund të jepë në diangozën e një alergje nga micetët me anë studimesh të sensibilitetit, është shumë e rëndësishme. Ai, përparrë së gjithash, duhet të njoftë përbajtjen micetike të atmosferës së zonës ku gjindet pacienti. Simptomat alergjike të aparitit të frysëmarrjes stinore dhe post-stinore që jo rrallë mendohet se rrjedhin nga tashquajtura faktor X atmosferik, i detyrohen në më të shumtën e rasteve, micetëve.

Por përvëç kësaj, një grup i madh këpurdhash patogenike që përbënbledh *trichophyton aspergillus*, *candida*, *coccidioides*, *blastomyces*, *hystoplasma* dhe *cryptococcus* jepin çregullime pulmonare për të cilat përpëra mendohesh se shkaktari ishte gjithnjë bacili i Koch-ut. Tashtë, me anë testesh specifike që tregojnë sensibilitetin e lëkurës ndaj këtyre këpurdhave, është treguar se edhe këta mund të janë shkaktare të çregullimeve pulmonare prandaj duhet patur gjithnjë parasysh edhe ky faktor.

Micetet alergenike që gjinden n'ajër, jepin manifestime në lëkurë dhe në mushkëri, si *asthma bronchialis*, ekzema por edhe *rinitis* e *konjunctivitis* diagnoza e të cilave, në rastet e dyshimit, kryhet mbas një anamneze të kujdesëshme dhe me anë testesh sensibiliteti të interpretuarë mitë.

Lagështia, presioni barometrik dhe erërat janë faktorë me rendesi në zhvillimin dhe përhapjen e sporave të miceteve që gjinden në tokë në bimët rrëthi e rrotulli shtëpisë, në pemë si limoni, portokalli etj, në saltam të përpunuar, djathë, bukë, në tekstile, në mobile të mbuluara dhe dyshkë prandaj, mjeku duhet të jetë në dijeni të burimeve të përgjithësme të miceteve në ambientin e pacientit dhe, kur shpërthen ndonjë formë alergjije, të marrë parasysh edhe faktorin erë. Ai duhet të dyshojë për allergji nga micetet në mënyrë të veçantë kur gjendet përpëra një astme ose rinopatiqe që është keqësuar mbas qëndrimit të pacientit në një vënd të lagët si qylarë, shtëpi të vjetër, në ndonjë vend ku ruhet bari i thatë ose aty ku rrizhet gruri.

Diagnoza e alergisë nga micetët kryhet me anë testesh të veçanta.

(Përbledhur nga Sh. Bashe.)

U MBROJTËN DY DISERTACIONE

Në sallën e madhe të fakultetit të mjekësisë, në pjesën e dytë të muajit mars, u mbrojt nga kirurgu i ri Besim Elezi disertacioni me temen «Rezultatet e largëta të mjekimit të ekinokokozës pulmonare».

Në auditor, perveç anëtarëve të Këshillit Shkencor të fakultetit, ndodheshin dhe një numur mjekësh pedagoge e studente. Ndodhesh gjithashtu dhe ministri i shëndetësisë shoku Ciril Pistoli etj.

Pasi u lexua dosja personale e disertantit dhe urdhëri i dekanit të fakultetit që lejon mbrojtjen, disertanti paraqiti shkurtimi i shëndetësoritet e studimit. Ai demonstroi se megjithëq ekinokoku bën pjesë në grupin e semundjeve infeksioze-parazitare dhe prej vjetësh ndodhet i përhapur në vëndin tonë, nuk kish patur mundësi të bëhen në studime serioze për kufizimin e përhapjes së saj. Një gjë e tillë u bë e mundur vetëm vitet e fundit në klinikën e kirurgjisë ospitaliere të drejtuar nga prof. P.Cani. Autori vuri në dukje divergjencat që egzistojnë midis dy tendencave në literaturën lidhur me rrugët më të mira në mjekimin e të sëmurëve me ekinokok pulmonar. Disertanti vuri në dukje se polemika zhvillohet midis atyre që përkrahin rrugën e operacioneve konservative dhe atyre që përkrahin rezekcionin pulmonar, megjithëse të dy tendencat kritikojnë njera tjetrën.

Disertanti i mbështetur në 126 të operuar nga ekinokoku pulmor dhe 11 të pa operuar studjon të gjithë ndryshimet e konstatuara dhe i paraqiti këto me radiografi, bronkografi e skica të ndryshme. Studimi i llojetëve të ndryshme të operacioneve të kryera në 126 të sëmurë i dha mundësi të verë në dukje fazat e ndryshme të kirurgjisë së ekinokokut pulmonar në vëndin tonë. Këtu ai jep shpjegime për çdo fazë të operacionit të kryer duke justifikuar dinamikën e nivelit gjithnjë në rritje të shërbimit kirurgjikal tek ne. Ajo që ka munguar në të kaluarën dhe që ka vështirësuar studimin është mungesa e të dhene postoperatorore. Me kuartesi u ekspozua puna e kryer nga autorët më të sëmurët për të zbuluar ndryshimet e ndodhura tek ata, për të parë rezultatet e largëta të operacioneve të kryera. Kështu p.sh. ai bëri përcaktimin e

kapacitetit vital, volumin respirator në minut, aspirografinë, radioplanimetrinë, provat e Farkut proven e Shtange, oksihemometrinë etj.

Në rezultatet e arritura nëpërmjet egzaminimeve të kryera, u vunë re shfaqje ose simptome të tilla që në autorët e konsultuar nga disertanti nuk janë konstatuar, ose të paktën nuk permënden.

Lidhur me klinikën dhe aftësinë për punë të të operuarve nga ekinokokoza pulmonare, autorët thotë se do të ishte e njëjaneshme dhe e pa mjaftuar pamja vetëm nga ana radiologjike e funksionale. Ai nënvoizoi se nevojitet marrja në konsideracion të gjëndjes klinike, sepse ngandonjëherë ndryshimet anatomicke nuk reflektohen plotisht në psiqikë dhe në aktivitetin krijorës të pacientit.

Pasi jep hollësira mbi simptomet poropositorët e gjetura tek të operuarit, nxjer konkluzione me një vlerë të mirë teorike e praktike në kirurgjinë e ekinokokut pulmonar

* * *

Gjithashtu në pjesën e dytë të muajit prill mjeku ftiziater Dhimitër Lito mbrojtjet disertacionin e tij me temë: «Veçoritë e zhvillimit dhe karakteristikat e tuberkulozit në qytetin e Shkodrës gjatë periudhës 1950-1960».

Tema e paraqitur trajtonte një problem shum aktual dhe të rëndëshëm për vëndin tonë. Nga statistikat e cituara gjatë mbrojtjes prej autorit dolli se tbc ka qënë në të kaluarën një e keqe e madhe shoqërore si nga ana epidemiologjike ashtu dhe ajo kurativ. Kështu p.sh. mortaliteti në këtë rreth në periudhën paraçirimit ishte 32.8% kurse në vitet 1958-1960 zbriti në 7%. Eshtë krejt e kuartë se ky ndryshim i madh në drejtim të uljes së mortalitetit u arrit në sajë të kujdesit të vazhduar të pushtetit populor si në drejtim kurativ ashtu edhe në atë higjeno-sanitar.

Disertanti e ka studjuar problemin në dy aspekte: Dinamizmi biologjik (organizem-mikrob) dhe dinamizmi shoqëror. Aspektet trajtohen sipas etapave nëpër të cilat kalon

fenomeni tuberkular, kjo sikurse përmendëm, për një periudhë 10 vjeçare në një vend të caktuar në Shkodër. Pra, si duket, problemi mer një karakter lokal, megjithatë kjo nuk do të thotë se nuk ka rendësi të përgjithshme. Ai fare mirë mund të meret si pikërisje për studimin e këtij problemi në trethet e tjera ose në të gjithë Republikën.

Në disertacion bie në sy zhvillimi i tuberkulozit në dy fazë: rënje dhe përsëri ngritje të kurbes së infeksionit. Pra, në periudhën dhjetëvjeçarë që studohet, sëmundja bën një terheqje të theksuar në krahasim me gjendjen alarmante në të cilën ndodhet më pare ky infektion. Kurse në fazën e dytë infeksioni përsëritet. Këtë fenomen që duket si paradoksal autorë i spjegon drejt e në mënyrë bindëse. Nga argumentat që ai sjell janë: Perfundimi i vështërësive të kohës së rindërtimit dhe rritja e lufteve antituberkulare, aplikimi i antibakterialeve dhe rritja e vazhduar e nivelit ekonomik dhe

kulturalo-sanitar të popullsisë. Disertanti, sëqaron me fakte se për 1960 përsëri tuberkulozi fillon të bjerë progresivisht. Këtë disertanti i argumenton si nga ana teorike ashtu edhe ajo praktike. Megjithatë, autori si një specialist i mirë i rrugëve të frysëmarrjes, tërheq vëmëndjen në faktin se me gjithë rezultatet e arritura vigjilencia e organeve të shëndetsisë nuk duhet të bjerë në gjumë.

Materiali i përpunuar për disertacion përbëhet nga 227.567 depistime 29.351 vizita patronazhi, 53.250 reaksione tuberkulinike dhe 27.324 vaksina B.C.G. në 18.752 të sëmurë të shtruar në dispanseri dhe në sanatoriumin e Shkodrës.

Oponentet zyrtare dhe diskutantet vunë në dukje vlerën pozitive të disertacionit, prandaj këshillë shkencor hodhi në votë kërkeshën e Dh.Litos, nga numurimi i votave u vertetua se ai e fitonte gradën e kërkuar pasi të aprovohej edhe nga komisjonii i lartë i atestimit.

SESIONI SHKENCOR I STUDENTAVE

Sesioni mjekos i shoqatës shkencore të studentëve organizoi, si pas traditës, sesionin shkencor të zakonshëm gjatë muajit mars.

Sesioni vazhdoi punimet dy ditë dhe degjoi 10 referate më karakter klinik dhe eksperimental që përfaqësojnë punimet më të mira të studentave pjestare të tretheve të ndrysh meshkencore. Në sesionin, veç studentave e njift mjekëve ndodheshin zëvëndës rektori i Universitetit dhe dekanë i fakultetit.

Eksperiencia e gjertanishme ka treguar se këto sesione i kanë dhënë një impuls punimeve të pavarura të studentave. Këto punime, jo vetëm që ndihmojnë për sqarimin e disa

problemeve klinike dhe eksperimentale por studentat fitojnë nëpërmjet këtyre punimeve, shprehët e një punë të mëtejshme të pavarur.

Referatet më të mira u nderuan nga zhuria me cmime. Nga referatet që u emuan si më të mira mund të përmendim atë të A. Kondilit «Veprimitaria e ujit mineral të Mamurasit mbi sensibilizimin», i Adrian Osmanllit e bashkëpunëtorëve më temen «Të dhënat e grupeve të gjakut të hipertoni, diabet melitik, leukoza dhe veset reumatizmale të zemrës», «Radikulitet lumbosakrale» të Ram Metoshit etj.

A.RAPO